

UNIVERSITETI I SHKODRËS
“Luigj Gurakuqi”

BULETIN SHKENCOR

Seria e shkencave shoqërore

Viti LXX i botimit

Nr. 70

Shkodër, 2020

REDAKSIA

Kryeredaktor - Prof. dr. Artan HAXHI
Sekretar shkencor - Prof. as. dr. Nevila DIBRA
Anëtarë - Prof. dr. Mimoza PRIKU,
prof. dr. Tomor OSMANI, prof. dr. Alfred ÇAPALIKU,
prof. as. dr. Alma HAFIZI

DREJTOR I REVISTËS
Prof. dr. Adem BEKTESHI

Korrektori dhe punoi në kompjuter: Arta Bajrami

Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Adresa e redaksisë: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Redaksia e Buletinit Shkencor
Seria e Shkencave Shoqërore
Tel/fax: ++399 22 43747

PASQYRA E LËNDËS

- *Gjuhësi*

Xhevat LLOSHI

Fjalori i Teodor Kavaliotit (1770)

T. Kavalliotis' Dictionary.....7

Emil LAFE

Prof. Ferdinand Leka 90!

Prof. Ferdinand Leka in his 90-th anniversary.....25

Begzad BALIU

Nelson Çabej dhe vendi i tij në historinë e albanologjisë

Nelson Çabej and his place in the history of albanology.....31

Artan HAXHI & Tefë TOPALLI

Terminologjia si sistem

(Fjalor i termave të gjuhësisë)

The Terminology as a system

(Dictionary of linguistic terms)..... 45

Evalda PACI

Rreth një tradite studimore mbi inicimin e lëvrimin të shkrimit shqip dhe reflektime të mundshme të zhvillimeve evropiane (shekujt XVI-XVII)

About a study tradition regarding the initiation of the cultivation of Albanian writing and possible reflections of European developments

(XVI-XVII centuries).....59

Kujtim BEVAPI

Lef Nosi si albanolog

Lef Nosi is an albanologist.....75

Karmen LAZRI & Zamira SHKRELI

Përdorimi kontekstual i disa proverbave e maximave latine në prozën e shkrimtarit Anton Harapi

(Në krijime letrare dhe oratori).

Contextual use of some proverbs of Latin maxims in the prose of writer Anton Harapi (In literary creations and

oratory).....79

Orjeta BAJA

Figurat e stilit

(Fjalor terminologjik shpjegues)

Figures of Speech

(Explanatory Terminological Dictionary).....95

• **Letërsi**

Alfred ÇAPALIKU

Rrugët paralele ... Dëshmi fotografike (23 – 36)

Parallel Roads... Photographic Attestations.....107

Ermira ALIJA

Mbi përgatitjen e botimit të rimarit të Ndre Mjedës, të punuar nga prof. Kolë Ashta

The preparation of the publication of Ndre Mjeda's rhyme book, made

by prof. Kolë Ashta.....115

Ilda ERKOÇI

Qyteti si tekst, teksti si qytet: Shkodra letrare

The city as text, the text as city: literary Shkodra.....125

- *Gjeografi*

Sokol AXHEMI

Qasja urgjente drejt ndërmarrjes së politikave kombëtare migratore. Ide dhe argumente

Urgent approach to undertaking national migration policies. Ideas and arguments139

KRITIKË E BIBLIOGRAFI

RECENSION

Mimoza PRIKU: Dy fjalë mbi përmbledhjen me studime “*Gjurmime filologjike mbi latinitetin dhe shkrimet e vjetra shqipe*” të prof. as. dr. Evalda Pacit, kërkuese shkencore mbi letërsinë e vjetër shqipe në Akademinë e Studimeve Albanologjike, Tiranë.

A few words on the summary of the studies on "*Philological research on Latinism and old Albanian writings*" by prof. as. dr. Evalda Paci, Scientific researcher on ancient Albanian literature at Albanian Studies Academy, Tirana.....151

Nekrologji:

David Luka
(1935 – 2020).....155

I. Botime

Publishing.....157

XHEVAT LLOSHI

**FJALORI I TEODOR KAVALIOTIT
(1770)**

Si autori i një fjalori të hershëm shumëgjuhësh, në të cilin është përfshirë edhe gjuha shqipe, Teodor Kavalioti ka zënë një vend të qëndrueshëm në historikun e shkrimeve shqipe. Vepra e tij është në të vërtetë i dyti fjalor i botuar, që përmban një leksik të shqipes, pas *Fjalorit latinisht-shqip* të Frang Bardhit (1635). Autorët që kanë shkruar për të kanë shprehur pikëpamje të ndryshme për vendlindjen e tij, ndërsa mbizotërojnë mendimet se ishte nga familjet e ardhura prej kohësh nga Kavalla e Greqisë ose nga Kavaja. Meqë ai jetoi, punoi dhe vdiq në Voskopojë, nuk e kanë shtruar pyetjen drejtpërdrejt nëse ishte shqiptar apo jo si kombësi, domethënë me fjalë të tjera, cili ishte identiteti i tij etnik. Duke pranuar se tipari mbizotërues për identitetin është gjuha amtare, kjo do të jetë pikënisja për të shtjelluar diskutimin e mëtejshëm.

Artikullin për T. Kavaliotin, botuar frëngjisht më 1966, A. Uçi¹ e ka titulluar “Një përfaqësues shqiptar i iluminizmit”. Pa ngurrim ai e quan Teodorin shqiptar me të atin shqiptar dhe të ëmën vllahë, por në mënyrë të çuditshme pohon se “njihte si gjuhë amtare shqipen, vllahishten dhe greqishten.” Me logjikën më të thjeshtë gjuha e tij amtare ka qenë arumanishtja, ndërsa analiza e fjalësisë së tij dëshmon se shqipen e kishte gjuhë të dytë. Edhe emri e mbiemri i tij, edhe atësia e tij nuk do të kenë qenë shqiptare, nëse shohim emrin e të atit *Anastasiu*, të gjitha nuk na dalin ndonjëherë sipas shqipes. Asnjëherë nuk kishte ndjekur ndonjë shkollë shqipe, madje as arumune, por vetëm greke dhe vetë ka dhënë mësim greqisht e ka shkruar vetëm greqisht. Nga ana tjetër, autorët tanë pa të drejtë i shmangin faktet e rëndësishme për profilin e Teodorit, duke mos vënë në dukje se ai *u vesh prift, u bë protopapë, jepte mësim në një shkollë teologjike e tregtare dhe vetë jepte mësim teologji greqisht*. Nxënësit e tij më pas janë bërë priftërinj dhe ieromonakë. Edhe shtypshkronja ishte ngritur pranë kishës së Gjon Teologut, domethënë nga të gjitha pikëpamjet ai ishte brenda ngrehinës ortodokse greke dhe nuk e kuptoj se si mund të flitet për filozofinë e tij, duke e përjashtuar këtë anë.

Kavalioti është shprehur prerazi, se duhen pranuar vetëm filozofët, që nuk janë në kundërshtim me Kishën universale; ai kërkonte që të drejtoheshim drejt së vërtetës në kuptimin e besimit të krishterë dhe të tjerët të urreheshin si mashtrues e të luftoheshin me gjithë forcat si sharlatanë.

Filozofia për atë ishte dashuri për perëndinë.

Jup Kastrati në “Historinë e albanologjisë”² i ka kushtuar T. Kavaliotit 28 faqe. E quan “mendimtarin më të shquar shqiptar të shekullit XVIII.” dhe “një prej figurave më të shquara të kulturës kombëtare shqiptare të së kaluarës.” Ky autor ka parafrazuar një punim diplome, të cilin e ka udhëhequr vetë, mirëpo edhe studentja është nisur jo prej origjinalit, që ka si gjuhë kryesore greqishten, por nga ribotimi i J. Thunmann-it (1774), i cili e kishte kthyer latinisht dhe kështu të metave të ribotimit prej J. Thunmann-it u janë bashkuar të metat e diplomantes dhe nuk mund të mbështetemi te ky parashtrim, i cili përndryshe do të ishte trajtesa më e gjerë gjuhësore e studiuesve shqiptarë për fjalësin e Kavaliotit. Për ta argumentuar këtë po sjell vetëm ndonjë shembull. Nuk janë te Kavalioti turqizma të shqipes: *balsam, dirsë, fërtere, gudulis, gulçim, gurmaz, gjind, haliç, hobe, honi, kallamar, kamillaf, kanistër, kofin, mëndafsh, mistri, mustaqe*. Kurse *gëdat, jyzhi* në origjinal janë *këndat* dhe *juzi*. Gjithashtu ka gabime për huazimet e tjera të shqipes, domethënë *kordhëzë* e quan edhe greke, edhe latine e kështu më tej. Në kundërshtim me nocionet e gjuhësisë quhen fjalë përmbledhëse: *dynja, fis, katund, millet*, madje *dynja* quhet edhe emër abstrakt, ndër të cilët për çudi përfshihen edhe: *brymë, bubullimë, drita, heqimi* etj., kështu që gjendja zbret deri te përcaktimi si emra mashkullorë për: *çadër, gënjeshtër, hasër, hudhër* dhe anasjelltas, *ujë, fëmijë, vath* qenkan emra femërorë dhe *i pakë* mbiemër i formës. Turqizmi *haps* për burgun quhet emër prejfoljor (nga *hap* e shqipes); trajtohen si me prapashtesën –ar fjalët *margaritar, sqepar*, për të mbërritur te folja *kuaj* (koj, mëkoj) që thuhet se vjen nga shumësi i emrit *kuaj-t*. Nuk po ndalem te përsëritja e të gjitha gabimeve të autorëve të mëparshëm.

T. Kavalioti nuk është autor shqiptar nga asnjë pikëpamje dhe në asnjë kuptim. Prej tij nuk kemi asnjë fjalë të vetme të shkruar shqip. Pjesën shqipe të fjalësit të vet e ka dhënë si përkthim për t’u mundësuar nxënësve shqiptarë të kuptonin tekstet greqisht, gjë që nënkupton, së pari, se në klasat e shkollës së Voskopojës kishte aq shumë nxënës shqiptarë, sa që nuk mund të shpërfillej prania e tyre dhe po kjo ka qenë arsyeja për librin e vogël të Dh. Voskopojarit më 1802. Së dyti, kjo nënkupton që këta nxënës dhe përdorues të tjerë shqiptarë, ashtu si edhe vllhtë, nuk e dinin mirë greqishten dhe Kavalioti e përfshinte gjuhën amtare të tyre nga nevoja për t’i kaluar në kulturën greke dhe *jo nga interesimi për vetë gjuhën e tyre amtare*. Shqipja ishte një mjet ndihmës për greqishten dhe jo sepse kishte ndonjë interesim Kavalioti për shqipen. Madje A. Hetzer-i mendon se fjalësi i tij shërbente “që nxënësit e mësimorese së Voskopojës të

drejtoheshin për të komunikuar gojarisht në gjuhën greke.”³, sepse ky fjalës nga ana tematike ishte i padobishëm për leximin e teksteve teologjike-didaktike, madje përmban edhe nga ato që i quajmë fjalë të ndyra. Gjithsesi edhe pohimet e A. Hetzer-it janë me kundërshti të brendshme, kur vijon se është një greqishte bizantine, që nuk shërben për jetën e përditshme. Tek ai ka jo pak fjalë në trajtat e greqishtes së folur. Nuk mund t’i shmangemi pohimit me shkrim në kopertinën e librit, se pati nxitjen e tregtarit nga Voskopoja, Jorgji Trikupës, të mbiquajtur Kosminski, që ta botonte “për të mirën e grekëve.”

Nga ana tjetër, A. Uçi⁴ e pranon, se “Tekstet e tij janë shkruar në një greqishte relativisht arkaike të shek. XVIII, por edhe me ngarkesa gjuhësore të greqishtes antike, bizantine e neobizantine kishtarë.” (f. 10) Lind pyetja: nga do të gjendeshin këta shqiptarë, aq më tepër nxënës, që të zotëronin një greqishte të tillë, pa e thelluar më tej këtë pikë, se me një gjuhë të tillë të vështirë trajtoheshin edhe çështje të filozofisë e të logjikës gjithashtu në vetvete tejet të vështira. Më duket se faktikisht dorëshkrimet e tij kanë qenë kompilime për përdorimin e tij vetjak, jo për t’i botuar, jo për t’ua dhënë nxënësve si libra mësimorë, por për t’i pasur si mbështetje sa kohë që jepte mësim. Më pas, kur e la atë punë, nuk pa ndonjë nevojë ose kërkesë për t’i shtypur. Kështu do të shpjegohej pse na kanë ardhur vetëm si dorëshkrime aq të rralla.

Së treti, Kavalioti nuk njihte ndonjë traditë të shkruar të shqipes. Nevojishtë i duhej të zgjidhte çështjen e alfabetit. T. Osmani⁵ e quan se fjalësi i tij ka interes për “historinë e shkrimit të shqipes me shkronja greke. Këtu gjejmë për të parën herë të shkruar gjerësisht shqipen me alfabetin grek.” E vërteta është se Kavalioti përpunoi një alfabet të arumanishtes mbi bazën e shkronjave greke dhe këtë e përdori pa ndryshime edhe për shqipen.⁶ Askush nuk e ka përdorur alfabetin e tij më pas, madje as edhe Kostë Berati, i cili ka kopjuar një pjesë të fjalësit të tij.

Mendimi im i përgjithshëm është se T. Kavalioti ka zënë një vend të gjerë që nuk i takon në shkrimet për shqipen dhe prandaj kontributi i tij duhet ridimensionuar. Studiuesi rumun P. Papahagi më 1909 ka hedhur në qarkullim një hamendësim të pambështetur,⁷ se Kavalioti kishte bërë një përkthim të Dhiatës së re shqip. Me të drejtë G. Petrota⁸ e mënjanon këtë, duke e quajtur një ngatërrim me përkthimin e Dhaskal Todrit, ndërsa do të shtoja që ndoshta është marrë gabimisht puna e Grigor Voskopojarit. Është pikërisht Grigori, nga i cili i kemi disa faqe të përkthyer. Ai ka dhënë afër 30 vjet mësim në Voskopoje dhe u zgjodh dhespot i Durrësit më 1748. Me sa duket, kishte nisur të jepte mësim që më 1718 dhe prandaj Kostë Berati e të tjerë janë ndikuar prej tij, domethënë ky është zanafilla e interesimit për

shqipen në hullinë e Voskopojës dhe jo T. Kavalioti. Sa për Dhiatën e re, ndonëse ka bërë prova me interes për disa pjesë, Grigori gjithashtu nuk i kishte as njohuritë dhe as përgatitjen për ta kthyer gjithë librin shqip, pavarësisht se Dh. Shuteriqi, duke u mbështetur te G. Zavirasi (1872), me dashamirësi shprehet se kishte përkthyer edhe Dhiatën e vjetër. Dëshiroj ta vë në dukje qartazi se as këta, as Anonimi i Elbasanit, as Dhaskal Todri e ndonjë tjetër nuk i kishin këllqet për të përkthyer të plotë Biblën dhe është e kotë të dëgjohen ankime për humbjen e dorëshkrimeve të tyre. Kanë ekzistuar dorëshkrime për pjesë të përshtatshme që vlenin për shërbesat në kishë, një traditë e cila vjen qysh nga Gj. Buzuku.

Të më lejohet ta përsëris, se jo vetëm nuk ka ekzistuar ndonjë përkthim i Dhiatës së re, por edhe se T. Kavalioti nuk ishte në gjendje të kryente një përkthim të tillë. A. Hetzeri, i cili ka bërë ribotimin e fjalorthit më 1981, e thotë prerazi, se: “Mund të quhet e vërtetuar, që Kavalioti, i parë nga ana gjuhësore, nuk ka qenë shqiptar”, ndërsa njohja e tij e shqipes nuk ishte mjaft e gjerë. Kjo tingëllon në kundërshtim me pohimin e J. Kastratit, se: “Kavalioti zotëronte në mënyrë të përsosur shqipen, vllahishten dhe greqishten e re.” Fjalësi i tij për greqishten ka 1170 njësi dhe një çikë më pak për shqipen (1100), ndërsa Dhiata e re ka një fjalës prej 4800 njësisish, domethënë jemi mjaft larg për të pasur pretendime. Mes leksemave të tija vetëm nja 20 janë për fenë e për kishën, ndërsa një të tretën e zënë sendet shtëpiake, bimët e kafshët, trupi etj., domethënë janë të sferës së diturisë së natyrës si lëndë shkollore dhe të mjeshtërive e të tregtisë.

Për shkak të zbrazëtisë që paraqet shek. XVIII, ngaqë ishte periudha e osmanizimit më të thellë të jetës kulturore shqiptare, studiuesit janë orvatur ta mbushin zbrazëtirën me letërsinë orientale (bejtexhinjtë) dhe me T. Kavaliotin. Ndërsa pa ndonjë ngurrim E. Çabeji më 1936 e quan se: “Me Teodor Kavaliotin fillon perioda e shkurtër e kulturës aromune në Shqipëri.”⁹ dhe i kushton vetëm katër radhë. N. Resuli pesë vjet më pas te libri me titullin pikërisht “Shkrimtarët shqiptarë”¹⁰ i kushton katër faqe, ndonëse për të qenë i drejtë me të, do të vija në dukje, se e ka shprehur qartë, që fjalësi i tij “nga pikëpamja thjeshtësisht gjuhësore . . . vlerë të madhe nuk ka.” Ndërsa një tekst shkollor i vitit 1952 vetëm sa e përmendte,¹¹ një të tretë faqeje i ka dhënë Dh. Shuteriqi në tekstin tjetër¹² për shkollat e mesme më 1958 dhe një vit më vonë K. Frashëri në vëllimin e parë të “Historisë së Shqipërisë” i ka ndarë katër faqe Akademisë së Voskopojës, duke e cilësuar T. Kavaliotin “mendimtar të shquar”, i cili paska qenë “udhëheqës i lëvizjes kulturele jo vetëm të Voskopojës, por edhe të krahinave të tjera të Shqipërisë së mesme e të jugut.”¹³ Nuk e di se

ku është mbështetur një rol i tillë, që me një modernizim të sotëm quhet lider.

Duke ardhur më afër në ditët tona, *Historia e letërsisë shqiptare* jep një shifër të pabesueshme prej 50 mijë banorësh dhe shprehet, që: “Lëvizja letrare e Voskopojës ishte pjesë përbërëse e lëvizjes së gjerë që zhvillohej në Ballkan nën ndikimin e iluminizmit perëndimor, po në hegjemoninë e kulturës greke.”¹⁴ Veprës së Kavaliotit i jepet pak vend dhe zbrazëtia mbushet me ekskursione të panevojshme në pikëpamjet filozofike, ashtu siç është bërë edhe në raste të tjera e në veçanti edhe në ribotimin e *Fjalorit enciklopedik shqiptar* më 2008 (vëllimi II, f. 1145-1147). Së fundi, fare pak vend i jep edhe R. Elsie në librin e tij,¹⁵ por jo pa anësi citon gjerësisht J. Thunmanin aty ku ky Voskopojën e vendos në Maqedoni dhe pa të drejtë e quan, se i fliste si gjuhë amtare greqishten, arumanishten dhe shqipen.

Rrjedhimisht, hiperbolizimi i figurës dhe i veprës së tij pas K. Frashërit dhe J. Kastratit, i mbetet A. Uçit, i cili në këtë hulli ecën së bashku me disa lëvrues të historisë së arsimit dhe të mendimit pedagogjik shqiptar, për të cilët T. Kavalioti madje qenka deklaruar “kundër dijetarëve grekë, të cilët pohonin se shqipja nuk mund të shkruhet” dhe “që i pari që hapi udhën për shqiptarizimin e didaktikës së tij, për të futur elementin shqiptar, elementin e gjuhës shqipe në shkollën dhe në tekstet e tij.”¹⁶ Në librat e tyre të vëllimshëm këta lëvrues i gjejnë rrënjët e këtij mendimi në një largësi që nuk e rrok historia.

T. Kavalioti nuk e dinte mirë shqipen. Po rendis disa fjalë nga fjalësi i tij për ta argumentuar këtë.

αββαζ *igumen* – përkthimin shqip e ka të njëjtë me të arumanishtes, por fjala greke përdoret vetëm për igumenin katolik, përndryshe shqip njihet si *abat*.

αγκωναζ *bëllyl* – trajtë e gabuar për *bërryl*, që mund ta jepte vetëm dikush, i cili nuk e ka shqipen gjuhë amtare.

αγωναζ *çallëstisjë* - përkthim i gabuar; shqip do të duhej *ndeshje*.

αγορα *të blem* – përkthim i gabuar për *treg, pazar*. Është përpjekur të bëjë një dallim ndërmjet *të blem* dhe *të blerë* (për blerje), që nuk e njeh shqipja

αδεια *gje* – trajtë e panjohur në shqipen për *leje*, ndoshta gabim shtypi.

αετος *fajkua* – përkthim i gabuar për *shqiponjë*, madje pikërisht këtë fjalë e kishte aty për arumanishten.

αωναζ *jetë* – përkthim i gabuar për *shekull*, nën ndikimin e arumanishtes, sepse që te Gj. Buzuku lat. *seculum* del me kuptimin e një periudhe të gjatë jete, moshe dhe me këtë kuptim *jetë* është përdorur për *shekull*, si arumanisht *etë*.

αμαρτια *faj* – përkthim i gabuar, duhej *mëkat, gjynah*.

αναγκη *nevojë* – gabim për *nevojë*.

απλος *myti* – përkthim i pasaktë; fjala greke do të thotë i thjeshtë, naiv, kurse fjala turke do të thotë i bindur, i nënshtruar; A. Hetzeri e ka vënë *i thjeshtë* si do të ishte shqip, por nuk mund të jetë sinonime për fjalën turke.

αρκετος *i sadoshim* – sajim i Kavaliotit për *i mjaftueshëm*.

αρμα *kuralie* – nuk ka fjalë të tillë në shqipen; edhe E. Çabej e ka quajtur se nuk ndeshet gjëkund. Mund të jetë nga tq. *kurali* me kuptimin e armës së ushtarit të kurasë, rekrutit.

αρνουμαι *arnis* – nuk kishte fjalë të tillë shipe për *mohoj*; është marrë thjesht fjala e arum. *arnisesku* për shkak të dygjuhësisë.

ασταχος *stahus* – nuk njihet një trajtë e tillë për shqipen (a)*stako*.

βαθος *fund* – përkthim i gabuar për *thellësi* nën ndikimin e arumanishtes *fundu*, e cila i ka dalë njësoj edhe për *πατος*.

βαρβαρος *shalavrik* – përkthim i gabuar për *barbar, i egër*; fjala shqipe ka kuptimin e atij që ecën hapashalthi dhe prandaj te K. Kristoforidhi del edhe për torollak.

βαρος *rëndjë* – trajtë e gabuar për *rëndesë, peshë*.

βεβαιος *i kavishim* – përkthim i gabuar për *i sigurt* me një turqizëm *kavi*, që do të thotë *i fuqishëm*.

βια *pahirjë* – sajim i Kavaliotit për *dhunë*, nga *pahir(i)* për të pasur emër si në arumanishten.

βλασφημος *nëmës* - përkthim i gabuar për *blasfemues*.

βρακι *brekë* – përkthim i gabuar nën ndikimin e greqishtes; shqip duhej *pantallona, brekushe*.

βραχνιαζω *lakësoj* – fjalë e panjohur në shqipen për *ngjirem*.

βρεχω *lagësoj* – sajim i Kavaliotit sipas greqishtes; nuk kishte fjalë të tillë shqipe.

γενεα dhe φυσις i ka përkthyer njëlloj me *soj*, ndërsa për arumanishten ka dhënë dy përkthime, që i dallojnë fjalët e greqishtes, domethënë në shqipen nuk e gjente këtë dallim.

γνωμι *mend* – përkthim i gabuar për *mendim* edhe nën ndikimin e arumanishtes *minde*.

γογγυζω *picëlloj* – përkthim i gabuar për *rënkoj; mërmërit*; trajta *picëlloj* lidhet me *piskëlloj* – nxjerr një piskamë të mbytur nga dhimbja, khs. sllav. *piska*.

γυρος *qerthëllim* - përkthim i pasaktë për *rreth, jo rrethim*.

δαμαλη e *re lopë* – për *mështjerrë*, fjalë që ai nuk e njihnte dhe prandaj e ka përkthyer përpikërisht togun arumun *nao vakë*, duke i dalë diçka e papranueshme për gjuhën shqipe.

δεχομαι *ikëratoj* – fjalë e panjohur për shqipen për *pranoj, qas*; ndoshta nga tq. *ikram* e *qas*, e nderoj.

δημιος *çartës* – nuk kishte fjalë të tillë të shqipes, e ka sajuar për *xhelat* (ai që të çart).

διπλος *i mtÿshim* – nuk kishte fjalë të tillë të shqipes, sajim i Kavaliotit për *i dyfishtë*, njëfarë *i mëdÿshëm.

δοκιμη *vizgim* – përkthim i gabuar për përjetim, përvojë.

ελεφας *fil* – e ka dhënë sipas arumanishtes me huazimin turk, domethënë nuk e dinte *elefant* të shqipes.

επιτηθειος *i mirudishim* – përkthim i parregullt për *i shkathët, i aftë* por edhe *i përshtatshëm, që shkon, që ujdÿs*; ka mundësi që Kavalioti për këtë dhe fjalë të tjera të jetë këshilluar me një elbasanas, i cili e ka sajuar këtë fjalë me kuptimin: që shkon mirë, që ujdÿs mirë, *i mirujdisshëm.

ερευγομαι *hërças* – përkthim i gabuar për *vjell*; fjala e dhënë del vetëm në rrethanat e dygjuhësisë, khs. serb. *hrčem*, bullg. *hërkam* – gërhas. A. Hetzer-i e ka dhënë gabim sinonimin *gromësj*.

ημερος *i zbutshim* – e ka dhënë gabim për *i zbutur*.

θαπτω *gropoj* – nuk kishte në shqipen një fjalë të tillë për *varros*; e ka sajuar sipas arum. *gropu*.

θαρρος *shpëresë* – përkthim i pasaktë për *mirëbesim*.

θυμος *hidhënim* – përkthim i gabuar për *zemërim*.

καβαδι *kapama* – turqizëm që nuk e ka shqipja, nën ndikimin e arum. *këpllëmë*.

κακος *i keqi* - është interpretuar gabim si *këeq* nga N. Jokli dhe dijetarët pas tij deri te A. Hetzeri, sepse kanë parë këtu një pjesë të parë *kë-*; në të vërtetë është thjesht një rast i vështirësisë së shkrimit të shqipes me alfabet të huaj. Po të shkruhej *κεκι* do të lexohej [qeqi], prandaj është shtuar një ‘ë’ dhe *këeq* lexohet drejt *keq*.

καμπουρης *i garmunjun* – trajtë e parregullt, duke shndërruar toskërishten *i gërmunjur* në një gegërishte të paqenë.

κανατα *lagjin* – përkthim i gabuar për *katruve, brokë*.

κανισκι *të faliëtë* - nuk e ka kapur drejt trajtën e shqipes, sepse kjo që ka dhënë është për emrin e veprimit (falje) dhe jo për dhuratën.

καπιλας *bakall* – përkthim i gabuar sipas arumanishtes; shqip do të ishte *mejhanexhi, tavernës*.

καρτερω *daloj* – përkthim i gabuar për *pres*.

καστρον *kale* - trajtë e gabuar për *kala*; me sa duket, turqizëm në sereb. dhe maq. *kale*.

κατσαρος *qimeshes* – nuk kishte fjalë të tillë shqipe; duhej *kaçurrel, qimepërdredhur*; ndoshta i kanë propozuar një *qimelesh, në kuptimin e

dikujt që i ka flokët të dredhur si lesh.

κεδρος *vgjenjë* – përkthim i gabuar për *cedër*.

κειτομαι *gjeç* – trajtë e panjohur si folje në shqipen për *gjendem, ndodhem*; ka mundësi ta ketë ngatërruar Kavalioti me *u gjendç*; përndryshe është nën ndikimin e arumanishtes.

κερκελι *reze* – fjalë e panjohur për greqishten, me sa duket e dygjuhësisë me arumanishten *kërteliu*.

κυλιω *llëkërej* – trajtë me metatezë për *rrëkëllej*; Kavalioti si arumun nuk e ka njohur trajtën e rregullt.

κινδυνος *qindhin* – nuk ka pasur një greqizëm të tillë në shqipen për *rrezik*.

κοινον *i gjithagjinshim* – sajim i Kavaliotit për *i përbashkët*.

κολακας *lajkëtuar* – gabim për *dinak*; edhe kjo duket sajim i tij, sepse K. Kristoforidhi e ka *lajkatar*.

κοντα *afër* dhe συμμα *afër* - të dyja i ka përkthyer me të njëjtën fjalë edhe për arumanishten, pa qenë në gjendje të shihte dallimin, ndërkohë që fjala e dytë do të thotë *bashkë me* dhe nuk përdoret kështu e shkëputur në greqishten.

κορυφη *qikëlë* – fjalë që nuk e njeh shqipja; nga arumanishtja *ciklëu*.

κουκουλι *kukumale* – përkthim i gabuar për *kukule, fshikëz mëndafshi*.

κουμπουρι *këllëf* – përkthim i gabuar; me sa duket është ngatërruar nga togu *këllëf i kobures*.

κουρδουβανι *kurdhuvan* – nuk ka fjalë të tillë shqipe për lëkurën nga Kordova.

κρουω dhe περωτω – është përpjekur të bëjë një dallim ndërmjet homonimeve *bie* (godas) dhe *bije* (rrëzohem), që nuk ndodh në shqipen.

κτηκιο *ohetik* - trajtë e njëjtë me arumanishten për *oftikë*.

κυβερνω *shërbëtoj* – nuk kishte fjalë të tillë të shqipes. Është sajim i Kavaliotit për *qeveris*.

λαβρακι *labrik* – trajtë e gabuar sipas arumanishtes; shqip është *levrek, lavrak*.

λαγκαδι *klirtë* – përkthim i gabuar, nuk kishte fjalë shqipe të tillë, si greqizëm, për *luginë; grykë*.

λακταρα *trishitië* – përkthim i gabuar, sepse në shqipen është greqizmi *llahtarë* me kuptim të ndryshuar, ndërsa në greqishten fjala ka edhe një ngjyrim për mallin përvëlues.

λειωος *i meetshim* – trajtë e gabuar për *i metë*, sipas disa mbiemrave të gegërishtes.

λεπρα *frëngjyzë* - është përkthim i gabuar, sepse kjo fjalë e shqipes është për sifilizin, sëmundjen e frëngjve, dhe jo për lebrën.

λυχνος *luqere* – italianizëm për llampën me vaj.

μαγος *majistrik* – trajtë e gabuar sipas arum. *mëjistru* për *magjistar*.

μαγουλον *mollë faqesë* – për *mollë e faqes*, domethënë *mollëz*, pa nyjën e përparme sipas arumanishtes së folur *merute faca*.

μακρος *gjatjë* – trajtë e gabuar për *gjatësi*.

μαντατον *myzhde* - përkthim i gabuar, sepse myzhdeja në shqipen është vetëm për lajmin e gëzuar dhe shpërblimin që i jepet atij, i cili sjell një lajm të tillë, ndërsa *mandata* është lajm i zi, i hidhur.

μαντηλι *rizë* - përkthim i gabuar, sepse në shqipen kjo fjalë është për peshqirin, jo për shaminë e dorës.

μαργιολος *liëkatar* – nuk ka fjalë të tillë të shqipes, ndërsa përkthimi i fjalës greke do të ishte *dinak*, *dhelparak*, që ai e ka si fjalë *lajkëtuar* për *κολακας*, por edhe kjo duket sajim i tij, sepse K. Kristoforidhi e ka *lajkatar*.

μαρουλι *lattugë* – italianizëm që nuk e ka shqipja, sipas arum. *laktuka*.

μαρτυρας *shahit* – përkthim i gabuar, e ka ngatërruar me *shehit*.

μερι *kopshë* - trajtë e gabuar për *kofshë*, nën ndikimin e arum. *koapsë*.

μετρον *matë* - trajtë e gabuar për *masë*; është e çuditshme që nuk është dhënë kuptimi *metër*.

μηνω *porosit* – përkthim i pasaktë për *njoftoj*, *dërgoj fjalë*.

μισω *hasmoj* – nuk kishte fjalë shqipe të tillë; e ka sajuar sipas arum. *ehthrevesesku*.

μοιρα *talih* - turqizëm për *fat*, të cilin edhe T. Dizdari e quan se nuk ka gjetur përdorim në shqipen.

μοιχος *kurvar* – përkthim i gabuar për *shkelës i kurorës* nën ndikimin e arum. *kurvaru*; e ka drejt për *πορνος* arum. po njësoj *kurvaru*.

μουγκριζω *bariroj* - nuk kishte fjalë të tillë shqipe; duhet të ketë qenë *buluroj*; prej tij e ka marrë edhe J. R. von Xylander-i.

νικη *mundië* – përkthim i pasaktë për *fitore*, *mposhtje*. Bën pjesë në një numër të madh emrash me prapashtesën *-jë*, me sa duket nën ndikimin e elbasanishtes ose të një elbasanasi, të cilit i është drejtuar për ndihmë, ashtu si edhe për mbiemrat me *-shëm*.

νοϊκι *qira shtëpisë* – për *qiraja e shtëpisë*, me të njëten mungesë të nyjës së përparme si te *molla faqes* sipas togfjalëshit të arumanishtes *αγωγε ακασελλη*.

νοτια *juzi* – turqizëm që nuk është përdorur në shqipen, nga *güz* vjeshtë, marrë për lagështirën e stinës së vjeshtës.

ξανθος *rus* – nuk kishte fjalë të tillë në shqipen për flokëverdhtë; Kavalioti e ka vënë sipas arumanishtes, huazim nga maq. *rus*.

ξεφαντωνω *tallem* – përkthim i gabuar për *argëtohem*, *bëj gosti*.

ξυω *gërruanj* – trajtë e parregullt për *gërryej*.

οργη *hidhënim* - përkthim i gabuar për *zemërim*, po ashtu si për θυμος. ορδινια *mestitjë* – italianizëm i arumanishtes, që nuk e ka greqishtja, ndërsa fjala për shqipen është, me sa duket, një sajim i Kavaliotit, duke u nisur nga folja e maq. *mesti* – vë në rregull, emri i veprimt *mestenje*, sepse italishtja ka *ordine, mettere in ordine*, që përputhet me fjalën arumune, të cilën Kavalioti e ka quajtur se e kishte edhe greqishtja; është shembull i qartë i arumanishtes si gjuhë amtare e Kavaliotit, i cili nuk shkëputej dot prej saj deri te sajimi i një kalkimi shqip, por mbi bazën e maqedonishtes, të cilën ndërkaq disa herë nuk e shquante mirë prej shqipes. W. Martin-Leak-u më 1814 e ka marrë këtë sajim dhe e ka shkruar *mësditjë* me kuptimin e urdhrit dhe të rregullit, e ka përkthyer *decree, command*, por ka shtuar edhe *order*, prandaj për shqipen ka dhënë edhe një përkthim të dytë: *nizam*, turqizëm që për ‘rregull’ dhe ‘ushtar i rregullt’ përputhet me kuptimet e foljes së anglishtes. Më pas fjalën e ka marrë më 1835 J. R. Von Xyländer-i nga Martin-Leake-u dhe e ka shkruar *mesditë* duke ia ndërruar kuptimin në ‘porosi’, njoftim’, sepse këtë e mundësojnë kuptimet e foljes *order* të anglishtes. Mirëpo kjo i ka dalë e njëjtë me *mesditë* dhe për ta shmangur homoniminë e papritur e ka shkruar këtë të fundit krejt gabim *mësedite*. Nga ana e tij J. G. von Hahn-i më 1854 ka parë këtu diçka jo të sigurt dhe ka vënë në kllapa (*mesditë, mestitkë*), ndërsa bashkë me përkthimin e Ksilandrit ‘Botschaft, Anordnung’, ka shtuar edhe ‘Verordnung’. Këtu trajta *mestitkë* ka shkuar tejet larg, prandaj me të drejtë G. Majeri më 1891 përfundimisht ka hequr dorë nga ky lëmsh dhe nuk ka përfshirë asnjëherë nga këto sajime, ndonëse herë të tjera ka raste kur i ka marrë në mënyrë jo kritike glosat e Kavaliotit.

ορθος *shtorasë* – nuk ka fjalë të tillë shqipe; ka mundësi të jetë përdorim në kushte dygjuhësie, khs. maq. *stojalishte* – vend qëndrimi më këmbë, drejt; bullg. *stojash*; e kanë marrë nga Kavalioti pa qëndrim kritik J. Xyländer-i, J. G. von Hahn-i, G. Meyer-i (nuk e ka gjetur etimologjinë) dhe ka trilluar *storasje* A. Leotti.

ορτικι *potpolloshkë* – fjalë e maqedonishtes për *shkurtëzën*; është e pakuptueshme se si Kavalioti nuk e njihete fjalën shqipe, kur edhe arumanisht e ka *shkurtiza* prej shqipes.

ορφανος *i varfër* – përkthim i gabuar sipas arumanishtes, ku *oarfanu* lidhet me lat. *orphanus* për *i varfër*, mirëpo në shqipen dhe në greqishten ka ndryshuar kuptimin për *jetim*; edhe fjalën greke πτωχος e ka përkthyer njësoj arum. *oarfanu* dhe shqip *i varfër*, këtë radhë drejt; një shembull tjetër i pakundërshtueshëm, se Kavalioti kishte gjuhë amtare arumanishten.

οχηντρα *nepërtkë* – trajtë e gabuar nën ndikimin e arumanishtes *nëpërtika*, trajtë të cilën e kanë shqyrtuar etimologët kryesorë të shqipes, pa

e diktuar që është thjesht gabim.

παγος dhe κρυσταλι i ka dhënë njësoj *akull*, sepse po ashtu i ka arumanisht, por fjala e dytë në shqipen është për kristalin; si gjuhë neolatine, te arumanishtja ka ndodhur kalimi prej akullit te kuptimi i gotave të qelqta, siç është shqipja *gastare*, por në shqipen kristali nuk ka lidhje me akullin.

παλαιβω *lottoj* – italianizëm që nuk e ka shqipja për *luftoj*, sepse del homonim me foljen *loto*.

πανηγυρι *panijir* – trajtë e gabuar për *panairin* sipas arum. *panijiru*

παστρα *spastr* – trajtë e gabuar për *pastërti*, e përfutur prej arumanishtes *spastrë*.

παστωνω *pastërmoj* – sajim i Kavaliotit sipas dy gjuhëve të tjera, nuk kishte një folje të tillë për *bëj pastërma*.

πηγουσι *pupëlëzë* - përkthim i gabuar për *mjekër*; me sa duket është ngatërruar me kuptimin e *pupëz*, *pupëlz* për xhufkën e qimeve të mjekrës.

πεινα *urrësi* – trajtë e gabuar për *uri*; arsyeja e zgjerimit është ndjekja e fjalës me prapashtesë të arumanishtes *foamita*, në vend që të ishte *foama.

πλεω *notoj* – përkthim i gabuar për *lundroj*; për të sajuar një dallim ka dhënë *mnotoj* për κολυμπω.

πνευμονας *shpirë* – përkthim i gabuar për *mushkëri*, ndërsa shpirra është një sëmundje mushkërish dhe prandaj vlen për φλεγμονι.

ποκαρι *ujkth* – përkthim i gabuar për *bashkë leshi*, gabim të cilin A. Hetzeri nuk e ka vënë re. Nuk ka asnjë lidhje me emrin shqip *ujk*; Kavalioti është nisur nga fjala greke ογκος me kuptimin e një mase leshi dhe nuk e ka rrokur, ashtu si për shkurtëzën, që fjala arumune *bashkë* është huazim prej shqipes, por të paktën e ka ndier se nuk ka lidhje me shqipen *ujk*, *ulk* dhe prandaj e ka dhënë me tjetër grafí ουϊκθ. Nuk e ka pranuar Martin-Liku, por e ka marrë Ksilandri, dhe e ka përkthyer gabim për lëkurë deleje, gabim të cilin e ka përsëritur J. G. von Hahn-i. Madje edhe G. Meyer-i e ka kujtuar për zvogëlim nga *ujk*, duke mos e vënë re që vetë Kavalioti e kishte dalluar në shkrim nga *ujk*.

ποτιζω *ujoj* – sajim i Kavaliotit për *ujis*, që nuk njihej në atë kohë, madje deri vonë në atë zonë është përdorur greqizmi *potis*.

πρεπει *ngjan* – përkthim i gabuar për *duhet*.

σαΐτα *shijë* – trajtë e rrëgjuar në shqiptimin gojor për *shtijë*, një dëshmi se mjaft fjalë Kavalioti i ka marrë nga shqiptimi gojor, të cilin nuk e ka perceptuar mirë, po ashtu si *shratth* për *shtrath*.

σαλιβαρι *fre* - duhet të jetë gabim për *χαλιναρι*.

σαλιον *ligë* – përkthim i gabuar për *pështymë*.

σισαμι *sisam* – trajtë e gabuar sipas greqishtes e arumanishtes për susamin.

σπουδη *spudhaksië* – greqizëm i sajuar nga Kavalioti, që nuk ndeshet në shqipen për *ngut*.

στερεος *i shtënguam* – trajtë e gabuar për *steré*; A. Hetzeri nuk e ka kuptuar dhe e ka quajtur se është për *i shtrënguar*; ata që ka pyetur Kavalioti kanë dashur t'i thonë tokë *e shtangët*, jo e lëkundshme si ujët e detit.

συχαινομαι *ndotem* – trajtë e gabuar për *më vjen ndot*, nën ndikimin e dy gjuhëve të tjera që e kanë folje.

σπαστρα *spastrë* - përkthim i gabuar si te *παστρα*, për pastërtinë, por këtë herë edhe për greqishten del një trajtë e panjohur, domethënë i ka rrafshuar të tria gjuhët sipas arumanishtes.

στιχ *stih* – greqizëm që nuk njihet përgjithësisht në shqipen për *varg*, por e ka dhënë nën ndikimin edhe të arumanishtes *stihu*.

συχος *i përherçim* – përkthim i gabuar për *i shpeshtë*, *i dendur*.

σφαλλω *fhenj* – trajtë e gabuar e pamundur në shqipen, e ka drejt *fëjej* te *φταινω*.

ταξιδι *taksith* – greqizëm për *udhëtim*, që shqipja përgjithësisht nuk e njeh.

ταπεινος *i mylaimçim* – turqizëm për *kokulur*, që nuk njihet përgjithësisht.

ταραζω *trazoj, shamatoj* – fjala e dytë si sinonime është vënë gabim.

τραχυλος *zverk* – përkthim i gabuar; e ka ngatërruar me *gusha, qafa*.

τρεμω *trishtoj* – përkthim i gabuar, shqip do të ishte *dridhem*.

τρεχω *shtrinj, rendonj* – përkthime të gabuara; *rendonj* është gabim për *rend*; *shtrinj* është për ndonjë nga kuptimet e kësaj fjale polisemike të greqishtes, e cila do të thotë edhe *rrjedh, vjen mbi diçka*.

τριζω *ckërtas* – trajtë e gabuar për *kërcas*, sipas arum. *skarciku*.

φακη *groshë, fierëzë* – fjala e parë është e gabuar.

φαρδος *zgjërim* – përkthim i pasaktë për *gjerësi*, nën ndikimin e arum. *lartzime*.

φυτον - *noshtrë* – përkthim i gabuar për *njomëz*.

φλαμπουρον *bajrak* – ndonëse e ka pasur praktikisht *flamur* në të dy gjuhët e tjera, shqip e ka dhënë me një turqizëm, po ashtu siç e kishte *gamile* në të dy gjuhët e tjera dhe për shqipen ka dhënë huazimin nga turqishtja *deve*, domethënë i kishte më të njohura fjalët e turqishtes sesa të shqipes.

φουσατον *sifer* – trajtë e gabuar për turqizmin *sefer* - ekspeditë ushtarake; përkthimi i drejtë do të ishte *ushtri*.

φταρμιζομαι *psherëtij* – përkthim i gabuar për *teshtij*.

φτενος *i hollë* – përkthim i gabuar për *i imët*; nën ndikimin e arumanishtes ka dhënë për së dyti të njëjtin përkthim edhe për λεπτος *supcure*, edhe për së treti për ψιλος, sepse të dy kuptimet i ka fjala e fundit e greqishtes.

χασκω *hutoj* – përkthim i gabuar; përkthimi shqip do të ishte *mbetem i hutuar, me gojë hapur*.

χνοτος *qerbësirë* – përkthim i gabuar për erën e qelbur të gojës.

χολη *tambë* – përkthim i gabuar për *vrer*, ndërsa A. Hetzer-i e ka ngatërruar me emrin e gegërishtes për qumështin. Këtu është fjala për tëmblin, tëmbthin si fshika e vrerit.

χρεια *lipsë* – sajim i Kavaliotit sipas arumanishtes për atë që lipset, nevojë, domosdo.

χρομα *fytyra* – përkthim i gabuar nën ndikimin e arumanishtes *boe*, një turqizëm (bojë) që edhe në shqipen përdoret për ngjyrën e fytyrës.

ψαχνον *i athëtë* – është krejt gabim; ndoshta e ka pasur për *i thatë* në kuptimin e mishit pa dhjamë, vetëm tul, siç është kuptimi i fjalës greke.

ψευδος *gënjeshhtë* – trajtë e gabuar për *gënjeshër*.

ψαλλω *psallonj* – trajtë e sajuar prej Kavaliotit për *psall*, meqë edhe në arumanishten kishte një prapashtesë zgjeruese; G. Majeri duhej të mos e pranonte si fjalë të shqipes.

ψηλαφιζω *zë* – përkthim i pasaktë për *prek* nën ndikimin e fjalës arumune, që e ka dhënë njësoj *akacu* edhe për *πιανω zë*.

ψυχρα *ftohjë* – trajtë e parregullt për shqipen; duhej të ishte *të ftohtë*; kjo i ka dalë te *κρυαδα* por pa nyjën.

Këta shembuj janë të mjaftueshëm, për të dëshmuar se Kavalioti nuk e zotëronte mirë shqipen. Për 68 fjalë të greqishtes ka dhënë 34 fjalë të arumanishtes dhe pikërisht po aq edhe për shqipen, që do të thotë se **nuk është nisur nga greqishtja për të dalë te shqipja, por nga arumanishtja**, duke mos njohur zgjidhje të tjera për shqipen. Në 44 raste për dy fjalë të greqishtes ka dhënë një fjalë të vetme të shqipes, të dhëna këto që vërtetojnë se njohjen e leksikut të shqipes e ka pasur më të varfër.

Ndeshen gjithsej 114 turqizma te fjalësi i tij, domethënë një e dhjeta e numrit të përgjithshëm. Përpara tij fjalori i F. Maria da Lecce-s (1702) kishte 430 turqizma dhe 27 prej tyre i ka edhe Kavalioti. Gjithashtu 45 turqizma janë të njëjtë me ata të arumanishtes. Ndërkaq, këtij i mungojnë edhe fjalë krejt të zakonshme, prej të cilave do të përmendja *bahçe, bakër, bereqet, çakmak, çorape, çelik, çizme, çoban, fishek, hambar, hesap, penxhere* e shumë e shumë të tjera, kështu që jemi përpara një varfërie leksikore. Nuk është vënë re deri më sot, se në fjalësin e tij ka edhe gjurmë

të maqedonishtes, diçka e kuptueshme për dygjuhësinë edhe me bullgaro-maqedonët, e cila e ka detyruar më pas edhe Dh. Voskopojarin që të përfshinte një gjuhë të katërt, bullgarishten, ndonëse ai e vetë nuk e njihte dhe prandaj porositi dikë tjetër. E vlen të përmendet se Voskopoja bënte pjesë në sanxhakun e Manastirit. Ndërsa disa italianizma janë marrë prej arumanishtes dhe nuk kanë qenë fjalë të shqipes.

T. Kavalioti nuk ka qenë iluminist. A. Uçi (f. 84-85) sajoi njëfarë “iluminizmi para iluminizmit”, diçka që nuk e njeh dituria botërore, ndërsa me përdhunë “racionalizmin karteziqian” të Kavaliotit e quan iluminizëm. Pas kësaj e shtjellon më tej sajimin e vet dhe shprehet se: “ishte një premisë që përgatiste terrenin drejt ndërgjegjes kombëtare.” Shfaqen kështu edhe pyetje të tjera: Cila do të ishte kjo ndërgjegje kombëtare me zanafillë të Kavalioti? Duke iu shmangur këtyre pyetjeve thelbësore, ky autor zbrit te pohime antihistorike, sipas të cilave Akademia e re dhe filozofia e Kavaliotit “drejtpërdrejt përbënin themelin e një ndërgjegjeje *parakombëtare*, domethënë etnike.” Këto janë arsyet përse e kam quajtur të nevojshme të shqyrtohej pa dredhime, se cili ishte identiteti i Kavaliotit.

Kam bindjen se arsyet për ta ridimensionuar trajtimin e T. Kavaliotit janë të mjaftueshme:

Identiteti etnik i Kavaliotit ishte arumun.

Identitetit gjuhësor ishte arumun, gjuha e tij amtare ishte arumanishtja. Shqipen e kishte gjuhë të dytë dhe nuk e zotëronte shumë mirë.

Gjuha e tij e kulturës ishte greqishtja. Në të gjithë punën e tij fetare, mësimore dhe si autor ka përdorur greqishten. Edhe shqipen i është drejtuar si mjet ndihmës për të mësuar greqishten.

Identiteti i tij kulturor ishte ortodoks grek.

Nuk ka qenë ndonjë lloj iluministi, mendimtari ose filozofi shqiptar dhe iluministët e vërtetë shqiptarë do të shfaqeshin bashkë me Rilindjen tonë, te të cilët ai nuk do të kishte ndonjë ndikim.

Nuk ka ndonjë trashëgim të Kavaliotit në kulturën shqiptare dhe nuk ka përse të njëjtësohet ai me Voskopojarin si simbol i saj. Aq më pak do të pranohej pohimi i A. Uçit se: “Jemi ndeshur edhe me mjaft aspekte të mendimit të tij me rëndësi për filozofinë e shkencat bashkëkohore.” (f. 12) Në ata pak libra përgjithësues që kam shfletuar për filozofinë, nuk më del askund që të përmendet emri i tij, me përjashtim të atyre pak shkrimeve, të cilat i janë kushtuar atij konkretisht. Nuk shoh arsye që të mëtohet se ka aspekte të mendimit të tij me rëndësi për shkencën bashkëkohore, e cila është shkenca e fluturimeve kozmike dhe e informatikës, për të mos përmendur arritjet e saj të pakrahasueshme me çdo

epokë tjetër të njerëzimit.

Teodor Kavalioti ka qenë arumun shqiptar; fshirja e këtij fakti objektiv është arsyeja e trajtimeve joshkencore për këtë figurë dhe për gjithë problematikën e lidhur me të.

Është meritë e mjedisit shqiptar, që bëri të mundur lulëzimin e një qendre ekonomike e kulturore në shek. XVIII në Voskopojë dhe qarkullimin e veprimtarëve të saj në një rajon më të gjerë, duke sjellë natyrshëm edhe praninë e gjuhës shqipe aty ku ishte e pamënjanueshme. Shkatërrimi i kësaj qendre ishte pasojë e proceseve negative të Perandorisë Osmane, e cila kishte nisur tatëpjetën, si dhe e faktorëve ekonomikë të varur nga tregtimi i leshit, siç e ka trajtuar gjerësisht P. Xhufi në librin *Shekulli i Voskopojës (1669-1769)*, ndërsa ashtu siç ishte kultura e saj me tipare arumune shqiptare nën ndikimin e pjesës së përparuar të kulturës greke të kohës, ashtu ishin edhe konfliktet e brendshme, edhe shtypja me natyrë osmane, pavarësisht se agjentët e kësaj shtypjeje ishin me natyrë osmane shqiptare. Vërtetimin më bindës e gjejmë në zhvillimet e mëtejshme, në të cilat bashkëjetesa miqësore e arumunëve me shqiptarët asnjëherë nuk ka shfaqur synime asimilimi, konflikte, dukuri agresive ose përbuzëse. Toleranca shqiptare po ashtu nuk ishte refraktare as ndaj kulturës greke, as ndaj shkollave greke dhe as ndaj ideve më të përparuara evropiane të asaj kohe, që në Ballkan po gjenin përhapje nëpërmjet greqishtes. Voskopoja ishte një dukuri ballkanike dhe kam përshtypjen se vetëm në truallin e përshtatshëm shqiptar gjeti kushtet e lulëzimit, ndonëse ishte e predestinuar për t'u rrënuar gjithashtu nga ato forca, që rrënuan edhe patriarkanën e Ohrit. T. Kavalioti ishte një intelektual arumun shqiptar dhe qe fati i tij të ndodhej në trevat shqiptare, ku nuk mund të shkëputej nga shqipja.¹⁷ Pa atë pak shqipe në librin e tij me interes leksikografik nuk do të kishte gjetur vend të ne gjithçka që është shkruar rreth tij.¹⁸

Studiuesit shqiptarë përmendin një numër jo të vogël autorësh rumunë, të cilët janë marrë me T. Kavaliotin, mirëpo asnjëherë nuk i kanë përkthyer punimet e tyre ose të paktën t'i citonin dhe t'i miratonin apo t'i kundërshtonin. Po sjell vetëm një emër të njohur: Theodor Capidan-i, i cili mes të tjerash më 1928 ka botuar "Kontributi i rumunëve në rilindjen shqiptare."¹⁹ Kësaj gjendjeje i duhet dhënë fund për t'i prerë rrugën edhe në këtë lëmë një romantizmi atdhetar, por të papranueshëm për standardet e sotme të kërkimit shkencor.²⁰ Më duket se është koha të rikthehemi të tempulli i rreptë i shkencës, që të bëhemi të besueshëm e me autoritet edhe për botën e shkencës.²¹

SHËNIMET

1. UÇI, A. (1966): *Un representant albanais des Lumières*, "Studia albanica", nr. 2, f. 185-196. Artikulli ka edhe pohime të tjera në kundërshtim me historinë. Kështu, thuhet se: "Në gjysmën e parë të këtij shekulli vazhdon të njohë ngritjen e saj të vrullshme *letërsia shqipe me subjekt konfesional katolik*.", në një kohë që nuk ka asnjë ngritje në gjysmën e parë të shek. XVIII, madje nuk ka libra të autorëve shqiptarë, me përjashtim të një përkthimi të vogël prej 46 faqesh të Gj. N. Kazazit. Bëhen hamendësime, të cilat nuk ka asnjë mundësi që të provohen, se nëpërmjet Fizikës ai "ka futur në mendimin filozofik të vendit tonë të tillë elementë, që mundësuan të hapej rruga për tendencat e reja të iluminizimit." Edhe në *Fjalorin Enciklopedik Shqiptar* (1985) artikulli përkatës është hartuar nga A. Uçi, me pohime alogjike, si p.sh: "T. Kavalioti, duke çarë guaskën e temave filozofike-tradicionale, hartoi një fjalor të gjuhës së vendit si edhe të folmes vllahe." Nuk ka nevojë të çahet ndonjë guaskë për të hartuar një fjalës trigjuhësh, i cili nuk ka se si të quhet fjalor i gjuhës së vendit.

2. KASTRATI, J. (2000): *Historia e albanologjisë*, Argeta LMG; *Teodor Kavalioti*, f. 281-308, citimet nga f. 282 e 284. Edhe te ky autor ka një varg deklaramesh e hipotezash të pambështetura, se e kishte shqipen gjuhë amtare, se "zbatonte praktikisht dhe vazhdimisht teorinë krahasuese të Leibnizit" etj. Këtu po shënohet vetëm përkthimin e fjalëve të D. Obradoviçit: "Papa Teodori, mësues i Voskopojës, kishte shtypur disa sende në gjuhë shqipe me shkronja greke". Në të vërtetë D. Obradoviç ka shkruar: "Në Venecie u njoha me një farë prifti Teodor, mësues nga Voskopoja, i cili kishte sjellë për të shtypur diçka nga shqipja me shkronja greke." Këtë Obradoviç e përmend lidhur me faktin, se vetë kishte mësuar të fliste shqip, prandaj nuk e zë në gojë se libri ishte greqisht, ndërsa njëkohësisht kërkonte që si shqipja, edhe arumanishtja të përdornin shkronjat sllave.

3. HETZER, A. (1981): *Die dreisprachige Wörterverzeichnis von Theodorus Anastasiu Kavalliotis*. Helmut Buske Verlag, Hamburg.

4. UÇI, A. (2004): *Filozofia e T. A. Kavaliotit*. ASHSH, Tiranë. Është një ritregim i përmbajtjes së dorëshkrimeve të përgatitura për qëllime shkollore.

5. OSMANI, T. (1999): *Udha e shkronjave shqipe*. Tiranë, f. 90. W. Martin-Liku e ka rimarrë tërësisht fjalësin e Kavaliotit dhe e ka plotësuar më tej. Besoj se pas këtij vështrimi nuk qëndron pohimi i Sh. Demirajt, se Kavalioti bën pjesë në "shkrimtarët e kësaj periudhe të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut, që bënë përpjekjet e para për shkrimin dhe lëvrimin e gjuhës amtare."

6. Shih hollësisht për këtë te *Alfabeti i rumanishtes për shkrimin e shqipes* në: LLOSHI, XH. (2008): *Rreth alfabetit të shqipes*. LOGOS-A, Shkup, f. 273-305, si edhe për kritikën kundrejt artikullit për T. Kavaliotin të A. Uçit në botimin e parë të *Fjalorit enciklopedik shqiptar* (1985).

7. PAPAHAĞI, P. (1909): *Scrittori Aromâni in secolul al XVIII*. Bukuresht, f. 31-40.

8. PETROTTA, G. (1932): *Popolo, lingua e letteratura albanese*. Palermo. Përkthyer shqip me titullin *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare*. Almera, Tiranë, 2008, f. 124.

9. ÇABEJ, E. (1936): *Elemente të gjuhës e të literaturës shqipe*, Tiranë, f. 31.

10. RESSULI, N. (1941): *Shkrimtarët shqiptarë*. Tiranë, f. 71-74.

11. — (1952): *Letërsia e vjetër shqipe dhe arbëreshe*. Redaktor Z. Kodra, Tiranë, f. 7.

12. SHUTERIÇI, DH. (1958): *Histori e letërsisë shqipe*. Tiranë, f. 28-29.

13. *Historia e Shqipërisë*, I. Tiranë, f. 417.

14. *Historia e letërsisë shqiptare*. Tiranë, f. 49-51. Lidhur me popullsinë e Voskopojës shifrat e zmadhuara për popullsinë vijnë nga mosnjohja se çfarë është një qendër banimi.

Kështu, për 50 mijë banorë duhet një sistem i fuqishëm për të sjellë ujë të pijshëm dhe për të larguar ujërat e zeza; gjurmë të tilla nuk ka në atë vendbanim.

15. ELSIE, R. (1997): *Histori e letërsisë shqiptare*. DUKAGJINI, Pejë, f. 100; botuar së pari anglisht më 1995 me titullin *History of Albanian Literature*.

16. KOLIQI, H. (2012): *Historia e mendimit dhe e arsimit pedagogjik shqiptar*. Prishtinë, f. 118-119. Në këtë hulli ka shkruar me dorë të lirë B. Dedja, ndërsa Sh. Osmani te *Fjalor i pedagogjisë*, Tiranë, 1983, f. 295 e ka përfshirë si pjesëmarrës në lëvizjen që “në qendër të saj kishte afirmimin dhe çlirimin kombëtar.” Vështirë të pranohet që ai: “u bë postbllok për mendimin e përparuar të filozofisë materialiste të shek. XVIII.”

17. Për një shqyrtim të gjerë të fjalësit të T. Kavaliotit, krahasuar edhe me fjalësin e Dh. Voskopjarit dhe me fjalorin e W. Martin-Leake-ut shih Parathënien (f. 3-115) në: WILLIAM MARTIN-LEAKE, *Kërkime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe*. BOTA SHQIPTARE, Tiranë, 2006.

18. Edhe nga autorët rumunë jo të gjithë e kanë çmuar veprën e T. Kavaliotit. A. Canarache (*Leksikografia gjatë shekujve*, 1970) nuk e përmend; M. Seche (*Skicë e historisë së leksikografisë rumune*, 1966) shkruante se nuk ishte asnjë të dhënë për një farë Calioti, por në vëll. II (1969) e ka ulur vlerën e punës së Kavaliotit e të Dhanilit, nuk e pranon se ata kanë hapur rrugën e leksikografisë arumune dhe e quan se nga cilësia nuk i përlligjin vlerësimet e dhëna.

19. Për banorët e krahinës Voskopoja është populluar vazhdimisht nga oparakët dhe kënga popullore thotë: *Voskopoja me Oparë / janë një e të pandarë*. Sipas Gaqo Veshit, nga fshati Marjan: “Edhe drejtori i ‘Akademisë së Re’ të Voskopojës, Teodor Kavalioti, ose ndryshe Dhori Nastas Zhava, nga ky fshat e ka origjinën.”; gazeta DITA, 2 korrik 2017, f. 7.

20. Në librin e A. Uçit ka edhe gabime të tjera. Sipas tij, “Gjatë shek. XVIII me anë luftërash vazhdoi zgjerimi i mëtejshëm i territoreve të pushtuara nga Perandoria Osmane.” (f. 31) dhe “Gjatë shek. XVII dhe fillimit të shek. XVIII nuk ndihej kriza e sistemit perandorak.” Për të shmangur citimet e gjata, po i drejtohem veprës së G. Castellan-it *Histori e Ballkanit*, përkthyer shqip më 1996, ku Kreu 7 titullohet “Peshku qelbet nga koka (1566-1683)” dhe vijohet me krizën e sistemit (f. 176), ndërsa edhe në kreun pasues tregohen krizat e brendshme gjatë shek. XVII-XVIII. Për A. Uçin “Nuk ka asnjë provë që Kavalioti të jetë larguar nga vendlindja as edhe atëhere kur është botuar më 1770 libri ‘Protopiria’ në Venedik.” (f. 80) E tregova se D. Obradoviçi e ka takuar Kavaliotin në Venedik. Vërejtja, se “Dekarti e kish kuptuar se latinishtja ishte pengesë për të përfshirë në komunikimin shkencor, filozofik e kulturor masat e gjera, që zotëronin gjuhët e veçanta kombëtare.” përmban nocionin e “masave të gjera”, të përdorur gjerësisht në literaturën ruse sovjetike, së cilës i referohej gjerësisht A. Uçi, madje edhe veprat e autorëve perëndimorë i citonte në përkthimet rusisht.

21. Mund të paraqitet edhe një mendim tjetër për vetë emrin e Voskopojës. Greqisht folja βοσκω do të thotë *kullot*; βοσκος është bariu, kullotësi; βοσκοπουλο është bariu i vogël. Emri i vendbanimit ka qenë që në fillim emërtim për stanet e vogla të bariut, të *çobanakut*, ndërsa emërtimi i *Voskopit* është shkurtim i *Voskopojë*. Atëhere Voskopoja është përkthim greqisht i *çobanakut*. Autorët grekë të vonë e ndryshuan në *Moskopolis* pikërisht për të mbuluar gjurmët, se kishte qenë vend i stanarëve, i çobanëve, domethënë i vllëve.

T. KAVALLIOTIS' DICTIONARY***ABSTRACT***

A Greek-Aroumanian-Albanian dictionary was published by Theodoros Anastasiu Kavalliotis in 1770 in Venice. After *Fjalor latinisht-shqip* by Frang Bardhit (1635), it is the second published dictionary also including a portion of Albanian lexicon. For the Greek part it contains 1170 items, and for the Albanian part 1100 words.

For a long time it was considered an important work for the Albanian lexicography as well as for the Balkan studies. But a closer study of the Albanian part shows that its importance must be re-considered.

The compiler of the Dictionary didn't know well the Albanian language. As a proof of that in the present paper are analyzed more than 100 words clearly demonstrating his errors because of the lack of a good knowledge of Albanian language. Th. Kavalioti was not an Albanian writer or author in any meaning. From him we have not a single sentence. The Albanian part of this work was included to give to the Albanian pupils the possibility to somehow understand the Greek texts. He was not interested in Albanian language themselves, but he aimed to convert the Albanian pupils to the Greek culture. The Albanian was an auxiliary means to learn Greek. As it is written on the cover of the book, the author was stimulated by the Greek merchant Jorgji Trikupa to publish it "for the good of the Greeks".

Th. Kavalioti was not acquainted with any written tradition of the Albanian language. Some linguists erroneously speak about an Albanian alphabet created by Kavalioti. He simply applied the alphabet he had invented for the Aroumanian. He was an Albanian Aroumanian; his mother tongue was Aroumanian; his cultural language was the Greek, and the Albanian was a secondary language for him. In general Kavalioti was a Greek Orthodox priest, working as a teacher in a Greek school. His place in the history of the Albanian language must be re-considered.

Emil LAFE

PROF. FERDINAND LEKA 90!

Më 18 prill prof. Ferdinand Leka, një nga punëtorët më në zë në fushën e filologjisë shqiptare e posaçërisht të gjuhësisë, arriti moshën e nderuar 90-vjeçare. Është i pari që e arrin këtë moshë nga gjuhëtarët e diplomuar në Universitetin e Tiranës. Për fat të mirë gëzon shëndet të kënaqshëm, vijon të ndjekë rregullisht fushat shkencore të veprimtarisë së tij dhe të jepet pas interesave të shumtë kulturorë e shkencorë që ka pasur gjatë gjithë jetës.

Ferdinand Leka lindi në Shkodër në një familje të thjeshtë qytetare arsimdashëse më 1930. Kreu gjimnazin e njohur të qytetit të lindjes (dega klasike), ku shfaqti interesa e prirje të veçanta për lëndët filologjike: gjuhë e letërsi shqipe, gjuhë të huaja, si: latinisht, greqishte e vjetër, italisht, frëngjisht dhe letërsitë në këto gjuhë. Njohuritë në ato fusha i zgjeroi e i përforcoi duke studiuar vetë sistematikisht dhe duke zgjeruar rrethin e njohjes së gjuhëve e të kulturës gjuhësore. Shërbeu disa vjet në sektorin e arsimit e të kulturës në Kukës. Më 1956–1960 ndoqi studimet në degën e gjuhës ruse në Universitetin e Tiranës, që i përfundoi me rezultate të larta. Më 1960 filloi punën në sektorin e terminologjisë të Institutit të Historisë e të Gjuhësisë, të drejtuar nga prof. Lirak Dodbiba, gjuhëtar me përvojë, njohës i disa gjuhëve të huaja, veçanërisht i frëngjishtes. Në atë kohë ishin hartuar e përgatitur për botim 10 fjalorët e parë të terminologjisë tekniko-shkencore dhe vijonte puna për përpunimin e terminologjisë në fusha të tjera. Përpunimi e rregullimi i terminologjisë është gjithnjë një veprimtari shumë e vështirë, por në rastin e shqipes ajo gërshetohej edhe me detyrën e mënjanimit të termave të huaj, duke i zëvendësuar me fjalë të gjuhës shqipe ose duke krijuar posaçërisht fjalë të reja nga brumi i shqipes. Fatmirësisht kjo punë e ndërlikuar ra në duar të mjeshtërve më të mirë të gjuhës shqipe: Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Mahir Domi, Selman Riza, Pashko Geci, Androkli Kostallari, Lirak Dodbiba dhe në rrethin e tyre hyri edhe Ferdinand Leka. Ai diti të përfitojë prej tyre gjithçka që duhej të përfitonte, dhe i dha asaj veprimtarie gjithçka që duhej t'i jepte me përvojën e vet si një ndër punëtorët e rysur të fushës së fjalëve e të nocioneve, siç është terminologjia tekniko-shkencore.

Fryt i angazhimit të ngulët të gjuhësisë shqiptare në fushën e terminologjisë janë mbi 30 fjalorë terminologjikë shumëgjuhësh të punuar me komisione specialistësh e gjuhëtarësh dhe të botuar nga vitet '60 deri sot, që përmbajnë me dhjetëra mijëra terma të degëve themelore të shkencës e të teknikës. Në shumicën e tyre është derdhur edhe mendimi e puna e lodhshme materiale e F. Lekës. Nga kjo veprimtari e gjatë, që ka shkuar krahas me studimin dhe njohjen e teorisë e të praktikës evropiane në fushën e terminologjisë e të leksikografisë në përgjithësi, kanë dalë edhe një varg studimesh, artikujsh e kumtesash që ai ka shkruar dhe ka referuar me raste të ndryshme. Ato pasqyrojnë dijet dhe përvojën e pasur të tij nga veprimtaria praktike e hartimit të fjalorëve. Megjithëse u nxor në pension para kohe, por sipas ligjit (60 vjeç), ai e vijoi bashkëpunimin me kolegët e fushës së terminologjisë dhe dha ndihmesën e tij të vyer në përfundimin e disa fjalorëve terminologjikë që ishin në procesin e redaktimit a të përgatitjes për botim. Dhe me këtë rast le të kemi parasysh se përskejimi administrativ (e shpesh me motive të padenja për fushën e shkencës) i të pensionuarve me tituj shkencorë, i bën të përshkënditen andej-këtej studiues me kualifikim të lartë e me përvojë të pasur, në një kohë që ata mund të vijonin në projekte shkencore dhe me përfitim ekonomik si për institucionin, ashtu edhe për ata vetë. Praktika e sotme ka sjellë edhe një ndërprerje të osmozës së dijeve ndërmjet brezave në shkencë dhe ka lënë pa nisur ose pa vijuar punën për t'i ngritur në shkallë më të larta një varg veprash kolektive të botuara më parë, që mund të rivështroheshin, të plotësoheshin e të përpunoheshin në pajtim me mundësitë, kërkesat e me nivelin e sotëm të dijes. Ne kolegët më të rinj e ndiem shpejt mungesën e Ferdinandit në Institut. Ishim mësuar ta pyesnim për gjithfarë gjërash dhe na sqaronte bukur me dijet e tij të gjera, që nuk i mbante vetëm për vete, po i ndante me dëshirë me këdo që i trokiste në derë. Ferdinandi, me natyrën e tij të hapur e dashamirë, vetëkritik dhe mirënjohës e miqësor ndaj kritikave, kishte respektin e të gjithëve në Institut. Ai shpesh theksonte në biseda e në diskutime se arritjet e secilit prej nesh në punë ishin bërë të mundshme falë bashkëpunimit me kolegët, falë asaj që kemi qenë pranë njëri-tjetrit, kemi ndërtuar së bashku një atmosferë pune krijuese, kemi funksionuar si një lloj orkestre shkencore, ku, duke pasur secili rolin e vet, krijohej simfonia e veprave dhe veprimtarive madhore të institutit, që jehojnë edhe sot.

Puna për terminologjinë e çoi F. Lekën edhe drejt interesimit për të njohur veprat, idetë dhe praktikat bashkëkohore në fushën e leksikologjisë e të leksikografisë. Në vitet 1975–1980 ai u përfshi në grupin e hartuesve të "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe" (1980), ku i takoi të hartonte fjalët e shkronjave N, S dhe një pjesë të mirë të fjalëve të shkronjës P (gjithsej

4600 fjalë, rreth një e nënta e vëllimit të përgjithshëm të fjalorit). Për vite me radhë, pak nga pak, por me hapa të sigurt, me një bashkëpunim të frytshëm me poliglotin e përkthyesin Zef Simoni, hartuan një fjalor italisht-shqip me rreth 50 mijë fjalë (botimi i parë 1986), me kritere leksikografike bashkëkohore. Ky ishte i pari fjalor dygjuhësh me përmasa të tilla e me kritere të leksikografisë moderne për gjuhën shqipe. Ai u pasua nga fjalori shqip-italisht po prej këtyre autorëve (botimi i parë 1996). Të dy fjalorët janë ribotuar me saktësime e plotësime. Për një rreth më të gjerë përdoruesish, sidomos për nxënësit e studentët, nga pena e F. Lekës (ai nuk punon me kompjuter) doli edhe një “Fjalor i ri kompakt italisht-shqip e shqip-italisht” (Infbotues 2007, 792 fq.). Duke pasur parasysh marrëdhëniet e dendura që kemi pasur dhe kemi me kulturën, shkencën dhe qytetërimin e shprehur në gjuhën italiane, fjalorët e mësipërm i kanë shërbyer dhe i shërbejnë një numri të madh përdoruesish. Krahas kësaj, me kujdesin që kanë treguar autorët, këta fjalorë kanë shërbyer edhe për të pasqyruar e për të hedhur në përdorim shumë fjalë e shprehje pak të njohura të gjuhës sonë ose fjalë të reja diturore të formuara rishtas. Ata kanë ndihmuar edhe për të mënjanuar një numër fjalësh të huaja, sidomos të gjuhëve neolatine (italishtes e frëngjishtes), që kanë hyrë në përdorim pa nevojë, sepse në vend të tyre shqipja ka fjalët e veta të përshtatshme.

F. Leka vijon të ndjekë me interesim ecurinë e zhvillimeve gjuhësore në hapësirën shqiptare. Vetëdija dhe edukata kombëtare e fituar që në hapat e parë të jetës, puna si gjuhëtar dhe përgjegjësia intelektuale e kanë nxitur të marrë fjalën e të ngrëjë zërin herë pas here për një kujdes më të madh shtetëror e shoqëror ndaj gjuhës shqipe. E brengos shfaqja e tepruar e fjalëve të huaja të panevojshme si në gjuhën e folur, ashtu edhe në gjuhën e shkruar. Edhe në konferencën që u thirr në mes të dhjetorit 2010 në Plazhin e Durrësit për promovimin e “politikave të reja të guximshme gjuhësore” F. Leka foli për përdorimin e fjalëve e të shprehjeve të huaja të panevojshme si një plagë e mahisur e gjuhës shqipe dhe bëri thirrje që pikërisht te kjo çështje të drejtohet vëmendja e gjuhësisë sonë dhe e institucioneve shtetërore të arsimit e të kulturës. Kohët e fundit ai botoi një broshurë me titullin “A mund të flasim e të shkruajmë pak më shqip?” (Infbotues, 2018). Është një thirrje lutëse e një mjeshtri që i vështron punët me syrin dhe mendjen e moshës ku ka arritur. Vërtet një broshurë e vogël, por shumë e dobishme, në radhë të parë për punonjësit e shtypit. Në faqet e saj F. Leka ka hedhur vëzhgimet gjuhësore dhe shqetësimet e tij të kohëve të fundit për fjalët e huaja të panevojshme dhe parregullsi të tjera që ka vërejtur në përdorimin praktik të gjuhës.

Duke u kthyer te fusha e fjalorëve, po përmendim librin e tij “Fjalor i termave të letërsisë” (Infbotues, 2013, 459 fq.), vepër shumë e nevojshme për kulturën letrare dhe shumë e dobishme për arsimtarët dhe studentët e degëve filologjike. Nëpërmjet këtij fjalori jo vetëm sqarohen e saktësohen disa qindra terma nga fusha e teorisë së letërsisë dhe e metrikës, por shpalosen edhe vlera të shumta artistike të letërsisë shqipe, që autori i ka qëmtuar me kujdes vite e vite me radhë.

Në fushën e gjuhësisë F. Leka ka dhënë ndihmesë me vlerë edhe duke redaktuar e përgatitur për botim disa punë të paraardhësve. Të tilla janë: studimi “Neologjizmat e K. Kristoforidhit”, i hartuar nga Kolë Ashta; vepra “Fonetika” e Kostaq Cipos (botim i Akademisë së Shkencave); “Fjalor arbërisht–shqip” i Kolë Kamsit (botim i Universitetit të Shkodrës). Që nga vitet '90 F. Leka i ka kushtuar vëmendje të veçantë studimit letrar të krijimtarisë së Gjergj Fishtës, duke përmbledhur në disa shkrime meditimet dhe vëzhgimet shumëvjeçare rreth veprës letrare e kulturore të pashembullt të këtij shkrimtari të papërsëritshëm.

Gjatë jetës së tij shkencore F. Leka ka përshkuar rrugën e gjuhësisë e të kulturës shqiptare. Ai ka marrë pjesë në një varg veprimtarish shkencore e kulturore, ku ka sjellë ndihmesën e vet, që mbështetet mbi veprimtarinë praktike dhe përshkohet nga një mendim racional e i peshuar. F. Leka është një ndër delegatët e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972), ku mbajti një kumtesë interesante dhe me vlerë të përhershme "Disa çështje që lidhen me drejtshkrimin e poezisë". Si gjuhëtar me horizont shkencor të gjerë dhe njohës i thelluar i teorisë dhe praktikës së formimit të gjuhëve letrare edhe te popuj të tjerë, ai e ka përkratur veprimtarinë e gjuhësisë sonë në këtë fushë. Ndonëse i rritur me një dialekt amtar të dallueshëm nga gjuha e sotme standarde, njohës i rrallë i traditës letrare të shkrimtarëve shkodranë, veçanërisht i Gjergj Fishtës, F. Leka e ka vlerësuar me bindje shkencore standardin e sotëm letrar si një zhvillim organik të procesit të lëvrimin të shqipes, që përmbush kërkesat e shprehjes gjuhësore të botës shqiptare dhe zhvillohet e pasurohet më tej duke u ushqyer nga të gjitha burimet e trojeve ku flitet gjuha shqipe.

F. Leka është një gjuhëtar me një spektër të gjerë interesash letrarë, që i ka shfaqur jo vetëm në përkthimet nga origjinali të disa veprave madhore të letërsive të huaja, si: "Lirikat" e Françesko Petrarkës, "Të fejuarit" e Alessandro Manzoni-t, "Lavdërimi i çmendurisë" i Erazmit të Roterdamit, "Triumfi dhe tragjizmi i Erazmit të Roterdamit" i Stefan Zweig-ut etj., por edhe në shkrime studimore të vetat. Krahas veprave letrare ai ka përkthyer nga origjinali edhe vepra historike e filozofike, si “Antologji e historisë së Kohës së Vjetër. Qytetërimet e lashta: Lindja e

Lashtë, Greqia, Roma, Ilirët. Pjesë të zgjedhura.” (“Infbotues”, Tiranë, 2016, 687 fq.); Nikollaj Berdiajev, “Zanafilla dhe kuptimi i komunizmit rus” (292 fq.); Jean Guitton, “Zoti dhe shkenca” (Logos, Tiranë, 2007, 151 fq.); Joseph Ratzinger (Papa Benedikti XVI) “Jezusi i Nazaretit” (2012, 322 fq.). Me këtë përzgjedhje ka synuar të sjellë për lexuesin shqiptar një varg veprash nga ato që përbëjnë themelet e kulturës së përgjithshme historike e letrare të njeriut dhe që të ndihmojnë ta njohësh e ta kuptosh botën e të orientohesh në larminë e problemeve e të situatave të jetës. Këtyre u shtohet edhe libri aq tërheqës e domethënës i Faik Konicës “Shqipëria: kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore” i botuar së pari anglisht dhe i përkthyer saktë e bukur nga F. Leka (2010).

Përmbledhja “Shkrime gjuhësore, letrare, sociale” (Infbotues. Tiranë, 2007, 519 fq.) e prof. Ferdinand Lekës përmban vetëm një pjesë të vogël të veprimtarisë së tij shkencore. Pjesa tjetër, më e madhja, janë vargu i gjatë i fjalorëve terminologjikë ose dygjuhësh, për të cilët ka punuar një jetë të tërë. Leximi i përmbledhjes së shkrimeve të tij është me përfitim të madh për çdo njeri që e ndien si detyrë të bëjë diçka të qëndrueshme në jetën e vet. Tani që kolegu ynë i vyer e i nderuar ka nisur, shtegtimin nëpër dhjetëvjetëshin e dhjetë të jetës, i urojmë me dashuri që, duke u çapitur me hapa të kujdesshëm e të sigurt, të arrijë njëherë cakun e 100-vjetorit! Dhe shembujt nga bota e shkencave filologjike nuk mungojnë. Prof. Idriz Ajeti (1917–2019) i kapërceu të 100-at!

Prof. Ferdinand Leka in his 90-th anniversary

ABSTRACT

This article is dedicated to one of the most prominent specialists in Albanian philology, the erudite linguist prof. Ferdinand Leka, on the 90th anniversary of his birth. One of his main areas of scientific interest was the elaboration of regulation and terminology. Prof. Leka from the '60s until today, made a significant contribution to the compilation of a long range of terminological or bilingual vocabulary. The work on the terminology led prof. Leka also to the interest to know contemporary work, ideas and practices in the field of lexicology and lexicography. The awareness and education of knowledge gained, that is in the first steps of life as well as the work as a family language and the protection of intellectual energy, have taught him to raise the awareness from time to time for a greater state and social care on Albanian language. Prof.

Ferdinand Leka has also helped by reducing and preparing for publication some works of his predecessors, in the implementation of the literary study of the creativity of Gjergj Fishta. Like a linguist he also had a wide range of literary interests, appearing not only in the translation of some original major works of foreign literature.

Begzad Baliu

NELSON ÇABEJ DHE VENDI I TIJ NË HISTORINË E ALBANOLOGJISË

I. Jetëshkrimi i tij

Nelson R. Çabej u lind në Gjirokastrë më 17 nëntor 1939. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në gjimnazin “Asim Zeneli”, në qytetin e lindjes. Studimet e larta i kreu në Fakultetin e Veterinarisë të Institutit të Lartë Bujqësor, në Tiranë. Në vitin 1976 u diplomua për inxhinieri kimike nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës dhe në vitin 1986 mbrojti doktoratën me një punim në fushën e filozofisë së biologjisë. Filloi punën si mjek veteriner në lokalitetin e Milotit të rrethit Krujë, ku kreu tri studime shkencore në fushën e veterinarisë. I shtyrë nga interesi i tij i veçantë për çështjet e albanologjisë, në vitin 1962 kërkoi të vazhdonte studimet universitare me korrespondencë në fakultetin Gjuhë-Letërsi të Universitetit të Tiranës. Kërkesa e tij u refuzua, por ai vazhdoi të përgatitej si autodidakt në fushën e gjuhësisë shqipe. Gjatë kësaj kohe bëri përkthime në shqip nga anglishtja, gjermanishtja, frëngjishtja e italishtja.

Në vitin 1971 ai filloi punën në repartin e serumeve antitoksike në Institutin e Higjienës dhe Epidemiologjisë, Tiranë, ku nisi kërkimet e para në Shqipëri në fushën e biologjisë molekulare, duke izoluar ADN-në nga bakterit *E. coli*, në bashkëpunim me imunokimistin H. Zaimi. Punimi nuk u lejua të botohej në *Buletin e shkencave të natyrës* me arsyetimin “sepse, siç kujton ai, ishte diçka që e kishin bërë të tjerët para nesh” (ai izolim u krye për herë të parë në SHBA në vitin 1961). Autorët mundën të botonin vetëm një variant të shkurtuar të punimit të tyre në revistën *Shkenca dhe jeta*. Në vitin 1975 atë e largojnë nga Instituti i Higjienës dhe Epidemiologjisë duke e njoftuar zyrtarisht në Komitetin e Partisë të Tiranës se kjo bëhej për shkak të “biografisë politike” të tij.

Në nëntor 1975, emërohet rishtas mjek veteriner në kooperativën bujqësore të Vërzhezhës, në rrethin e Skraparit dhe po atë vit, pas pesë muajsh si i papunë, filloi punën si mjek veteriner në kooperativën bujqësore të Gurrës në rrethin e Tiranës. Në vitin 1976, ai përfundoi studimet universitare (sistemi i natës) në degën e inxhinierisë kimike dhe u diplomua si inxhinier kimist nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës të Universitetit Shtetëror të Tiranës.

Gjatë kësaj kohe ai botoi dhjetë artikuj në revistën më të rëndësishme shkencore të kohës “*Shkenca dhe jeta*” në fushën e biologjisë. Në vitin 1977 ai botoi veprën *Gjenetika në shërbim të njeriut* (8 Nëntori, Tiranë, 1977), në vitin 1978; *Ç’është imunologjia* (8 Nëntori, Tiranë, 1978) dhe në vitin 1979, si bashkautor me B. Shehun, botoi librin e parë të gjenetikës në Shqipëri *Gjenetika*, (Tiranë, 1979). Në vitin 1980 botoi librin *Nga historia e zhvillimit të shkencës shqiptare* (Tiranë, 1980).

Pasi kërkesa e tij për të punuar në Qendrën e Kërkimeve Biologjike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë iu hodh poshtë zyrtarisht, në vitin 1980 filloi punën si redaktor në redaksinë kulturore-enciklopedike të Shtëpisë Botuese “8 Nëntori”. Aty ka redaktuar botime të fushave të ndryshme të biologjisë, të kulturës, gjuhësisë e historisë së shqiptarëve nga autorë vendas e të huaj. Në vitin 1986 mbrojti doktoratën në fushën e biologjisë.

Veprimtaria e tij shkencore e kësaj periudhe pasqyrohet në botimin e punimit shkencor *Mbi natyrën e jetës* (Tiranë, 1984) dhe dy libra për probleme të filozofisë dhe teorisë së njohjes në biologji: *Njohja shkencore dhe biologjia e sotme* (Tiranë, 1988) dhe *Probleme filozofike të biologjisë* (1988). Gjatë kësaj kohe botoi dhe një numër artikujsh albanologjikë në organe të shtypit qendror e lokal, si dhe në revistat *Shkenca dhe jeta* dhe *Ylli*, për historinë e lashtë të Ilirisë, kulturën ilire të Halshtatit, lokalizimin e vendbanimeve të lashta ilire dhe evolucionin e emrave të tyre. Për t’u shënuar këtu është studimi i tij “Rreth pikëpamjeve që kundërshtojnë autoktoninë e shqiptarëve”.

Në vitin 1991 ai emigroi në Gjermani dhe në vitin 1992 u vendos në SHBA, ku botoi, në fushat e biologjisë evolucionare dhe biologjisë së zhvillimit, librat *Quantic Evolution* (2001, Albanet Publishing, Dumont, NJ), *Neural Control of Development* (2005, Albanet, Dumont, NJ, Albanet) si dhe teorinë e tij epigjenetike të evolucionit organik në *Epigenetic Principles of Evolution* (Albanet Publishing, Dumont NJ) dhe në vitin 2012, ribotuar në Elsevier Publications. 1st edition, Amsterdam - Boston), *Building the Most Complex Structure on Earth* (Elsevier, Amsterdam – Boston), *Epigenetic Principles of Evolution. 2nd revised edition* (Academic Press, London - San Diego - Cambridge – Oxford), *Epigenetic Mechanisms of the Cambrian Explosion* (2019, Academic Press. Në shtyp).

Gjatë qëndrimit në SHBA ai botoi një numër artikujsh në gazetën *Dielli* të Federatës Panshqiptare Vatra dhe në *Illyria* si dhe në organe të shtypit shqiptar (shih listën e artikujve albanologjikë e joalbanologjikë).

II.1. Kultura e tij

Nga pikëpamja e formimit kulturor, Nelson Çabej është një intelektual i shumanshëm, të cilit në njëfarë kuptimi, do t'i përshtatej shprehja e poetit latin Terencit: *Homo sum, humani nihil a me alienum puto* (Jam njeri, andaj asgjë njerëzore nuk është e huaj për mua). Kërshëria për të ditur e për të njohur duke kërkuar në të panjohurën e bëri atë që kur mbaroi studimet e larta ishte në gjendje të shfrytëzonte burimet e shkruara letrare dhe shkencore në tërë gjuhët kryesore perëndimore dhe në rusisht. Kjo, natyrisht e rriti potencialin e tij shfrytëzues, krahasues dhe asimilues në shkencë. Me atë etje, që në rini, ai përpinte çdo gjë që i binte në dorë a kishte mundësi të lexonte që nga politika, sociologjia, letërsia, artet e sidomos shkenca, që nga shkencat natyrore biologji, kimi e fizikë, në shkencat e aplikuara (mjekësi, mjekësi veterinare) e deri në shkencat shoqërore të gjuhësisë e historisë, sidomos gjuhësisë shqiptare dhe historisë së Shqipërisë. Ky bagazh intelektual që ai krijoi ndër vite nuk mbeti thjesht një tregues i erudicionit të tij, por u mishërua dhe gjeti pasqyrim të plotë në krijimtarinë e tij intelektuale gjysmëshekullore.

Si intelektual, N. Çabej u formua tërësisht në shkollën dhe ambientin shqiptar pas Luftës së Dytë Botërore, pa asnjë shkollim a specializim jashtë atdheut. Ai është krenar të jetë një “produkt i pastër” i asaj shkolle.

Nelson R. Çabej u formua si shkencëtar e intelektual në një rrugë të veçantë e tejet të vështirë. Ai nuk pati fatin të punonte në universitet a në ndonjë institut të Akademisë së Shkencave, të merrte leje krijuese, të përfitonte nga oraret e reduktuara a pushimet e verës. Vite të tëra ai nuk pati as leje vjetore e madje edhe shumicën e të dielave duhej të ishte në punë. Për studime a specializime brenda ose jashtë shtetit as që mund të bëhej fjalë e madje as mund t'i shkonte ndër mend. Formimin e tij si shkencëtar e si intelektual ai e konsideron si një ndër ato ngjarje që “ndodhin në kufirin e së pamundurës”. Dhe fakti që kjo ndodhi është ngadhënjim i pasionit të tij për dije, shkencë e kërkim shkencor.

Diplomimet në fushën e mjekësisë veterinare dhe të inxhinierisë kimike, mbrojtja e doktoratës në biologji, njohja si autodidakt i fushave të gjuhësisë historike të shqipes e të historisë së popullit e trojeve shqiptare nga lashtësia parahistorike deri në kohën tonë, si dhe studimet si autodidakt në fushën e fizikës e të filozofisë, botimet e tij, studimet mbi problemet e situatës dhe zhvillimeve politike, të bashkimit kombëtar të shqiptarëve, të zhvillimit të shkencës dhe kërkimit shkencor, etj., që flasin për interesat shumë të gjera intelektuale dhe erudicionin e tij janë pasqyruar mirë në krijimtarinë e tij. Ai arriti të kontribuojë në nivel shkencor në fusha aq të ndryshme sa shkencat natyrore dhe shkencat shoqërore.

Me diplomimin në fushën e kimisë dhe studimet në fizikë si autodidakt, ai arriti një formim intelektual bazë në fushat e biologjisë dhe kimisë, që i shërbyen si premisa të domosdoshme për arritjet dhe veprimtarinë e tij të mëtejshme kërkimore në fusha aq të ndryshme të biologjisë, sa disiplinat e imunologjisë, gjenetikës, biologjisë molekulare, teorisë së evolucionit dhe epigjenetikës, siç shihet në artikujt shkencorë, librat dhe artikujt që ai ka botuar në këto fusha, jo vetëm në shqip, por edhe në anglisht me shtëpinë botuese më të madhe të botës (Elsevier/Academic Press) për botime akademike, libra të nivelit post-doktoral (*Epigenetic Principles of Evolution, Building the Most Complex Structure on Earth* dhe *Epigenetic Mechanisms of the Cambrian Explosion*).

Pjesë të veprimtarisë së tij krijuese janë edhe teoria e njohjes dhe filozofia e biologjisë, të cilave ai u ka kushtuar dy libra: *Njohja shkencore dhe biologjia moderne* (Tiranë, 1988); *Probleme filozofike të biologjisë* (Tiranë, 1988).

Në fushë të kontributeve të tij me karakter shumëdisiplinar, sa intelektual aq edhe historik, kulturor, problematizues e etno-gjuhëhësor do përmendur vepra *Ilirët që mbijetuan* – një përgjigje shkencore, që ishte pritur më shumë se një shekull nga dija e albanologjisë dhe ja tani i jepej simpoziumit “Ilirët dhe Shqiptarët” të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve (1986), por që, për shkaqe që nuk vareshin prej tij, u botua vetëm një çerek shekulli pasi u shkrua.

Në veprën *Ilirët që mbijetuan* (2009) si dhe në një punim të mëparshëm të botuar në “Shkenca dhe jeta” ai lokalizon një sërë kështjellash në territorin shqiptar (“Epirus vetus” dhe Eprus nova”) që dalin në një listë të Prokopit të Cesaresë (*De Aedificiis*).

Duke provuar se evolucionit i një sërë vendemrash ilirë të paanalizuar deri atëherë deri në format e tyre të sotme, kishte ndodhur në pajtim me ligjet fonetike të shqipes, pa ndërmjetësimin e ndonjë gjuhe tjetër, ai zgjeroi ndjeshëm listën prej tetëmbëdhjetë makrotoponimeve ilire, që gjuhëtarët i kishin përdorur para tij si prova gjuhësore të autoktonisë së shqiptarëve në trojet e tyre të sotme dhe të vazhdimësisë së pandërprerë iliro-shqiptare në këto troje. Shumicën e këtyre shembujve ai i ka përfshirë të zgjeruara e të plotësuar me rezultate të reja edhe në vëllimin *Vazhdimësi iliro-shqiptare në emrat e vendeve* (Tiranë 2014, 162 f).

Në fushën e historisë ai ka hyrë me librat *Nga historia e zhvillimit të shkencës shqiptare* (1980) dhe *Prejardhja dhe formimi i popullit shqiptar I* (2016), si dhe *Epirotët – shqiptarë të lashtësisë* (2019), që më parë ishte botuar në gjuhën angleze, *Epirotes – albanians of antiquity* (2016)

Kontributet e tij shtrihen edhe në një numër të madh përkthimesh nga anglishtja, gjermanishtja dhe rusishtja, ndër të cilat duhen përmendur përkthimi nga origjinali anglishtja e vitit 1872: Charles Darwin, (1872), *The Origin of Species*, John Murray, London, i kryeveprës së Darvinit *Prejardhja e llojeve* (Darwin C. (1972); përkthimi nga gjermanishtja i studimit të Gregor Mendelit [Mendel, G. (1866). *Versuche über Pflanzenhybriden*. Brunn], që hodhi themelet e gjenetikës klasike *Eksperimente me hibridet e bimëve*, që u botua nën titullin *Zbulimi i ligjeve të trashëgueshmërisë*. (Tiranë, 1988) dhe është pajisur me një studim kritik të tij prej tridhjetë e pesë faqesh për lexuesin shqiptar. Këtu hyn edhe zgjedhja e përkthimi nga gjermanishtja i shkëpusave (fragmenteve) të zgjedhura nga veprat e dymbëdhjetë gjuhëtarëve, historianëve dhe filozofëve gjermanë, duke filluar me Leibniz-in nga fillimi i shekullit XVIII. Në vitin 2019 ai përktheu nga origjinali anglisht punimin e tij *Epirotes - albanians of antiquity* (Albanet Publishing, Dumont NJ).

II. 2. Çështje të metodës

Në studimet e tij rreth evolucionit fonetik të makrotoponimeve ilire në trojet shqiptare ai ndoqi parimin e gramatikanëve të rinj (Junggrammatiker) për ekzistencën e ligjeve të ndryshimit të tingujve të kushtëzuar nga fonetika e jo nga struktura gramatikore (p.sh., koha e foljes), një afrim që ende sot pas 150 vjetësh mbetet afrimi më shkencor¹.

Kujdes të veçantë i kushtoi shfrytëzimit sa më të plotë krahasimtar e kritik të burimeve ekzistuese, por edhe të dhënave nga fushat e tjera të albanologjisë që mund të ndihmonin në shpjegimin e çështjeve që hetoi. Ai u lë një vend të mjaftueshëm edhe pikëpamjeve të tjera, duke përfshirë ato që nuk përputhen me pikëpamjen e tij. Si një shembull tipik mund të përmendet fakti që në vëllimin e dytë të *Prejardhjes dhe formimit të popullit shqiptar* ai jo vetëm që parashton me imtësi pikëpamjen e Gustav Weigand-it për prejardhjen e mundshme trake të gjuhës shqipe, por ka përfshirë edhe tekstin e plotë të origjinalit gjermanisht “Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrer oder der Thraker? “*Janë shqiptarët pasardhës të ilirëve apo të trakëve*². Dhe duhet mbajtur parasysh se ky artikull ka

¹ Hill, N.W., 2014. Grammatically Conditioned Sound Change. *Language and Linguistics Compass* 8, 211-229.

² Weigand, G., 1927. Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrer oder der Thraker? *Balkan-Archiv* 3, 227-251.

shërbyer si burim i thujse të gjitha argumenteve që janë parashtruar gjatë gati një shekulli kundër prejardhjes ilire të gjuhës shqipe e të popullit shqiptar.

Në parim, Nelson R. Çabej, kur flet a diskuton për një mendim a pikëpamje të autorëve të tjerë kujdeset që perifrazimi/parafrazimi ose citimi i autorëve të përputhet me kontekstin e gjerë në të cilin ata e kanë përdorur. Ai përdor citimet në masën më të madhe të lejueshme në narracionin shkencor dhe shumë herë, krahas përkthimit të tij, në referimet jep edhe citatin e plotë në gjuhën nga e cila e ka përkthyer.

Në përgjithësi në studimet e tij ai ndoqi dy nga parimet themelore metodologjike të Profesor Eqrem Çabejt.

- Së pari, se në studimin e evolucionit fonetik duhej nisur nga shqipja, dhe vetëm në qoftë se mjetet e të dhënat e shqipes do ta bënin të pamundur shpjegimin e atij evolucionit, duhej kërkuar në mjete e burime të gjuhëve të tjera, dhe

- Së dyti, barra e provës bie mbi kundërshtarët e autoktonisë së shqiptarëve, të cilët duhet të tregojnë kohën dhe vendin nga kanë ardhur shqiptarët në trojet e tyre të sotme në qoftë se kërkojnë të ngrënë një hipotezë rreptësisht shkencore, gjë që përmbi një shekull askush nuk ka mundur ta bëjë.

Në etimologjizimet e tij Nelson Çabej eci nëpër udhën që hapën Norbert Jokli dhe Eqrem Çabej, për ta nisur kërkimin “nga brenda jashtë”, për të kërkuar shpjegimin në të dhënat e mjetet e shqipes dhe jo “nga jashtë brenda”, siç ka ndodhur përgjithësisht para tyre.

Në ndjekjen e evolucionit fonetik të emrave të vendbanimeve të lashta ilire deri në format e sotme ai merr parasysh dhe shqyrton pikëpamjet e mëparshme, si ato që pranojnë evolucionin e këtyre emrave në bazë të rregullave të fonetikës shqipe, edhe ata që e kundërshtojnë këtë pikëpamje.

Në përpjekjet e tij për lokalizimin e qyteteve, vendbanimeve dhe kështjellave të Ilirisë së Jugut që dalin në burimet e lashtësisë, ai nisur nga parimi se ata emra nuk humbin, por vetëm mund të evoluojnë ose t’i kalojnë ndonjë vendbanimi tjetër në afërsi, në qoftë se vendbanimi origjinal është shuar dikur në mesjetë. Përvoja në këtë fushë i ka treguar atij edhe rolin e madh që ka etimologjia popullore (Volksetymologie) në evolucionin fonetik të vendemrave ilirë, e cila nganjëherë i shndërron ato në forma shumë të vështira për t’u lidhur me origjinalin.

Edhe pse fusha e kërkimeve të N. Çabejt impononte një përdorim përpjesëtimor më të madh të metodës diakronike, analiza sinkronike gjithashtu i ka shërbyer atij në kërkimin dhe krahasimin e formave lokale.

Në përballjen me pikëpamjet e autorëve që mohojnë prejardhjen ilire të gjuhës shqipe dhe autoktoninë e shqiptarëve në trojet shqipfolëse ai i jep rëndësi paraqitjes sa më të plotë të thelbit të atyre pikëpamjeve para se të nisë shqyrtimin analitik të tyre, duke u kujdesur të vlerësojë edhe rangun e pikëpamjes si një opinion, hipotezë pune apo hipotezë shkencore.

Siç vinte në dukje Eqrem Çabej, fshatrat në Shqipëri, ashtu si në tërë Ballkanin në përgjithësi, nuk janë shumë të vjetër ndaj dhe emrat e tyre nuk vijnë nga Lashtësia. Rrjedhimisht, edhe nuk kanë ndonjë vlerë identifikuese (veç rasteve kur ndonjë emër fshati i sotëm mund të ketë trashëguar emrin e një vendbanimi të lashtë ilir), fakt që e detyron kërkuesin të përqendrohet në identifikimin analizën e makrotoponimeve të lashta ilire që dalin në burimet historike greke e latine që u përgjigjen makrotoponimeve (qytete, emra malesh e lumenjsh) të sotme.

Pikëpamja e parë (fantastike) për prejardhjen e shqiptarëve nga Kaukazi është parashtruar për herë të parë nga disa historianë kishtarë të shekullit XVIII. Pastaj ajo pikëpamje u mor e u zhvillua më tej nga studiuesi grek Nikolaos G. Nikokles, si temë disertacioni³.

Prejardhja kaukaziane, por edhe pikëpamjet e tjera mbi prejardhjen e shqiptarëve nga jashtë Ballkanit (nga Alba e Italisë ose nga Skocia) janë hedhur poshtë si joshkencore e madje fantastike dhe nuk kanë më asnjë jehonë në diskutimet për prejardhjen e shqiptarëve. Po kështu, tanimë janë hedhur pas krahëve edhe hamendjet mbi prejardhjen e tyre nga Karpatet e madje edhe pikëpamja e Konstantin Jirecekut (1854-1918) për formimin e popullit shqiptar brenda Ilirisë, diku midis Dalmacisë dhe Danubit, që përputhet afërsisht me Bosnjen e sotme.

Problemi i madh me lëvizjen dhe pikëpamjen për prejardhjen jo ilire të shqiptarëve është se edhe sot më shumë se një shekull, pasi u parashtrua në mënyrë rudimentare nga Hermann Hirt⁴, nuk ka një mendim të unifikuar për kohën dhe vendin e ardhjes së mëtuar të shqiptarëve në trojet e tyre të sotme. Edhe në vetë simpoziumin *Ilirët dhe shqiptarët* (Iliri i albanci, 1988) autorët serbë nuk mundën të arrijnë një konsensus për vendin e hamendësuar se nga erdhën shqiptarët në trojet e tyre të sotme. Ai vend është një herë Dakia e një herë Daki-Moezia, një herë Dardania e një herë një zonë e ngushtë malore midis lumenjve Mat/Drin dhe Shkumbin. Paraqitja e katër vendeve të mundshme të prejardhjes së shqiptarëve e bën

³Nikokles, N.G., 1855. *Περὶ τῆς αὐτοχθονίας τῶν Ἀλβανῶν ἤτοι Σκιπιδάρ*. (Diss.) Gottingae.

⁴Hirt, H., 1898. Die sprachliche Stellung des Illyrischen. In *Beiträge zur alten Geschichte und Geographie*. Reimer, Berlin, f. 187.

pikëpamjen serbe tepër amorfe dhe shumë nën nivelin e një hipoteze shkencore, që mund t'i nënshtrohej provës dhe falsifikimit, siç kërkon teoria e shkencës.

Por edhe sikur studiuesit serbë të kishin arritur një konsensus për të përcaktuar një vend të vetëm të prejardhjes së shqiptarëve, të dhënat dhe argumentet që ata paraqesin nuk të shpien kurrsesi në përfundimin e kërkuar se shqiptarët janë të ardhur në trojet e tyre të sotme. Me gjithë një mbizotërim në simpozium të idesë për Trakinë si atdhe i mundshëm i shqiptarëve, siç vinte në dukje gjuhëtari jugosllav Radoslav Katičić, “Asgjë me vlerën e një prove nuk është paraqitur deri sot për prejardhjen trake të shqiptarëve”⁵.

II. 3. Njohja e kulturës kombëtare

Tematika albanologjike e Nelson Çabejt u përcaktua tërësisht nga problematika e albanologjisë shqiptare të kohës, kur në një sërë studimesh, sidomos të autorëve të vendeve fqinje, të frymëzuara më shumë politikisht sesa shkencërisht, shtrembëroheshin dhe mohohej e vërteta rreth gjuhës, prejardhjes dhe formimit të popullit shqiptar. Ishte koha kur Shqipëria kishte humbur patriarkun e studimeve albanologjike, Eqrem Çabejn.

Në veprën albanologjike të Nelson Çabejt trajtohen aspekte të shumta të historisë, gjuhës dhe kulturës materiale dhe shpirtërore të popullit shqiptar. Hetimet shkencore atë e shpien deri në prehistorinë ilire, në periudhën e formimit të etnosit ilir dhe të paraardhësve indoevropianë të ilirëve, duke ndjekur rrugën e tyre mbështetur edhe në lidhjet gjuhësore me gjuhët baltike dhe gjermanike, që flasin për fqinjësinë e dikurshme në rrugën e emigrimit të tyre drejt Ballkanit Perëndimor. Në veprën e tij del qartë vazhdimësia e kulturës materiale ilire në Ballkanin Perëndimor, siç provohet dhe nga analiza e Kulturës Koman-Krujë në Mesjetën e hershme, që u përhap vetëm në trojet shqiptare, duke përfshirë trojet shqipfolëse në Mal të Zi, Maqedoni e Greqi deri në Janinë e Korfuz.

Një vend të rëndësishëm në studimet e tij zënë prejardhja e gjuhës shqipe dhe prejardhja e formimi i popullit shqiptar, autoktonia e shqiptarëve në trojet e sotme dhe trojet historikisht shqipfolëse, duke përfshirë Epirin. Kemi parasysh këtu veprat *Ilirët që mbijetuan*, *Epirotët – shqiptarë të lashtësisë* dhe *Prejardhja dhe formimi i popullit shqiptar*.

⁵ Katičić, R., 1976a. *Ancient Languages of the Balkans*. Mouton & Co., The Hague, f. 187-188: “Nothing in the nature of a proof has been presented so far for the Thracian origin of Albanian”.

Varfëria relative e burimeve historike për periudhën e Mesjetës së hershme përcakton edhe rolin e madh që kanë njohja e natyrës së evolucionit fonetik të onomastikës ilire, emrave ilirë të vendeve (qyteteve, maleve e lumenjve), emrave vetjakë dhe emrave etnikë në nivelin e fiseve për vërtetimin e prejardhjes ilire të gjuhës shqipe e të shqiptarëve. Që në fillimet e veprimtarisë së tij albanologjike, duke ndjekur metodat e paraardhësve shqiptarë e të huaj në këtë fushë të kërkimit, ai e drejtoi vëmendjen nga vendemrat ilirë që dalin në burime të Lashtësisë së vonë (Hierokli, Stefan Bizantini, Prokopi i Cezaresë), por nuk ishte lokalizuar vendndodhja e tyre, të tilla si: Baiake, Damastioni, Scodreoni, Onhesmi, Klodiana etj., dhe në këtë proces ndoqi evolucionin fonetik të këtyre vendemrave. Rezultatet e kësaj pune ai i botoi nga gjysma e dytë e viteve 80-të dhe i përmbloodhi në librin *Vazhdimësi iliro-shqiptare në emrat e vendeve* (2014).

Vend të rëndësishëm në krijimtarinë e Nelson Çabejt zënë gjurmimet e tij në fushën e kulturës popullore dhe besimit të ilirëve, të cilat janë pasqyruar gjerësisht në monografinë *Në gjurmët e perëndive dhe mitologjemave ilire* (Fan Noli, Tiranë, 2014), por edhe në vëllimin *Prejardhja dhe formimi i popullit shqiptar I*. Ai arrin të identifikojë një numër perëndish ilire, që dalin në dokumente dhe mbishkrime të lashtësisë, duke bërë edhe përpjekjen e parë për të rindërtuar panteonin ilir dhe kozmogoninë ilire, si degë të panteonit dhe kozmogonisë indoevropiane, duke vënë në dukje edhe gjurmët e besimit ilir në besimin, mitologjinë dhe ritualet e shqiptarëve. Elementë të moralit, të së drejtës, artit, muzikës dhe folklorit ilir dhe lidhjet e tyre me elementet përkatëse shqiptare ai i jep në të dyja veprat e mësipërme.

Njohjes së evolucionit dhe zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë shqiptare nga lashtësia deri në kohën tonë ai i ka kushtuar një monografi të veçantë, *Nga historia e zhvillimit të shkencës shqiptare* (1980). Në këtë punim ai tregon jo vetëm gjendjen dhe evolucionin e shkencës dhe teknologjisë iliro-shqiptare në shekuj, po edhe kontributet konkrete të ilirëve dhe shqiptarëve në shkencën e teknologjinë evropiane nga Lashtësia deri në vitet 50-të të shekullit të kaluar.

Interesat e tij jashtë lëmit të shkencave natyrore, të aplikuara dhe shoqërore shihen edhe artikujt e tij rreth problemeve të zhvillimit shkencor në Shqipëri, lidhjeve midis artit dhe shkencës, rolit të frymëzimit në art e në shkencë, si dhe në një artikull për polifoninë popullore shqiptare dhe një vështrim të saj në *Epirotët – shqiptarë të lashtësisë*.

II. 4. Pikëpamjet mbi natyrën e gjuhës dhe vazhdimësinë e saj

Lindja e gjuhës njerëzore u parapri nga evolucioni i një mekanizmi biologjik tingullformues që ndodhi krahas daljes nga mbretëria e kafshëve dhe evolucionit të *Homo sapiens* dhe *Homo sapiens sapiens*.

Gjuha njerëzore nuk është një strukturë statike, por një dukuri dinamike në ndryshim të vazhdueshëm në bazë të ligjeve të saj të brendshme, që lindin dhe evoluojnë bashkë me të. Në këtë kuptim thuhet se gjuha “nuk është, por ndodh”.

Në përpjekjen e tij për të njohur prejardhjen dhe formimin e popullit shqiptar N. Çabej shfrytëzoi njohuritë, mjetet dhe metodat e gjuhësisë historike, e posaçërisht të fonetikës historike shqipe të zhvilluar nga gjuhëtarë të shquar të huaj dhe një plejadë gjuhëtarësh shqiptarë të prirë nga Eqrem Çabej nga gjysma e dytë e shekullit XX. Themelet e gjuhësisë historike të shqipes ishin hedhur më shumë se një shekull e gjysmë më parë, kur gjuhëtari danez Rasmus C. Rask (1787-1832) në vitin 1814⁶ (Pedersen, H., 1922) dhe gjuhëtari gjerman Franz Bopp (1791-1867) në vitin 1855⁷ (Bopp, F., 1855).

Gjuha shqipe është një pjesëtare e familjes gjuhësore indoevropiane që lindi dhe evoluoi brenda më pak se 10 mijë vjetëve të fundit⁸ (Gray and Atkinson, Q.D., 2003). Gjuha shqipe qysh në fillim të shekullit XVIII e deri sot është konsideruar si një vazhdim i ilirishtes ose i një dialekti jugor të saj⁹ (Meyer, 1888) nga shumica e gjuhëtarëve dhe thuajse nga të gjithë ata gjuhëtarë që e kanë njohur atë me themel.

Vendi i gjuhës shqipe në pemën gjenealogjike të familjes së gjuhëve indoevropiane nuk është saktësuar. Ajo nuk shfaq tipare që do ta lidhnin ngusht me ndonjë prej grupeve të tjera të kësaj familjeje. Në klasifikimin e parë gjenealogjik të August Schleicher-it ajo është lidhur në njëfarë mënyre me greqishten, por kjo nuk i ka rezistuar kohës. Kështu, E. Hamp¹⁰ (Hamp,

⁶ Pedersen, H., 1922. Review: Norbert Jokl: linguistisch - kultur - historische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen. *Philologica: Journal of Comparative Philology* 1-2, 110-115.

⁷ Bopp, F., 1855. *Über das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen*. Stargardt, Berlin.

⁸ Gray, R.D., Atkinson, Q.D., 2003. Language - tree divergence times support the Anatolian theory of Indo - European origin. *Nature* 426, 435 - 439.

⁹ Meyer, G., 1888. Die lateinischen Elemente im Albanischen. Në *Grundriss der romanischen Philologie I*. Trübner, Strassburg, f. 804-821: “Es ist keine Grund vorhanden, dieselbe für etwas anderes zu halten, als für die jüngere Phase des alten Illyrisch oder richtiger einer der alten illyrischen Mundarten.”

¹⁰ Hamp, E.P., 1990. The Pre-Indo-European Language of Northern (Central) Europe. Në *When Worlds Collide: The Indo-Europeans and the Pre-Indo-Europeans*. Red. T.L.

1990) dhe klasifikimi më i fundit kompjuterik i gjuhëve indoevropiane e bashkon shqipen me grupin e gjuhëve indoevropiane perëndimore.

Edhe ndarja e madhe e gjuhëve indoevropiane në dy grupet e mëdha kentum dhe satem nuk ndihmon, jo vetëm për shkak të vlerës së diskutueshme të asaj ndarjeje, por edhe sepse shqipja shfaq si elementë satem dhe kentum (po ashtu si dhe ilirishtja, por ndryshe nga trakishtja që duket qartë të ketë qenë një gjuhë e tipit satem), një fakt që mendohet se flet për lashtësinë e kësaj gjuhe, që shkon para fillimit të ndarjes së gjuhëve indoevropiane në këto dy grupe të mëdha, rreth shekullit XVI p.e.s.

Gjuhësia historike e shqipes ka dhënë një ndihmesë të paçmueshme për njohjen e historisë së lashtë dhe parahistorisë së shqiptarëve, duke na sjellë dokumentet më të vjetra të historisë së formimit të etnosit ilir dhe të popullit shqiptar.

Natyra dinamike e sistemit gjuhësor kërkoi analizën diakronike të evolucionit morfologjik, gramatikor e sintaktik, të gjuhës shqipe. Kjo analizë bëri të mundur arritjet e njohura sidomos në drejtim të zbulimit të ndryshimit morfologjik të fjalëve shqipe në përpjekjet për etimologjizimin e fjalëve shqip, duke filluar kryesisht nga fundi i shekullit XIX me hartimin e *Fjalorit të parë etimologjik të shqipes* nga Gustav Meyer, me punimet e Holger Pedersenit, Norbert Joklit, Stewart Mann-it, Erik Hamp-it, etj., që u kurorëzuan me korpusin themelor 7-vëllimësh të *Studimeve etimologjike në fushë të shqipes* të Eqrem Çabejt.

Përgjithësisht, Nelson Çabej beson në drejtësinë e pikëpamjes së gramatikanëve të rinj (Junggrammatiker), të “shkollës së Lajpcigut” me përfaqësues gjuhëtarë të mëdhenj si Karl Brugmann (1849-1919), Hermann Osthoff (1847-1909), Hermann Paul (1846–1921), Berthold Delbrück (1842–1922) etj., të fundit të shekullit XIX, sipas të cilëve ndryshimet fonetike prekin të gjitha fjalët dhe se këto ndryshime janë të kushtëzuara vetëm fonetikisht, pavarësisht nga rrethanat gramatikore e sintaktike në të cilat ndodh ndryshimi. Kur evolucioni i një fjale duket se bie në kundërshtim me ligjin, ai duhet parë si një analogji ose një përjashtim që ka ndodhur nën influencën e një fjale fonetike të ngjashme ose si formë në procesin e ndryshimit. Doktrina neogramatikane u tregua shumë produktive, shërbeu si bazë për rikonstruktimin e fjalëve dhe përshkrimin e evolucionit të gjuhëve indoevropiane, duke përfshirë shqipen, duke treguar se ndryshimet fonetike të fjalëve të një gjuhe iu nënshtrohen ligjeve fonetike të rrepta të cilat, siç tregojnë ndryshimet dialektore, nuk janë

absolute, por shumë të vlefshme në kërkim. Për këtë arsye, Eqrem Çabej fliste vetëm për rregulla që lejonin edhe përjashtime të rralla. Megjithatë, kohët e fundit penduli duket se ka lëvizur në drejtim të parimit të gramatikanëve të rinj dhe kundër kushtëzimit gramatikor të evolucionit të fjalëve¹¹ (Hill, 2014).

Ky parim “junggramatikan” e shpuri Nelson Çabejn në bindjen se emrat ilirë të vendeve dhe fjalët e pakta ilire që dalin në ato burime janë aty në forma të evoluara në shkallë të ndryshme në bazë të ligjeve fonetike të shqipes. Në studimet e tij ai u udhëhoq nga parimi se ato emra nuk janë zhdukur pa gjurmë, por gjenden diku aty, në të njëjtin vendbanim të sotëm ose në ndonjë vendbanim a emër vendi përreth. Me këmbëngulje ai i kërkoi dhe arriti të lokalizojë një numër të konsiderueshëm vendbanimesh të lashta ilire, si: *Baiake, Claudiana, Damastion, Pelion, *Argyrion, Kanina, Amantia, Skydreon* etj., dhe të provojë se evolucioni i tyre ka ndodhur në pajtim me ligjet fonetike të shqipes, duke dhënë prova të rëndësishme gjuhësore të autoktonisë shqiptare në trojet e sotme dhe në trojet historikisht të banuara nga shqiptarë.

PËRFUNDIME

Studiuesi i përmasave të gjera në fushë të shkencave të natyrës, shkencave shoqërore dhe gjuhësore, madje të një fushe shumë specifike, Ilirisë dhe ilirishtes, Nelson R. Çabej është njëri prej personaliteteve më të rëndësishme të dijes albanologjike.

Megjithëse i formuar fillimisht në shkencat e natyrës, ai shpejt do të hapë horizontet e dijes në fushë të albanologjisë, e brenda saj në periudhën më të diskutueshme të saj, formimin e popullit shqiptar e të gjuhës shqipe brenda hapësirës ballkanike.

Në përgjithësi në studimet e tij ai ndoqi dy nga parimet themelore metodologjike të E. Çabejt: së pari, se në studimin e evolucionit fonetik duhet nisur nga shqipja, dhe vetëm në qoftë se mjetet e të dhënat e shqipes do ta bënin të pamundur shpjegimin e atij evolucionit, duhet kërkuar në mjete e burime të gjuhëve të tjera; dhe së dyti, barra e provës bie mbi kundërshtarët e autoktonisë së shqiptarëve, të cilët duhet të tregojnë kohën dhe vendin nga kanë ardhur shqiptarët në trojet e tyre të sotme në qoftë se kërkohen të ngrënë një hipotezë rreptësisht shkencore, gjë që përmbi një

¹¹ Hill, N.W., 2014. Grammatically Conditioned Sound Change. *Language and Linguistics Compass* 8, 211-229.

shekull askush nuk ka mundur ta bëjë; dhe së treti, një përbërës të veçantë të metodës së studimeve të tij paraqet mendimi kritik dhe diskutimi polemizues mbi studimet e gjertanishme në fushën ku ai bën kërkimet shkencore.

Brenda këtyre parimeve Profesor Nelson Çabej ia ka dhënë albanologjisë një rëndësi prej antologjive më të mira etno-historike dhe gjuhësore e kulturore, e cila edhe pas shumë dekadave nuk është tejkaluar, si dhe disa nga sintezat më të mira etno-historike për raportet mes dy popujve të vjetër të Ballkanit: grekëve dhe shqiptarëve. Të një rëndësie të veçantë janë studimet e hapura mbi trashëgiminë mitike të kulturës shqiptare dhe mbi bazën gjuhësore të disa prej toponimeve, mikrotoponimeve dhe ojkonimeve të hapësirës ballkanike. Po kështu mund të thuhet për studimet kritike e polemizuese mbi prejardhjen e popullit shqiptar e të gjuhës shqipe dhe mbi vendin e tij në hapësirën ballkanike, një përgjigje kjo brilante dhënë studiuesve serbë të dekadave të fundit.

Veprat e studiuesit Nelson Çabej përfaqësojnë vazhdimin e traditës më të mirë të shkollës shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX, që nën ndikimin e Profesor Çabejt ishte vetëm një vazhdimësi e shkollës austro-gjermane dhe asaj italiane, sidomos në fushë të studimit të historisë së gjuhës. Në këtë rrjedhë studiuesi Nelson Çabej përfaqëson një model brilant në fillim të shekullit XXI.

Veprat albanologjike

1. Çabej, Nelson R. 1980. *Nga historia e zhvillimit të shkencës shqiptare*, 8 Nëntori, Tiranë.
2. Çabej, Nelson R. 1990. *Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane*. 8 Nëntori, Tiranë.
4. Çabej, Nelson R. 2013. *Ilirët që mbijetuan*. Fan Noli, Tiranë.
5. Çabej, Nelson R. 2014. *Në gjurmët e perëndive dhe mitologjemave ilire*. Fan Noli, Tiranë.
6. Çabej, Nelson R. 2014. *Vazhdimësi iliro-shqiptare në emrat e vendeve*. Fan Noli, Tiranë.
7. Çabej, Nelson R. 2016. *Epirotes – Albanians of Antiquity*. Albanet, Dumont, NJ USA.
8. Çabej, Nelson R. 2016. *Prejardhja dhe formimi i popullit shqiptar I*. Fan Noli, Tiranë.

Nelson Çabej and his place in the history of albanology

ABSTRACT

Nelson R. Çabej, a researcher of vast dimensions in the field of natural sciences, social sciences, and linguistics, and even in a very specific

field, Illyria and Illyrian, is one of the most important personalities of Albanian knowledge.

Although initially formed in the natural sciences, he will soon open the horizons of knowledge in the field of albanology, and within it in its most controversial period, the formation of the Albanian people and the Albanian language within the Balkan space.

In general, in his studies he followed two of the basic methodological principles of E. Çabej: first, that in the study of phonetic evolution one should start from Albanian, and only if the means and data of Albanian would make it impossible to explain *e* that evolution must be sought in the means and sources of other languages; and secondly, the burden of proof falls on the opponents of the autochthony of the Albanians, who must show the time and place where the Albanians came from in their present lands if they seek to eat a strictly scientific hypothesis, which for over a century no one could not do it; and third, a particular component of his study method is the critical thinking and polemical discussion of studies so far in the field where he does scientific research.

Within these principles, Professor Nelson Çabej has given albanology one of the best ethnohistorical and linguistic and cultural anthologies, which even after many decades has not been surpassed, as well as some of the best ethnohistorical syntheses for the relations between the two peoples. *Old Balkans: Greeks and Albanians*. Of particular importance are the open studies on the mythical heritage of the Albanian culture and the linguistic basis of some of the toponyms, microtoponyms, and ojkonims of the Balkan space. The same can be said for the critical and polemical studies on the origin of the Albanian people and the Albanian language and on its place in the Balkans, a brilliant answer given to Serbian scholars of recent decades.

The works of the scholar Nelson Çabej represent the continuation of the best tradition of the Albanian school of the second half of the XX century, which under the influence of Professor Çabej was only a continuation of the Austro-German and Italian school, especially in the field of studying the history of language. In this course, the researcher Nelson Çabej represents a brilliant model at the beginning of the XXI century.

Artan HAXHI & Tefë TOPALLI

TERMINOLOGJIA SI SISTEM

(Fjalor i termave të gjuhësisë)

(vijon)

AKORDIM

Akordimi (nga lat. vulg. *adchordare* “me akordu”, fillimisht i përdorur për instrumentet muzikore) është një fenomen sintaksor, i cili nënkupton përshtatjen formale midis dy a më shumë elementeve të fjalisë sa i takon përzgjedhjes së kategorive morfosintaksore përkatëse (përshtatja e mbiemrit me emrin, përshtatja e kohëve të foljeve etj.). Kështu, në frazën *Mollët janë të pjekura*, emri *Mollët*, duke qenë në gjininë femërore, numri shumës, kërkon që folja *jam* të vendoset në numrin shumës (*janë*), sepse përshtatet me emrin *mollët*, po kështu edhe mbiemri *të pjekura* merr gjininë dhe numrin e emrit *Mollët*, duke u përshtatur me të.

Hapësira dhe modalitetet e përdorimit të akordimit variojnë nga gjuha në gjuhë, edhe në varësi të tipit gjuhësor. Në përgjithësi, një gjuhë, sa më shumë priret drejt tipit fleksiv, aq më shumë përdor akordimin morfologjik (p.sh. latinisht, italisht, svahili, shqip etj.) dhe anasjelltas, një sistem që priret drejt tipit izolues, akordimi synon të jetë minimal (p.sh. anglisht, kinezisht etj.).

Një nga tipat kryesorë të akordimit gramatikor është ai i sintagmës emërore, ku më i përhapuri është ai që ndeshet në ndërtime në të cilat elementet përcaktuese përshtaten me emrin me të cilin lidhen në disa nga kategoritë morfologjike përkatëse, si rregull (të paktën për shumicën e gjuhëve indoevropiane) në gjini e në numër, p.sh. *i capelli biondi* (it.), *les cheveux blonds* (frëngj.), *flokët e verdhë* (shqip) etj..

Brenda sintagmës emërore emri që paraqet kokën e sintagmës shërben si element dominues ose kontrollues, duke pasqyruar treguesit morfologjikë mbi treguesit e tjerë të sintagmës, të cilët mund të jenë të kontrolluar nga emri (cfr. Simone 1990). Kurse në disa gjuhë të tjera, p.sh. në anglisht, shprehja e ngjashme *the blond hair*, në fakt duket e privuar nga akordimi, meqenëse nyja dhe mbiemri janë të pandryshueshëm.

Një tip specifik akordimi është edhe ai predikativ, që ka të bëjë me subjektin dhe me predikativitetin e tij. Tek kallëzuesi emëror (si me foljen gjysmëndihmëse *jam*, ashtu edhe me folje të tjera këpujore) emri ose mbiemri në funksion predikativ përshtatet, si rregull, me kryefjalën në gjini, numër e ndonjëherë edhe në rasë, për shembull (shqip) *Maria është*

doktoreshë; ndeshja duket interesante; (gjer.) er ist Student; (lat.) Marius videtur dux etj..

Përveçse në përbërje të sintagmës apo edhe të fjalisë, akordimi mund të realizohet edhe në distancë, pra, ndërmjet elementeve që u përkasin përcaktorëve të ndryshëm ose të njëjtit përcaktor, por në fraza të ndryshme. Në këtë rast flitet për akordim anaforik, pasi ka bashkëpërshtatje në mes të një përemri dhe emrit të tij të referencës. Një tip i tillë akordimi mund të jetë edhe ai midis një përemri lidhor dhe paraardhësit të tij (*Fustani që e bleva dje është shumë i bukur*) ose një përemri vetor dhe paraardhësit të tij, që mund të jetë emër ose përemër, p.sh. *Kam parë Aldon dhe i kam thënë të vijë*, ku trajta e shkurtër *i* është në përshtatje me emrin të cilit i referohet (*Aldon*) në numër (njëjës) dhe në gjini (mashkullore).

AKROFONI

Akrofofi (nga greqishtja ἄκρος, *i lartë, në krye* dhe φωνή, *tingull*) është ligji fonetik, sipas të cilit një ideogram me kalimin e kohës ka humbur kuptimin e tij fillestar dhe ka fituar vlerën e tingullit nistor të tij. Për shembull, ideogrami semitik *aleph* me kalimin e kohës e ka humbur kuptimin fillestar, atë të *kaut* (*viçit*), dhe ka marrë vlerën e tingullit nistor të përfaqësuar nga shkronja **A** e alfabetit grek dhe latin.

AKROFONIK

Akrofonik (rrjedh nga *akrofofi*) është ai sistem alfabetik që ndjek rregullat e akrofonisë. I tillë është alfabeti fonetik egjiptian-semitik, i cili konsiston në dhënien një shenje (në origjinë piktografike), të vlerës së tingullit nistor të fjalës së përfaqësuar prej saj: kështu, shenja që tregon “*dorën*”, e cila në Egjipt është e vlefshme me *d*, në shkrimet semite ka vlerën e *i*, sepse fjala “*dorë*” në gjuhën semitike është *yōd* (mbi këtë parim është formuar edhe një nga sistemet e numrimit grek, në të cilin numrat tregoheshin me shkronjën fillestare të emrit të tyre: p.sh. Π = πέντε, 5 ; Δ = δέκα, 10).

AKROLEKT

Akrolekt (nga greq. ἄκρον “*majë*” dhe λέγω “*me folë/me thënë*”) është varieteti gjuhësor më i ngritur (varieteti i prestigjit) brenda një sistemi social dhe kulturor, i cili do të jetë model për t’u imituar nga grupet e tjera. Në shumë bashkësi gjuhësore në mbarë botën dëshmohen situata të diglossisë, domethënë prani të varieteteve të ndryshme gjuhësore, të cilat shpesh përdoren në kontekste të ndryshme dhe me funksione të ndryshme. Varieteti apo sistemi gjuhësor i konsideruar nga anëtarët e bashkësisë gjuhësore si më i ngritur apo më prestigjozi është akrolekti dhe pikërisht për këtë arsye ai mund të përdoret edhe si gjuhë zyrtare nga shteti. Një

shembull tipik i akroletit është latinishtja mesjetare. Në periudhën e Mesjetës gjuhët romanze përdoren për komunikim të përditshëm dhe për qëllime kryesisht praktike (si bazilekt), ndërsa latinishtja ishte gjuha e kulturës dhe e Kishës, pra përdorej si gjuhë e prestigjit. Në mënyrë të ngjashme, gjuha shqipe kryen funksionet e një akrolekti në krahasim me dialektet. Në përgjithësi, statusi i akroletit është edhe shkak i zgjedhjes së atij varietetit si gjuhë zyrtare nga një shtet. Akrolekti është e kundërta e *bazilektit* dhe e *mesolektit*.

AKUZATIVE

Akuzative (nga lat. *accusativus*, që është përkthim nga greq. αἰτιατική, *aitiatikè ptôsis* – rasë e asaj që është shkaktuar), ndryshe *kallëzore*, është rasë morfologjike që shërben për të shënuar funksione të caktuara sintaksore, zakonisht kundrinën e drejtë. Si i tillë, akuzativi, që mund të jetë kategori emërore ose përemërore, drejtohet nga folja, zakonisht kalimtare, p.sh.: lat. (*video*) *matrem meam* – (*shoh*) *nënë* time.

Ajo është rasë tipike për gjuhët e hershme indoeuropiane dhe ekziston akoma në disa prej tyre (përfshirë latinishten, sanskritishten, greqishten, gjermanishten, polonishten, rusishten, por edhe shqipen), në gjuhët fino-ugrike dhe në gjuhët semite (si arabishtja), pra, e gjuhëve që kanë lakim. Kjo rasë shërben për të shënuar funksione të caktuara sintaksore, zakonisht kundrinën e drejtë.

Termi latin që është në bazën e emërtimeve moderne të kësaj rase, rrjedh nga një keqkuptim i termit korrespondues të saj në greqisht : *aitiatikós* është në fakt mbiemri që rrjedh nga *aitiatikón* (efekt, produkt i aksionit), teknikizëm i antologjisë së Aristotelit, përkthimi korrekt i së cilës do të ishte *causativus* (*De Mauro, 1971*).

Rasa kallëzore pa parafjalë në shqipen e sotme përdoret vetëm me folje dhe mund të shënojë :

1. objektin mbi të cilin bie drejtpërdrejt veprimi i shprehur nga një folje kalimtare (kundrina e drejtë) (*e nxori peshkun mbi ujë*). Po ashtu mund të tregojë edhe sendin mbi të cilin veprimi bie pjesërisht, si: *pi ujë, ha bukë, solli mish* etj.;
2. një tipar të kushtëzuar të sendit të treguar nga kundrina (plotësin kallëzuesor të kundrinës), si: *e zgjodhën kryetar, e ka vëlla* etj.;
3. kohën e kryerjes së një veprimi, si: *Gjithë natën kishte rënë borë; Javën e kaluar organizuam një ekskursion* etj.;
4. sasi e masë : *e kam blerë 500 lekë, peshon 4 tonë* etj..

Rasa kallëzore me parafjalë merr kuptime të ndryshme :

1. tregon vend : *në shtëpi, nëpër male* etj.;

2. shënon përmbajtjen e të menduarit, e të thënit : *mendonte për **djalin**, foli mbi **detyrat*** etj.;
3. për të karakterizuar një send : *mur me **tulla**, njeri me **vullnet*** etj.;
4. për të shënuar mjetin me anë të të cilit kryhet një veprim : *shkruaj me **penë**, lufton me **pushkë*** etj..

Në pjesën më të madhe të gjuhëve bashkëkohore të folura në Evropë të privuara nga sistemi rasor funksioni i kundrinës së drejtë shprehet në ndonjë mënyrë tjetër, zakonisht përmes rendit të përbërësve të fjalisë.

AKRONI → *pankroni*

Termi **akroni** (nga gr. *a* “*pa*” + *chrónos* “*kohë*” pa referenca kronologjike) përdoret për të shënuar fenomene që nuk i përkasin një epoke të caktuar, por janë të përgjithshme dhe nuk u referohen momenteve të veçanta historike. Gjuhësia historike e 800-ës identifikonte përputhje ose transformime që vlejshëm në fusha të ndryshme dhe në periudha të caktuara historike (p.sh. [*k*] latine tek *vicinum* shndërrohej në [*ʃ*] e më pas në [*ʃʃ*] në dialektin fiorentin *vicino*, [*ts*] e më pas në [*s*] në atë venecian *visin*).

Pjesa më e madhe e kërkimeve moderne të prodhuara në hapësirën e gjenerativizmit synon të identifikojë norma të tipit “*universal*”, pra, pankronike apo akronike.

AKRONIM

Akronimi (nga greqishtja ἄκρον, akron, “ekstremitet” + ὄνομα, onoma, “emër”), është një fjalë e formuar me shkronjat ose rrokjet nistore (ose ndonjëherë edhe fundore), ose më gjerësisht nga renditja e një ose më shumë shkronjave të disa fjalëve të një fraze ose një emërtimi, të lexueshme sikur të ishin një fjalë e vetme, pra, është një shkurtesë, p.sh. : OKB, KE, RTSH, KESH etj..

Karakteristika thelbësore e akronimit është të lexuarit si një fjalë e vetme e shkronjave, rrokjeve ose grupeve të shkronjave të njëpasnjëshme që përbëjnë akronimin, të cilat jo domosdoshmërisht mund të jenë vetëm shkronja e parë e fjalëve, për shembull: *lazer* (*Light Amplification by Stimulated Emission of Radiation*), por edhe radar (*RAdio Detection And Ranging*), *algol* (*ALGOriithmic Language*) etj..

AKS

Me *akse të gjuhës* nënkuptojmë rrafshet mbi të cilat ushtrohet veprimtaria mendore e qenieve njerëzore në lidhje me gjuhën. Fillimisht ishte gjuhëtari zviceran Ferdinand de Saussure (1857-1913) ai që identifikoi dy lloje

kryesore të marrëdhënieve midis elementeve gjuhësore, të cilat i quante “*marrëdhënie sintagmatike*” dhe “*marrëdhënie asociative*”. Kështu, sipas Saussure, veprimtaria e folësit nënkupton qoftë një renditje “*horizontale*”, të përfaqësuar nga radhitja e tingujve të transmetuar konkretisht, ashtu edhe një renditje “*vertikale*”, të përfaqësuar nga marrëdhënie ndërmjet njësive të ndryshme të gjuhës që i përkasin të njëjtës klasë morfosintaksore dhe/ose semantike dhe që janë praktikisht të zëvendësueshme.

Në këtë mënyrë, përshkruhet një *aks sintagmatik*, mbi të cilin është strukturuar marrëdhënia sintagmatike midis elementeve gjuhësore, dhe një *aks paradigmatic*, (siç do të përcaktohet më pas nga gjuhëtari danez Louis Trolle Hjelmslev), i cili ka të bëjë më tepër me semantikën e elementeve gjuhësore të përfshira në ligjërim.

Pra, aksi horizontal është sintagmatik, ai tregon mënyrën e renditjes së fjalëve (sintaksë), kurse aksi vertikal është paradigmatic, ai tregon shoqërimet e mundshme semantike.

Sa i përket *aksit sintagmatik*, fonemat janë në një marrëdhënie të tillë ku secila shenjë merr një vlerë të caktuar në raport me kundërvënien që ka me shenjat e tjera bashkekzistuese në një fjalë, në veçanti me ata që e paraprijnë dhe e ndjekin atë.

Përkundrazi, flitet për *aks paradigmatic*, kur kemi marrëdhënie asociative midis elementeve të shenjave gjuhësore, në kuptimin që ekziston një marrëdhënie midis elementeve gjuhësore të vendosura në zinxhirin fonik dhe të tjerëve, alternativë me të parët, të cilat sidoqoftë kujtohen nga një element i përbashkët me ato fakultativë.

Elemente të tilla të përbashkëta mund të jenë semantike (kështu kur themi *mësimdhënie*, mund të nënkuptojmë *edukimin*). Në raste të tjera, mund t’i përkasin të njëjtës paradigmë leksikore (siç është emri *punë* dhe folja *punoj*) ose paradigma fleksionale (siç është emërorja e emrit *puna* dhe dhanorja përkatëse *punës*).

Përsëri sipas terminologjisë së Saussure, marrëdhëniet sintagmatike zhvillohen në prani (*in praesentia*), ndërsa në boshtin paradigmatic, i cili ka një zhvillim “*vertikal*”, elementet gjuhësore në kundërvënie janë alternative për njëra-tjetrën, kështu që ato jepen në mungesë (*in absentia*).



Ndërkohë, gjuhëtari rus Romàn Jakobsòn flet për një “*aks të kombinimit*” (ose “*bashkimit*”) dhe një “*aks të përzgjedhjes*” (ose “*zëvendësimi*”), që korrespondon përkatësisht me boshtin sintagmatik dhe me boshtin paradigmatic.¹

“*Rezervat*” vertikale mund të jenë shoqërime semantike (*mbesë, shoqe, armike, shok* etj.), leksikore (mikeshë për t'u dashur), fleksionale (*bëhet, ishte, do të jetë, nuk është* etj.).

Ky term vjen e përdoret edhe në fusha të tjera ndërdisiplinare të gjuhësisë, si, b.f. në Stilistikë, në Histori gjuhe etj.: *aksi diakronik* dhe *aksi sinkronik*.

AKSIOMË

Aksiomë (nga greq. *Αξίωμα*, *axioma* - vlerë, vleftë) quhet tërësia e formulave të sakta, por të paprovuara, të një sistemi apo një teorie gjuhësore. Pra, është një pohim që shpreh marrëdhënie midis kuptimeve themelore të një teorie që pranohet apriori dhe mbi vërtetësinë e së cilës nuk dyshohet. Fillimisht ky term është përdorur në matematikë. Historikisht, i pari (e për shumë kohë edhe i vetmi) shembull i teorisë matematikore i organizuar aksiomatikisht ka qenë gjeometria euklidiane. Përdoret edhe në fusha të tjera të shkencës, pra edhe në gjuhësi. P.sh. simboli i fillimit të rregullave sintagmatike të një gramatike gjenerativiste është një aksiomë: për shembull simboli Σ (frazë).

AKSIOMATIK

Aksiomatik, që ka karakterin e një aksiome, që nuk ka nevojë për vërtetim, pra, që pranohet si diçka e ditur, p.sh.: *teori aksiomatike, parim aksiomatik, e vërtetë aksiomatike, në mënyrë aksiomatike* etj..

¹ Jakobsòn, Romàn (1963), *Saggi di linguistica generale*, Parigi, cit. te Marchese, cit., lemma *Assi del linguaggio*, fq. 30-31.

AKT

Nocioni i **aktit gjuhësor** (nga angl. *speech acts*) është koncepti kryesor i pragmatikës, baza e studimit të përdorimit të gjuhës në rrethana konkrete². Sipas teorisë së *akteve gjuhësore*, të përpunuar nga dijetarët John Langshaw Austin³ dhe John Searle,⁴ *akti gjuhësor* përbën njësinë themelore të të folurit, duke u konsideruar si aktivitet konvencional i përfshirë në kontekste të sakta, në të cilin “*të thuash*” është gjithmonë i barabartë me “*të bësh*”.

Sipas kësaj teorie, të përdorësh një gjuhë do të thotë të impenjohesh në një sjellje komplekse, çka nënkupton që kur njerëzit flasin, jo vetëm shqiptojnë fraza që i nënshtrohen gjykimeve të gramatikalitetit (të krijimit të frazave të pranueshme, të ndërtuara mirë nga pikëpamja gramatikore e semantike), por kryejnë edhe veprime që shkaktojnë disa efekte tek bashkëbiseduesit. Këto akte, që i nënshtrohen parimit “*përshtatshmërisë*”, angazhohen në një formë sjelljeje të qeverisur nga rregulla që nuk janë vetëm gjuhësore, por edhe sociokulturore, të veçanta për një bashkësi të caktuar në një fazë të caktuar të historisë së saj. Për shembull, fjalia: *Ja ku është dera*, nga pikëpamja gramatikore është fjali dëftore (që tregon një fakt të caktuar), ndërsa në këndvështrimin pragmatik mbetet një fjali që mund të shprehë edhe një ftesë ose një urdhër për t’u larguar nga ai vend, gjë që mund të shkaktojë ndryshim të sjelljes së bashkëbiseduesit (ta detyrosh të ikë). Me fjalë të tjera, akti gjuhësor, është një formë kumtimi që ka për qëllim të *zbulojë synimet e folësit dhe në shumicën e rasteve të provokojë kundërveprime të caktuara tek bashkëbiseduesit*⁵

Një kërkesë, një konstatim, një premtim, një falënderim, një urdhër, një deklaratë etj. janë akte gjuhësore, domethënë janë veprime të mirëfillta që kryhen në mënyrë universale në të gjitha rastet e ndërveprimit dhe të bisedës.

Ishte filozofi analitik J. L. Austin, ai që, ndërmjet viteve 1951 dhe 1955, bëri teorizimin sistematik dhe klasifikimin e parë të përdorimeve të gjuhës, duke ofruar tri nivele të përshkrimit apo tri lloje aktesh:

- akt lokutor,
- akt ilokutor,

² Sbisà, Marina (1978), *Gli atti linguistici-Aspetti e problem di filozofia del linguaggio*, Milano, Feltrinelli.

³ Austin, J. L. (1962), *How to do things with words*, London: Oxford University Press.

⁴ Searle, J. R. (1969), *Speech Acts*, Cambridge University Press.

⁵ Gjata, Lindita (2010), *Teksti argumentues*, Geer, Tiranë, f. 28.

- akt perlokutor.

Në vitet e mëpastajme janë propozuar edhe klasifikime (taksonomi) të tjera të akteve gjuhësore (për shembull nga J. Habermas⁶ më 1967 dhe nga J. R. Searle⁷ më 1969).

1. *Akti lokutor* (ang. *locutionary act*) është akti me të cilin prodhohet një frazë duke iu nënshtruar rregullave gramatikore të gjuhës. Për shembull fjalia: *Kjo është dera*, është një *akt lokutiv* në të cilin ka një strukturë të caktuar fonetike, leksikore, sintaksore dhe semantike. Pra, ai është thjesht akti i të thënit diçka. Sipas Austin, *akti lokutor* përbëhet nga prodhimi i disa tingujve të caktuar (akti fonetik), të organizuara në fjalë të caktuara dhe të pajisur me një strukturë sintaksore (akti fatik), në gjendje të prodhojë një njësi gjuhësore të pajisur me një kuptim të caktuar (akti retik). Pra, tërësia e këtyre tre akteve përbën aktin lokutor.
2. *Akti ilokutor* është niveli më i rëndësishëm i aktit gjuhësor, ashtu siç kuptohet nga teoria e J. L. Austin (1962), pra, niveli në të cilin realizohet një ndryshim i kontekstit dhe që saktëson në mënyrë thelbësore idenë e gjuhës si mënyrë të vepruari.

Kjo do të thotë se çdo *akt gjuhësor*, përveç se zotëron një vlerë *lokutore*, ka gjithashtu edhe një vlerë që nuk varet nga përmbajtja, por nga mënyra e vetë frazës: pikërisht ky është një *akt ilokutor*. Ndërkohë që *akti lokutor* përfundon në dimensionin sintaksor dhe semantik, ai *ilokutor* shkon përtej këtyre hapësirave, duke u vendosur në mënyrë të veçantë në dimensionin pragmatik dhe në dinamikat ndërvepruese, pra, ai prodhon diçka duke thënë diçka.

Sa herë që themi diçka (*akti lokutor*), realizojmë automatikisht një veprim (urdhërojmë, pyesim, ndalojmë, kërkojmë falje, falënderojmë dikë etj.). Pra, kjo thënie mund të jetë një urdhër, një pyetje, një përgjigje, një sugjerim, një thirrje etj.. Për shembull, shqiptimi i frazës së mësipërme *Ajo është dera*, përveç se një *akt lokutiv*, përbën edhe një *akt ilokutiv*, sepse urdhëron ose fton dikë që të lëvizë: të dalë jashtë apo të hyjë brenda. I njëjti *akt ilokutiv* mund të realizohet në forma të ndryshme gramatikore; bie fjala, kjo kërkesë mund të shprehet edhe në formë urdhëri: *Dil jashtë!* ose në një mënyrë indirekte, me mirësjellje gjuhësore, realizuar me anë mjeteve intonative.

Kjo forcë *ilokutore* mund të manifestohet në mënyra të ndryshme:

⁶ Habermas, Jurgen (1967, 1990), *On the Logic of the Social Sciences*, The MIT Press, ISBN 0262581043.

⁷ Searle, J. R. (1969), *Speech Acts*, Cambridge University Press.

nëpërmjet një pjesëze, mënyrës së foljes, intonacionit, të ashtuquajturave “*folje interpretuese*” (ose performative, p.sh.: *premtoj, urdhëroj, betohem, pranoj, mbroj* etj.⁸) apo kontekstit, p.sh., në frazën “*Ke shkuar te mjeku?*”, tregues i forcës ilokutore është intonacioni pyetës. Këta tregues nuk janë gjithmonë lehtësisht të identifikueshëm. Ndonjëherë ato janë të rrënjësor në strukturën e thellë të fjalisë. Aktet gjuhësore, të klasifikuara nga Austin⁹, sipas forcës së tyre ilokutore, janë pesë:

- a. *akte vendimore,*
- b. *akte ushtrimore,*
- c. *akte të kryerjes,*
- d. *akte të sjelljes,*
- e. *akte të paraqitjes.*

Këto akte, të cilat taksonomia austiniane i përshkruan veç e veç, në praktikën e vërtetë komunikative njerëzore, janë shpesh të ndërlidhura ndërmjet tyre.

Ndërsa ky akt - që mund të jetë edhe i tërthortë - është përkufizuar si ilokutor, forca e tij është qartësuar nga një folje, e quajtur interpretuese e cila shprehet në vetën e parë, njëjës, koha e tashme e dëftores

3. ***Akti perllokutor*** është akti i të prodhuarit, me anë të të thënit, të efekteve mbi bashkëbiseduesin (qëllimisht ose jo). Ai përbëhet nga pasojat e shkaktuara apo nga rezultatet e arritura përmes *aktit ilokutor*. Ai është një proces i fokusuar tek marrësit dhe jo një forcë konvencionale (ndryshe nga *akti ilokutor*), si dhe i çliruar nga normat e gjuhës ose nga sisteme të tjera shenjash konvencionale. Në hapësirën e akteve perllokutore Austin dallon arritjen e një qëllimi (*perlocutionary object*) dhe prodhimin e pasojave (*perlocutionary sequels*).

Një akt gjuhësor perllokutiv është atëherë kur me anë të një thënieje arrihet një qëllim ose prodhohet një efekt, i dëshiruar ose jo nga bashkëbiseduesi; fjala vjen, shqiptimi i fjalisë *Ajo është dera*, është akt perllokutiv, në qoftë se bashkëbiseduesi largohet, ndjehet i ofenduar ose shpërthen në vaj. Duke thënë diçka, folësi synon të zgjojë ndjenjat, të stimulojë mendimet apo të prodhojë veprime tek ai që dëgjon.

⁸ Morpurgo-Tagliabue, Guido (1980), *Demetrio, dello stile*, Roma: Ed. dell'Ateneo.

⁹ Austin, J. L. (1962), *How to do things with words*, London: Oxford University Press, fq. 108-120.

AKTANCIAL

1. Quhet *model aktancial* i një rrëfimi (tregimi) një model me të cilin mund të realizohet një strukturë narrative nga marrëdhëniet e vendosura në mes të aktantëve apo aktorëve të një tregimi, përralle, miti etj., përfaqësuar nga qeniet frymore apo jofrymore.
2. Në semantikën strukturore, *modeli aktancial*, i quajtur ndryshe edhe *skemë narrative aktanciale*, është një mjet i përdorur për të analizuar veprimin që zhvillohet në një tregim, real qoftë apo imagjinar.¹⁰
3. *Fjali aktanciale*, sipas gjuhëtarit francez Lucien Tesnière, janë ato fjali që luajnë rolin e një aktanti, pra, kanë aftësinë të shndërrohen në aktantë. Në periudhën *Mira shpreson se do të ketë sukses*, fjalia e varur *se do të ketë sukses*, që luan rolin e një aktanti (*se do të ketë sukses* zë vendin e *në sukses*), quhet fjali *aktanciale*.
4. *Struktura e aktanciale* e një gjuhe (nganjëherë quhet rreshtim sintaksor, shtrirje morfosintaksore) tregon mënyrën në të cilën gramatika e saj organizon marrëdhëniet midis llojeve të ndryshme të foljes dhe aktantëve kryesorë në frazë. Ajo është një element i rëndësishëm në përcaktimin e tipologjisë së gjuhëve.

AKTANCË

Aktancë (frëngjisht: *l'actance*) është një term i sintaksës dhe i gramatikës deskriptive, që përshkruan marrëdhëniet midis foljes-kallëzues dhe aktantëve (argumenteve emërore) të tij në frazë, të cilët mund të jenë subjekt (kryefjalë), objekt i drejtpërdrejtë (kundrinë e drejtë) ose objekt indirekt (kundrinë e zhdrejtë) i foljes. Në frëngjisht, termi *aktancë* ka kuptimin e përgjithshëm të studimit të aktantëve (argumenteve) të foljes në frazë.

AKTANT

Aktant (nga lat. *actio*, aksion, veprim) është term i futur në sintaksë nga gjuhëtari francez Lucien Tesnière, më 1959.

1. Emri *aktant* i është dhënë vetës që kryen veprimin e treguar nga folja (jokalimtare) ose grupit foljor të formuar nga folja dhe objekti i saj (kalimtare). Ai i përgjigjet pyetjes së nënkuptuar *çfarë bën X?*, ku X është aktanti ose agjenti i veprimit.

¹⁰ Herbert, Louis (2006), *The Actantial Model*, in Louis Hébert (dir.), Signo [online], Rimouski (Quebec), <http://www.signosemio.com>

2. Në analizën strukturore të tregimit, *aktanti* është protagonist i veprimit, i dallueshëm nga marrësi (pësuesi); *aktanti* dhe përfituesi i veprimit (pësuesi) në raste të caktuara mund të përkojnë me të njëjtin person.
3. Tesniere quan *aktantë* njësitë që përcaktojnë qenie ose gjëra që, në një mënyrë ose në një tjetër, marrin pjesë në veprimin e shprehur nga folja. Kështu, në frazën *Vera i jep një karamele djalit të saj*, edhe emrat *karamele* dhe *djalë*, të cilët nuk përfaqësojnë atë që kryen veprimin, janë *aktantë*. Aktantët janë gjithmonë emra ose ekuivalentë me ta.
4. *Aktantë*, sipas teorisë sintaksore të Tesnière, janë elementet që “plotësojnë” valencën e një foljeje, d.m.th. ato që detyrimisht duhet të përdoren së bashku me foljen. Në këtë kuptim foljet janë të karakterizuara nga numri i aktantëve që mund të kenë. Kështu ka folje pa aktant, si: *vetëtin, bubullin, veson, bën ftohtë* (folje zerovalente); folje me një aktant, si: *eci, hyj, shkoj, vdes, fle, ndodh, ngjan* etj. (folje njëvalente); folje me dy aktantë, si: *shoh, dua, hap, besoj* etj. (folje dyvalente); folje me tre aktantë *them, jap* (folje trevalente). Në këtë kuptim termi *aktant* është përdorur si sinonim i termit argument.
5. Tesniere i konsideronte funksionet e foljes si më të rëndësishmit, prandaj ai përdori termin *aktant*, duke i klasifikuar ato në:
 - “*aktanti kryesor*”, rasa emërore,
 - “*aktanti i dytë*”, rasa kallëzore,
 - “*aktanti i tretë*”, rasa dhanore.

Ky koncept i *aktantit* është i ngjashëm me atë të argumentit.

Kurse studiuesi lituanez Algirdas Julien Greimas ripërcaktoi *aktantët* si 3 palë “*modulime*”, duke i klasifikuar në:

- *aktanti-subjekt* dhe *aktanti-objekt* i veprimit,
- *aktanti-dërgues* dhe *aktanti-marrës* i informacionit,
- *aktanti-mbështetës* dhe *aktanti-kundërshtues* i vullnetit.

Aktanti i parë është subjekt në frazën aktive, aktanti i dytë objekt në frazën aktive dhe kundër-subjekt në frazën pasive (në fjalinë *Beni godet Gertin*; *Beni* është aktanti i parë – subjekt; *Gerti*, i goditur nga *Beni* është kundër-subjekt, është aktanti i dytë). Aktanti i tretë përcakton atë që kryen ose pëson veprimin (plotësi i tërthortë, plotësi i dytë ose plotësi i ndarjes). Kjo lloj analize u përfshi si në studimet gramatikore, ashtu edhe në analizën strukturore të rrëfimit.

AKTIONSART

1. Termi *aktionsart* (me origjinë gjermane) është përafërsisht ekuivalent me termin anglisht *aspekt leksikor* ose lloj veprimi. Ai lidhet me

kallëzuesin (kryesisht atë foljor), sidomos me përbërjen e brendshme të përkohshme të një lloj situatë të shënuar nga një folje - kallëzues e caktuar¹¹ (Bache 1985: 10).

Aksionsart është nocion semantik që ka të bëjë me klasifikimin e foljeve në bazën e disa veçorive karakteristike të kuptimit të tyre, kryesisht sa i takon llojit të veprimit që ata shprehin. Ai ka të bëjë me mënyrën në të cilën folja është strukturuar në lidhje me kohën. Çdo veprim, gjendje ose proces që shpreh një folje, mund të thuhet se ka të njëjtin aspekt leksikor.

Aspekti leksikor dallohet nga aspekti gramatikor: aspekti leksikor është pjesë e pandarë e një ngjarjeje (semantik), ndërsa aspekti gramatikor është pjesë e një realizimi (sintaksor apo morfologjik). Aspekti leksikor është i pandryshueshëm, ndërsa aspekti gramatikor mund të ndryshohet sipas dëshirës së folësit. Për shembull, *hani një mollë* ndryshon nga *uluni*, mbasi ka një përfundim natyror ose konkluzion (*të ngrënit e një molle*). Por, këtu ka një kohë në të cilën veprimi i *të ngrënit* ka mbaruar, është përfunduar ose është realizuar. Në të kundërt, veprimi i *të ulurit* nuk mund të ndalohej: nëse shtojmë më shumë detaje, ka pak kuptim të thuhet se dikush “*përfundoi*” të ulurin, duke thënë se “*e ndaloj*” të ulurin. Ky është një dallim i aspektit leksikor midis dy foljeve.

Në këto kushte foljet që kanë përfundime natyrore janë quajtur “*telike*” (nga greqishtja e lashtë *telos*, fund); ata që nuk kanë janë quajtur “*atelike*”.

Klasifikimi më me ndikim i *aktionsartit* deri më sot është bërë nga studiuesi Zeno Vendler¹². Ai dallon katër lloje të situatave të mundshme:

- *gjendje*, futen disa folje që nuk tregojnë veprime, por që përshkruajnë një gjendje, siç është p.sh.: *njoh, gjej*;
- *realizim*, futen folje që tregojnë ndryshime të papritura të gjendjes, si: *arrij në majë të malit*;
- *veprimtari*, futen folje që tregojnë veprime që ndodhin në periudha kohore jo të kufizuara, p. sh.: *ec*;
- *performancë* ose *përmbushje*, futen folje që tregojnë ndryshime në gjendje, që ndodhin me kalimin e kohës, siç është *plakem*.

¹¹ Bache, Carl (1985), *Verbal Aspect: A General Theory and Its Application to Present-Day English*, Odense: Odense University Press, fq. 10.

¹² Vendler, Zeno (1967), *Verbs and times*, in *Linguistics in Philosophy*, Ithaca (New York), fq. 97-121.

Këto katër kategori kryesore të *Aktionsart* mund të grupohen në dy grupe :

- “*folje telike*” (nga greqishtja e lashtë *telos*, fund) ku përfshihen foljet që kanë përfundime natyrore, kanë një pikë kulmore dhe një fund. Këtu futen foljet e *realizimit* dhe foljet e *përmbushjes*.
 - “*folje atelike*”, pra, ato folje që tregojnë një veprim që nuk është i kufizuar nga ndonjë përfundim: në këtë kategori bëjnë pjesë foljet e veprimtarisë dhe të gjendjes.
2. Në një kuptim më të veçantë, aktual në studimet sllave (sllavistikë) e gjermane (gjermanistikë), termi ***aktionsart*** nënkupton edhe disa ndajshitesa të cilat janë të afta të ndryshojnë vlerën bazë të foljes, si p.sh. parashtesa *za* në rusisht, që i paravendoset foljes për të treguar fillimin e një veprimi, p.sh.: *pet - këndoj, zapet - filloj të këndoj* etj..

BIBLIOGRAFI

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2002), *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë.
- Austin, J. L. (1962), *How to do things with words*, London: Oxford University Press.
- Bache, Carl (1985), *Verbal Aspect: A General Theory and Its Application to Present-Day English*, Odense: Odense University Press, fq. 10.
- Beccaria, G.L. (2004), *Dizionario di linguistica e di filologia, metrica, retorica*, Piccola Biblioteca Einaudi.
- Belluscio, G. & Rrokaj, Sh. (2011), *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë*, Arbëria, Tiranë.
- Dubois, J. & Giacomo, M. & Guespin, L. & Marcellesi, Ch. & Marcellesi, J. & Mevel, J. (2001), *Dictionnaire de linguistique*, Larousse, ISBN : 2-03-532047-X.
- Gjata, Lindita (2010), *Teksti argumentues*, Geer, Tiranë, f. 28.
- Herbert, Louis (2006), *The Actantial Model*, in Louis Hébert (dir.), Signo [online], Rimouski (Quebec), <http://www.signosemio.com>
- Jakobsøn, Romàn (1963), *Saggi di linguistica generale*, Parigi, cit. te Marchese, cit., lemma *Assi del linguaggio*
- Leka, Ferdinand (2013), *Fjalori i termave të letërsisë*, INFBOTUES, Tiranë, ISBN 978-9928-173-11-9.
- Sbisa, Marina (1978), *Gli atti linguistici-Aspetti e problem di filozofia del linguaggio*, Milano, Feltrinelli.
- Searle, J. R. (1969), *Speech Acts*, Cambridge University Press.
- Vendler, Zeno (1967), Dubuc, R. (1992), *Manuel Pratique de terminologie*, Liguattech: Brossard.
- Vendler, Zeno (1967), *Verbs and times*, in *Linguistics in Philosophy*, Ithaca (New York)

The Terminology as a system***ABSTRACT***

This article comes is a continuation of the article with the same title which was published in the previous publications. In it, 15 language terms have been explained, which we come across in the field of literature, both in contemporary and traditional one. In our explanations, we have tried to preserve the particular characteristics that often reflect the original value they have, according to different linguistic theories or which might be revised by the Science of Albanian Language to different concepts.

Evalda PACI

**RRETH NJË TRADITE STUDIMORE MBI INICIMIN E
LËVRIMIT TË SHKRIMIT SHQIP DHE REFLEKTIVE
TË MUNDSHME TË ZHVILLIMEVE EVROPIANE
(SHEKUJT XVI-XVII)**

Çështja e shqyrtimit dhe e studimit më të thelluar të teksteve biblike që për më tepër të orientojnë drejt periudhash më të hershme të zhvillimit të mendimit filozofik, dijes njerëzore dhe kushteve të ndryshme të përpilimit të librave, botimeve dhe ruajtjes së dorëshkrimeve duhet të marrë parasysh në çdo rrethanë dhe ndikimin gjegjës që teknologjia e realizimit të kësombllave dhe raporti me burimet e konsultuara ka luajtur pothuaj në çdo rasë. Një traditë e pasur dhe solide ekzemplarësh që për më tepër ofron dhe të dhëna mbi ekzistencën e vepërave që në jo pak raste rezultojnë të jenë më të përmbushura dhe falë prurjeve figurative që me tiparet e tyre unike janë dëshmi e kohës dhe e ndikimit të disa disiplinave në realizimin e tyre, shërben dhe sot e kësaj dite për të krijuar një ide mbi një tranzicion të pashmangshëm në formate librash që qytetërimi do të mësohet t'i quajë dhe konsiderojë fryt i një metodologjie të re teknike, asaj të shtypshkrimit. Një fazë më e hershme që ruan si relike për brezat pasardhës imazhe libërthash, doracakësh, modelesh librare të përmasave dhe vëllimeve të ndryshme, praktika ikonografike që mahnisin me ngjyrat dhe figuracionin gjegjës, dëshmon gjithashtu sa i rëndësishëm ishte për individin dhe përdorimi i teksteve të personalizuar, duke qenë pikërisht në këta shekuj mjaft i përhapur dhe modeli a praktika e porositjes dhe e realizimit të librave të orëve, që në mjaft raste dhe shërbejnë për të konkretizuar afri dhe diferencime mes vendesh, visesh dhe personalitetesh. Janë pikërisht ekzemplarë të tillë dhe mundësi për të qëmtuar në pasazhe të caktuara elemente që rimerren dhe në Pesëqindën në librat që evokojnë të njëjtën traditë liturgjike, por sigurisht me diferencime që mund të diktohen nga një sërë faktorësh, ndër të cilët dhe fakti që ndonjëherë Oficja që tradicionalisht rimerrej në këta libra, i bashkëngjitej një kompleksi libror më gjithëpërfshirës, që kishte në vetvete dhe liturgjiarin dhe ecurinë e meshëve që duhej të thuheshin a mbaheshin gjatë vitit kalendarik liturgjik, pa përjashtuar psalmet, litanitë dhe lutje të tjera që zakonisht përmbahen në ritualin roman. Diversiteti në brendi dhe elemente përmbajtësore të librave të orëve mund të gjejë jo pak shpjegime nga ana e studiuesve të periudhave në të cilat këto të fundit ishin vërtet objekt jo vetëm i përpilimit më konkret të

një praktike që përfshinte individin e më tej komunitetin me të cilin ky i fundit ishte i lidhur, por dhe i praktikave miniaturiste dhe artistike që në shumë raste vetëm se shtojnë më shumë vlerat e disponimit të një trashëgimie të tillë kulturore. Do të përbënte një argument mjaft interesant jo vetëm renditja e disa reflektimeve mbi vlerën që në ditët e sotme paraqesin kësombllat përkatëse të këtyre veprave, ndikimin në ecurinë e praktikave të shtypit dhe të përpilimit të ekzemplarëve të veçantë në traditën përkatëse liturgjike, por dhe gjurmimi i një ndërlidhjeje më se të arsyetueshme dhe sa i përket pasqyrimin të kësaj të fundit dhe në historinë e librit në gjuhën shqipe, më saktë të veprave të letërsisë së vjetër shqipe, falë të cilave shënohet dhe inicimi i një vijimësie kulturore dhe shkrimore që na lidh me zhvillimet e kohës në Evropë dhe Ballkan. Ekzistenca dhe evidentimi në indice konkrete i Offices së Vogël të Zojës vihet në dukje dhe nënvizohet në pikëpamje tiparesh dhe tekstesh nga studiuesit më të afërt të librit të Gjon Buzukut(1555), bashkë me faktin që mungesa e faqeve që duhej të përmbanin dhe elemente të domosdoshme eksplikative dhe ilustruese për krejt veprën përbën një problematikë që pret prej vitesh një saktësim të domosdoshëm për njohjen e saktë të historikut të saj.

Përkthimet e tekstit biblik në gjuhët e Evropës kanë qenë e mbeten objekt i një vëzhgimi në thelb ndërdisiplinor, po që nuk mund të mos kenë prioritare një përmasë që lidhet me një vetëdije të natyrshme që në syrin dhe botëkuptimin e përpiluesit a përpiluesve reflektohet në disa elemente përmbajtësore dhe teknike. Natyrisht që dhe kërkimi a gjurmimi i një lidhjeje mes zhvillimeve të kohës që ndikojnë drejtpërdrejt në kulturën librore dhe elemente të transmetimit të dijes falë shtypshkrimit dhe inicimit të tij në disa vende evropiane duhet parë në bashkëpërkim me çka parashtrajmë zakonisht kur bëjmë fjalë për veprat që shënuan një periudhë me rëndësi për shkrimin shqip dhe modelet me të cilat ky i fundit u shënuan në pikëpamje realizimi dhe arritjesh konkrete. Historiku i realizimit për shtyp të mjaft veprave që paraqiteshin me rëndësi për tematikën që trajtonin dhe për vetë paracaktimin konkret të tyre përbën mundësi verifikimi në lidhje me lejimin për shtyp apo dhe me një rishikim të mundshëm për arsye të ndryshimeve që mund të ndodhnin pikërisht pas daljes në dritë të shtypit të tyre. Kultura librore e kohës është shënuar nga një sërë rrethanash që jo gjithmonë duket se favorizonin lexueshmërinë e librave dhe manualeve me tematikë të përcaktuar nga historia e religjionit, teologjia e krishterë, letërsia artistike(në veçanti ajo klasike) e nga vetë historia e filozofisë, por dhe një fakt i tillë duhet parë si shfaqej në vise të ndryshme dhe në periudha konkrete. Një gjë është mjaft e qartë: debutimi kryesisht në viset italice i një kulture shtypshkrimi që favorizonte realizimin për shtyp të një sasive të

konsiderueshme librash e doracakësh do të përbënte një faktor ndikues dhe në përballjen me një prurje të pazakontë veprash me të cilat përfaqësoheshin kategori të caktuara shoqërore, të interesuara për të qenë aktorë të një konteksti kulturor e politik. Protagonistë të këtij skenari do të jenë shtypshkruesit, stampatorët, librarët, botuesit, por mbi të gjitha vetë autorët e veprave në fjalë. Kompetencat e editorëve, botuesve, kuratorëve të vëllimeve që do të shihnin dritën e botimit, roli i autorëve vetë në realizimin për shtyp të tyre janë elemente të një konteksti mjaft interesant që në dritën e kohës për të cilën flitet, përbëjnë një panoramë vërtet komplekse e të bartur me veçanti të ndryshme. Janë shekuj që shënohen ndjeshëm nga të tilla inovacione teknike dhe tipografike, në të cilët dhe personalitete të caktuara gjetën mënyrën për të ndikuar me pikëpamje, vendime, veprime dhe vepra konkrete, një pjesë e të cilave qenë dhe shtypa për ngjallje polemikash në disa fusha të mendimit e të dijes njerëzore. Çdonjëri nga shekujt që do të merren në analizë në përbërje të kësaj trajtese do të jetë i lidhur me ndryshime që pasojnë njëri-tjetrit dhe që natyrshëm do të shihet se kanë ndikuar dhe në zhvillime të kulturës së librit dhe të shkrimit në vise me të cilat dhe vetë kisha e Romës kishte marrëdhënie prej kohësh. Vetë modelet që u propozuan në formate herë të thjeshta nga pikëpamja e ndërtimit, herë më komplekse e më afër librave që për kohën ishin dhe ekzemplarë të një destinacioni me rëndësi për meshtarët dhe besimtarët, dëshmojnë që një ndikim i tillë ishte përherë i pranishëm në format e adaptuara në të shkruar e përpilim prej autorëve të letërsisë së vjetër shqipe.

Janë me interes të veçantë zhvillimet gjegjëse në shekujt në të cilët kanë parë dritën e shtypit veprat e para të letërsisë së vjetër shqipe dhe pikërisht periudha që konstatohet prej vetë autorit të *Mesharit* në përmbyllje të librit të tij aq të ndërmendur në studimet tona është e shënuar nga përpjekje për reformime dhe ndryshime në konceptimin dhe realizimin e veprave të asaj natyre.¹ Proceset mirëfilli evolutive që njohu në viset tej

¹ Shtypshkrimi si proces dhe si fenomen përfshiu pa dyshim një rreth të gjerë dijedashësish në Evropë dhe njëkohësisht ndikoi në zhvillime të panjohura deri në atë kohë, që do të kishin të bënin natyrshëm dhe me transmetimin e Shkrimit të Shenjtë dhe me një sërë kompetencash që më parë mbulohehin nga kopistët, të konsideruar shkruar të teksteve, po që sigurisht me njohuritë relative që zotëronin ishin dhe "autorë" në çështje të transmetimit të brendisë dhe të elementeve teknike të ndërtimit të teksteve që kujdesonin. Studime jo të pakëta janë përvijuar pikërisht mbi Biblën e shtypur, në kuptimin e varianteve përkatëse që u realizuan pas inicimit të shtypit si praktikë dhe si kulturë e njohjes së librit më tej. Një fakt i tillë do të luante rol dhe në pikëpamje të varianteve të dallueshme në aspekte themelore të përpiluara nga Luteri e ndjekës së tij,

Adriatikut kultura e shtypshkrimit, çështja e njohjes dhe e atribuimit të të drejtave të autorit dhe rolit në këtë drejtim të vetë stampatorëve dhe botuesve nuk mund të mos kenë ndikuar në historinë konkrete të veprave mbi të cilat ndërtohet një kapitull i tërë i historisë së shkrimit shqip.² Pavarësisht paqartësive që shpjegohen dhe me mungesë indicesh konkrete në lidhje me dokumentet shkrimore më të hershme të historisë së gjuhës së shkruar shqipe, një ndikim i tillë mund të gjurmohet dhe nga vetë elementet që njoftohen nga autorë të letërsisë së vjetër shqipe, ndër të cilët dallohet veçanërisht Pjetër Bogdani, përpilues i veprës *Cuneus Prophetarum*(Patavii, 1685). Një periudhë si ajo e letërsisë së vjetër shqipe, emërtuar nga disa studiues si letërsi ungjillore, por dhe ekleziastike mbart dhe një karakteristikë themelore që me të drejtë ndikon t'i atribuohen të tilla emërtime, në veçanti dy të fundit. Përdorimi i gjuhëve të vendit, aq më tepër për një lëndë që në atë kohë iu nënshtrua rishikimeve tejet përmbajtësore dhe rrënjësore nga hierarkia kishtarë e kohës, përbën të parën premisë për t'u konsideruar bashkë me faktin e peshimit të shkallës së përshtatshmërisë së teksteve në fjalë për botimet në të cilat dhe panë dritën e shtypit.³ Shekulli në të cilin botohet libri i Gjon Buzukut në të

si dhe nga aktorë të Kundërreformës, emri i të cilëve mbetet pazgjidhshmërisht i lidhur me këto ndryshime të sipërcituara e me botime konkrete të librave që janë pjesë e Besëlidhjes së Vjetër, apo Ungjijve që bëjnë pjesë në Besëlidhjen e Re. Kultura e njohjes së Biblës së shtypur do të njohë një prirje të re zhvillimi në veçanti pas gjysmës së dytë të shekullit XV, pikërisht mbas shpikjes së shtypit falë Gutenbergut dhe realizimit në vijimësi të Besëlidhjes së Re në veçanti nga autorë që kishin qëllim të tyrin të përhapnin pikërisht këtë të fundit në gjuhë të ndryshme nga latinishtja. Duhet njohur një moment i tillë si një hap vendimtar në zhvillimet e njohjes dhe të kulturës së kësaj dukurie, duke qenë vetë mediumi konkret i cituar(shtypi) një faktor që i ndihmon të dyja këto elemente, njëkohësisht dhe nxitës për përpilime të reja të të interesuarve për të qenë aktorë të një skenari historik të papërsëritshëm. Është pikërisht periudha në fjalë që jo vetëm do të shpjerë në mënyrë të pashmangshme në përpilime inovatore dhe në pikëpamje të realizimit teknik e tipografik, por dhe që do të jetë shtysë për parashtrimin e rregulloreve që kanë të bëjnë me lejet e shtypit dhe të ribotimit për libra që lidhen me dije specifike, në veçanti dhe me shkencat e natyrës.

² Castellani C., *I privilegi di stampa e la proprietà letteraria in Venezia*, në "Archivio veneto", XXXVI, 1888.

³ Studimet kryesisht historike dhe kulturore mbi periudhën e Reformës dhe Kundërreformës, që marrin parasysh dhe rrjedhojat e një ngjarjeje vendimtare siç ishte inicimi i shtypshkrimit në vende të Evropës e për më tepër në ato vende në të cilat ishte i fortë ndikimi i katolicizmit dhe i praktikës së liturgjisë sipas riteve të përcaktuara deri në atë kohë, janë dhe një pasqyrë e pikëpamjeve jo përherë të njëjta mbi lejimin a moslejimin e përdorimit të teksteve specifike që mund të transmetoheshin dhe në gjuhë të ndryshme nga latinishtja. Janë pikërisht dy shekuj në veçanti në lidhje me të cilët dhe

vërtetë shënohet nga ndryshime që po të shihen me një sy veçanërisht kritik dhe në kërkim të një lineariteti të justifikueshëm, bëjnë të mendosh për rishikime pikëpamjesh dhe mendimesh nga vetë përpiluesit e indekseve të veprave që duhej të ndaloheshin për konsultim a përdorim. Afërsisht me vitin që i atribuojmë daljes në dritë të shtypit të kësaj vepre aq me rëndësi për studimet tona aktivizohen dhe korpuse që në të vërtetë përfaqësojnë indekse të përcaktuara mbi librat që duheshin parë me një vëmendje të rreptë rishikimi dhe kriticiteti nga autoritetet kishtarë hierarkike, apo dhe që duheshin ndaluar nga qarkullimi dhe konsultimi.⁴ Një fakt i tillë, i trajtuar në detaje dhe nga studiues të vetë periudhës për të cilën bëhet fjalë, besojmë se në njëfarë mënyrë mund të ndihmojë të krijohet një ide më e qartë mbi vetë lejueshmërinë a mundësinë për lejim përdorimi të një vepre në gjuhën shqipe si ajo e vitit 1555, ndërkohë që kompleksiteti përmbajtësor që konsiston në të është një tjetër element që të orienton dhe ndaj hapash që u ndërmorën në atë kohë, dhe vit pas viti ndaj modelesh që mund të gjinden të përmbajtura dhe te libri i Gjon Buzukut. Paqartësia që lind sa herë i rikthehemi faktit të dëmtimit apo eliminimit fizik të faqeve të para të këtij libri jo vetëm që shpie në hipoteza mbi përmbajtjen e mundshme që duhej të kishin këto të fundit nëse do të ishin pjesë plotësuese e Ofices që rezulton në ato pjesë që arrijmë t'i konsultojmë fizikisht, por dhe mbi mundësinë e shprehjes po aty të detajeve që nuk arrijmë t'i qëmtojmë vetëm nga ç'thuhet në pasthënien e tij.

Bibla e transmetuar në gjuhët e vendit nuk duket se ka patur përherë të njëjtën vijimësi njohjeje dhe aprovimi dhe ndërkohë do të shihet se revizionimit në kuptimin e mirëfilltë të fjalës do t'i nënshtrohet *Vulgata* vetë, e cilësuar dhe si *Vulgata Sistoklementine* dhe që duket që ka pasur një përhapje të gjerë në viset italice pikërisht në këtë periudhë.⁵ Do të jetë po

mund të gjurmohet një çështje e tillë, e bërë objekt studimi dhe nga studiues që shohin në një optikë të veçantë zhvillimin e editorisë dhe praktikës së shtypshkrimit në vende, si: Italia, Franca, Gjermania, Spanja etj.

⁴ Disa dekada pas daljes në dritë të shtypit të librit të Gjon Buzukut, por gjithmonë brenda të njëjtit shekull do të shënohen dhe realizime më të thjeshta në dukje e që kanë të bëjnë me kontributin e Roberto Bellarminos S.I. në lidhje me Doktrinën e krishterë dhe variantet më të përshtatshme të brendësimit të saj nga kategori të caktuara përdoruesish dhe lexuesish. Gjuha në të cilën do të botoheshin doracakët kateketikë e liturgjikë mbetet përherë e rëndësishme në vëmendjen e aktorëve të Koncilit të Trentit edhe shumë vite më vonë. Një çështje e tillë do të ndikojë dhe në lexueshmërinë e mjaft veprave të tjera, dhe pse me një tematikë të ndryshme nga ajo fetare.

⁵ Barbieri E., Zardin D., *Libri, biblioteche e cultura nell'Italia del Cinque e Seicento*, Einaudi, Torino, f. 36.

ky shekull që do të karakterizohet dhe nga zhvillime të lidhura me vetë frymën e epokës së emërtuar si e Reformës dhe e Kundërreformës, zhvillime të konkretizuara nga përkthime të teksteve biblike në referim dhe qasje të qartë ndaj gjuhësh të konsideruara burimore: ebraishtja, greqishtja e vjetër etj. Çështja e referencialitetit ndaj këtyre gjuhëve dalloi mirëfilli prirje të motivuara të individualiteteve që u morën me sjelljen e Biblës në gjuhët e vendeve si dhe u bë shtysë për zhvillime polemikash e vështrimesh kritike që zgjatën në kohë dhe karakterizuan ndër të tjera dhe një historik të profilizuar të arritjeve në këtë drejtim.⁶ Në të vërtetë, për të njohur a kuptuar më qartë klimën e kësaj periudhe, vetë ndjekja e ecurisë së mbajtjes apo ndërmarrjes së një ngjarjeje si Konkili i Trentit, i tejzgjatur në kohë dhe procedura, apo dhe përballja nëpërmjet tij me çështjen e argumenteve doktrinare që duheshin përcaktuar më qartë ndihmon për të kuptuar mirëfilli ç'rol i jepej dhe tekstit biblik në gjithë këtë kontekst sa historik, aq dhe politik e antroposhoqëror.⁷

Të tilla referime duket se kanë shoqëruar çdo periudhë të zhvillimit të mendimit gjegjës në lidhje me një problematikë komplekse si ajo e sipërcituara, duke qenë se çdonjëra palë e interesuar ka pasur të qartë vetëdijen që njohja sa më e thellë e teksteve burimore përbën një bazë të qëndrueshme dhe për të rindërtuar interpretime pa të cilat dhe brendësimi i tekstit biblik nuk mund të jetë i mundur. Do të jetë pikërisht dhe referimi gjegjës ndaj gjuhësh që konsiderohen parësore për t'u orientuar ndaj studimesh të thelluara në këtë fushë të dijes që do të dallojë në mënyrë thelbësore dhe autorët më në zë të kësaj periudhe, qoftë luteranët dhe ndjekësit e një linje që synonte me çdo kusht nxitjen dhe inicimin e reformimit në hallkat e hierarkisë kishtare, qoftë dhe teologë të Kishës së

⁶ Janë pjesë e këtij historiku përpjekjet e jo pak personaliteteve evropiane që iu kushtuan përkthimit të Besëlidhjes së Vjetër dhe asaj të Re, ndërkohë dhe duke u dalluar për cilësi të sprovave që realizuan, si dhe për dallime thelbësore qoftë dhe në pikëpamje të referencialitetit ndaj teksteve kryesisht në greqishten e vjetër apo ebraishten. Janë personalitete që ndërmenden pikërisht për arsye të këtyre sprovave dhe në traditën e studimeve mbi përkthimin si prirje studimore, por dhe në atë të studimeve më specifike mbi historinë e besimit të krishterë në këta shekuj. Një traditë e mëvetësishme dhe me mjaft interes do të përvijohet nga botimet që do të ndjekin njëri-tjetrin në vazhde të një procesi të gjatë reformativ, që dhe pse synojnë të jenë reflektim i sjelljes sa më të plotë të Biblës kryesisht në gjuhët evropiane, do të jenë dhe dëshmi e një larmie modelesh që pasurojnë një panoramë realizimesh karakteristike për kohën.

⁷Shih në veçanti Properi A., *Questioni dottrinali*, në *Il Concilio di Trento: una introduzione storica*, Einaudi editore, Torino, 2001, f.51-72.

Romës, që ndërkohë që njihnin më së miri vlerat e njohjes së burimeve më të afërta me realizimet e ungjijve dhe teksteve të tjera të librave të Biblës, nuk nënvleftësonin as dobinë e përafrimit me nocionet themelore dogmatike përmes doracakësh dhe modelesh që do të përvijoheshin më tej konkretisht, mbas përfundimit të punimeve të Koncilit të Trentit. Do të jetë pikërisht kjo periudhë që pason përfundimin e punimeve të këtij koncili që do të dëshmojë dhe realizimin e modeleve librore që reflektojnë ndër të tjera dhe çka synojë përmes tij dhe prej vetë personaliteteve që çuan në konkludime konkrete dhe prirjet kundërreformiste të parashtruara dhe përgjatë zhvillimit të këtyre punimeve.

Trajtimi i shqipërimin të tekstit biblik në veprat e letërsisë së vjetër shqipe kërkon detyrimisht konsiderimin e një faktori që njëkohësisht hedh dritë mbi formimin dhe njohuritë konkrete të autorëve përkatës mbi modelet e kohës dhe përafrimin me një përmbajtje që pikërisht në këtë periudhë bëhet herë pas here objekt i një vëmendjeje revizionimi në pikëpamje të brendisë dhe elementeve të tjera ndërtimore. Një faktor i tillë që ofron dhe një fushë të gjerë diskutimi është pikërisht ai i burimeve referenciale që dhe ndryshojnë në një hapësirë kohore që ndan realizimin e librit të Gjon Buzukut(1555) me variantet doktrinare të Pjetër Budit, të ribotuar dhe pas vdekjes së tij, ndërkohë dhe me mbështetjen e Kongregacionit të Propaganda Fide-s. Në këtë hark kohor pikërisht në lidhje me librin dhe kulturën e religjionit shënohen ngjarje të diktuar nga rrethana mjaft specifike, që shoqërohen nga arritje konkrete në dy linja që kanë të bëjnë si me kishën e Romës, si me prirje që u mbështetën në krye të herës nga ithtarë të protestantizmit në Evropë. Është një periudhë në të cilën konkurrohet mirëfilli për njohjen sa më të mirë të burimeve të teksteve biblike, për brendësim sa më të thellë të gjuhëve të vjetra në të cilat figuronin variante me rëndësi për ezegjezën biblike dhe interpretimin tekstor të vetë pasazheve të Biblës, për qasje sa më autentike dhe sigurisht kompetente ndaj tekstit origjinar dhe elementeve që duhen receiptuar prej tij. *Vulgata latine* mbetet një burim themelor nëse bëhet fjalë për qasje që hedhin dritë mbi sjelljen besnike të tekstit e të mesazhit biblik në shqipen e kohës, ndërkohë variante të Psalmeve dokumentohen pothuaj në të gjitha veprat e letërsisë së vjetër shqipe, sigurisht në mënyra të ndryshme paraqitjeje, e një diversitet i tillë diktohet mandej nga natyra e botimit dhe shkalla e koncizitetit që duhej të respektonte autori. *Vulgata latine* është korpusi tekstor mbizotërues në pikëpamje referencialiteti dhe jo pak gjurmime qoftë dhe në pikëpamje të ndikimeve që dëshmojnë në studiohen nënsisteme të caktuara gjuhësore në një vështrim krahasues mes gjuhëve, e dëshmojnë një fakt të tillë. Për këdo që e njeh nga afër ndërtimin

e *Mesharit*, psalmet zënë një vend të konsiderueshëm të përmbajtjes së pjesës së parë e jo vetëm në atë ndarje që u kushtohet plotësisht të ashtuquajturve *psalma penecialë*.⁸ Gjurmimi i ndikimeve të mundshme nga tekste kryesisht latine në përbërje të librit të Gjon Buzukut, pa përjashtuar praninë e elementeve të përveçme me origjinë greke, italike apo sllave, përbën në të vërtetë një linjë studimore të ndjekur me sukses dhe nga studiues të mirëfilltë të ekdotikës tekstuale në studimet filologjike shqiptare dhe në këtë pikëpamje, këndvështrimet e paraqitura në raste analizash tekstore në përgjithësi gjejnë pika përkimi.

Studimet mbi tekstet e vjetra shqipe janë dalluar dhe nga prirja për të nënvizuar a deduktuar ndikime të kuptueshme nëse bëhet fjalë për zhvillime që lidhen me historinë e besimit të krishterë dhe me reflektimin e reformave që ndërmoi kisha e Romës gjatë Pesëqindës dhe më tej. Kultura librore e kohës, por dhe zgjimi i një vetëdijeje kombëtare që receptohet në pasazhe të caktuara të veprave të letërsisë së vjetër shqipe bën të mundur të rikonstatohet dhe tash një fakt i tillë, si një element që vetëm se risjell në vëmendjen tonë idenë e një shkrimtarie që ruan tipare origjinaliteti që sigurisht tekstet qartësisht të përcaktuara që bëjnë pjesë në të nuk e zbehin. Vlerësimi objektiv i një pune kryesisht përkthimi në vepra konkrete të letërsisë së vjetër shqipe gjithashtu përbën një faktor për t'u marrë në konsideratë sa herë ndërmerret dhe një analizë e kujdesshme mbi brendinë, ndërtimin dhe modelin a modelet që çdo autor kishte si referim në proces të punës për përpilimet aspak të lehta që kishte marrë përsipër.

Po aq sa është diskutuar dhe në lidhje me natyrën e mirëfilltë të ekzemplarëve të veçantë me të cilët përfaqësohet kjo letërsi, po aq sa vijon të paraqitet aktuale ideja e rizbulimit të modeleve analoge në ndërtim dhe natyrë tekstore, edhe vetë koncepti i përcaktimit të autenticitetit të teksteve

⁸ *Meshari, botim kritik i përgatitur nga E.Çabej*, Tiranë, 1968, f.41/b-49/a. Tekstet e psalmeve në përbërje të librit të Gjon Buzukut e më konkretisht në këtë botim kritik që citohet jo rrallë dhe prej nesh shoqërohen nga shënime që orientojnë më së miri ndaj brendësimit kuptimor të vargjeve të caktuara, ndërkohë dhe të ndikimit pothuaj përherë të pranishëm nga burime kryesisht në gjuhën latine. Ndikime që në pamje të parë mund të duket se i përkasin një niveli më së pari të ndërtimeve të natyrës sintaksore, në të vërtetë dhe dëshmojnë në ndonjë rast një pamundësi për të evidentuar me shprehjen gjegjëse në gjuhën shqipe të një koncepti themelor për tekstin dhe transmetimin e tij. Do të jenë pikërisht psalmet dhe ndonjë tekst tjetër specifik që rimerret në të njëjtën pjesë të librit të Buzukut që mund t'i shërbejnë një qasjeje mirëfilli tekstologjike dhe krijimi të një ideje më të plotë mbi ndikimet e mundshme kryesisht gjuhësore të autorit nga gjuhët me të cilat konsultohet.

që përbëjnë lëndën parësore mbi të cilët rindërtojmë prej vitesh arsyetime dhe interpretime kryesisht të natyrës filologjike, përbën një prej argumenteve që pikësëpari gjen mundësi të rimerret dhe falë faktorëve që me kalimin e kohës bënë më të afërt studimin përmbajtësor të tyre, në disa pikëpamje dhe mënyra vështrimi. Sa i përket modelit më të afërt referencial në lidhje me librin e Gjon Buzukut, vetë tradita e përpilimit të librave që ishin të paracaktuar t'i shërbenin një praktike të përditshme, por dhe komplekse në kuptimin e larmisë së teksteve që duhet ta shoqëronin një ecuri të tillë përditshmërie, ka ndjekur në shekuj një vijimësi jo fort të lehtë për t'u ndjekur në pikëpamje ekzemplarësh dhe kësombllash që nuk rezultojnë të jenë të njëjtit në vise të ndryshme të Evropës e në veçanti në ato më afër Romës dhe Selisë së Shenjtë. Në këtë libër kaq të çmuar për faktin që e disponojmë në një ekzemplar të vetëm e që ndërkohë dhe për nga brendia dëshmon një ndikim të qartë nga një traditë që do të modifikohej mbas përfundimit të punimeve të Koncilit të Trentit, përmbledhen një sërë tiparësh ndërtimore që gjithsesi do t'i gjejmë dhe më vonë në libra të mëvetësishëm, ashtu siç ndodhte që dhe më parë librat e orëve të mund të gjurmoheshin si realizime më vete, jo domosdoshmërisht të bashkëngjitur me modele të tjera, përfshirë *Mesharin* dhe Ritualin Romak.

Një hap i domosdoshëm që u hodh mbas përpjekjesh disavjeçare për të njohur nga afër veprat dhe kontekstin historik që shoqëroi realizimin e tyre është vetë transkribimi i secilës, i vënë zakonisht krahas riprodhimit fotomekanik të vetë përmbajtjes, duke qenë se ndërkohë dhe realizuesit e tyre dhe sot e kësaj dite vijojnë të hulumtojnë në kërkim të rrethanave konkrete që e bëjnë dhe periudhën në fjalë më të prekshme në ngjarje dhe realitetin që i karakterizon.⁹

Përkthimi i tekstit biblik i vëzhguar në përpilime të Pesëqindës e më tej akoma, nxit pa dyshim një kompleksitet interesash studimore nëse kemi parasysh që dhe nga vepra në vepër gjurmohen tipare të lidhura me ndryshime konkrete që reflektohen në natyrën e librave që e përfaqësojnë letërsinë e vjetër shqipe dhe që mund të shpjegojnë më mirë dhe natyrën unike të disa prej tyre. Sidomos në raste të përpilimit të doracakëve doktrinarë e që pikënisjen e kanë në variantet e Roberto Bellarminos S.I., nuk mënjanohet dot prirja për ndërtime që flasin më qartë mbi formimin e autorit që ndërmerr një sprovë të tillë. Një fakt i tillë dëshmohej në botimet

⁹ Demiraj B., *Areali kulturor i Veriut në shek.XVI-XIX*, Botime Onufri, Tiranë, 2017.

që njohim e që kapërcejnë Shtatëqindën nëse kemi parasysh dhe variantin dygjuhësh që arrin të realizojë së pari në vitin 1845 Atë G. Guagliata, një meshtar jezuit që reflekton në mënyrën e vet dhe përpjekje për të shpënë më tej një traditë që zë fill me Pjetër Budin e që në botimet më të para shihet se mbështetet nga botues privatë.¹⁰ Raportin me tekstin biblik e përcakton më së pari natyra e veprës e kur bëhet fjalë për vepërza që në pamje të parë duken të paracaktuara për një përdorim të natyrës didaktike, një fakt i tillë mund të gjurmohet njëlloj, dhe pse në tekste më të përcaktuara në disa pikëpamje. Një dëshmi të qartë e jep varianti më i parë i botimit të Doktrinës së kërshenë të Pjetër Budit (Romë, 1618), në të cilin gjurmohen fraza latine të cilat dhe ndiqen po aty nga shqipërimi gjegjës, me gjasë një kontribut i vetë përpiluesit. Po në këtë variant paraqitet rasti jo pak herë të konstatohen përdorime që dhe pse mund të jenë kalkime fjalësh nga gjuha latine, formojnë natyrshëm një spektër terminologjik e semantik që i shkon më së miri formatit të një doracaku doktrinar. Katekeza e Budit karakterizohet nga referime permanente ndaj Ungjijve e një fakt i tillë përveç se orienton në njohjen më të mirë të brendisë së veprës së tij, bën të mundur dhe qasjen me pasazhe të ngjashme me një referent paraardhës si ai i *Mesharit* (1555).¹¹ Dhe përpilime të tjera që mbajnë autorësinë e këtij prelati dhe janë përgatitur si variante të para në të gjallë të tij e në një periudhë të përafërt me realizimin e botimit më të parë të Doktrinës së kërshenë (1618), karakterizohen nga një problematikë e ngjashme në pikëpamje të mundësisë së referimit ndaj modelesh gjegjëse në një kontekst kishtar e kateketik dhe për më tepër paraqiten gjithsesi në formate më të

¹⁰ Emri i Bartolomeo Zannettit, në tipografinë e të cilit sheh dritën e botimit dhe varianti i parë i DC të përpiluar prej Pjetër Budit prej Gurit të Bardhë (1618), lidhet me një sërë botimesh të tjera që realizohen veçanërisht në këtë periudhë disavjeçare në të cilën do të vihet re dhe kurorëzimi i kontributeve të vyera të tij. Të tilla botime lidhen gjithashtu me të njëjtat leje botimi dhe kanë një destinacion të ngjashëm me ato të përpilimeve që i atribuojmë Pjetër Budit, ndërkohë që dhe janë paraqitur në frontespis në gjuhë romane, jo detyrimisht në latinisht. Përposë librash specifike që botohen në gjuhën latine dhe ndërkohë dhe siglat e shpjegimet përkatëse mbi vëllimet në fjalë janë gjithashtu në këtë gjuhë, nuk mungojnë të tjerë ekzemplarë që të përpiluar kryesisht në gjuhën italiane, nuk humbasin vëmendjen ndaj lidhjes me gjuhë të tjera, ndër të cilat dhe greqishja e asaj kohe. Shih ndër të tjera dhe veprën voluminoze me titull *Vocabolario Italiano et Greco, nel quale si contiene come le voci Italiane si dicano in Greco volgare. Composto dal P. Girolamo Germano della Compagnia di GIESV*. In Roma, per l'Herede di B. Zannetti, 1622. (Con Licenza de' Superiori).

¹¹ Vërej ndër të tjera dhe shqipërimin përkatës të dhënë nga Budi (DC 1618, f.22) në lidhje me frazën biblike *Beati mundo corde quoniam ipffi Deum videbunt*; lumtë mpafterte ete delirete mendye e zemre pse atta cane meepaam tenezotne...

thjeshtuara sa i përket përmbajtjes dhe renditjes së elementeve që i ndërtojnë ato.

Sprova me shqipërimin e tekstit biblik kanë përballuar pothuaj të gjithë autorët e kësaj letërsie: jo të thjeshtë e ka pasur ndërmarrjen dhe autori i *Cuneus prophetarum*(Patavii, 1685), që dhe pse duket se ka disponuar tjetër lirshmëri në pikëpamje të shtrirjes përmbajtësore dhe shtjellimit të krerëve përkatës të veprës së tij, natyrisht që ka respektuar një model libror që njihej në atë kohë dhe që kërkonte një vëmendje të madhe nga ana e Bogdanit. Në një diskutim që sigurisht do të kërkonte dhe hapësirë kohore më të gjerë, do të duhej të parashtroheshin në vijimësi çështje të origjinalitetit të përkthimit të frazave të caktuara nga ana e tij dhe prirja për të shoqëruar me interpretime thënie të përfshira në tekst;¹² përdorime në thelb analitike, por që dëshmojnë që shqipja zotëronte dhe përveçime në lidhje me fjalë-terma që rezultojnë në variantin krahas atij në gjuhën shqipe; ndërtime që shërbyen më tej si bazë burimore për përpilues doracakësh më të thjeshtë, por që në pikëpamje doktrinare dhe shprehësie duhet të ishin njëlloj të vëmendshëm ndaj kanoneve kishtarë të kohës. Vetë realizimi i një vepre të tillë si *Cuneus prophetarum*(1685), pothuaj në përfundim të Gjashtëqindës e në një kontekst që favorizonte e në të njëjtën kohë mbikëqyrte botimin e ekzemplarëve të asaj përmbajtjeje dëshmon që kjo e fundit përmbushte parametra të domosdoshëm në kuptimin e shprehësisë dhe krerëve që e ndërtonin atë. Vetë ndërlidhja me ente të mbikëqyrjes përmbajtësore dhe dogmatike që dëshmohet në paragrafet hyrëse të kësaj vepre rikonfirmon një fakt të tillë dhe për më tepër dhe përfshirjen e vetë autorit në qerthuj të natyrës hierarkike kishtarë dhe kulturore. Duhet kujtuar ndërkohë që pikërisht në këtë shekull në të cilin sheh dritën e botimit dhe kjo vepër kaq e vyer e letërsisë së shkruar shqipe, kanë marrë një tjetër zhvillim dhe çështjet e rishikimit të veprave me një tematikë të prirur nga teologjia e krishterë dhe kontekstualizimi i tyre ndaj një publiku sa të kulturuar, aq dhe të lidhur me problemet e jetës kishtarë të kohës.

Me rëndësi mbetet në këtë drejtim theksimi i disa teksteve themelore në përbërje të Biblës e që pavarësisht nga autorët përpilues dhe

¹² Shih ndër të tjera dhe trajtimin gjegjës në *Cuneus prophetarum, botim kritik përgatitur nga A.Omari, Shkalla I, Ligj.IV, Tiranë, 2015, f.13, në lidhje me njërin nga psalmet: David Profeta ndë *Salmi* 66 thotë këto fjalë: *Bekoftë neve Hyji, Hyji ynë bekoftë neve. Hyji do me thanë, na bekoftë neve Hyji Atë, bekoftë neve Biri, Hyji ynë përse bëm nierë, bekoftë neve Shpirti Shent.**

periudha në të cilën iu nënshtruan modifikimeve të ndryshme, vijnë të jenë më të rëndësishmit dhe për vëmendjen e studiuesve të letërsisë e të filologjisë së tekstit. Variante që paraqesin interes dhe në pikëpamje të studimit të nënsistemeve të veçanta mbeten pjesë të Besëlidhjes së Vjetër që më së pari i gjejmë në tekstet e *Mesharit*, bashkë me indice të vlefshme që pikërisht nga vetë siglimet e përpiluesit apo autorit japin të kuptojnë dhe burimet me të cilat ky i fundit mbështeste përgatitjen e veprës në fjalë. Duhet theksuar dhe në këtë rasë që në çdo periudhë të zhvillimit të mendimit filozofik njerëzor e në veçanti kur u vu re një vijimësi e qartë vëmendjeje dhe ndaj varianteve biblike e më saktë dhe gjuhëve në të cilat ato duhet të njiheshin, brendësoheshin, përktheheshin apo përshtateshin, analiza filologjike dhe vështrimi përmbajtësor ka qenë një prirje që ka karakterizuar çdo linjë a rrymë që koha prodhonte e që më tej bëri të mundur dhe të përvijojë një histori fort e pasur në arritje, burime dhe botime të studimeve të tekstit mbi Biblën dhe pjesët përbërëse të saj. Konsiderimi si tërësi i përmbajtjes së *Mesharit* ndër të tjera na shpie sërish drejt nënvizimit të kontributit unik dhe metodologjisë së gjurmimit tekstologjik që me largpamësi prej studiuesi të sprovuar Eqrem Çabej e dëshmoi në linjat e ndjekura jo vetëm në konceptimin e realizimit të një botimi filologjik e kritik që paraqitet ekzemplar në pikëpamje të arritshmërisë, por dhe qasjeve me vend që bëjnë që shënimet me të cilat shpjegohen fragmente, sintagma, fjali e tekste të tëra të jenë prijës dhe në konstatimin e lidhjeve të natyrshme mes pjesëve që e përbëjnë këtë libër. Do të mund të gjurmohet i rimarrë dekalogu, qoftë dhe në tekste që u përkasin letrave të Apostujve,¹³ një tjetër variant nëse kemi parasysh që ky i fundit do të renditet ndër tekstet tipike të pjesës së parë të librit; pasazhe nga ungjijtë që jo vetëm janë të njëjtë në pikëpamje burimore, por dhe mbeten dëshmi të konsultimit të përpiluesit me disa burime të mundshme referenciale; ndërtime të përveçme me vlerë sintagmatike që jo vetëm dëshmojnë një ndikim të qartë nga forma referenciale tipike për ligjërimin biblik dhe ungjillor, por dhe ngulitjen me kohë të përdorimit të tyre në kulturën kishtarë shqiptare.¹⁴ Do të jenë me të drejtë variantet e psalmeve të pendesës që të vëna përballë tekstesh në disa gjuhë, qoftë dhe në botime që diferencohen me ndonjë shekull nga realizimi i librit të sipërcituar, dëshmi e jo pak vështirësive konkrete në pikëpamje të përmbajtjes a më saktë

¹³ *Meshari, botim kritik i përgatitur nga E.Çabej*, Tiranë, 1968, f.103/b.

¹⁴ Shih ndër të tjera dhe ndërtime sintagmatike te *Meshari, (botim kritik i cituar)*, Tiranë, 1968, si: *Regjinë e shekullit*, f.27/b; *Regjina e mishëriersë*, f.31/b; *Regjina e qiellsë*, f.31/b etj.

përkimit ndaj burimit origjinar të konsultuar. Lapsuse të vëna në dukje dhe në shënimet e botimit kritik të sipërpërmendur (Tiranë, 1968) rikujtojnë rëndësinë e njohjes së paradigmave të fjalëve të caktuara, sidomos të atyre në gjuhën latine dhe që kanë një peshë të caktuar dhe në përbërje të vetë tekstit biblik në gjuhën që shërben si burim referencial. Do të jetë rasti pa dyshim të nënvizohen devijime nga kuptimi i mirëfilltë i frazës qoftë kur përpiluesi nuk duket të ketë të qartë trajtën përfaqësuese të një fjale të caktuar (më saktë, elemente paradigmatiche të qenësishme që dallojnë një fjalë nga një tjetër dhe brenda së njëjtës ndarje kategoriale) e që ka shpënë në keqkuptime të pakthyeshme në pikëpamje të brendësimit të fjalisë nga psalmi,¹⁵ qoftë dhe kur në përpyekjen për të përkthyer *ad litteram* nga varianti në gjuhën latine, nuk jep si duhet idenë a konceptin që në të vërtetë në atë gjuhë me të cilën është shërbyer përshkruhet në një mënyrë të caktuar shprehjeje. Psalmet përbëjnë tekste që dhe pse dallohen në pikëpamje të ndërtimit kryesisht të përcaktuar sa i përket shtrirjes së tekstit dhe koncizitetit të shprehësisë, në disa raste kanë mbartur dhe ndryshime që në thelb nuk duhet të jenë synim për të modifikuar atë çka duhet nënvizuar apo theksuar, por lidhen me vetë shprehjet që një gjuhë e caktuar zotëron në lidhje me një nocion të caktuar. Pikërisht tekste të tilla që rimerren natyrshëm dhe në veprën *Cuneus prophetarum* (1685) të Pjetër Bogdanit duke ofruar mundësi për reflektime të mëtejme mbi besnikërinë e shqipërimin, apo të ruajtjes së kuptimit në burimet gjuhësore origjinare, mbeten tipike për të realizuar dhe përfundime mbi variantet e mundshme të psalmeve në letërsinë e vjetër shqipe. Pothuaj në përmbajtjen e secilës prej veprave të letërsisë së vjetër shqipe gjinden premisa për të shtjelluar interpretime të tëra mbi shqipërime të mundshme që vijnë të jenë shtysë diskutimi, mbi njohjen *a priori* të një regjistri a regjistrave terminologjike që sigurisht mund të segmentohen në mjaft nëndarje nëse kemi parasysh linjat që autorët ndoqën në varësi të objektit të materies së trajtuar. Ka qenë kjo një arsye më shumë që të realizoheshin në kohë të ndryshme dhe pse mbi metodologji jo të njëjta studime mbi leksikonin e këtyre veprave që përveç evidentimit të zërave të mëvetësishëm, shërbenin dhe për të shpënë më tej pista hulumtimi mbi sferat semantike përkatëse dhe lidhjet mes një përdorimi me kontekstin apo më shumë përdorimesh mes tyre. Merita autoriale mund të konstatojmë dhe sa i përket respektimit të emërtimeve të festave të urdhënuome, gjithashtu festave të paluajtshme, që bëjnë të mundur dhe në pikëpamje të modifikimit fonetik të trajtave të veçanta të deduktohen gjykime mbi lashtësinë e praktikimit të tyre në viset tona. Përbën një periudhë e tillë një dëshmi realizimesh që shërbyen si provë e një pasurie të konsiderueshme formash e përdorimesh, gjithashtu dhe tekstesh që rindërtojnë profilin e një gjuhe që bëri të renditen natyrshëm në regjistrat e kohës

¹⁵ Shih shënimin përkatës të E.Çabejt në lidhje me Psalmin 101 (*po aty, botim kritik i cituar, Psalmus contra invidiam*, f.45/b) që vë në dukje keqkuptimin mbi trajtën –os, që duhej të ishte përkthyer me kuptimin e *ashtit, eshtrës*, jo gojës: Nj zani të fshamëvet mive u afëruo goja eme mishit tim.

dhe vepra të formateve të sipërcituara, natyrisht në një linjë me prirjet e kohës dhe zhvillimet përkatëse kulturore.

Edhe hulumtimet më specifike mbi aspekte që lidhen me historinë e botimit të librave kishtarë në viset tona pikërisht mbas inicimit të shtypshkrimit na shpjen në mënyrë të pashmangshme në njohjen e një konteksti që me gjithë veçoritë që kanë të bëjnë me persona të caktuar, individualitete të kulturës librare dhe të vetë mendësisë së asaj kohe pa dyshim që luajti një rol të përcaktuar dhe në realizimin e një sërë botimesh që për studimet tona mbeten përfaqësuese të një periudhe me rëndësi për shkrimin shqip dhe për zhvillime të tjera që lidhen me të. Libri shqip i asaj periudhe nuk mund të mos reflektojë elemente në dukje të kulturës tipografike e teknike, por dhe me një rëndësi të madhe sa i përket përshtatjes me një linjë që do të përcaktonte dhe vijimësinë e receptimit dhe të njohjes në arealin për të cilin dhe ishte paracaktuar të shërbente si mjet dhe instrument mësimi dhe transmetimi të një kulture qoftë kishtarë, qoftë të dobisë së leximit si koncept. Disponimi i disa varianteve të ribotimit të këtyre veprave na bën të reflektojmë dhe mbi një historik të rimarrjes së tyre prej kolegësh apo organesh botuese që në atë kohë përfaqësojnë autoritete të vlerësimit dhe një fakt i tillë bën të mundur të ndiqet dhe çështja e përmirësimit përmbajtësor të tyre. Veprat e letërsisë së vjetër shqipe që pasojnë njëra-tjetrën në një vijimësi të natyrshme nga shumë pikëpamje, në të vërtetë dhe ndihmojnë në ndjekjen e një panorame mbi të gjitha historike që në gradualitetin e vet bëri të mundur që dhe në viset tona të reflektohej ndikimi përkatës në fakte dhe ngjarje.

BIBLIOGRAFI

- Ageno Brambilla F., *L'edizione critica dei testi volgari*, Antenore, Padova, 1984.
- Antonelli R., *Interpretazione e critica del testo*, në *Letteratura italiana, Vellimi IV*, Einaudi, Torino, 1985.
- Bainton R., *La riforma protestante*, Einaudi editore, Torino, 2000.
- Baldacchini L., *Il libro antico, (nuova ed. aggiornata)*, Carocci editore, Romë, 2001.
- Barbieri E., *Guida al libro antico. Conoscere e descrivere il libro tipografico*. Le Monnier, Firenze, 2006.
- Barbieri E., *La tipografia araba a Venezia nel XVI secolo, una testimonianza d'archivio dimenticata*, në *Quaderni di Studi arabi*, n.9, 1991.
- Bentivogli B., Vecchi Galli P., *Filologia italiana*, Bruno Mondadori, Milano, 2002.
- Bertolo F.M., Cherubini P., Inglese G., Miglio L., *Breve storia della scrittura e del libro*, Carocci editore, Romë, 2004.
- Bessi R., Martelli M., *Guida alla filologia italiana*, Le Monnier, Firenze, 1984.
- Blaise A., *Manuel du latin chrétien*, Brépols, Strasbourg, 1955.
- Blaise A., *Le vocabulaire latin des principaux thèmes liturgiques (ouvrage revu par D.Antoine Dumas O.S.B.)*, Brépols, 1966.
- Bogdani P., *Cuneus prophetarum (Çeta e profetëve), botim kritik përgatitur nga A.Omari*, ASHSH, Tiranë, 2015.
- Bonora E., *La Controriforma*, Laterza editore, Roma-Bari, 2001.
- Budi P., *Rituale Romanum et Speculum confessionis in Epyroticam linguam a Petro Budi Episcopo Sapatense et Sardanense translata*, Romae, 1621.
- Budi P., *Dottrina Christiana, composta per ordine della fel.mem. di Papa Clemente VIII*, Roma, 1664.

- Budi P., *Dottrina Christiana(1618), with a transcription into modern orthography and a concordance prepared by Gunnar Svane*, Institut for Lingvistik, Aarhus, 1985.
- Budi P., *Poezi, (Parathënia, tejshkrimi dhe komentet: R.Ismajli)*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shëjzat, Romë, 1960.
- Camaiani P.G., *Interpretazioni della Riforma cattolica e della Controriforma*, në *Grande Enciclopedia filosofica*, VI, Milano, 1964.
- Carmassi P., *Libri liturgici e istituzioni ecclesiastiche a Milano in età medioevale(studio sulla formazione del lezionario ambrosiano)*, Aschendorff Münster, 2001.
- Carrez M., *Le lingue della Bibbia (dai papiri alle bibbie in stampa)*, Edizioni Paoline, Romë, 1987.
- Chiaramonte Z., *Il Messale di Gjon Buzuku(1555). Un hapax in lingua albanese tra riforma, controriforma e islam*, në *Rivista liturgica*, n.6, Abbazia S.Giustino, Edizioni Messaggero Padova, 2011.
- Contini G., *Breviario di ecdotica*, Einaudi, Torino, 1992.
- Corsani B., *Esegesi.Come interpretare un testo biblico*, Piccola Collana Moderna Claudiana, 2001.
- Corsani B., *Guida allo studio del Nuovo Testamento*, Società Biblica Britannica e Forestiera, Romë, 2005.
- Crupi G., *Gli incunaboli italiani in lingua volgare: preliminari di una ricerca*, La Sapienza Editrice, 2012.
- Çabej E., *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në *BUSHT*, n.2, 1959.
- Demiraj B., *Gjon Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Demiraj B., *Dictionarium latino-epiroticum (Romae, 1635), per R.D. Franciscum Blanchum*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.
- Di Troyes R., *Commento all'Esodo, (a cura di Sergio J.Serra)*, Marietti editore, 1988.
- Di Troyes R., *Commento alla Genesi(a cura di Luigi Cattani)*, Marietti editore, 1999.
- Fahy C., *Saggi di bibliografia testuale*, Antenore, Padova, 1988.
- Ferrari M., Navoni M.(përg.), *Nuove ricerche su codici in scrittura latina dell'Ambrosiana*, Bibliotheca erudita, Atti del Convegno, Milano, 2005.
- Felici L., *La riforma protestante nell'Italia del Cinquento*, Carocci editore, Roma, 2016.
- Firpo M., *Riforma protestante ed eresie nell'Italia del Cinquecento*, Editori Laterza, Bari, 2008.
- Fischer G., *Teologie dell'Antico Testamento*, San Paolo Edizioni, 2015.
- Fragnito G., *Cinquecento italiano. Religione, cultura e potere dal Rinascimento alla Controriforma*, Il Mulino, Bologna, 2012.
- Fragnito G., *La Bibbia al rogo: La censura ecclesiastica e i volgarizzamenti della Scrittura*, Il Mulino, Bologna, 2015.
- Fuiano M., *La stampa nel Cinquecento: breve prospetto*, Libreria Scientifica, 1967.
- Genesin M., Matzinger J., *La pubblicazione dei primi testi in lingua albanese nel contesto dell'attività editoriale della Polyglotta*, në *L'Albania nell'Archivio di Propaganda Fide*, a cura di A.Ndreca, Urbaniana University Press, Romë, 2017.
- Grillo A., *Introduzione alla teologia liturgica(Approccio teorico alla liturgia e ai sacramenti cristiani)*, EMP, 2011.
- Hill C.E., Kruger M.J., *The Early Text of the New Testament*, Oxford University Press, New York, 2012.
- Lécureux B., *Le latin, langue de l'Église*, Éditions Spes, Paris, 1964.
- Mansaku S., *L'orientation culturelle et religieuse des Albanais au moyen âge et les débuts de l'écriture de la langue albanaise*, në *Studia Albanica*, 2006.
- Menchi S.S., *Le traduzioni italiane di Lutero nella prima metà del Cinquecento*, në *Rinascimento*, n.17, 1977.
- Paci E., *Pikëpamje të Zamputit mbi vendin e "Mesharit" në historinë e letërsisë së shkruar shqipe*, në *Studime filologjike*, n.3-4, 2014.

- Paci E., *Elemente të leksikut të liturgjisë në veprat e letërsisë së vjetër shqipe-Zotynë si rast studimi*, në *Hylli i Dritës*, n.3-4, 2014.
- Paci E., *Cenni ed osservazioni linguistiche sul primo libro scritto in lingua albanese(1555)*, në *Studia Albanica*, 1-2, 2014.
- Paci E., *La Dottrina Cristiana del Bellarmino in una versione del gesuita Giuseppe Guagliata*, në *L'Albania nell'Archivio di Propaganda Fide*, a cura di A.Ndreca, Urbaniana University Press, Romë, 2017.
- Paci E., *Studime mbi tekstet e vjetra shqipe*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2017.
- Pasquali G., *Storia della tradizione e critica del testo (1952)*, Mondadori, Milano, 1974.
- Petrotta G., *Saggio di bibliografia albanese(1500-1930)*, Palermo, 1931.
- Prospero A., *Il Concilio di Trento: una introduzione storica*, Piccola Biblioteca Einaudi, Torino, 2001.
- Prospero A., *L'inquisizione romana : letture e ricerche*, Edizioni di Storia e Letteratura, Romë, 2003.
- Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, L.O.P.Geuthner, Paris, 1932.
- Schmidt H.A.P., *Liturgie et langue vulgaire: le problème de la langue liturgique chez les premiers réformateurs et au Concile de Trente*, Aedes Universitatis Gregorianae, Romë, 1950.
- Sforza P., *Istoria del Concilio di Trento*, Romë, 1666.
- Sedaj E., *Bibla e përkthimet e saj në gjuhën shqipe*, Shtufi, Prishtinë, 1999.
- Stoppelli P., *Filologia dei testi a stampa*, Il Mulino, Bologna, 1987.
- Zamputi I., *Qëmtime për Budin e Bardhin*, në *Studime historike*, n.1, 1985.
- Zamputi I., *Mbi rrethanat historike të botimit të "Mesharit" të Gjon Buzukut dhe vendin e tij në letërsinë e vjetër shqiptare*, në *Studime filologjike* n.3, 1986.
- Zamputi I., *Les circonstances historiques de la parution du "Missel" de Gjon Buzuku et sa place dans la littérature albanaise*, në *Studia Albanica*, n.1, 1988.
- Zamputi I., *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe*, në *Hylli i Dritës*, n.1-2, 1995.
- Zappella G., *Il libro antico a stampa: struttura, tecniche, tipologie, evoluzione*, Editrice Bibliografica, 2001.

About a study tradition regarding the initiation of the cultivation of Albanian writing and possible reflections of European developments (XVI-XVII centuries)

ABSTRACT

About a study tradition on the initiation of the cultivation of Albanian writing and possible reflections of European evolutions (XVI-XVII centuries)

This essay addresses some aspects of the initiation of the writing culture in our area taking in consideration also sources that dealing with important cultural developments in Europe during XVI-XVII centuries. The initiation and inauguration of the press caused radical changes in the culture of the book and of its publication, fact that will influence in other innovations and developments not only in the European region but also in the Balcans and in our country. Important authors on Albanian written literature as Buzuku, Bardhi, Bogdani would bring with their reflections through their works and compilations the echo of important changes that affected above all the publication and the distribution of the books with predefined ecclesiastical and liturgical thematics.

Kujtim BEVAPI**LEF NOSI SI ALBANOLOG**

Rilindja Kombëtare nuk ishte një akt i vetëm, por një vazhdimësi idesh dhe veprimesh, që kishin një synim të qartë: Pavarësinë e Atdheut. Qe një brez patriotësh në periudhën e Rilindjes e më pas, të cilët të parët e panë se po vinin kohë të reja, dhe se Shqipërisë së robëruar prej pesë shekujsh, i duhej zëri i saj, i plotë, i përpunuar si fakt i njësisë kombëtare, për ta zgjuar popullin për liri. Këtij brezi i takonte edhe Lef Nosi, i cili si albanolog përbën një fenomen në kulturën shqiptare.

U përpoq shumë, duke u bërë zëdhënës i aspiratave madhore të popullit shqiptar. Jetoj e veptoi në dy dhjetëvjeçarët e fundit të shek. XIX dhe gjysmën e parë të shek. XX.

Albanologjia, duke qenë tërësia e studimeve, që kanë bërë dhe bëjnë studiuesit e huaj dhe ata shqiptarë për historinë, gjuhën e kulturën e popullit shqiptar, e tërhoqi që në të ri Lef Nosin, sepse te Shqipëria dhe shqiptarët, ai shihte një vlerë madhore, për të cilën duhej luftuar, që të mbijetonte. Dhe përbërëse të kësaj vlere ishin lashtësia, autoktonia dhe origjinaliteti i shqiptarëve.

Por duhet theksuar se si shembëlltyrë në jetën e veprën e tij shërbeu K. Kristoforidhi, bashkëqytetari dhe komshiu i lagjes së tij, Kalasë. Nuk është e rastit që Lef Nosi përvetësoi prej tij një metodë serioze pune, por dhe hyri në rrethin e gjerë të dijes albanologjike.

Aktivitetin e tij patriotik, politik e shoqëror e nis në fund të shek. XIX. Ngriti klube e shoqëri patriotike, qëndron në krye të aktiviteteve madhore, si: Kongresi i Manastirit” (1908), “Kongresi i Elbasanit” (1909), kontribuon në çeljen e Shkollës Normale (1909), themelon e drejton gazetën e parë të Elbasanit, "Tomorri" (1910), ndihmon dhe ishte një nga drejtuesit e së përkohshmes "Kopështi letrar" (1918-1919), është pjesëmarrës dhe anëtar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, themelon me Faik Konicën në Londër partinë “Ana Kombëtare” (1907), ndërmerr një udhëtim te shqiptarët e Amerikës, në Filadelfia (1908), në shërbim të çështjes shqiptare¹.

¹ Bevapi, K.: Etnografi - Etnologu: “Hulumtime etnologjike”, Elbasan, “Sejko”, 2005, fq. 74

Ai punoi njëherësh në lëmë të kulturës e patriotizmit, me patriotë të tjerë, por dhe i vetëm. Prandaj me të drejtë shtypi i kohës do ta cilësonte si "I famshmi atdhetar" apo "atdhetar i shkëlqyer"². Jeta dhe veprimtaria e tij kanë qenë të vrullshme, por edhe të trazuara me shpërngulje të shpeshta e shtegtime të gjata në shërbim të çështjes kombëtare shqiptare.

Një letërkëmbim i gjerë do të bëhet pjesë e jetës së tij me figura, si: Fan Noli, Faik Konica, Aleksandër Xhuvani, Sotir Kolea, Sotir Peci etj., por edhe me albanologë, si: A. Herbert, M. Hasluk etj.

Por të gjitha këto nuk mund të ishin pa pasoja për Lef Nosit. Ndaj drejtuesit të gazetës "Tomorri", i jepet dënimi kapital nga Perandoria Osmane. Vetëm ndërhyrjet dhe protestat e patriotëve shqiptarë, bënë që ky dënim të kthehet në internim, në Brusë të Anadollit, ku mbas disa muajsh burgosjeje kthehet në Elbasan³. Me forca të reja, ai i hyn punës, që programin e Rilindjes, të përpiquej ta zbatonte, duke punuar në truallin e vet. I duhej të dëshmonte me vepra para Evropës e më gjerë se cilët ishin Shqipëria e shqiptarët, ndryshe do të mbetej mënjanë si lëmishte buzë rrymës.

Si albanolog mbledh dhe gjurmon dokumente historike, antika, koleksione të rralla, një material të pasur folklorik, si: Ciklin e Kreshnikëve, Këngët legjendare, baladat. Por Lef Nosi gjurmoi dhe u la trashëgim brezave dorëshkrimin e Anonimit të Elbasanit, material ky që lidhet drejtpërdrejt me origjinat e shqipes së shkruar. Është një fond model i koleksioneve albanologjike, i përzgjedhur nga ky patriot me kompetencë e siguri, por dhe me dhimbje e vështirësi. Ato fillojnë nga lashtësia me autorët antikë grekë e romakë mbi Ilirët e Ilirinë, vijnë me periudhën e Perandorisë Osmane dhe, në mënyrë të veçantë, me autorë të shumtë, të huaj e shqiptarë të periudhës së Rilindjes Kombëtare e Pavarësisë, të disa fushave, të cilët pa dyshim i shërbyen atij si bazë për t'u marrë me studime të natyrës albanologjike, që fatkeqësisht një pjesë u tretën në brymë të kohës, të tjera mbetën dorëshkrime, anonime apo një pjesë të përvetësuar. Biblioteka e tij numëronte rreth 10 mijë vëllime e koleksione periodiku me vlerë albanologjike e ballkanologjike⁴.

Rrethanat historike e politike, mënyra se si ngjarjet po rridhnin për Shqipërinë Lef Nosi kishte filluar ta ndiente se harta e Ballkanit do të ndryshonte. Vijat në harta gjithmonë janë hequr me shpatë dhe në rastet kur flitet për kufijtë gjuhësorë, etnikë, atëherë dalin nga arkivi librat e historisë,

² "E vërteta", Pera, 1911, 5 qershor.

³ "Tomorri", Elbasan, 10 prill, 30 prill.

⁴ Fondi Arkivor i Bibliotekës Publike "Q. Baholli", Elbasan. Albanologjia. Ballkanologjia.

tekstet e vjetra, abetaret, gramatikat dhe nis lufta me këtë armë shpirtërore. Si albanolog, do të duhen disa epitete për të përcaktuar punën e tij, në studimet shqiptare: arkivist, folklorist, filatelist, gjuhëtar, etnograf, numizmat, mbledhës i materialit arkeologjik, duke i sjellë shërbime kolosale kombit. Një figure si Lef Nosi, koha i caktoi rolin e një regjisori në skenën e historisë, paçka se në shumë vepra ai mbetet anonim, ndërkohë ishte i pranishëm kudo, por edhe njëherësh i padukshëm. I ngjan një ajsbergu që i duket vetëm maja. Fondi arkivor në AQK, përmban një vëllim prej 12 mijë faqesh me vlera dokumentare. Aty ka edhe studime të fushave historike, gjuhësore, biografike etj. Fondi përmban përkthime të dokumenteve historike të gjykatës turke, shariatit të Elbasanit, që fillojnë që nga viti 1560, si dhe regjistrat e vjetër të esnafëve të Elbasanit, për të cilat ai ka lënë edhe shënime. Dokumentet janë në gjuhën shqipe, por edhe në osmanisht, greqisht, anglisht, frëngjisht.⁵ Harton dhe lë në dorëshkrim një fjalor me rreth 3 mijë fjalë, të papërfunduar.⁶

Tërë këtë ndërrmarrje të guximshme me të tilla përmasa, nuk mund ta vështrojmë thjesht si një dëshirë apo pasion të rastit të një studiuesi. Ato janë shtysa të fuqishme të një njeriu për vepra madhore, që këtë pasuri ta trashëgojnë brezat. Kjo është dëshmi që tregon se historisë këta rilindës iu përgjigjën pikërisht për t'u dhënë një mbështetje historike kërkesave kombëtare, për t'i mbushur me krenari shqiptarët që t'u kundërvihën pretendimeve të shovinizmit fqinj dhe për të tërhequr vëmendjen e opinionit të huaj te populli shqiptar, si një popull me vlera, me histori e kulturë të hershme.

Një pyetje lind vetvetiu: Ç'forcë e brendshme qëndronte te këta patriotë, që të përballonin këto rrethana dhe të ecnin përpara, me gjithë sakrificat e vështira që u kërkoheshin?

E vetmja përgjigje është se ata i frymëzonte besimi i patundur te vlerat kombëtare të këtij populli, të cilat nuk mund të zhdukeshin nga asnjë forcë, sado e egër që të ishte, por ata i frymëzonte dhe bindja se këto vlera kishin një të ardhme edhe në kohët e reja që do të vinin, kur liria do të fitonte mbi robërinë, dija mbi tiraninë.

Lef Nosi është ndër studiuesit më fatkeqë. Ndonëse me këtë veprimtari me këto përmasa, tërë këtë pasuri nuk e trashëgoi. I ekzekutuar nga diktatura komuniste nën akuzën si kolaboracionist, ky veprimtar e patriot u ekzekutua dy herë: një herë me plumb dhe një herë me harresë.

⁵ Arkivi Qendror i Shtetit (AQSH), Lef Nosi, Fondi 32.

⁶ Qendra e Studimeve Albanologjike (QSA). Arkivi i Bibliotekës së Institutit të Gjuhësisë.

Prandaj kur themi vepra e Lef Nosit nga Elbasani, ajo do kuptuar jo vetëm me shkrimet, por edhe me veprimtarinë e tij, sepse ai nuk ishte vetëm gjurmuesi, studiuesi i kësaj pasurie, por edhe veprimtari. Duke qenë pjesë e programit dhe e luftës politike e shoqërore të Rilindjes e Pavarësisë sonë Kombëtare, ajo nuk ishte vepër e një dijetari apo studiuesi, por edhe një vepër politike e shoqërore.

Lef Nosi mbetet një albanolog i dëgjuar në historinë e popullit tonë, por edhe një shqiptar i shquar në vetëdijen e kombit, me një tingëllim të pashuar edhe sot për mëse gjysmë shekulli mbas vdekjes së tij.

Lef Nosi is an albanologist

ABSTRACT

The work of Lef Nosi from Elbasan should be understood not only by the articles, traces and rich Albanian national studies as the work of a scholar and researcher, but also as the work of an albanological character.

As an albanologist he collected and traced historical documents, antiques, rare collections, a rich folklore material, such as: The Kreshnik Cycle, legendary songs, ballads.

Lef Nosi traced and bequeathed to generations the manuscript of Anonymous of Elbasan, a material that is directly related to the origins of written Albanian.

It is a model resource of albanological collections, selected by this patriot with competence and assurance, starting with Greek and Roman authors, as well as the Illyrians and Illyria in antiquity; continuing with the period of the Ottoman Empire, in particular with numerous authors of the period of the National Renaissance and the Independence that undoubtedly served him as a basis for engaging in albanological studies. His library consisted of nearly 10 thousand volumes and periodical collections of Albanological and Balkanological value. Therefore, Lef Nosi remains a prominent albanologist in the history of our nation, but also an outstanding Albanian in the consciousness of the nation.

Key words: albanological character, historical documents, albanological collections, albanological and balkanological value.

Karmen LAZRI, Zamira SHKRELI

PËRDORIMI KONTEKSTUAL I DISA PROVERBAVE E MAXIMAVE LATINE

NË PROZËN E SHKRIMTARIT ANTON HARAPI

(Në krijime letrare dhe oratori)

Anton Harapi (1888 – 1946)

“Anton Harapi ka qenë klerik dhe veprimtar politik. Lindi në Shirokë të Shkodrës. Studioi filozofi në Salzburg, Schwaz e Villach të Tirolit të Austrisë, teologjinë e kreu në Romë. Më 1910 ishte mësues në Kolegjin e fretërve në Shkodër: më pas shërbeu në Malësnë e Madhe. Më 1925 hartoi librin e parë nga fusha e pedagogjisë me titull “Edukata ose mirërritja e fëmijëve”, një përshtatje e parimeve pedagogjike botërore për fëmijët shqiptarë.”¹ Këta 20 vjetët e fundit, pati edhe disa publikime të veprës së A. Harapit, si përmbledhja “Kulla e Babelit”, përgatitur nga dr.Aurel Plasari.² Me rastin e 120-vjetorit të lindjes së Harapit, Instituti i Kërkimeve Politike “Alcide de Gasperi”, organizoi Konferencën shkencore, ku u majtën disa kumtesa nga studiues të njohur të vendit. Vëllimi me shkrime publicistike “Naltimi i ndërgjegjës kombtare”, botuar në vitin 2017, përmban artikuj nga revista “Hylli i Dritës”. P.Anton Harapi njihet në letrat shqipe si

¹ ASHSH, **Fjalor Enciklopedik Shqiptar-2**, Tiranë 2008. (Më tej, autori i zërit të A. Harapit shton: “Në vitet 1921-1924 mori pjesë në veprimtari politike dhe ishte një ndër drejtuesit e organizatës “Ora e Maleve” dhe drejtor i gazetës me të njëjtin emër. Harapi bënte pjesë në opozitën demokratike (1923-1924) e u arrestua e u burgos disa herë. Me pushtimin e vendit nga Italia, u bë anëtar i Asmablesë Kushtetuese, Drejtues i françeskanëve (1941-1943), kurse në periudhën e pushtimit gjerman (1943-1944) ishte anëtar i Këshillit të Lartë të Regjencës. Pas çlirimit u arrestua e u dënua me vdekje, si bashkëpunëtor i pushtuesve. Ka shkruar veprat: **Andrra e Pretashit** (2008 – Roman historik botuar në të përkohshmen “Hylli i Dritës” me titullin “Urti e burri nder banorë të Cemtit”), **Valë mbi valë** (1995, Romë), **Vlerë shpirtërore** (Kontribut per trajtimin mendor të shqiptarit, Shtypshkroja Françesakane, Shkodër, 1936; botue rishtas në vitin 1942, në 1994 dhe në vitin 2009), **Naltimi i kombit shqiptar** (2017).” Për figurën politike të A.Harapit, duhet lexuar parathënia e A.Plasarit – Anton Harapi – **Redimensus** – të botimit të “Hyllit të Dritës” “Vlerë shpirtërore”, Tiranë, 1994, f. 3 – 54.

² Harapi, Ât Anton. **Kulla e Babelit, seria “mendimi shqiptar 5”**, Phoenix& Shtëpia e Librit, Tiranë, 1999.(Në faqen para fillimit të shkrimeve, shënohet: nga “**hylli i dritës**”).

prozator, pedagog, mendimtar, sociolog, orator dhe polemik, i cili lëvroi shkrime të thukëta në këto fusha, duke u dalluar për gjuhën e stilin e veçantë në shkrimtarinë e tij. Ai dha një shembull të rrallë për kohën, kur shkroi dhe botoi përmbledhjen me ligjëratë filozofike në variantin e shkruar të toskërishtes, kur takonte e fliste me intelektualët e qytetit të Korçës. Gjatë leximit të ligjëratave të P. Antonit para atij auditori të ngritur kulturalisht, të qytetit të Korçës, mendon sa afër e pranë janë dialektet kryesore të shqipes, me ç’gjuhë të bukur dhe të papërzier ka folur ky shkrimtar, që gjithë prodhimin letrar e ka në të folmen e Veriut (Gropës së Shkodrës, siç quhet). Por në botimin e vitit 1936 të përmbledhjes “Vlerë shpirtërore”, autori shkruan: “*Merret vesh se kto konferenca i shkrojta dhe i mbajta gegërisht, por që të kuptohet më lehtë nga këndojësit e Shqipërisë së Jugës, se çë fare mejtojm ne katolikët për besim dhe per idealet e jetës, dhe që të shihet qartë se në çë farë provash e pshtesim ne ideologjinë, i pregatita, si dija, toskërisht, për botim.*”³

Në ligjërimet e lira me gojë, të cilat prej shekujsh studiohen në artin e oratorisë, por edhe në ato me shkrim, janë përdorur e vazhdojnë të përdoren fjalë të urta, proverba, apo thënie të njerëzve të shquar, të cilat koncentrojnë një mendim a përvojë të njohur dhe që kanë marrë një vlerë të gjithëkohshme; nga ana tjetër, ato shërbejnë për të mbështetur tezat e hedhura për diskutim, dalin në të mirë të ngulitjes së çështjeve të trajtuara, bashkë me temat përbërëse të tyre. Thëniet e urta, popullore qofshin, apo nga njerëz të shquar sikur i *hedhin kripë* ligjëratës publike, ose shkrimeve të kësaj gjinie; për shembull, nëse një prind autoritar, përgjatë qortimit të ashpër që mund t’i bëjë të birit, të përdorte në një çast shprehjen e Horacit (nga Epistolaret) “*Jurare in verba magistri*” – shqiptuar me ton të lartë, do të mbetej, për pasojë, në një pozicion qesharak, pasi thënia e poetit romak karakterizon autoritetin dogmatik të mësuesit në shkollat greke e romake dhe jo një marrëdhënie “prind-fëmijë a adoleshent”, rast që mund të na sjellë në mendje një urdhërim nga Moisiu: “*Ndero prindin tënd!*” Kështu ngjet edhe në ligjërimet publike: përdorimi pa vend i maksimave, jashtë kontekstit, nuk na mban në vijën e shtjellimit të lartë të një çështjeje apo diskutimi.

³ Po ai, po aty, f. 13-14. (me rasë të botimit të dytë, autori shprehet: “*Kam pritë qi t’i bate kush një kritikë këtij libri, jo per tjetër, por qi të m’epete shkas me e plotsue mendimin me pikpamje e synime të reja. Nukë e paçë fatin. E pra m’a thotë mendja, se vepërza as asht aq e persosun, sa mos me pasë shka me i gjetë, as aq e pavjeftje, sa mos me pasë pse me e xanë në gojë.*” (F. 14-15.)

Përgjatë shkrimtarisë së Harapit kalojnë para nesh: emri i Solonit – me idealizmin e atenasve, emri i Likurgut – me jetën spartane; njihemi me mbarë botën helene nëpërmjet filozofëve Sokrati, Platoni dhe Arsitoteli, i cili, sipas Harapit, *vën cak ligjët e arsyetimit e të rregullimit botnuer*. Më pas ai sillet nga filozofët modernë, si: Kanti, Rouseau-i, William James, etj., duke shfaqur thelbin e tyre në fushë të mendimit njerëzor, ashtu si na njeh me thënie të Kepleri-t, Leibniz-it, Fichte-S, Pestalozzi-T, Fenelon-it, Herbart-it, Salzmann-it, Denzel-it, Harnisch-it, Beneke-s, Grafer-it, Horn-it, Herget-it, William Martin-it, Grooti-t, Taylor-it, Milton-it, Humboldt-it, Hartmann-it, Voltaire, etj., duke përdorur fjalë, togje fjalësh apo edhe njësi-fjali të plota brenda frazës së tij, për shembull:

“Timoni i jetës pra, edhe për hartuesat si edhe për shijuesat e vepres së hartit, do të jetë arsyeja: ajo urdhnon masen në gjithshka: *est modus in rebus*, çdo gjë ka një kufi (cak), ; ka rregull në sendet; Ajo na detyron të majm dinjitetin: *ne quid vile!* Kerkon të mahet harmonija ndershej qufivet: *serva ordinem et ordo servabit te, mbaje rregullën dhe rregulla do të mbajë ty!*;! Ligja e natyrës, arsyen e pshtetjen e vet e ka në ligjen e në vullndesen hyjnore, e cilla don qi të mahet rregullimi në natyrë e ndalon shrrregullimin: *ordinem naturalem conservari jubens, perturbari vetans*.(Aug.)⁴

Përveç këtyre dijetarëve në fushë të sociologjisë dhe filozofisë, në përgjithësi, si Mill, Spencer dhe Mach, Harapi – formuarnë kulturën gjermane, gjithnjë duke i përkthyer vë në shkrimin e tij, edhe thënie të plota nga poeti i madh Goethe, si: “*Po t’ishin nanat më t’edukueme, edhe fëmijt paten me le më t’edukuem*.” Ose: “*...me kë në zëmermirë, bujar e i gatshem për m’u ndimue tjerve, janë pënë, të cillat e madhnojn nierin permbi të gjitha kafshët...*”⁵ Po kështu ai na njeh me maximën e qëlluar të pedagogut të madh Pestalozzi, që ka lënë të shkruar: “*Kurrsi nuk mund u ndimojn njerzve më mirë, se tue i mësue e tue i bënë të zotët, qi ata vetë t’i ndimojn vetit*.”⁶ Por ne na interesojnë të ndjekim latinizmat dhe rolin e tyre brenda frazave të shkrimtarit, të tilla siç është modeli i ndërtimit më poshtë, edhe këtu të dhënë në kuptimin e vërtetë nga vetë autori:

- *pro aris et focis* – për altar dhe vatër (d.m.th. për mëmëdheun, për Atdheun), : “*Greqia dhe Roma, këta dy popuj të mëdhenj, kur qenë në kulmin e fuqisë dhe në më të lartën shkallë t’organizatës dhe të madhësisë*

⁴ Harapi, P.Anton. **Naltimi i ndërgjegjes kombtare**, Botime Françeskane, Shkodër, 2017, f. 294.

⁵ Po ai, po aty, f. 40-41.

⁶ Po ai, po aty, f. 56.

sëvet, ngjitur me Aeropagun dhe me Senatin patnë tempullin dhe altarin, krahas me sundonjës nderuan Perënditë, dhe të tëra thesaret dhe idealet e tyre përmbledheshin në këtë dy fjalë: pro aris et focus, për altarë dhe vatër.”⁷

Këtu, siç shënuam, mbizotërojnë thëniet, fjalët e urta dhe maximat latine, të cilat po i sjellim në shfaqjen e tyre kontekstuale, në njësitë kumtuese:

- *Veritatis servi* – të njihet e vërteta;

- *Charitatis laboro* – të ngadhënjejë dashuria e vërtetë;

- *Mehr Licht* – dua të shoh qartë. Është një thirrje e lëshuar nga Goethe, e cila mund të përshtatet për mjaft domethënie, kur trupëzohet brenda frazës a ligjërimit, siç dhe bën Harapi: “*Mehr Licht, thoshte Gëteja, dua të shoh më qartë, dhe ky është rënkim i shpirtit të kohës: duam t’i kuptojmë më mirë problemet e jetës.*”⁸ - *Omne simile generat sibi simile* – Ç’del nga macja, gjuan minj;⁹

- *vir dolurum* – njeri i dhimbjeve: Dëgjoni. Kanë kaluar 20 shekuj qëkurse një njeri,

njeriu më i madh, i vetmi njeri, njeriu vetë, qe rrethuar më tepër se kushdo nga dhimbjet

dhe vuajtjet, sa u mbiquajt *vir dolurum*...

- *Inventies requiem* –

- *Gratis accepistis et gratis date* – Falas po i merrni e falas t’i jepni.

- *Estote perfecti sicut pater vester coelestis perfectus est* – Ji i përsosur sikundër ati yt

është i përsosur.

- *servile deo regnare est* – T’i sherbesh Zotit do të thotë të sundosh.

- *Digitus Dei est hic* – Këtu ka gisht Perëndia.

- *Charitas Christi urget nos* – Për hir të Krishtit nuk ngopemi me kaq...

- *Prima veneziano, poi cristiano* (it.) - Së pari venecian, mandej kristian...(Përdorur në

kontekstin e kushteve të shqipes: Më parë shqiptar, mandej katolik);

- *Veritatis et Charitatis* – paçim të vërtetën udhëheqëse, dashuria të na mbajë ngaherë!

- *qui pacem dicunt et desolationem faciunt* – ata që në emën t’idealit e të kombsisë nuk

po lanë gja pa përmbysë...

Përveç këtyre, në traktatin filozofik e teologjik gjenden edhe një dorë

⁷ Harapi, P.Anton. **Vlerë shpirtërore**, Botime Françeskane, Shkodër, 2009, f. 137-138.

⁸ Harapi, P.Anton. **Vlerë shpirtërore**, Botime Françeskane, Shkodër, 2009, f. 63.

⁹ Po ai, po aty, f. 92.

frazeologjizmesh shqipe,¹⁰ që pajtohen aq mirë me përmbajtjen e thënieve a të gjithë tekstit ku bëjnë pjesë, si:

- *nuk e bluan mendja* – nuk e merr mendja, nuk arrin ta kuptojë: Ja se ç'gjë nuk mund ta

bluajë në asnjë mënyrë mendja e disave. (f. 95)

- *mbahen në këmbë* – rrinë drejt, qëndrojnë ngritur: Si mund të shpjegohet ndryshe që

popuj dhe kombe mbahen në këmbë sot që demoralizimi po përhapet kudo? (f. 96)

- *e rrihte ket çashtje*: qi t'a rrihte ket çashtje aq me randsi, f. 31: ta diskutonte çështjen,

problemin, ta hidhte në kuvend për të arritur një zgjidhje;

- *ja ka vu barrë krahit*: ia ka vu barrë krahit urtis e burrnis së marë popullit Shqyptar, f.

31: në kuptimin “ia ka vënë si detyrë, e ka ngarkuar me një mision”;

- *ka bënë* : qi ka bënë me e ruejt besnikisht tansin e mëvehtsin e tokës shqyptare, f. 31: një formim që nuk ka pasur jetë përdorimi në gjuhën shqipe, pasi në vend të saj del “është betuar”

- *në kambë e në dorë*: me e kallxue ashtu në kamë e në dorë, f. 33: shkurt dhe shpejt, aty

për aty, menjëherë, pa u parapërgatitur, i gatshëm në përgjigje dhe veprim për diçka;

- *me dhanë gjygin definitiv të vetin*: me marrë vendimin përfundimtar të vetin;

Në përbërje të shkrimeve publicistike, ka raste kur autori jep përmbajtjen e maximave filozofike, duke krijuar thënie të tilla në gjuhë shqipe, përkthime a përshtatje në gjuhën amtare, si në tekstin vijues: “...Por edhe pa shkollë, shqyptari, në themel t'arsyes e kupton mâ së miri pozicionin e jetës. Ai e shprehë mâ së miri zotnimin e ides mbi tjerat veprime të nierit, kur thote: “Kush s'ka mend ka kambë.”, qi don me thanë njata shka tha Platoni (Fedon.64; Fileb.28,66,62), se nieri, qi nuk vepron mbas arsyeje,âsht i gjykuem me rrënue si shtasët. Prap, mandej duhen “mâ shum mend se dhen” e kështu tuj i dhanë na vendin e parë mendjes, pa i perjashtue tjerat të mira, provojm njata shka tha Aristoteli (Etik. Nikomak. 16,1097;

¹⁰ Harapi, P. Anton. **Naltimi i ndërgjegjes kombtare**, Botime Françeskane, Shkodër, 2017, f. 37. (Këtu autori vëren: “Frazeologjia popullore perfton prej rrethanavet jetsore e shprehë mâ së miri shpirtin a se psyken e popullit; prandej na, per me sprovue pohimet tona, në ket studim jo vetun po u pështetemi fakteve, por në dishmi do të përdorim sidomos frazet shqyptare.” F. 37.

19, 1099) se virtyti – ideari i jetës së nierit – nuk perjashton pasunin, miqsin, andet e tjera të mira të rendit të dytë. Këta don me thanë se shqyptari arsyeton e pa veshitersi pershkon nder të vërtetat më të naltat. Praktikisht mandej, jeten e pështetë në ndimen e Zotit e në të drejtën e fituese me kujdes e me mûnd: “Nimo Zot e e drejta, e duerët, e kambët e shpejta”, prandej, në kuptimin e shqyptarit, tagri nuk themelohet në forcë, si pat mendue Kant-i, kuer tha, se e ka bjerrë tagrin njaj, i cilli s’âsht i Zoti t’a mëprojë.¹¹

Ka raste kur autori, në shkrime argumentuese divulgative, të niset nga një premisë negative, për të kaluar në mbrojtjen e një rrethane shoqërorepozitive, për të cilën fton bashkatdhetarët të ngulmojnë për ta arritur, siç vërejmë tek paraqitja e “egoizmit të natyrshëm”, si e quan ai në artikullin e revistës “Hylli i Dritës”nr.1 1930. Shkruan Harapi, duke u mbështetur tek një term i pedagogjisë moderne, për të vërtetuar dukuri shoqërore që i shihte në jetën e bashkatdhetarëve të tij, si në diskutimin në vijim:

“Veç se shka, shqyptari shum relacione të jetës i merr e i kupton fare gabueshem. N’at mndyrë si fmija i vogël s’sheh tjeterkend, por veten, gjithshka gjykon mbas veti e të tana punët e sendet i endë per rreth atij “Ego-concentricum”qi s’âsht tjetër, por egoizmi në kulmin e vet, ashtu shqyptari, anë e kand porsit thalbi në gerojë, endet e përmblihdet n’individualizem qyshe se, “i krishtëni bân kryq per veti e myslimani thotë bismilahi per veti”, e, si njëni tjetri thotë “tymi i êm shkoftë ndrejtë” pse “kur të des un, bâhet dita e gjygjit a e kjahmetit”.¹² Kështu, pa u larguar nga krahasimi me percetimin e edukatës së fëmijëve, autori konkludon se n’at mëndyrë si fëmija, tuj marrë një edukatë të shëndoshtë, prej egoizmit të tepërm, xên me ndie e me punue edhe per tjerë, a kështu trajtohet per veti e per shoqni; një per një shqyptari, me at masë qi të dalë prej individualizmit, ka me i u afrue kulturës e qytetnimit. Mâ e para pâra pûnë pra, qi do të bâjmë per trajtimin e popullit tonë, do të jetë negative; jo me shue personalitetin e shqyptarit, por me vû në binar të duhun egoizmin e

¹¹ Harapi, P. Anton. **Naltimi i ndërgjegjes kombtare**, Botime Françeskane, Shkodër, 2017, f. 37. (Këtu autori vëren: “Frazeologjia popullore përfton prej rrethanave jetsore e shprehë më së miri shpirtin a se psyken e popullit; prandej na, per me sprovue pohimet tona, në ket studim jo vetun po u pështetemi fakteve, por në dishmi do të përdorim sidomos frazet shqyptare.”, f. 37 - 38.

¹² Harapi, At Anton. **Naltimi i ndërgjegjes kombtare**, Botime Françeskane, Shkodër, 2017, f. 38.

*natyrshem e mos me lanë të kapërcejë caqet e arsyes.*¹³Më tej, në këtë shkrim, ai shtron përpara lexuesve konceptin e *familjes*, për të cilën shprehet se *është themeli e âma e popullit, e komit e e shtetit...prandej jeta e nji popullit, tuj xânë fill në familje, vjen e shtrihete unjisohet aq per bukuri, sa me terhjekë bindjen e kënaqen e të gjithve*. Pas kësaj, Harapi e sheh të nevojshme të na njohë me thënien patetike të Paulsen-it: *“Drejtija, dashtnija, shpënesa e nderimi per shoqishoqmin, si dhe durimi, mirsija, ndiesit e pikëpamjet eperbashkta janë fuqit, mbi të cillat pushtetet të tanë jeta shoqnore.”*¹⁴ Citimin e ndjek përsëri një thënie e këtij autori, të cilin studiuesi ynë e sjell në gjuhën shqipe: *“Është gjykue me hupë njaj popull e njajo kulturë, e cilla e ka bjerrë poezin e pastrin e jetës familjare, kur nuk i nderon njato ligjë e njato caqe, brenda të cillave enden e përmblidhen tagri, detyra, morali e ndera e familjes.”*¹⁵ Edhe thënie të plota të shkrimtarëve latinë, si b.f., nga Horaci, autori parapëlqen ta sjellë vetë në gjuhën shqipe: *“...jo çdo rromanx, teatër a film ka qëllimin edukativ e instruktiv; vetem njat herë janë per ket qellim, kur sillen rreth objektit të ndershem e msojn tuj kënaqë”*, si thotë Horaci.¹⁶

Vendi i maximave latine në frazë

Thëniet e maximat në gjuhën latine zënë vendin kryesor në shkrimet e publicistikës, oratorisë dhe polemikës së shkrimtarit A. Harapi; ato paraqesin interes njohjeje dhe diskutimi jo aq në përmbajtjen e tyre, por më së pari, për t’u njohur me mjeshtërinë dhe teknikën e topikës në radhën e gjymtyrëve të njësive kumtuese apo në raport edhe me funksionet sintaksore që luajnë fjalitë brenda frazave a periudhave gjuhësore. Disa prej tyre i kemi sjellë, bashkë me kontekstin që ka krijuar autori ynë, si:

- *Omne nimium vertitur in vitium* – teprija është tepri edhe në të mirën: “Qe se si besa degeneron, nuk është ma një virtyt e një punë e arsyeshme, por është një pasion e një ves. *Omne nimium vertitur in vitium*, d.m.th. – teprija është tepri edhe në të mirën.” f. 47

- *materia aequa viribus*: f.57 “Kemi mjaft po muejtem me bâ, qi shkrimet e botimet t’ona të lexohen me interesë prej atyne, të cillët, a per ideal, a per zyre e pozicion qikan, mahen e janë udhëhjekset e popullit; e po na duel m’u vjeftë e m’u ndimue sadopak në ket perlim, na e xâm se i a kemi dalë

¹³ Po ai, po aty, f. 38.

¹⁴ Harapi, At Anton. **Naltimi i ndërgjegjes kombtare**, Botime Françeskane, Shkodër, 2017, f. 39.

¹⁵ Po ai, po aty, f. 39.

¹⁶ Po ai, po aty, f.100.

qëllimit, e për ne kjo është ajo materia *aequa viribus* e Horacit.”¹⁷ Jo rrallë Harapi, njohës i mirë i pasurisë së gjuhës amtare, kur merr e shpjegon një latinizëm, nuk mjaftohet vetëm me një kuptim, por kërkon e gjen edhe sinonime të tij, si shihet më poshtë, ku, për një maximë, dalin tri fjalë të urta shqipe.

- *gutta cavat lapidem* – f.57 “Por edhe mbas i a mrrijshim as kaq, gjithnji s’na lëshon zëmra, as do të rijm me durr m’i, por gjithnji do të vijojm me çilë sÿnore të reja në jeten shqyptare, tue e dijtë, se *gutta cavat lapidem*: gur gur bâhet mur, mur mur bâhet kalaja, e së mbrâmi, në mos rrjedhët, pikon.”¹⁸ Përsëri gjenden disa sinonime për një thënie latine:

- *maxima debetur puero reverentia* - f.61.Citat i Juvenalit (nga Satira, XIV, 47), përdorur nga autori si parim i përgjithtë e i perhershëm, mbas të cillit na të rit tonë i shikojm porsî driten e sÿve, i duem porsî loçken e zëmbrës, i ruejm porsî thalbin e jetes...¹⁹

- *in facto esse*, f. 63: - në veprim, në zbatim, duke e shfaqur hapur diçka:²⁰ “Qe se si me iden “burrni” na i shprehim të gjitha virtytet vetjake e shoqnore jo vetem në dispozicion e n’aftsi, por në veprim e në zbatim a si i thonë *in facto esse*.”

- *Si vis pacem, para bellum*, f. 70.

Në shumë segmente të shkrimeve publicistike, Harapi zë e përkthen vetë maximat latine, brenda frazës së gjeneruar, bile, edhe duke u shprehur “*pat thanë aj i moçmi*”, sikur të dëshironte që urtësinë e përmbajtjes së maximave, t’ua atribuojë shqiptarëve të vjetër, si në frazën në vijim: “Veçse posë pagjes botore të jashtme, do të shikojm me e majtë sidomos pagjen gjytetse të mrendshme; ky do të jet kahri ma i madhi, jo vetun i atyne, qikan frenin e shtetit në dorë, por edhe i seicillit shqyptar, qi don Shqypnin, pse pat thanë aj moçmi: *Si vis pacem, para bellum*, shterngoju në do me e gzue pagjen; e na kurrsi nuk kemi me e bâ ket gatim mâ mirë, se tue shkue jeten me shoqishojnë në bashkim e në qetsi gjytetse.”²¹ Ose, autori shfaq aq shumë kujdes, në rastet kur thëniet latine futen në indin e frazës, pa pasur nevojë përshtatje vete të foljeve e rase të emrave:

¹⁷ Po ai, po aty, f. 57.

¹⁸ Harapi, At Anton. **Naltimi i ndërgjegjes kombtare**, Botime Françeskane, Shkodër, 2017, f. 57.

¹⁹ Po ai, po aty, f. 61.

²⁰ Jashari, Ali. **Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe**, Botimet Dudaj, Shtypshkronja “KOTTI”, Korçë, 2005.

²¹ Harapi, Anton. **Naltimi i ndërgjegjes kombtare**, Botime Françeskane, Shkodër, 2017, f.70-71.

- *memo index in causa propria*, f.175:”...edhe un prej anës s’ême i siguroj se do t’i rrî per mjedis e më të pleqnis ku të na vën një “*jury*” e paanshme, pse *memo index in causa propria*.”²² - *suprema lex*,* “*res difficiles in crastinum differre*”, f. 84: “Jo vetun është mirë, por është detyrë e detyrë e randë fort per të gjith sa jemi, qi kuptojm, mos të prishim varrë, mos të shprushim gaca e mos të njallim çashtje, pse pagja e qetsija janë *suprema lex* per ne; porse “*res difficiles in crastinum differre*” mos me marrë para sÿsh vëmen e rrezikut, mos me i ra mbrapa me kohë, me urti e mëndyrë që n’edukaten shpijake e shkollore, fort kollaj, një ditë, pa pritë pa kujtue mund të gjindemi para ndo’j katastrofe shtetnore.”²³

Po kështu vepron Harapi kur merr e shpreh mendimin e shkrimtarit e filozofit frëng De la Rochefoucauld, sjellë për lexuesin në ligjëratë të zhdrejtë se jeta nuk është tjetër, por praktika e egoizmit e e utilitarizmit, e se, në botë nuk ka as mirsi, as drejtsi, as ideal, por vetem interesë, qi mlohet me hijen e me duken e virtytit.²⁴

Për kulturën që përcillte, është e natyrshme që midis thënieve latine, ndonjë prej tyre, në prozën e Harapit, ta gjejmë edhe të përkthyer në gjuhën gjermanë, në të cilën autori kishte kryer studime të larta teologjike e filozofike, si:

- *Toleranz ist ein intolerantes Wort*,* f. 73: “Njimend se fjala *tolerancë*, si thotë Ad.Harnack, është një fjalë mjaft e vrashtë per nierz të gjytetnuem: “*Toleranz ist ein intolerantes Wort*”, me gjith këta, shikjue nder parime të së vërtetës, nuk është fjalë pa vend, e si motit, është nder ditë të sodit me shum arsye mund të perligjet.”²⁵ - *per fast et nefas*,*f.89:“..kerkon grada e zyre per të cillat nuk është, e tue u orvatë *per fast et nefas* per një gjêje, qi s’i pershtatet, maron m’u bâ haram per veti edhe per shoqni.”²⁶

²² Po ai, po aty, f. 175.

**suprema lex*- shkurtime i shprehjes së Ciceronit “*salus populi, suprema lex*” – e mira e popullit është ligji më i lartë. (A.Jashari, vepër e cituar, f. 357)

²³ Po ai më lart, po aty, f. 84.

²⁴ Po ai, po aty, f. 120.

**Toleranz ist ein intolerantes Wort* (ger.): Fjala “*tolerancë*” është një fjalë intolerante.(Autori ynë e sjell si maximë nga vepra *Aus Wissenschaft und Leben I...*(Geissen 1911, f. 233: më pas citon politikanin gjerman Arthur Zimmermann me veprën *Soll die Religion national sein?*, Freiburg, 1914, f.14)

²⁵ Po ai më lart, po aty, f. 73.

**per fast et nefas*–me të vërtetat dhe të pavërtetat; me të gjitha mënyrat; me çdo mjet duke u përpjekur e duke shfrytëzuar gjithçka.(A.Jashari, vepër e cituar, f. 355)

²⁶ Harapi, Anton. *Naltimi i ndërgjegjes kombtare*, Botime Françeskane, Shkodër, 2017, f. 89.

- *ad captum aetatis*, f.94: “Me gjith këta, shkolla, duem të ndryshojë kahë mosha; të caktohet definitivisht programi i fillloreve, qi janë universitetet e njimendta, d.m.th. të gjith shqyptarvet m’u dhënë njohtsit mbi gjithshkafen, mërret veshta *ad captum aetatis*; pra m’i dhanë kulturen kombtare.”²⁷

- *status quo ante*, f.105: gjendje e mëparshme, gjendje deri në një çast të caktuar: “...me mëndyrë e mjete me të cillat duen m’e rritë gruen, me liri e llastim, qi duen me i dhënë, mërrijn t’a bajn gruen një kufomë epshi e kurrjë tjetër; të pa numer mandej janë ata, të cillët duen të rrije grueja në *status quo ante*, pa marrë para sÿsh as fare rrymët e nevojët e reja, nder të cillat, sod e mrapa, dashtë e pa dashtë do të vuez jeten çëdo bij shqyptare.”²⁸

- *cujus regio illius et religio*, f.118 – sipas vendit dhe besimi; njeriu pranon fenë që sundon (A.Jashari, f. 266): “Aso kohe nierzt e perulen religjionin tuj e bâ vegël politike të vetat mrrÿjten me i mohue Kishës ndigiesen deri nder çashtë besimi, tuj zgjedhë per fill jete parimin: *cujus regio illius et religio*.”²⁹

- *conditio sine qua non*, f.125- kusht pa të cilin nuk ka; kusht i domosdoshëm: “...le t’a bâjë proven; porse, kur bashkërritjen e gjinive na e paraqesin porsÿ një pÿnë pa të cillen *conditio sine qua non*, nuk ka bazë civilizimi njerzuer, nuk mund të durohemi pa u përplasë nder sÿ...”³⁰

- *patres patriae*, f.128: - ati i atdheut; titull për ata që bajnë shërbime të larta ndaj atdheut; “Jeni verte *patres patriae*, mâ të mdhajt bâmirsa të kombit.” F.128

- *viribus unitis*, f.171- me forca të bashkuara: “Lama e veprimit âsht e haptë e e paprekun; kush do t’a ndieje vetin, mos të tallet, se koha nuk pret: “*viribus unitis*” të punojmë per mproje e permirsim të të miravet ideale e materiale të banorit të malevet e të katundevet.”³¹

- *de jure belli ac pacis*, f.258 – mbi ligjshmërinë luftës dhe paqes;”Olandezi Hugo Groot (1583-1645), per me mprojtë tagret e kombit e per të çilë tregtin me Indje, në veprën e vet “*De jure belli ac pacis*” sajoi një sistem filozofije, të cillin e thirri *ligja e natyrës*.”

- *splendide mendax et in omne virgo nobilis aevum* (Horaci, Odes, III, XI,35) f. 258 – “Âsht lëja me rrÿjtë sa herë nuk muejm ndryshe me e pshtue të pafajin a me ndalue një delikt, si per shembull bâni Ipermnestra, e cilla

²⁷ Po ai, po aty, f. 94.

²⁸ Po ai, po aty, f. 105.

²⁹ Harapi, Anton. **Naltimi i ndërgjegjes kombtare**, Botime Françeskane, Shkodër, 2017, f. 118.

³⁰ Po ai, pa aty, f. 125.

³¹ Po ai, po aty, f. 171.

dha fjalën se do t'a mbytte burrin e vet, por rrëjti, pse nuk e mbajti fjalën, e për ket vjerrshtari e madhon pors *splendide mendax et in omne vargo nobilis aevum*.³²

- *vulgus vult decipi* – f. 259bota (populli) dëshiron me u rrejte;”Por mbasi pûna ka vojte der ktû, as mâ mirë me hiekë perden e marres e merzin e arsyetimit, e me thënë të rrëjë kusht të muej? Jo, pse *vulgus vult decipi*, e at herë s’ka kush rrëhet mâ, e nierzt e ultë e të vogjel në vend m’u rrëjtë, kishin me kap hunin m’ata qi duen t’i rrëjn.³³

- *Risum teneatis amici*, f.263 – fjalë e portit romak, Horaci: “Qe në shka mahet siguriya matematike: Hypoteza e sensi logjik! *Risum teneatis amici!* Për me diftue se ndokush, punon me hamendje e jo me dieje, italjajt thonë se ka “buon senso” e shqyp e thomi: i a pret mendja, i a han palla, i hîn në perde e por edhe, ka hunden e mirë.³⁴ (me sinonimi).

- *circulus vitiosus*, f.263- rreth i mbyllur, rreth vicioz, gjendje pa rrugëdalje: “Kësaj i thonë shqyp dushk për gogla, për mos me thanë një fjalë tjetër edhe mâ shqyp: e në filozofi i thonë rreth me qark a se *circulus vitiosus*...”³⁵

- *jus omniun in omnia*, f. 269-të gjithë patën të drejtë në gjithçka.”Hobbes e Spinoza me tanë mprojsat e evolucionizmit moral, kujtojn se së pari-thonë ata- kur nieri ene ishte në gjëje të shtâsvet, kje *jus omniun in omnia*, të gjith patën të drejtë në gjithshka.³⁶

- *lucta omniun contra omnes*,f.269 – lufta e të gjithëve kundra të gjithëve: “Në ket luftim, kur të gjith luftojshin kundra të gjithve, *lucta omniun contra omnes*, nierzt shtÿ prej droje, ran në mendim edhe pan se mâ mirë do t’ishte të bâjshin një marrëveshje shoq me shoq, edhe e bënë.”

- *homo homini, lupus*, f. 269- sjellë nga Harapi me elipsën e foljes “është”. Shprehje e poetit romak Plauti; nga filozofi anglez Tomas Hobs është

³² Po ai, po aty, f. 258.

³³ Po ai, po aty, f. 259-260.

³⁴ Po ai, po aty, f. 263.(Ja dhe vargjet e Horacit: “*Humano capiti cervicem pictor equinam/lungere se velit et varias inducere plumas/ Undique collatis membris, ut turpiter atrum/Desinat in piscem mulier Formosa superne:/ Spectatum admissi risum teneatis, amici?*”- Në shqip: “Kokën e njeriut sikur mbi qafë t’ia ngjiste kalit piktori/dhe gjymtyrëve të mbledhura gjithandej t’ua shartonte/puplat e larme asisoj që gruaja lart mbi bel, fort e bukur,/të shndërrohej në peshk të shëmtuar e të përhimë,/ju të ftuar për të parë, o miq të mi, a do të përmbaheni së qeshuri?”Fjalë për fjalë shpjegon A.Jashari: A mundeni, o miq, të trajtoni orizin! Mos qeshni miq! Mbajeni gazin zotërinj!; përdoret me shaka kur flitet për gjëra qesharake e të pamundshme.”**Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe**, Botime Dudaj, Korçë, 2007, f.348.

³⁵ Po ai, po aty, f. 263.

³⁶ Po ai, po aty, f. 269.

përdorur për të cilësuar egoizmin e skajshëm: “njeriu për njeriun është ujk”: “Jemi plotësisht në gjëjen e bimorvet e të shtëpsvet: *homo homini, lupus*.

- *Militia est vita hominis super terram*, f. 270 -jeta e njeriut mbi tokë është luftë;”Jetë e njerit është një luftë e padame, jo vetem e njerit si vehtëje, por edhe e nierzvet si kolektivitet: *Militia est hominis*.”

Një radhë fjalësh me bazë latine gjejmë tek proza gazetareske e Harapit, të cilat mund të jenë ndër të parat që dalin në përdorim, si: *eureka, a priori, tolerancë, intolerancë, teoritike, dogmatike, partikularizëm, hyperkulturë, zrivjalitet, pornografi, emancipacion, utilitarist,ekuivokacion-i (që ka dy kuptime), egzigencë, moventi (shkasi), në fieri (n’evolucjon e sipër), Übermensch-i, (mbinjeriu), etj.*

Tek rendi i fjalëve a sintagmave:

Ngjet që në prozën publicistike të Harapit, të gjenden edhe nga dy a më tepër shprehje sintagma me fjalë latine, të cilat, në kësi rastesh, autori ka ditur aq bukur e me vend t’i sjellë në indin e strukturës gjuhësore të njësisive-fraza, brenda kushtit të logjikës që ato të plotësojnë njëra-tjetrën, siç do t’i shohim në vijim të kësaj ndarjeje:

- *post factum*, f. 34: ...nxjerr këtë përfundim *post factum*...

- *ab ovo*, f. 37: ...po deshten me e endë *ab ovo* që në vëme...f. 37

- *primus inter pares*, f.41: ...Shqyptari njimend njuhë krenë e bajraktarë, dán pari e vogjli, por bajraktarin, ate qi ka autoritetin, e mban “*primus inter pares*”, por si të parë ndere, edhe po i u bind e i u shtrua, këta i a ban per nder, ja per ndroje, e rrallë e gati kurr per ndërgjegje e detyrë. (f.41). Edhe me nga dy latinizma brenda një fjalisë gjejmë në prozë:

- *ubi consistam* –

- *modus vivendi* – f. 53 (brenda një fraze)...”Shqyptari...porsi i mbytuni neper shkumbë gjindet i kapërthym në mende të vet, e pors i fëmija gjit e pors i vorfni copen, lypë e kërkon t’i çilet perdja e jetës së vërtetë, mos të rrijë mâ berr, por t’a njohë at “*ubi consistam*”, per me mujtë me sajue pjanin e jetës së re, qi i tëfaqet, e kështu, me gjetë një “*modus vivendi*” - sa mâ të pershtatun per lumni e fatbardhsi të vet.”³⁷

- *modum facti* – f.58: “*Shka janë mendja e vullnesa në një nieri, njata janë menduesët e fatosat per një popull, vepra e frymsimi i të cillvet, aq hënë e deperton në jeten, në shpirtin e në mirvojtjen e tij, sa per modum facti populli disi vetit vjen e personifikohet e unjsohet nder ta...*”³⁸ - *entimemë-a*, f.173-gr. quhet edhe silogjizëm retorik, përcaktuar në retorikën e Aristotelit

³⁷ Harapi, Anton. **Naltimi i ndërgjegjes kombtare**, Botime Françeskane, Shkodër, 2017, f. 53.

³⁸ Po ai, po aty, f. 58.

si një organizim në formë silogjizmi, në të cillin një nga premiset nuk del e qartë, por vetëm e mundshme. “Më gjetet se fjalët e “Hyllit të Dritës” për kah forma përmbajnë një *entimenë*, në të cillen nuk përmendet një termë (premisë) e silogjizmit..”³⁹ Në grupin e thënieve të mençurisë popullore, Harapi sjell herë pas here maxima të tilla që pa mëdyshje mund të përfshihen në radhët e fjalëve të arta të popullit, proverbat, siç gjejmë në veprën e sapobotuar “Naltimi i ndërgjegjes kombëtare”, vetëm për *fjalën*:

Për fjalën e dhënë të burrit

Kush e ka fjalën fjalë e punën punë, nuk ka si punon shtremtë.
 Burri flet e ngulë.
 Burri s’i bân hile fjalës
 Fjalës së tij një ashke s’mund i hiqet
 Burri s’u bân lak fjalëve
 Beja e bame asht mâ e madhe se fjala e dhânun
 Fjala e dhânun asht një gâ shêjte. (f.45)

Edhe duke marrë shkas nga publikimi postum i librit të poetit të madh D.Agolli, “*Nulla Dies Sine Linea*”,⁴⁰ mendojmë se, pas leximit dhe njohjes me idetë e traktatit oratorik “Vlerë shpirtërore”, nga filozofi, pedagogu e sociologu A. Harapi, mund të rreshtojmë mjaft aforizma, për të cilat duhet nënvizuar se janë të gjithëkohshme, ashtu si merren edhe ato që shënuam në gjuhën latine e që i ka përdorur me aq mjeshtri autori dhe oratori ynë, Harapi. Natyrshëm që Pater Antoni, si teolog i krishterë, në oratoriet e veta para intelektualëve korçarë, ka përdorur edhe aforizma nga Ungjilli e Bibla, por ne nuk i regjistruam ato, pasi edhe nuk përbënin ndonjë numër të konsiderueshëm. Vërejmë se brenda frazave, thënieve, paragrafëve dhe teksteve ku gjenden këto aforizma të shkëputura nga ligjëratat e Korçës, gjuha fiton shprehësi të reja, mendimi mbështetet aq mirë dhe lexuesi lidhet më tepër me tekstin, edhe duke receiptuar më drejt e në thellësi përmbajtjen apo idetë e shprehura të autorit, si:

- Lëmë gurrat e duam të mbledhim pikat. (f. 59)
- Skeptiku nuk është i denjë për jetën. (f. 60)
- Kriza mendore është shuplaka më e madhe në botë. (f. 62)
- A ka më hall se të mos dijë njeriu nga t’ia mbajë? (f.62)
- Pasi gaboi mendja, iu vu njolla dashurisë. (f. 64)

³⁹ Po ai, po aty, f. 173.

⁴⁰ Agolli, Dritëro. *Nulla Dies Sine Linea – Aforizma*- Botimet “Dritëro”, Tiranë, 2017.

- Çështja e pronës dhe e pasurisë është më e tharta çështje e kohës. (f.65)
- Njeriu, jo vetëm që është një mikrokozmos në vetvete, por natyrisht hyn që të marrë pjesë si gjymtyrë e botës familjare, dhe nëpërmjet kësaj ai është pjesë përbërëse dhe plotësuese e botës së gjerë që e quajmë atdhe. (f. 138)

Mbizotërojnë në thëniet maxima të shkrimtarit A.Harapi, ato që lidhen me atdheun, sepse vetë koha që kalonte e kërkonte një drejtim të tillë për bashkëkombësit e autorit për t'i ftuar shqiptarët të vinin të gjitha forcat për ta ndërtuar Shqipërinë europiane, nga të cilat veçojmë disa prej tyre:

- Atdhetarizëm do të thotë dashuri për njerëz, dashuri e sinqertë, dashuri vepruese, dashuri ideale. (f. 140)
- Atdhetarizëm nuk do me thënë ideal në tymb, fjalë të mëdha kumbuese, ide të larta tërheqëse, hyjnizim teorik i shqiptarit dhe i kombësisë. (f. 140)
- Atdhetarizëm nuk do me thënë interes dhe egoizëm, por do të thotë altruizëm, madhështi shpirtërore, fisnikëri ndjenjash, kontribut nderi, morali, kulture, diturie, arti, qytetërimi, duke filluar nga vetja dhe duke shtënë dhe përhapur në jetë dhe në mendësi të gjithë atyreve me të cilët e kemi të njëjtë thesarin e gjuhës e të shpirtit dhe lumturinë e jetës. (f. 141)
- Atdhetar është ai që di dhe që është i zoti të dashurojë më fort, më mirë, më me të vërtetë, dhe për dashuri bën therror veten dhe çdo gjë. (f. 147)
- Kur troket zemra sadopak për atdhe, s'ka si të mos e dëgjojë zërin vajtimtar që ky ideal i shenjtë, Shqipëria, na e drejton ne të gjithëve sa jemi bijt e saj. (f. 151)- E vërteta dhe dashuria në ngadhënjim, kjo është lumturia dhe fati i bardhë i zemrës sonë, i Nënës Shqipëri. (f. 153)

PËRFUNDIME

Pas kësaj paraqitjeje, mund të rreshtojmë disa përfundime për autorin e zgjedhur dhe rolin e thënieve e maximave të përdorura në prozën oratorike dhe publicistike të A.Harapit në ligjërimin e shkruar të tij, si:

- Pa mëdyshje, për P.Anton Harapin, duhet të shprehemi se midis shkrimtarëve françeskanë, ai dallohet në përdorimin e thënieve dhe maximave latine intelektuale dhe kjo ngjet për faktin se ai ka qenë jo vetëm pedagog dhe sociolog, por edhe shkrimtar e polemik, orator dhe filozof dhe ishte i pajisur me një kulturë të gjerë për kohën.
- Veçoria e përdorimit të fjalëve të urta në prozën e Harapit, qëndron në faktin se mjaft prej tyre aii përshin në strukturën e frazës.

- Po kështu, konstatohet se disa thënie a maxima, autori ynë i përkthen vetë, duke e shtrirë shpjegimin brenda frazës ku gjenden ato.
- Duke menduar se në prozën e shkruar të Harapit, mund të ketë aula të ndryshme për nga treguesit arsimorë dhe intelektualë të dëgjuesve, përgjatë frazave të Harapit, gjejmë edhe jo pak raste ku kuptimet a shpjegimet e thënieve të lihen pa shqipëruar, duke nënkuptuar se ato mund edhe të kuptohen apo njihen në përmbajtjen e tyre.
- Sa i takon dendurisë së latinizmave që kemi trajtuar këtu në këtë shkrim, proza e Harapit sikur ndërron regjistrat: nga thënie fjali, në sintagma dy e trifjalëshe, deri edhe një fjalë e vetme, të cilat ndikojnë në gjithë strukturën e frazës.
- Thëniet e maximat latine të sjella nga Harapi janë të shpërndara përgjatë shkrimeve të Harapit, sipas fushave të njohjes apo dallimeve tematike e përmbajtjes.
- Harapi ka edhe merita të veçanta në lëmë të leksikut, pasi, me shkrimet e veta, solli një serë termash nga fusha të ndryshme të kulturës, të cilat edhe mund të kenë hyrë për së pari në fondin e leksikut të gjuhës sonë.

BIBLIOGRAFI

- ASHSH, Fjalor Enciklopedik Shqiptar-2, Tiranë, 2008.
- A.Plasarit – Anton Harapi – Redimensus – të botimit të “Hyllit të Dritës” “Vlerë shpirtërore”, Tiranë, 1994, f. 3 – 54.
- Harapi, Ât Anton. Kulla e Babelit, seria “mendimi shqiptar 5”,Phoenix& Shtëpia e Librit, Tiranë, 1999.
- Harapi, P. Anton. Naltimi i ndërgegjes kombtare, Bot.Françeskane, Shkodër, 2017.
- Jashari, Ali. Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe, Botimet Dudaj, Shtypshkronja“KOTTI”, Korçë, 2005.
- Agolli, Dritëro. Nulla Dies Sine Linea – Aforizma- Botimet “Dritëro”, Tiranë, 2017.
- Ndreca, Mikel. Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja, Prishtinë, 200.
- Qirjazati, Kosta. Fjalor i shprehjeve dhe thënieve latine, Botime enciklopedike, Tiranë,2001.

Contextual use of some proverbs of Latin maxims in the prose of writer Anton Harapi (In literary creations and oratory)

In this lecture, Dr. K.Lazri and Dr. Z.Shkreli argues that Latin proverbs in literary creativity also require the contextual context of their use, in order to attain the linguistic expression and intellectual coloration of the teaching masses used, such as: in a statement, within a paragraph or in a new text. This request is based on literary and publicity (writer) of the writer, controversy, apologist, sociologist, philosopher and professor Anton Harapi, whose work is now published and

republished in all kinds and genre.

The author underlined that the presence of proverbs and Latin maxims, whether from another language, is, first of all, indicative of the level of culture and intellect of the person who knows them and has the ability to use it throughout the discourse act. On the other hand, the phrases and syntax segments that are contained in these units are differentiated from the literary creation to the oratory or publicity of the writer A. Harapi, bringing close to the texts they contain with sayings or paragraphs where such latinisms are missing. Dr. K. Lazri has followed the A. Harapi's literary production very carefully and has shown that, although it is about an author, the presence of Latinisms is subordinate to literary genres; Thus, for example, in the journalist and orator, where Harapi has a work so marked as the collection of "Spiritual Value" lectures held with the intellectuals of Korca in 1936, there is more space for the use of Latin sayings such as *Veritati servant, Charitati laboro, Omne similis generat sibi bonum, vir dolorum, inventies requiem* etc.; while in artistic creations presentations come forth as: *O beata solitudo, modus in rebus, Caritas Christi urget nos, Ubi spiritus Domini, ibi libertas, charta magna, Video meliora proboque, sed deteriora sequor, ignoramus et ignorabimus et al.ect.*

In addition to the use of Latin sayings (even from other languages), according to the genres or types of writers' creativity, the author does not leave without describing the infrequent phenomenon when Latin maxima and proverbs in this language unfold and produce effects opposed to the expressiveness of the language, which is the purpose of the speaker or the creator, as it appears in the public lecture, when speakers can bring such expressions into segments that cannot be included because of their semantics. On the other hand, the publisher should see the degree of culture and reader education, as in the halls of free lectures, must -known intellectual level of the audience, that the word, phrase and all said catch understandable to them; otherwise, we need to ask *who we write or talk about? Who are we addressing?* By the way, if during one hour of teaching Latin, bring to the students of the first year in this subject Suarcz's statement *Multa sunt bona, not quia praecepta, sed quia bona, sunt praecepta*; we would be so incomprehensible that the subjects that are in the first steps of acquaintance with Latin do not follow us.

Key words: creativity, sayings, maxima, latinism, intellectual prose, author's culture.

ORJETA BAJA

FIGURAT E STILIT
(Fjalor terminologjik shpjegues)

*Stilistika*¹ - si degë e gjuhësisë që studion mjetet dhe ndërtimet gjuhësore shprehëse që çojnë në përfitim të figurave të stilit, të cilat mundësojnë kryerjen sa më me efektshmëri të komunikimit - e ka origjinën tek Retorika.

Siç shkruan studiuesi Olivier Reboul, *Retorika vetë është e vjetër në historinë e saj. ... E ndesh Retorikën të indutë, kinezët, egjiptianët, hebrejtë. Megjithatë, thuhet se Retorika është një shpikje greke.*² E nëse i referohemi edhe përcaktimeve mbi prejardhjen e çdo figure stili të paraqitur në vijim, vihet re se pjesa më e madhe e tyre rezultojnë me origjinë nga gjuha greke, ndjekur nga ajo latine (me një numër më të vogël); të modifikuara më vonë në gjuhë të ndryshme. Edhe vetë termi *figurë* (gr. schêma; lat. figura)³ buron nga kultura antike e grekëve dhe e romakëve, lidhur në origjinë me retorikën - artin e të folurit bukur.

Megjithë punën e bërë për shqipërimin e shumë termave të fushave të ndryshme të shkencës e të teknikës, sidomos gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, vëren se, mes fushash të ndryshme, edhe fondi terminologjik me **figura stili**, shfaqet pothuajse i tëri me terma të huazuar. Kështu, duke

¹ “Emri i disiplinës së *Stilistikës* dhe autonomia e saj shkencore i njohin fillesat nga Charle Bally (1905 -1909), i cili themeloi studimin sistematik të burimeve shprehëse të gjuhës, shkëputur nga Retorika. Termi *Stilistikë* (marrë nga gjerm. *Stilistik*, krijuar nga Novalis pak para vitit 1801) u përhap në Itali në mesin e viteve ‘800 me kuptimin “arti i të krijuarit”, përmes përshkrimit të tropeve e figurave të ligjëritimit dhe të rregullave të tyre të “kompozimit”. Me këtë vlerë stilistika do të mbijetonte në seksionet e manualit shkollor të deri gjysmës së dytë të viteve ‘900. Nga antikiteti deri në vitet ‘900, ajo që i përkiste stilistikës, mbulohej nga retorika, në kuadrin e *elocution* (me ndarjet e mëtejshme: *disposition* e *invention*). E për retorikën, stilistika bëhet pjesë themelore, kur tratatistika (arti, teknika e të shkruarit traktate – shën. im) praktikisht përkon me studimin e “të bukurës”. Kjo shpjegon kryqëzimet e mbivendosjet që ekzistojnë edhe sot ndërmjet retorikës e stilistikës. Objektet dhe funksionet e stilistikës përkufizohen në marrëdhënie me vlerat e stilit.” (Gian Luigi Beccaria, *Dizionario di linguistica (e di filologia, metrica, retorica)*, “Einaudi”, Torino, 2004, f. 734 - 736)

² Olivier Reboul, *Introduction à la rhétorique*, “PUF”, Paris, 1998, f. 13.

³ Gian Luigi Beccaria, *Dizionario di linguistica (e di filologia, metrica, retorica)*, “Einaudi”, Torino, 2004, f. 315.

qenë se pothuajse të tërë këto terma kanë karakter ndërkombëtar, për shpjegimin e tyre i jemi referuar disa fjalorëve terminologjikë gjuhësorë shpjegues neolatinë: frëng e italianë (për faktin se në shqip akoma nuk kemi një të tillë, shpjegues), në përjasje edhe me fjalorë letrarë në vendin tonë.

1. Tipare të figurave të stilit

Mësuesit dhe teoricienët e Retorikës dhe të Gramatikës kanë vërejtur ndër të parët karakteristikat e shprehjes gjuhësore të figurave të stilit. Ata i kanë pikasur, i kanë vërtetuar dhe i kanë përcaktuar si nocione parësore dhe sintetike nga ana stilistike, duke mbetur në shekuj, si edhe në kohën tonë, të kuptueshme, të sakta dhe të pranueshme në kuptimin teorik gjuhësor e letrar.

“Është e rëndësishme të theksohet se përdorimi i figurave nuk është privilegj i një shkrimtari apo i njerëzve eruditë. Figurat krijohen më shumë se kurrë në të folurën popullore më spontane. Kështu, një gjuhëtar francez në librin e tij “Trajtimi i tropeve” (1730) theksonte se mund të krijohen më tepër figura në një ditë pazari sesa në disa seanca akademike”⁴, - vë në dukje gjuhëtari Sh. Rrokaj.

Sipas Thomas S. Kane: “Figurat stilistike janë shmangie nga emërtimi i drejtpërdrejtë, trajtime, ndërthurje dhe ndërtime, që tërheqin vëmendjen.”⁵ Po ky studiues vazhdon: “Figurat nuk janë një zbukurim i jashtëm; ato përftojnë marrëdhënie të reja, shpesh të papritura, e pasurojnë përmbajtjen, nxisin krijimtarinë.”⁶

Th. S. Kane shtjellon më tej nocionin e figurës e të gjuhës së figurshme, duke sjellë disa tipare të tyre:

- 1 - Kur është e endur si ndërthurje e goditur tërësore, gjuha e figurshme e pasuron ndjeshëm ligjëratën.
- 2 - Figura mund ta qartësojë një ide abstrakte ose të pazakonshme, e thekson nëpërmjet një imazhi mbresëlënës, të cilin lexuesi sikur arrin ta shohë e ta kapë. Ajo e thekson ose e zgjeron idenë.
- 3 - Kur e konkretizon mendimin, figura i drejtohet një paraqitjeje më të kapshme, e cila në këtë rast themi se bën një modelim të idesë, siç bëjmë në disa fusha të shkencës për të shpjeguar dukuri që nuk kapen me

⁴ Gian Luigi Beccaria, *Dizionario di linguistica (e di filologia, metrica, retorica)*, “Einaudi”, Torino, 2004, f. 11.

⁵ Thomas. S. Kane, *Si të shkruajmë shqip* (redaktor: Xhevat Lloshi), Tiranë, 2010, f. 530.

⁶ Po aty, f. 531.

anë të shqisave.

4 - Me figurat thuhet diçka, që ose nuk mund të shprehej e ngjeshur me mënyra të tjera, ose nuk do të kishte atë gjallëri e bukuri. Figurat ndikojnë në përfytyrimin, ndihmojnë për përshkrimet, për paraqitjen vizatuese, piktorike, fytyrëzuese.

5 - Figura sjell një gjykim vetjak, i cili ndikon mbi ndjenjat tona lidhur me atë subjekt: ne ose e miratojmë në drejtimin më të mirë të funksionit, e pëlqejmë a e çmojmë, ose e kundërshtojmë si të tepruar, të padrejtë, të papëlqyeshëm. Nëpërmjet vlerësimit ne sjellim në tekst edhe anën tonë emocionale.

6 - Gjuha e figurshme është tërheqëse. Ne ndiejmë kënaqësi nga mprehtësia e gjetjes, nga mënyra e ngjeshur për ta thënë të gjallë diçka që, përndryshe, është një ide abstrakte, e ndërlikuar ose e thatë për ta rrokur.⁷

Sot, sipas studiuesit Rrokaj, “Stilistika gjuhësore po zë një vend të rëndësishëm me ndihmesën e saj të madhe në analizën e figurave stilistike.

Me figura do kuptuar ato trajta, forma apo përdorime më të dukshme se të tjerat, me një efekt pak a shumë të kënaqshëm, nëpërmjet të cilave, një tekst, në shprehjen e ideve, mendimeve apo ndjenjave të caktuara, dallohet nga një tekst i thjeshtë dhe i zakonshëm. Figura është një formë ligjërimi, realizimi i së cilës në një tekst mund të jetë origjinal ose konvencional, d.m.th., ajo mund të përdoret për herë të parë ose të kemi një rimarrje të një figure të krijuar nga folës të tjerë më parë.”⁸

2. Figurat e stilit – gjuhësore e letrare

Figurat e stilit, të cilat mund të vështrohen si në pikëpamje gjuhësore, ashtu edhe letrare, tregojnë qartë për lidhjen e ngushtë të gjuhës me letërsinë.

Gjuha është mjete kryesor për përfundimin e krijimeve letrare artistike, për krijimin e veprave të artit të fjalës; letërsia dëshmohet pikërisht nëpërmjet gjuhës si materie kryesore, jashtë saj ajo nuk mund të krijohet, të ekzistojë, të komunikojë e as të bëjë ndikimin estetik. Një gjë të tillë e pohon edhe studiuesi i shquar i gjuhësisë, Ferdinand de Saussure, kur vë në dukje se s’ka tekst letrar pa gjuhë. Pa e kuptuar gjuhën, përkatësisht natyrën

⁷ Thomas. S. Kane, Si të shkruajmë shqip (redaktor: Xhevat Lloshi), Tiranë, 2010, f. 531 - 532.

⁸ Shezai Rrokaj, *Probleme të Stilistikës gjuhësore: kuptimi, ndërtimi dhe përdorimi i disa figurave stilistike*, në “Çështje të gjuhës shqipe - 2”, “Shkronjë pas Shkronjë”, Tiranë, 2009, f. 11.

e saj, nuk mund ta kuptojmë as natyrën e letërsisë. Me fjalë të tjera, pa e njohur vendin dhe rolin e gjuhës në dukurinë letrare, nuk mund të ndriçohen veçantitë e një vepre letrare e as të dallohet ndryshimi midis strukturës gjuhësore dhe strukturës gjuhësore poetike.

Fjalësi terminologjik paraqitur në vijim, dëshmon qartë lidhjen e ngushtë e të ndërsjellë të gjuhësinë me letërsinë.

3. Klasifikimi i figurave të stilit

Ekziston një numër i madh përcaktimesh mbi figurat e stilit, të cilat, përgjithësisht pajtohen në elemente të përbashkëta që çojnë në një përgjithësim të tillë: *Figura sjell një mënyrë më të gjallë ligjërimi se ç'është ligjërimi i zakonshëm dhe qëllimi është që, përmes saj, të zgjohet vëmendja e lexuesit a dëgjuesit me origjinalitetin që ajo mbart. Figurat qartësojnë, konkretizojnë, pasurojnë, shprehin ndjenja, gjykime e vlerësime dhe janë burim kënaqësie.*

Po a ekziston një numër i përcaktuar dhe një klasifikim përfundimtar mbi figurat e stilit?

Studiues të ndryshëm, në kohë e vende të ndryshme, i kanë trajtuar gjatë figurat e stilit. Ashtu sikurse retorët e parë, edhe ata i kanë konsideruar si mjete për t'u shprehur në mënyrë të habitshme, me sharm e me emocion, duke përdorur rreth 250 emërtime për to. Por, shumë prej tyre nuk pajtohen me numrin e figurave stilistike, as me domethënien e tyre, as për grupin ku mund të grumbulloheshin figurat e ngjashme. Kështu, tipologjitë e sjella nga retorika klasike, karakterizohen nga heterogjeniteti, kompleksiteti, me mënyra trajtimi të ndryshme, gjithmonë të diskutueshme:

Mjeshtërit e oratorisë të viteve 1960 - periudhë në të cilën *Stilistika* u bë vazhdim i pjesës më të rëndësishme të *Retorikës*, të quajtur *elocucio* (elocution) - u përqendruan mjaft në studimin e *figurave të stilit*, duke i përkufizuar si *shmangie në raport me normën apo "shkallën zero"* e duke synuar t'i grupojnë, por pa arritur në një ndarje përfundimtare, edhe pse disa prej tyre bashkoheshin në mendim.

Për Bernard Dupriez, në librin "L'étude des styles" (1969)⁹, në klasifikimin e figurave mund të zbatohet një ndarje sipas katër niveleve të këndvështrimit: a) figura të mendimit, b) figura të fjalëve, c) figura të ndërtimit, d) figura të diksionit.

Pak vite më vonë, Pierre Guiraud, në librin e tij "La stylistique"

⁹ Bernard Dupriez, *L'étude des styles*, "Didier", Paris, 1969.

(1972)¹⁰, sjell pothuajse të njëjtën ndarje: a) figurat e diksionit, b) figurat e ndërtimit, c) figurat e mendimit, d) tropet.

Gjithashtu, nga studiuesja franceze, Catherine Fromilhague, me studimin “Les figures de style” (2000)¹¹ dhe nga studiuesi kroat Milivoj Solar në tekstin “Hyrje në shkencën për letërsinë” (2003)¹², ndeshim pothuajse të njëjtin klasifikim të figurave të stilit, në: a) figura diksioni, b) figura ndërtimi, c) trope, d) figura mendimi.

Një ndarje pothuajse e njëjtë e figurave ndeshet edhe në shpjegimin e termit *figurë* në “*Dictionnaire de linguistique*” (2001), ku, pas përkufizimit: *Në retorikë, figurat janë aspekte të ndryshme që mund të përfshijnë në ligjërim shprehje të ndryshme të mendimit*¹³, dallohen këto grupime: a) figurat e mendimit, b) figurat e kuptimit, c) figurat e shprehjes, ose tropet, d) figurat e diksionit, e) figurat e ndërtimit, f) figurat e elokucionit, g) figurat e mendimit.

Gjuhëtari stilist Xhevat Lloshi, në librin “Stilistika e gjuhës shqipe e pragmatika” (1999, 2005, 2012, 2015)¹⁴, në kapitullin mbi *Stilistikën e shprehësisë*, që shqyrton mjetet dhe mënyrat shprehëse në gjuhën shqipe në rrafsh të ndryshme të saj, sjell këtë ndarje për figurat e stilit: a) stilistika e mjeteve fonetike (fonostilistika), b) stilistika e mjeteve morfologjike (morfofilistika), c) stilistika e leksikut (leksikostilistika), d) stilistika e kuptimeve (semantostilistika), e) stilistika e togfjalëshave dhe e fjalive (sintaksostilistika), duke e parë stilistikën të lidhur ngushtë me çdonjërin prej niveleve të gjuhës. Edhe përkufizimet e termave të këtij Fjalori do të nisin së pari me një përcaktim mbi nivelin gjuhësor që i përkasin.

Siç bie në sy, disa tipologji të përmendura më sipër përtakojnë në konceptim me njëra – tjetrën, duke u klasifikuar sipas kriteresh të ngjashme, por, të tjera, jo. Që prej fillimeve të artit oratorik (të retorikës), klasifikimi i figurave ka qenë objekt debati për shkak të larmisë dhe emërtimeve të ndryshme. Akoma sot, ato nuk kanë një klasifikim përfundimtar unik, përveç atyre të paraqitura në trajtimet stilistike të vjetra

¹⁰ Pierre Guiraud, *La stylistique*, “PUF”, Paris, 1967.

¹¹ Catherine Fromilhague, *Les figures de style*, “Nathan”, Paris, 2000.

¹² Milivoj Solar, *Hyrje në shkencën për letërsinë* (përshtatur nga Floresha Dado), “ShBLU”, Tiranë, 2003.

¹³ Jean Dubois; Mathée Giacomo; Louis Guespin; Christiane Marcellesi; Jean-Baptiste Marcellesi; Jean-Pierre Mével, *Dictionnaire de linguistique*, “LAROUSSE”, Paris, 2001, f. 203.

¹⁴ Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, “ShBLU”, Tiranë, 1999; Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, “Albas”, Tiranë, 2005, 2012, 2015.

apo moderne.

* * *

Në këtë fjalor, paraqitja e **Figurave të stilit** do të vijë alfabetikisht, duke synuar atë të llojit shpjegues, me shtrirje teorike dhe praktike, me qëllim që të qartësojë aspekte konceptuale të termave.

Shpjegimi i lemave të këtij glosari është rezultat i përjasjes së disa literaturave: leksikografike - gjuhësore e leksikografike - letrare, si dhe teorike retorike e stilistike, duke pasur si objektiv mbledhjen e një informacioni sa më të plotë për gjithsecilën prej tyre. Çdo lemë-figurë do të shoqërohet me përcaktimin mbi *etimologjinë* e saj dhe do të prezantohet si term edhe në gjuhët: *frënge* dhe *italiane* (gjuhë të cilave i jemi referuar në këtë punim).

Secila figurë stili është shembëllzuar me *pasazhe ilustruese*, kryesisht nga letërsia shqipe, me emra të tillë shkrimtarësh, si: Filip Shiroka, Andon Zako Çajupi, Gjergj Fishta, Faik Konica, Musine Kokolari, Mitrush Kuteli, Migjeni, Ndre Mjeda, Fan Noli, Koçi Petriti, Arshi Pipa, Lasgush Poradeci, Frederik Rreshpja, Xhevahir Spahiu, Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Alfred Çapaliku, Stefan Çapaliku, Mimoza Ahmeti etj., të cilat dëshmojnë qartë pasurinë stilistike të gjuhës sonë.

Ky fjalor shpjegues terminologjik mbi *Figurat e stilit* konsiderohet i dobishëm, si mjet konsultimi për të njohur më mirë përmbajtjen e këtyre termave, e për t'u zotëruar nga një rreth i gjerë përdoruesish, si: shkrimtarë, publicistë, mësues, studiues në fushën e stilistikës etj., krahas studentëve të degës Gjuhë – Letërsi, për të cilët do të shërbejë si një material ndihmës për lëndën e Stilistikës së gjuhës shqipe.

Figurat e stilit

(Fjalor terminologjik shpjegues)

Shkronja A

aferez/ë, -a f. - nga gr. *aphairéo*, “eliminim, heqje” (*fr.* *aphérèse*; *it.* *aferesi*)

Figurë fonostilistike që konsiston në rënien e një tingulli apo të një grupi tingujsh në fillim të një fjale për të mos tejkalar sasinë e rrokjeve të duhura brenda vargut, p.sh.: “*Shndet prej meje të m'i falësh / 'saj (asaj) shpisë vjetër ku kam le.*” (F. Shiroka).

akrostik, -u m. - nga gr. *akróstichon*, “ekstremitet i vargut” (*fr.* *acrostiche*;

it. acrostico)

Figurë e nivelit grafik që shfaqet si një lojë letrare që përfshihet në të shkruarit e një poeme, përmes së cilës mund të lexosh një fjalë të formuar nga inicialet e vargjeve. Kjo mund të jetë një fjalë në raport me titullin e poemës, emrin e autorit të saj apo të atij që i dedikohet poem, p.sh.:

Sh *Shumë ëndërrova të doja një njeri,*
K *kështu më mbeti koka kthyer nga dashuria,*
Ë *ëndërr pas ëndrre blova dhimbje e vetmi,*
N *në zemër mblodha gjithë muzgjet me shkëndija.*
D *Duhej të prisja që veç ty të të desha,*
I *i rrethuar kështu përjetësisht me xixëllonja.*
J *Jam unë që të dua vërtet gjer në eshtra,*
A *apo ti të më bësh të të harroj je e pazonja? (K. Petriti)*

alegori, -a f. - nga gr. *allegoría*, “të folurit ndryshe” (*fr. allégorie; it. allegoria*)

Figurë semantostilistike shprehur me fjalë ose shprehje, prapa të cilave fshihet një kuptim ndryshe nga kuptimi i tyre i drejtpërdrejtë, që është në lidhje të ngushtë me të. Ky veprim retorik lejon të transformohen nocione abstrakte ose koncepte morale në figura shpesh tërheqëse. Tekste letrare në të cilat alegoria është më tipike, janë *fabulat*, ku vese e virtyte fshihen nën figurën e kafshëve etj. Thuhet: Përdor alegorinë. Me gjuhën e alegorisë. Flet me alegori. P.sh.: *Një anije e hedhur në det, e tronditur nga era dhe dallgët, pasqyron alegorikisht kushte të jetës humane pa mbrojtje. Alegorik është edhe udhëtimi në botën e përtejme, i përshkruar nga Dante Aligieri tek vepra “Komedia Hyjnore”.*

aliteracion, -i m. - nga lat. *allitteratione*, “përsëritje e shkronjave” (*fr. allitération; it. allitterazione*)

Figurë fonostilistike që konsiston në përsëritjen e një tingulli a një grupi tingujsh bashkëtingëllorë, të njëjtë a të ngjashëm, në fillim të disa fjalëve të njëpasnjëshme, për ta rritur fuqinë shprehëse të thënies përmes tingëllimit të tyre. Dallohet nga **asonanca**, e cila i referohet tingujve zanorë. Aliteracioni është përdorur si mënyrë veprimi e stilit në prozën poetike e në poezi. Thuhet: Varg me aliteracion. P.sh.: *“Duro, vashë, të durojmë / Si duron mali dëborën. / Në të shtëna moj në dorë / Do të ngroh si top dëborë.”* (L. Poradeci).

aluzion, -i m. - nga lat. *allusione*, “lojë fjalësh” (*fr. allusion; it. allusione*)

Figurë semantostilistike që konsiston në pohimin e diçkaje me qëllim që të bëjë të kuptohet një tjetër, e cila ka me të parën një lidhje historike, letrare, mitologjike etj. Aluzioni buron nga fjalë ose shprehje me kuptim të fshehur, thënë tërthorazi, që mund të nënkuptohet se bëhet fjalë për dikë a për diçka. Një figurë e tillë mund të përftohet duke u mbështetur në një ngjarje historike, si p.sh. shprehja: “*një fitore e Pirros*”, për të treguar një fitore të padobishme e të paguar me çmim të shtrenjtë, si ajo e arritur nga mbreti i Epirit, Pirro, kundër romakëve; ose mund të merret nga ngjarje e personazhe të mitit a të letërsisë, si në shprehjen: “*një labirint*”, për të përmendur një situatë të palexueshme ose të ngatërruar. Thuhet: Aluzion i hapur, i qartë, i errët. Bën aluzion për dikë (për diçka). Flet me aluzione.

anadiploz/ë, -a f. - nga gr. *anadíplōsis*, “dyfishim” (fr. *anadiplose*; it. *anadiplosi*) → **epanadiploza, epanastrofa**

Figurë sintaksostilistike që përftohet nga rimarrja e fjalës a e shprehjes së fundit të fjalisë a vargut të parë, në fillim të fjalisë a vargut të dytë për t’i krijuar emfazë shprehjes; kështu, fjala a shprehja e përsëritur i jep fuqi më të madhe mendimit, p.sh.: “*Po kjo gjamë qi ban natyra / Kjo duhi qi s’ka pushim / E kësaj zemrës a pasqyra / A pasqyra e vajit tim.*” (Nd. Mjeda).

anamor/ë, -a f. - nga gr. *anaphorá*, “përsëritje” (fr. *anaphore*; it. *anafora*) → **epanafora**

Figurë sintaksostilistike që përftohet nga rimarrja e së njëjtës fjalë a grupi fjalësh në fillim të disa fjalive në një vepër artistike në prozë apo të disa vargjeve të njëpasnjëshme. Kjo mënyrë synon për ta theksuar a për ta nxjerrë në pah më me forcë një nocion përmes fjalës së përsëritur, p.sh.: “*Humba lojën e trillshme të ndnjenjës / Humba prerinë e vajzërisë së pare / Humba bredhjet e tepërta, shkujdesjet / Humba shikime që më patën ngarë.*” (M. Ahmeti). Cilado qoftë gjinia ku gjendet anafora, ajo i jep një hov ritmik formulimit. Roli i anaforës, si figurë ekzemplare e figurave të përsëritjes, bie në sy veçanërisht në artin gojor.

anakolut, -i m. - nga gr. *anakóluthon*, “mungesë vijimësie” (fr. *anacoluthé*; it. *anacoluto*)

Figurë sintaksostilistike që konsiston në pasimin e dy ndërtimeve të ndryshme brenda së njëjtës fjali, ku, i pari del i papërfunduar. Në një rast të tillë, gjymtyrët e periudhës kanë një mospërputhje gramatikore në mes tyre: njëri prej grupeve sintaksore të frazës qëndron “në ajër”, pa “ankorim”

sintaksor. Kjo figurë, përftuar nga prishja e koherencës sintaksore të frazës për qëllime të caktuara nga shkrimtari (si: për t'i qëndruar më afër të folmes popullore të ndonjë personazhi a për t'i dhënë një fuqi disi të veçantë e karakteristike shprehjes), në dukje si gabim gramatikor, nuk është gjithmonë e lehtë të dallohet, p.sh.: “*Ato që vdesin, duhet të lutet Zoti për to.*”. Në këtë frazë, siç shihet, dy ndarjet janë formalisht të rregullta nëse merren veçamas, por janë të parregullta kur pranëvihen e paraqesin dy subjekte te ndryshme.

analogji, -a f. - nga gr. *analoghía*, “ngjashmëri” (*fr.* analogie; *it.* analogia)

Teknikë shprehëse që konsiston në ndikimin që një formë gjuhësore ushtron mbi një tjetër me qëllim përngjashmimi me të; lidhjet e vendosura ndërmjet tyre, privuar nga dukja e çdo lloj lidhjeje logjike. Figurë që jep një veprim a pamje të ngjashme, por që shpesh rezulton edhe e errët.

anastrof/ë, -a m. - nga gr. *anastrophé*, “kthim anasjelltas, përmbysje” (*fr.* anastrophe; *it.* anastrofe) → **inversioni**

Figurë sintaksostilistike që konsiston në përmbysjen e rendit të zakonshëm sintaksor të fjalëve në ligjërim për të krijuar efekt, ose për të ruajtur rimat e ritmin e vargjeve në poezi. Kështu, kallëzuesi mund të dalë para kryefjalës, mbiemri cilësor para emrit, emri në rasën gjinore para emrit në emërore etj., p.sh.: “*Oh zbrit ndër ne, mbretnore / Shqipe, edhe’j’herë, si zbritë / Kur përmbi ball, madhnore / T’madhit Kastriot i shndritë / E u trand gjith bota unji / Prej vringllit t’shatës s’tij.*” (Nd. Mjeda).

antanaklas/ë, -a f. - nga gr. *antanáklasis*, “ndryshim” (*fr.* antanaclasse; *it.* antanaclase) → **diafora**

Figurë semantostilistike përftuar me polisemi, e cila konsiston në përdorimin e së njëjtës fjalë në kuptime të ndryshme brenda së njëjtës periudhë, p.sh., në fjalinë “*Zemra ka arsytet e saj, që arsyeja nuk i njuh.*”, fjala “*arsye*” është përdorur fillimisht në kuptimin e “*motivit*” dhe më pas në kuptimin “*aftësi për të menduar e gjykuar*”. Apo në vargjet: “*...Tak-tak, troket, tak-tak: / - "As hape derën pak / Dhe zemrën hape pak." / Dhe përsëri / Hyn brenda Zonja Shërmëri...*” (M. Kuteli). Kjo figurë është shfrytëzuar shpesh nga teatri.

antifraz/ë, -a f. - nga gr. *antíphrasis*, “kundërshprehje” (*fr.* antiphrase; *it.* antifrasi)

Figurë semantostilistike që konsiston në përdorimin ironik të një fjale a shprehjeje, d.m.th. me kuptim të kundërt kundrejt atij të mirëfilltë,

p.sh.: *Është “një gjeni”* për të thënë *Është një budalla*. Ndeshet mjaft si dukuri e gjuhës në përfitim të figurave të **ironisë** e **litotës**, si dhe të disa eufemizmave.

antitezë, -a f. nga gr. *antíthesis*, “kundërvënie” (fr. antithèse; it. antitesi)

Figurë semantostilistike që përftohet me anë të dukurisë së antonimisë, duke ndërtuar një lidhje kundërshtie mes dy elementeve të një thënieje. Përqasja e dy nocioneve, ideve, mendimeve, situatave të ndryshme, përmes fjalësh e frazash të pranëvëna me kuptim të kundërt, përdoret si mjet stilistik për t'i dhënë shprehjes forcë e qartësi, p.sh.: “*Mos bëj fjalë për qetësim detesh / Zhurmim janë detet / Mos bëj fjalë për qetësim jetësh / Gulçim janë jetët.*” (M. Ahmeti). Antiteza përdoret dendur si një mjet i fuqishëm shprehës kryesisht në poezi. Thuhet: Antitezë e fuqishme.

antonomazi, -a f. - nga gr. *antonomasía*, “tjetër emër” (fr. antonomase; it. antonomasia)

Figurë stilistike që konsiston në përcaktimin e një personi ose të një gjëje të veçantë me emër të përgjithshëm, për të nënvizuar përsosmërinë e tij, p.sh.: “*Nëna e të varfërve*” = Nënë Tereza, “*Luani i Krujës*” = Skënderbeu, ose anasjelltas, një emër i përveçëm në vend të një emri të përgjithshëm, p.sh.: “*një Judë*” = një njeri fals e gënjeshtar, “*një Venerë*” = një grua e bukur e joshëse, “*një Herkul*” = një njeri shumë i fuqishëm.

apokopë, -a f. - nga gr. *apokopé*, “cungim, heqje, prerje” (fr. apocope; it. apocope)

Figurë fonostilistike që konsiston në rënien e një a më shumë tingujve në fund të një fjale për arsye stilistike, eufonike a metrike, p.sh.: “*Si mo’ Zo’ mâ keq për né / Qi a ndopak n’ Shqypni kem’ le*” (Gj. Fishta). Në frëngjisht, fjalët “*metro*” dhe “*cinéma*” vijnë nga apokopa e *métropolitain* dhe *cinématographe*.

apostrofë, -a f. - nga gr. *apostrophé*, “largim, shmangie” (fr. apostrophe; it. apostrofo)

Figurë sintaksostilistike që ndërtohet duke ndërprerë papritur ligjërimin dhe duke iu drejtuar me thirrje një njeriu ose një sendi të personifikuar, personave jo të pranishëm a disa qenieve abstrakte, p.sh.: “*Të falem, Shqipni / Ti e shpirtit tem dishiri!*” (Gj. Fishta). Thuhet: Bëri një apostrofë.

asindet, -i m. - nga gr. *asýndeton*, “pa lidhje, pa lidhur” (fr. *asyndète*; it. *asindeto*)

Figurë sintaksostilistike që konsiston në afrimin e fjalëve apo fjalive pa përdorimin e lidhëzës bashkërenditëse të pritur, për të dhënë përgjithësisht një forcë shprehëse dhe shpejtim të ritmit. Asindet është një mjet sintaksor parataktik dhe hipotaktik, që dëshmohet dendur si në poezi, ashtu edhe në prozë, p.sh.: “*Hapu, zmbrapu nper bushnjesh / Kê lê pa krye, kê lê pa vesh / Me at tagan, me at armë besnike / Qi me gjak kurr nuk po u ngike!*” (Gj. Fishta). E kundërta: **polisindet**.

asonanc/ë, -a f. - nga lat. *adsonanza*, “kumbim, jehonë” (fr. *assonance*; it. *assonanza*)

Figurë fonostilistike që konsiston në përsëritjen e tingujve zanorë në disa fjalë të njëpasnjëshme; në metrikë, një lloj rimimi në të cilin zanoret fundore përsëriten, ndërsa bashkëtingëlloret ndryshojnë, p.sh. “*Bijtë e tu buzë dafinave ecën / zgjatën duart këputën një fletë / me të në buzë vërshëllyen / këngët e gjakut të nxehtë.*” (Xh. Spahiu).

Vijon ...

BIBLIOGRAFI:

Beccaria, Gian Luigi (Direzione scientifica):

- *Dizionario di linguistica (e di filologia, metrica, retorica)*, “Piccola Biblioteca Einaudi”, Torino, 2004.

Belluscio, Giovanni – Rrokaj, Shezai:

- *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë* (shqip - italisht - frëngjisht - anglisht), “Arbëria”, Tiranë, 2011.

Dubois, Jean – Giacomo, Mathée – Guespin, Louis – Marcellesi, Christiane – Marcellesi, Jean-Baptiste – Mével, Jean-Pierre:

- *Dictionnaire de linguistique*, “LAROUSSE”, Paris, 2001.

Patota, Giuseppe (Direzione scientifica):

- *Il Dizionario medio Garzanti della lingua italiana*, Dizionario Interattivo Garzanti, De Agostini Scuola S.p.A., “Stabilimento di Lavis (TN)”, 2010.

Baja, Orjeta:

- *Terma të përbashkët të gjuhësisë me letërsinë (në funksion stilistik)*, në revistën “Buletini shkencor”, nr. 9-3, Ulqin (Mal i Zi), 2017.

Topalli, Tefë – Baja, Orjeta:

- *Glosar - (100 terma gjuhësorë-stilistikë e retorikë)*, në: O. Baja, “Shqipja përmes shkrintarit”, “Fiorentia”, Shkodër, 2014.

Leka, Ferdinand:

- *Fjalor i termave të letërsisë*, “INFBOTUES”, Tiranë, 2013.

Zheji, Gjergj – Xhafka, Natasha:

- *Fjalor enciklopedik letrar*, “Mihal Duri”, Tiranë, 2001.

Fromilhague, Catherine:

- *Les figures de style*, "Nathan", Paris, 2000.

Kane, S., Thomas:

- *Si të shkruajmë shqip* (redaktor: Xh. Lloshi), "Qendra për Arsim Demokratik", Tiranë, 2010.

Lloshi, Xhevat:

- *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, "Albas", Tiranë, 2005, 2012, 2015.

Reboul, Olivier:

- *Introduction à la rhétorique*, "PUF", Paris, 1998.

Figures of Speech (Explanatory Terminological Dictionary)

ABSTRACT

The figures of the style, which can be seen both linguistically and literary, clearly show the close connection of language with literature.

Different scholars, at different times and places, have long treated the figures of style. They have considered them as tools to express themselves in a surprising, charming and emotional way, using about 250 names for them. But many of them do not agree with the number of stylistic figures, nor with their meaning, nor with the group where similar figures could be collected. Thus, the typologies brought by classical rhetoric, are characterized by heterogeneity, complexity, with different ways of treatment, always controversial. Even today, they do not have a unique final classification other than those presented in old or modern stylistic treatments.

In the vocabulary we intend to bring, the presentation of the Style Figures will come alphabetically, aiming at that of the explanatory type, with theoretical and practical extension, in order to clarify the conceptual aspects of the terms.

This terminological explanatory dictionary on Style Figures is considered useful as a consulting tool to better understand the content of these terms, and to be mastered by a wide range of users, such as writers, publicists, teachers, researchers and students.

Alfred ÇAPALIKU

II. RRUGËT PARALELE ...DËSHMI FOTOGRAFIKE (23 – 36)

“Thaçi per teknikën e persosun xën nji vënd të posaçem në letërsin t’ onë.”

Kolë Ashta

RRUGËT PARALELE ...

Një jetë bivalente që ec në rrugët paralele të letërsisë dhe të ekonomisë, ku vargjet e lëmuara të poetit ndërthuren me kalkulimet e sakta të ministrit. Dy rrugë paralele ku jeta e përkthyesit, e publicistit, e poetit dhe e shtetarit Kolë Thaçi nuk matet me 54 vite, por me shumë më tepër vepra të pafshishme. Të afirmohesh me librat e poetit dhe të firmosësh në planet financiare të shtetit nuk janë e njëjta gjë, por kanë përgjegjësi mjaft të skajshme. Kurba e jetës së tij është në ngjitje: nxënës shembullor, mësues kolegji, përkthyes letrar, drejtor dogane, vlerësues mallrash, kodifikues këmbimesh, ekspert monetar, publicist atdhetar, poet neoklasicist, deputet parlamentar, ministër financash, intelektual klasi. Pasqyrimi mbi gjysmë shekullor i portretit letrar dhe i profilit zyrtar të dr. Kolë Thaçit përfshin botimin e pesë veprave letrare dhe juridike, publikimin e njëzet e shtatë krijimeve artistike dhe artikujve gazetareskë; po ashtu edhe manifestimin e pesë pjesëmarrjeve nëpër kabinete të ndryshme qeveritare të poetit - ministër.

Fenomeni i përfshirjes në linjën e qeverisjes shtetërore të shkrimtarëve ndodhi me shtatë personalitete gjatë viteve të Pavarësisë: 1. Mithat Frashëri mori përgjegjësi si Ministër i Punëve Botore, më 1912 e si Ministër pa Portofol, më 1918. 2. Luigj Gurakuqi, Ministër i Arsimit, më 1912, 1920 e Ministër i Punëve të Brendshme, më 1921; po ashtu Ministër i Financave, më 1924. 3. Kristo Floqi, Ministër i Arsimit, më 1920. 4. Fan Noli, Ministër i Punëve të Jashtme, më 1921 e Kryeministër, më 1924. 5. Hilë Mosi, Ministër i Arsimit, më 1921, 1932 e Ministër i Punëve Botore, më 1927; gjithashtu Ministër i Arsimit e njëkohësisht Ministër i Punëve Botore, më 1930. 6. **Kolë Thaçi**, Ministër i Financave, më 1921, 1922, 1923, 1930, 1936. 7. Ernest Koliqi, Ministër sekretar Shteti për Arsimin, më 1939.

Kolë Thaçi është shkrimtari i parë shqiptar që publikoi një libër artistik, më 11 prill të 1909-ës, me alfabetin e përbashkët kombëtar të Kongresit të Manastirit, i cili e zgjidhi përfundimisht çështjen grafike

në gjuhën tonë amtare.

Ai është ekonomisti i parë që botoi një kanun administrues doganor jurisprudence për marrëdhëniet tregtare dhe financiare të shtetit të ri, nenet e të cilit u zbatuan pas Kongresit të Lushnjës (31 janar 1920) në mbarë atdheun. Libri i tij primar i asaj fushe (1920) nis t'i përshtatet kodit "Parime e rregulla mbi ortografinë e gjuhës së shkrueme" miratuar nga Komisia Letrare Shqipe (janar 1917).

Veprën e Ipeshkvit italian Filippo Allegro "Sh' Eustaki o familja e martirve", për t'ua bërë më të lehtë lexuesve, Kolë Thaçi e pajisi me tabelën krahasuese mes alfabetit të moçëm e të riut. Ai spikati tetëmbëdhjetë ndryshime të rëndësishme grafemash tek "Abeçedeja e re e vuemun me t' vjetren" dhe paraqiti shembuj nëpërmjet asaj tabele. Ai e përmylli veprën me një vështrim shpjegues të fjalëve të rralla, duke dhënë kështu ndihmesë modeste në leksikografinë shqipe.

Kur lindi Kolë Thaçi, në librin e porsadalë në Shkodër më 1886: "T'mblefunit e dotrins ksctën. Daa n'kater òrt. Sckrue prei mesctarit D. A. Ferrari e siełun scciöp prei Dom Nnre Logorezzit, prift i arkidioceit Sckodrs", (*Botim I në 64 faqe - shënimi im: A. Ç.*), gjuha shqipe pasqyrohej me formën reliktoje. Njëzet e tre vite më vonë, kur në Shkodër më 1909 u botua libri "Sh' Eustaki o Familia e martirve. Tragedi me pës hova. Kthye shqyp mbas italishtes prej Kol Thaçit, msues n' kolegje t' Shejtit Sh'Françesk Saverit"; gjuha shqipe shfaqej me formën e avancur grafike, por me mungesën e përkohshme në shtypshkrim të germës "ë", boshllëk që u mbush aty me grafemën (ε). Rinovimi i traditës së Dom Ndre Logorecit, tek përkthyesi Kolë Thaçi gjatë një harku çerekshekullor, u jep argumente historisë së gjuhës së shkruar dhe filologjisë së tekstit, përsa i përket prirjes shkrimore të njëjtë të shqipes. Ky fill i pashkëputur i kulturës gjuhësore e ndoqi Kolë Thaçin në sprovat e tij të ndryshme shkrimore.

Le të citojmë mendimin e gjuhëtares Evalda Paci:

"Ky variant (i afërt në shkrim me K. Thaçin - shënimi im: A. Ç.) karakterizohet nga një kthjelltësi e pashoqe në pikëpamje të përdorimit të trajtave gjuhësore që dëshmojnë mbi të gjitha njohjen nga ana e autorit e një sërë përdorimesh dhe regjisttrash gjuhësorë që lidhet me një dialekt të rëndësishëm të gjuhës shqipe." (1)

Kolë Thaçi hyri në letërsinë artistike si shqipëruar i shkëlqyeshëm. Publicisti Ernest Koliqi më 1965 në Romë ka theksuar se ndër përkthimet shembullore në shqip të gjysmës së parë të shekullit XX spikasin ato të Fan S. Nolit nga anglishtja; të Frano Alkajt dhe të Henrik Lacës nga gjuhët e vdekura, prej latinishtes dhe prej greqishtes së vjetër; të Lazër Shantojës

nga gjermanishtja; të Vinçenc Prennushit dhe të Ndre Mjedës nga gjuhë të ndryshme; si dhe të Kolë Thaçit nga italishtja. (2)

Kolë Thaçi qe poliglot brilant, si shumë intelektualë përfaqësues të kohës së tij. Njohës me themel i gjuhës shqipe dhe i pajisur me kulturë perëndimore - lindore, fliste rrjedhshëm italishten, frëngjishten, gjermanishten, turqishten, gjithashtu dinte greqishten e vjetër dhe latinishten. Hartimin e 15 krerëve të librit të tij normativ “Kanun i doganës josë Administrimi doganuer në Shqipënië i shvilluem mbas ligjëve e rregulloreve të doganave otomane të perparëshme. Tekst i vetun”, për t’ua bërë sa më të qartë zbatuesve dhe tregtarëve, ai e shoqëroi me një parathënie shteruese divulgative prej 14 faqesh.

Tek ditari i mbajtur me 19 nëntor 1919 gjatë kalimit nëpër Shqipëri, fotografi francez Marcel Bolotte dëshmonte se në pazarin e larmishëm në mall të Shkodrës:

“ ... ka lloj - lloj monedhash, ku variacionet e këmbimit e komplikojnë shumë përcaktimin e vlerës së vërtetë.” (3)

Mendimi ekonomik i Kolë Thaçit shkëlqeu tek projektimi dhe vënia në jetë e njësisë monetare kombëtare bazë, emertuar lek, të cilën e kemi edhe sot në përdorim si vlerë qarkulluese paraje në formën e monedhës e të kartmonedhës. Kulturologia Zenepe Dibra, më 2016, në Shkodër, tek një fjalor enciklopedik shkodran e ka trajtuar figurën e tij si ekonomist, si ligjvënës dhe si ligjzbatues:

“Kolë Thaçi me Ndoc Çobën, Ahmet Daklin, Tefë Curanin, krijuan Drejtorinë e parë Doganore Shqiptare, me Ahmet Boriçin nga Shkodra, drejtor të përgjithshëm. Më 16 shkurt 1922 doli ligji që dispononte prerje kartëmonedhash kombëtare me emrin “Lekë”, bazuar në ar dhe duke u njehsuar 100 lekë baras me 20 franga ari. Kartëmonedhat do të pjesëtoheshin në 25 qindarka të lekut, në 50 qindarka, 1, 2, 5, 10 dhe 25 lekë. Autorizimi i prerjes do të kufizohej në 3.000.000 franga ari. Ata krijuan Ligjin e Parë Doganor Shqiptar, të firmosur nga kryedrejtori i Doganave, Ahmet Boriçi më 20 gusht 1922 e hartuan tarifën e parë doganore shqiptare.” (4)

I takoi Kolë Thaçit të ishte Ministër i Financave në këtë periudhë kohore. Emisioni i lekut u bë nga Banka Kombëtare e Shqipërisë, më 10 mars 1926, me hedhjen në qarkullim të monedhave metalike prej nikeli me vlerë 0.5, 5, 10, 20, 50, 100 lekë dhe të kartmonedhave me vlerë 100, 200, 500, 1000, 5000 lekë.

Mendimi i tij ekonomik i vuri vulën miratuese planeve vjetore financiare kryesore të shtetit, që parashikonin shumën e të ardhurave e shpenzimeve sipas degëve të ndryshme. Ai qe njëkohësisht relatori dhe

rregullatori i buxhetit kombëtar.

Mes numrave arabë dëshmohet profesioni zyrtar i Zotni Kolë Thaçi, kur ai vendos siglën si ministër financash. Ndërsa mes shkronjave latine shijohet talenti letrar i “Sh. P.” apo “Dora e harrueme”, kur ai vë firmën si poet neoklasicist.

Përveç përkthimeve spektrale dramatike dhe krijimit të vjershave e poemave origjinale, Kolë Thaçi u paraqit me dinjitet edhe me shkrime të shumëllojta në publicistikë. Duke lëvruar kryesisht esenë ai shtjelloi në prozën gazetareske disa çështje me karakter shoqëror, pa pretenduar për rrokje shteruese të objekteve e të problemeve që pasqyronte. Njëmbëdhjetë artikujt në formë e në përmbajtje janë gazetari letrare. Në trajtesat e tij çdo fenomen i analizuar kalon në filtrin personal të erudicionit. Kontributet e Kolë Thaçit në eseistikë janë origjinale. Ato nuk përsërisin tematikën dhe problematikën që trajtonin bashkëpunëtorët e revistave konkurruese të “Perparimit”, të “Lajmtarit të Zemërs s’ Jezu Krishtit” dhe të “Agimit”. Figurativiteti i Thaçit pasqyroi gjallërisht dukuritë, faktet e situatat me nota të theksuara shprehëse emocionale. Njëpërmjet shkrimeve ai ndikoi në krijimin e një opinioni publik të interesuar për dijeni dhe zhvillime të reja, të përparuara.

Interes të veçantë paraqet eseja debutuese “Nji gjak, nji mënde, nji zëmer”, dalë tek “Perparimi”, Shkodër nëntor 1914, ku Kolë Thaçi kërkon e dëshiron bashkimin harmonik të shqiptarëve, se ata qenë të rrethuar keqas prej armiqsh. Ai e shqipëron dhe e aktualizon mesazhin e fortë të poetit eklektik italian Vincenzo Monti (1754 - 1828) tek tragjedia “Aristodemo” (1787), në skenën e shtatë të aktit të dytë:

*“Keem per brii
Teben e rrebtë edhë smirzezë Athinen
Qi presin me fashitë nder ne degàma
Per me i kcyë me shum turr fituesit t’ lodhun
E fitimin me i marrë e me ja rrxue
Madhniin porsaa tuj lee.”*

Faqet 165 - 166.

Duket qartë reaksioni zinxhir, që nis nga shija e përkthyesit poet dhe mbërrin tek funksionalizimi i saj, përmes erudicionit të gazetarit eseist Kolë Thaçi.

Veprës së tij letrare i kanë bërë jehonë disa personalitete të spikatura të gjysmës së parë të shekullit XX, si: poeti Gjergj Fishta, gjuhëtari Justin Rrota, albanologu Gaetano Petrotta, melodramaturgu Ndre Zadeja, kulturologu Justin Rrota, historiani i letërsisë Karl Gurakuqi, shkrimtari Ernest Koliqi, studiuesi Kolë Ashta.

Ja sesi është shprehur përmes mbresave të forta personale drejtori i gazetës bilinge “Posta e Shqipërisë” poeti Gjergj Fishta më 1917, në Shkodër, për poemën e Kolë Thaçit “Tu tempulli i Mariës, josë Mbi Ndertesë të Kishës bria Rozafet”:

“Pershtypja maa e para qi kaa nieri prejë leximit t’ ktii liber, asht kjo, qi duket kjarisht, se auktori do t’ keet qitë në pùnë një cenë të t’palodhshme e një kujdes t’posaçem n’ t’ perbaam t’ ktii hymn. E kjo asht një pùnë e madhe n’ literaturë e per t’ u ndjekun prejë shum Shqyptarësh, sidomos kuur shkruajn vjerrsha... Prandej na po pergzohëna me gjith zëmer me auktorin per ket liber t’ rii, me t’ cillin e ka bgatë visarin e literaturës shqype, e shpnesojëm, se me at cenë e kujdes, me t’ cillin kaa shkruet hymnin “Tu tempulli i Mariës”, kaa me botue edhe kangë tjera.” (5)

Ja si e përcolli daljen nga shtypi të veprës së Kolë Thaçit, me komentin si lexues elitar, redaktori i revistës “Zoja e Shkodërs - Drita e Shqipërisë” poeti Ndre Zadeja:

“N’ ket kohë verevertë t’ arët, i vlerti e fort i njoftuni Zotnië Kolë Thaçi, u lshue m’ një hov poetik, tujë shkruet ket hymn t’ madhnueshëm, ku me nÿyre t’ zjarta, pomëndohen t’ nodhnat e lumnueshme. Rreth ktii fronit t’ dashtun n’ kohë t’ Madhit Shqyptaar, vajtohet mii veriga të perlotueme, qi ju njeshne, shqyptarëve t’ shkret e ktii Tempull t’ bekuem, e kunorohet saa poetik, aq me t’ knaqun t’ zëmers, me at dishiir t’ amel, me kthye fugurja e të dashtunes Zojës s’ onë. Si kahë naltsia e mëndimeve, si kahë hovet poetike, si kahë stolia e gjiuhes, si kahë argumenti i madhnueshëm, qi zgodh; i vlerti poet shqyptaar meriton lavdimet maa t’ mdhaat, tujë i urue ksajë pëndës s’ larët, perparime te reja e t’ madhnueshme.” (6)

Stili i veçantë i Kolë Thaçit ka gjetur mbështetjen për botim dhe për afirmim nga disa revista me prestigj në traditën e publicistikës sonë, si “Elçija e Zemrës së J. Krishtit”, “Perparimi”, “Zani i Shna Ndout”, “Kumbona e së Dielles”, “Cirka” dhe e ndonjë organi tjetër në qytetin e Shkodrës. Ndërsa figura komplekse e Kolë Thaçit ka tërhequr vëmendjen e disa albanogëve, si: Giuseppe Valentini (Shqipëri), Gaetano Petrotta, (Itali), Stuart E. Mann, (Angli) në librin e parë mbi letërsinë shqipe në gjuhën angleze, Markus W. E. Peters (Gjermani), Robert Elsie (SHBA). Bukur e ka përkufizuar shkrimtarin, me një me stil konçiz, albanologu gjerman Markus W. E. Peters në faqet e një monografie kulturore kushtuar shtypshkrimit:

“Aktiviteti letrar i Thaçit bie në fazën e “Rilindjes kombëtare dhe letrare”. Sidomos metrika e vargut klasik, nëpërmjet Thaçit, pati një lulëzim në shqipen moderne.” (7)

Neoklasicismi në letërsinë botërore ishte një lëvizje artistike e shekullit XVIII e lidhur me Iluminizmin. Ajo mbështetej në modelet klasike duke theksuar arsyen, harmoninë dhe kufizimin. Kolë Thaçi me krahët e fantazisë arrin spikatjen në vizionin poetik. Ai përsos mjeshtërinë krijuese në mënyrë minucioze, gjer në realizimin perfekt të formë – përmbajtjes me narrativitet elegant. Kolë Thaçi zbaton parimin neoklasist për edukimin moral të lexuesve përmes artit. Prurja kulturore e shkrimtarit Kolë Thaçi krijon një materie specifike me gjuhë ekspresive dhe është njësisia matëse e jetës së tij artistike. Kjo cilësi tërheq lupën e studiuesit Kolë Balto Ashta, që shkruan:

“Thaçi bjen në poezinë shqiptare një karakter të rëndësishëm. Kërcimet pindarike përbajnë një shej dallues të poezisë thaçjane, stili i naltë lirik, shllimet e rralla, të cilat nuk ulen kurr ndër sende të zakonshme, perdorimet e vargjeve në një mënyrë të vergjiltë, qëllimi i të porsit purist i gjuhës, i japin vendin e meritueshëm.” (8)

Ai që në një garë reale me gjashtëmbëdhjetë poetët e qytetit të Shkodrës: Filip Shiroka, Ndre Mjeda, Gjergj Fishta, Shtjefën Gjeçovi, Risto Siliqi, Vinçenc Prennushi, Hilë Mosi, Ndre Zadeja, Bernardin Palaj, Lazër Shantoja, Ernest Koliqi, Kolë Mirdita, Hamid Gjylbegu, Migjeni, Veli Stafa, Gaspër Pali.

Tri pjesët e mëposhtme janë dëshmi të sakta qysh flitej e sesi shkruhej shqipja zyrtare dhe ajo letrare prej njërit nga intelektualët e shquar shkodranë, shkrimtarit **Kolë Thaçi**, gjatë viteve ‘20 - ‘30 të shekullit të njëzetë:

A. NGA NJË PARATHËNIE

“Jena madjë moralisht të seguruem se po këtë qi vala e kritikave e të shpoëtinave kaa me humbë njat grimë vleri qi mundet me pasë vetëvedi ky liber, nuk kaa me muejt asnji herë me poshtnue randsiën e dliresiën e qellimit qi permendme syprri, e kjo per mündin qi bame mjafton, sepsë mbajm ndër ménd gjithherë fjalët e dijetarit të moçem : Finis coronat opus.”

Shkoder, me 20 Nànduer 1919.

AUKTORI.

SH. P. - Kolë Thaçi: “Parathanje”. Kanun’ i doganës josë Administrimi doganuer në Shqypënië i shvilluem mbas ligjëve e rregulloreve të doganave otomane të perparëshme. Tekst i vetun. Shkoder, 1920, f. 15.

B. NGA NJË BISEDË

“Z. Thaçi. Min. i Financave: *Përpara se të flas mbi budgjetin e Ministris due të zhdrivilloj ma parë, kah do t’i gjejmë këto shpenzime? Në budgjet të përkohshëm që kemi paraqitë kemi vue disa sende si bfi. humbje kursi etj. që nuk do me thanë se do të harxhohen me të vërtetë. Sa për mbulimin e këtij budgjetit kemi të mbrapa mbetuna të vjetit të kaluem, kemi taksa që do të veihen në veprim sa ma parë, të cillat do të sjellin të marruna. Pra kemi sa sende që figurojnë në prishje, si hua ...”*

Bisedimet e Këshillit Kombtar. Legjislatura e parë. Në Tiranë, në Mbledhjen e XII- të. E Hanë, me 23. I. 1922, ora 2. 30 mbas dreke. (9)

C. NGA NJË POEMË

*“Q’ at’ herë qi un mora lyren t’ ême s’parit
E n’ prëndveren e jetës vallen e xuna,
Nder virtyte mâ t’ bukra e n’ besë Shqyptarit
Synin e vûna.*

*T’ mira zakonet, e por Besa e Nderi,
Qi ruejn Fatosat nder brezni mâ t’ vjetra
U shtojn gjithnji mâ fort çmim edhe vleri
E famë nder letra.”*

Kolë Thaçi. “Njizetepësë vjetori i Liris”. Poemë. Revista “Cirka”. Shkodër. Nr. 33 - 34, 28. 11. 1937, f. 280.

... DËSHMI FOTOGRAFIKE

Fotografi Kel Marubi (Shkodër 1870 - 1940) qe profesionisti zyrtar i ngarkuar nga shteti shqiptar për pasqyrimin e ngjarjeve më të rëndësishme zyrtare në periudhën e Republikës. Pas shkrepjes së paralajmëruar të fotoapararit nga Mjeshtri Marubi, **Kolë Thaçi** fiksohet në celuloid, vetëm apo në grup. Secila prej fotove me teknikën bardhë e zi paraqitet e arrirë artistikisht dhe e gjetur grafikisht. Pozat e realizuara në Tiranë dhe në Shkodër, kanë kundërshti tonale të forta, ku e bardha shfaqet e pastër dhe e zeza është e plotë. Kjo ka sjellë që jo vetëm Kolë Thaçi, por edhe çdo person i shënuar nëpër dicitura, të shihen qartë në fotografi. Parlamentari Kolë Thaçi dëshmohet si portret, si duet, si kuartet apo si kompozicion; në natyrë dhe në studio. Dritëshkronja “Marubi”, përmes filmit të stampuar në një karton special, e dokumenton Zotni Kolë Thaçin veç një herë të ri, më 1913 dhe në të gjitha rastet e tjera e rijep atë rreth moshës së mesoburrit, në vitet 1921 - 1927.

REFERENCA:

1. Evalda Paci: "Disa njoftime mbi jetën e Imzot Ndre Logorecit. Një botim i vyem në lamije të studimeve albanologjike". T'mblefunit e dotrins ksctën. Daa n'kater ört. Sckrue prei mesctarit D. A. Ferrari e sielun scciõp prei Dom Nnre Logorezzit, prift i arkidiocecit Sckodrs. Datum Scodrae, die 15 Novembris 1884. (Shkodër, 1886. Botim IV. Shkodër, 2019, f. VI.)
2. Shih Ernest Koliqi: "'Nji tragedi e Alfieri-t' përkëthye shqip". Rev. "Shejzat", Romë, 1965. Nr. 7 - 8, f. 263 - 264.
3. Luan Rama: "Au revoir Albanie! ...". Bonjuer Albanie. Shkrime nën hijen e bombave. Tiranë, 2014, f. 253.
4. Zenepe Dibra: "Kolë Thaçi (1886 - 1941)". Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane. 2". Lezhë, 2016, f. 730 - 731.
5. Pa autor (Gjergj Fishta): "Nji liber vjerrshash i ri". Gaz. "Posta e Shqypniës". Shkodër, 17 tetor 1917. Nr. 90, f. 4.
6. Chriticus (pseudonim i Ndre Zadejës) : "Bibliografië. Kolë Thaçi - Tu Tempulli i Mariës josë Mbi ndertesë të Kishës brii Rozafet". - Hymn - . Rev. "Zoja e Shkoders - Drita e Shqypniës". Shkodër, 1917. Nr. 11. (Kopertina e pasme).
7. Markus W. E. Peters: "Kolë Thaçi". Der äteste Verlang Albaniens und sein Beitrag zu Nationaltewegung, Bildung und Kultur. Die "Buchdruckerei der Unbeflecten Empfängins" zu Shkodra (1870 - 1945). Hamburg 2007, s. 487.
8. Kolë Ashta: "Nji Vegim i veprimtaris letrare të nji shkrimtari shqiptar. Kolë Thaçi". Rev. "Kumbona e së Diellës". Shkodër. Nr. 38, f. 458.
9. Kolë Thaçi: Rev. "Bisedimet e Këshillit Kombtar". Legjislatura e parë. Botohet katër herë në muej. Shtypshkronja "Nikaj". Tiranë. Viti II, 1922 / 1, f. 135 - 136.
*(Shkodra 2 december 1886 - Tirana, 14 July 1941) The neo - classical; Writter Kolë Thaçi.

Parallel Roads... Photographic Attestations**ABSTRACT**

Kolë Thaçi's contribution to publicity, including a professional archive of the entry of the book "The Rule of Jose Customs, Customs Administration in Albania... – Kanun' i Doganës juse Administrimi Doganuer në Shqypenie..." can be enough to be included in the inheritance of Albanian public communication as a polyedric figure. As well as in the publicity activity Thaçi was the prototype of the intellectual who did not treat his knowledge as a personal property, but he shared it through the press. He used it to the maximum and put it to the service of others during the period when Albanian society needed the erudition very much. But the complete Thaçi's work is not yet fully included in the system of Albanian literary values. The writer Thaçi is sometimes called as minor; thanks to the qualitative literary translations, light narrative poems, lyric poems and the model of publicist writing that has become a point of reference between the old Albanian literature and the new one. The neo-classical writer Kolë Thaçi, as a perpetual tree, stands out in the artistic horizon of the first half of his twentieth century.

Ermira ALIJA

MBI PËRGATITJEN E BOTIMIT TË RIMARIT TË NDRE MJEDËS, TË PUNUAR NGA PROF. KOLË ASHTA

Rimari i Ndre Mjedës është një pjesë nga punët e shumta dorëshkrim që ka lënë prof. Kolë Ashta. Është punë me interes, duke u nisur nga koha kur u shkrua dhe mënyra si u konceptua. Me anë të këtij punimi prof. Kolë Ashta dha kontribut të rëndësishëm në themelimin e një tradite që fokuson rimat, traditë që, siç duket, në vitin 1955, kur mendohet se u mbarua rimari, nuk ka qenë e izoluar¹.

Interesant është të parit në perspektivë i këtij objekti punimi, kur kemi parasysh mundësinë e këndshkimeve mbi bazën e përpunimit statistikor të të dhënave jo vetëm nga i njëjti autor, por edhe nga autorë të ndryshëm. Një sërë këndshkimesh të tilla kanë filluar të trajtohen², si për shembull: llojet e rimave (si sasi dhe ndërtim), numri i fjalëve të rimuara, mesatarja e përsëritjes së një rime, raporti i fjalëve rimuese, prozodia në rimë (larmia tingullore, tingujt mbizotërues...), pasuria e veçantia leksikore e fjalëve që bëjnë rimat etj., ashtu siç mund të vazhdojnë të trajtohen të zgjeruara dhe në studime specifike edhe çështje të tjera, më pak të trajtuara deri sot, si: rimat mbështetëse, rimat e thjeshta e të përbëra, rimat e brendshme etj.

Ideja e lëvruar e krahasimit të rimave të autorëve shqiptarë në rrafsh diakronik dhe sinkronik ka shtruar hipoteza interesante shkencore.

Këto janë disa nga arsyet se pse u gjykua nga Qendra e Studimeve Albanologjike e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, që Rimari i Mjedës të futet në proces të redaktimit dhe botimit si vepër më vete, në vazhdimësinë e botimeve të dorëshkrimeve të prof. Kolë Ashtës.

Duke qenë pjesë e komisionit redaktues, ne jemi përpjekur të bëjmë të njëjtin rrugëtim që ka bërë prof. Kolë Ashta, duke ndjekur të njëjtën metodologji pune, kur shkruan tek “Pasqyra e shkurtimeve” se tek: “...

¹ Shih: Sh. Sinani, ikja prej rimës gramatikore si ikje prej rapsodisë, Qendra Muzeore “Ndre Mjeda”, Enti Botues “Gjergj Fishta”, Mjedologji 3, 2016, f. 70.

² Shih: Sh. Sinani, ikja prej rimës gramatikore si ikje prej rapsodisë, Qendra Muzeore “Ndre Mjeda”, Enti Botues “Gjergj Fishta”, Mjedologji 3, 2016, f. 74 - 79.

Këndime per Školā tē para tē Škypniasē I, II, III u muer botimi i dytē pse asht me shkroja tē Manastirit...”. Ky parim i Ashtës na është dukur i vlefshëm për dy arsye:

1. Sepse i rri besnik pikëpamjeve të Mjedës, kur prof. Ashta përmend në rimar që Mjeda teksteve ... *me dorë të vet u bani ndryshime ma të shumtën gjuhsore tue e ndjekë zhvillimin e shqipes së shkrueme.....*
2. Sepse unifikon në vepër sistemin alfabetik të përdorur nga Mjeda. Kështu edhe ne, duke iu referuar alfabetit të Kongresit të Manastirit, mund të ruajmë, ashtu siç i ka ruajtur prof. Kolë Ashta, tingujt e Mjedës në origjinal, duke pasur në dorë një rimar pothuajse anastatik të tij.

Gjatë punës për redaktimin e Rimarit, pas kompjuterizimit të dorëshkrimit, është ecur duke gjurmuar kodin e simboleve që përdor prof. Kolë Ashta, që thotë: “*K.I,15,3: numri i parë asht i vëllimit, i copës së vëllimit³, i rrjeshtit të copës*”.

Kemi vënë re se origjinali i titullit të përbashkët të leximeve sipas alfabetit të Kongresit të Manastirit është “*Këndime per Shkollë të para të Shqypnís*” dhe shoqërohet nga shënimi tjetër që ndjek titullin: *Libri i parë, Libri i dytë, Libri i tretë*. Kolë Ashta përdor fjalën *vëllim* në sqarimet e tij për të përcaktuar klasën (ka parasysh vëllimin e parë të materialeve të destinuara për klasën e parë), kurse, kur e shkruan në shkurtime, përdor fjalën *Këndime*, si titulli i origjinalit.

Gjatë punës kemi parë se në dorëshkrimin e Ashtës, në një referencë në fillim është përdorur (*Këndime 4*, tek rima â: *Sÿni i Zotit 4*), kur dihet se nuk ka pasur katër këndime të botuara⁴, por tri. Që bëhet fjalë për një lapsus, na tregon fakti se kemi vetëm një rimë të përdorur në *Këndime 4* tek poezia: “*Sÿni i Zotit*”, kurse të gjitha rimat e tjera të kësaj poezie kanë shënimin *Këndime II*, kurse rima e shënuar me *Këndime 4* është e vetmja që mungon tek poezia “*Sÿni i Zotit*”, *Këndime II*, gjë që na vërteton se shënimi *Këndime 4*, është, ashtu siç e thamë, thjesht një lapsus. Edhe fakti

³ Nënvizimi është i yni.

⁴ *Rreth vjetëve 1905-1906 Xanoni në bashkëpunim me Ndre Mjedën përpiloi tekstet e para të leximit për shkollat e para shqipe, të shtypuna nga qeveria austriake. Këto antologji dhe libra leximi me pjesë të zgjedhuna auktorësh vendas dhe të huej u botuen nën titullin “Këndime për shkollë të para të Shqypniis”, ndër tri vëllime, libri I,II,III. Nga tri volume, libri i tretë qe gati krejt i Xanonit ... Ato qenë botue dhe ribotue disa herë. Me 1926-1927, nën kujdesin e Ndre Mjedës, u botuen edhe një herë tre librat e hartuem së bashku me Anton Xanonin: “Këndime për shkollë të para të Shqypnisë”, Jup Kastrati: “Anton Xanoni”. Rev “Shkodra”, Shkodër, viti II, nr. 1 (2), 1962, f 90; 110.*

që *Këndime 4* është shënuar me numër arab, kurse të gjithë numrat e tjerë të këndimeve janë të shënuar me numra romakë, e vërteton përsëri të qenit një lapsus, ku ka mundësi që është shënuar pa vetëdije në dorëshkrim numri i vargut në vend të atij të librit të leximit.

Rreshtimi i rimave nga prof. Ashta është bërë sipas rendit alfabetik. Po kështu edhe i fjalëve rimuese. Duke e ditur që Mjeda ishte mjeshtër i muzikalitetit në varg dhe një faktor i këtij muzikaliteti është sistemi rimor, prof. Kolë Ashta ka vëzhguar dhe ka shënuar me akribi shkencore rimat fundore dhe të brendshme të vargjeve të Mjedës. Tek poezi të tilla si: “*Dora e Tenzot*” (K.I) apo *Diten e motmotit të rí (Prindve)* (K.I), vargjet e të cilave janë ndarë me cesurë dhe me vizë ndarëse, Ashta ka analizuar me kujdes rimat e brendshme, prandaj në Rimar na dalin fjalë që nuk rimojnë ose që rimojnë me të njëjtin numër vargu, nën të njëjtin titull poezie, si: *hjekun 8, vend 8*; .

... ..

... ..

... ..

qi na prûni gjith ket shënd

Por qe duhija - tui vishkullue

Gádi gjith lulet - na i ká farue?

Ah mos ankoni - gjind e pápiekun,

Se lulja e hjekun - La kokrrat në vënd.

“Dora e Tenzot” (K.I)

Bab’ e nânë – Zot, m’ké dhânë

Per me më rritë – Me më soditë

Diten e motmotit të rí, (Prindve), (K.I)

I tillë është edhe rasti i rimave të çdo dy strofave 4-she e 10 rrokëshe, të rimuara sipas skemës klasike: ABAC/BEEC, tek poezia Mahmud Pasha, apo rimave të brendshme tek poezia: *Kùkulla*:

Tui lujtun Maruka me ‘j kukull’ me **bojna**, ... A

Shum loj’ e shum **ojna** po i delshin prei **sì** A, B

E merrte me védi, t’a puthte e shterngote, ... C

Gjith ditën i thote – “moj kukull’, ç’je **tí**” ? C, B

Por kuklla i pergjegjte, se fëmijve kurr **loja** ..., D

S’ju ngiatë, mb’ sà **goja**-ju ndalet mb’ nji **cak**. D, E

Â shkruemun per lojna m'u ul' e m'u çue; ..., F
Djè plase per mue – sot s't' duhem' aspak. F, E

Kemi vëmë re se prof. Ashta nuk ka shënuar disa rima jo të plota (asonanca), si për shembull:

E me calina në dorë e qej per anë/ T'a pámen Prëndi të gjith at frotë tui dalë.

Prëndi (K.III).

Priremi të mendojmë që në këtë rast ka qenë një opinion i Ashtës, për të mos i shënuar, sesa një harresë e tij, ndoshta duke u nisur nga ngjyresat e ndryshme të **a**-ve përkatëse bashkë me faktin që kjo rimë është e vetmja në 14 vargjet e para të poezisë Prëndi (K.III).

Ideja e mosshkrimit të qëllimshëm të rimave jo të plota nuk përforcohet, kur shohim se në dorëshkrimin e rimarit ka edhe disa asonanca të tjera, që shënohen e disa që nuk shënohen, si:

per**mb**rênda - Rrêna 6 (K. I) në dorëshkrim është e shënuar: *brenda*
rrêna - Rrêna 5 (K. I) e shënuar në dorëshkrim

tê - Andra e jetës: Trina III, 16 e pashënuar në dorëshkrim

xê - Andra e jetës: Trina III, 12 e pashënuar në dorëshkrim

hír - Fjalë t'urta 10 (K.III) e pashënuar në dorëshkrim

(i) mirë - Fjalë t'urta 9 (K.III) e shënuar në dorëshkrim si fjalë, por jo si rimë e poezisë

Fjalë t'urta 9 (K.III)

Ndoshta mund të bëhet fjalë edhe për mëdyshje, por ndoshta më shumë për harresa apo ngatërresa gjatë punës me skedat. Këtë na e përforcon fakti se nga krahasimi i materialit të vargjeve të Mjedës që u është referuar prof. Ashta me materialin e dorëshkrimit të tij, ka rreth 40 fjalë që mungojnë, që përbëjnë afërsisht 2% të materialit të analizuar.

E rëndësishme në këtë çështje është të përmendim se nuk mund të flasim për parim të prof. Ashtës për të përjashtuar nga Rimari gjithë rimat jo të plota. Në këtë fokus paraqet interes edhe diskutimi i fjalës: *Mirditas et*, e cila nuk është vendosur në Rimar nga prof. Ashta. Ajo përsëritet (duke krijuar rimë me veten e vet, nëse mund të thuhet kështu), duke qenë fjala e fundit e vargut refren që përdor Mjeda në poezinë *Kangha e Mahmud Pascs* në vargjet: 16, 19, 22, 25, 28, 31, 34.

Ka qenë parim i prof. Ashtës që të mos shënojë si rimë përsëritjen e së njëjtës fjalë. Kjo shkruhet edhe në shënimet e tij dhe duket edhe në raste

të tjera, kur prof. Ashta nuk shënon fjalën që ka qenë rrjedhojë e përsëritjes së të njëjtit varg. Në numrin e atyre vargjeve, ku përsëritet e njëjta fjalë, e shënuam me bold, për t'i spikatur:

shpejtò - Váji i bylbylít I, 24, **56**

gjimon - Váji i bylbylít I, 4, **64**

shkon - Váji i bylbylít I, 2, 46, **62**, III, 18 (e shtuam ne)

gëzue - Váji i bylbylít IV, 4, **8,12,16,20,24,28,32,36,40,44,48,52**

Koncepti i rimës nuk presupozon përsëritjen e fjalës, pavarësisht se, nëse flasim për muzikalitetin e vargjeve, rimarrja e të njëjtit varg, pra edhe e të njëjtës fjalë, është një faktor ndikues. Te krijimtaria poetike e Mjedës numri i vargjeve dhe i fjalëve që përsëriten, është i vogël. Këtë gjë studiuesit e Mjedës e lidhin me largimin nga folklori në funksion të modernitetit të letërsisë deri në simbolizëm. Ky arsytim na bën të mendojmë pse prof. Ashta ka zbatuar mosshkrimin e përsëritjes së fjalëve dhe na tregon edhe ne se shtimi i këtyre numrave nuk ndryshon ndonjë vlerë në muzikalitetin e poezisë mjediane.

Kemi vënë re se Ashta ka korrigjuar ndonjë fjalë të Mjedës duke e shkruar në fjalor ashtu si duhej të ishte, jo ashtu si ka qenë e fiksuar në ndonjë botim, kur e ka kuptuar se është gabim shtypi apo harrim, si p.sh.: *dill* që është shkruar në origjinal pa *i* (*dilli*) dhe që prof. Ashta e ka kuptuar këtë, nga konteksti: *Jo mos m'thuni se nadie kthen dill(i)(1)*, dhe e ka shkruar si duhet rimën pasardhëse *qilli(3)* në poezinë *Bija e verbt c'prei t'leemi*, e cila është botuar vetëm një herë në 1888 në *Scahiri Elierz*. Përsëri prof. Ashta korrigjon *kale* me *halle* në të njëjtën vjershë: *Bija e verbt c'prei t'leemi* 36, mbasi kuptohet nga konteksti se është *halle* dhe jo *kalle*.

Ky parim i Ashtës na shtron edhe ne një parim të mundshëm, që të korrigjojmë lapsuset, ose gabimet e shpejtësisë, që kemi vënë re mes fjalëve të gjetura në origjinal dhe atyre të dorëshkrimit (kur edhe origjinali, edhe rima na e vërteton faktin e të qenit lapsus), si p.sh.:

Mund të zëvendësojmë fjalën *zaptón* me *copton* (Váji i bylbylít III, 2), mbasi të gjitha rimat e tjera të kësaj poezie në dorëshkrim janë në rregull dhe fjala e vetme e mbetur si mundësi për gabim është *zaptón* fjalë që përkon edhe me numrin e vargut dhe të pjesës.

Po kështu mund të zëvendësojmë titullin e poezisë *Thnegla e zogu* 4 (K. I) tek fjala rimuese *loton* me titullin *Fëmija e Zogu* 4 (K. I), pasi edhe kjo rimë është e vetme nën këtë titull, kurse të gjitha rimat e *Fëmija e Zogu* janë të sakta në Rimar e mungon vetëm ajo e shënuar nën titullin *Thnegla e zogu* (K. I). Nga ana tjetër Mjeda s'ka shkruar ndonjë poezi me titullin: "Thnegla dhe zogu", por ka një poezi, e analizuar në rimar: "Thënegla e

pllumbi“, me të cilën mund të jetë ngatërruar. Fakti që përmendet vetëm një herë në tekstin e të njëjtës klasë, ku kemi po atë numër e po atë lloj rime, tregon se me siguri ka qenë një lapsus.

Gjithashtu mendojmë se mund të korrigjojmë ndonjë ngatërresë fjalësh që mund të ketë ndodhur, ose gjatë marrjes nga skedari, ose gjatë kopjimit të rimarit. Këto lloj ngatërresash nuk janë të shumta, përkundrazi mund të numërohen me gishtat e duarve⁵. Gjithashtu mendojmë se mund të plotësojmë apo të korrigjojmë tituj poezish, numra vargjesh apo emërtime klasash, që thjesht janë ngatërruar apo janë harruar. Ato nuk përbëjnë shkelje të parimeve apo rregullave të vendosura nga prof. Ashta.

Prof. Kolë Ashta nuk ka marrë në konsideratë rimat e disa vargjeve pa titull më vete, që janë futur në fillim, në mes, në fund të disa pjesëve të karakterit edukativ apo njohës në leximet 1, 2 (pasi leximi i tretë nuk ka të tilla) për të konkretizuar ndonjë ide të tyre. Ashta i ka konsideruar këto vargje didaktike, prandaj rimat e tyre nuk i ka marrë në shqyrtim. Për arsye konkretizimi dhe njohjeje, ne kemi shënuar si tituj të tyre ato të teksteve ku janë integruar dhe po jua paraqesim.

Këto vargje tek libri i dytë (botimi i tretë) janë:

Agimi

U kuq qielli prej agimit
Prej këtij prësit qi çoj dita
E kadál tu' u rritun drita
Fush' e male po lulzon.

Frynë prej bjeshkët ér' e lehtë,
Rruzullimit i ndërron ftyra
E prej shëndit gjith natyra
Në duk' e në petka po gazmon.

Ati i ynë, qi rri në qiell,
Përmbi gjith shka ké krijue
Emnin t'ând tuj e békue
T'a permëndin qiella e dheu.

⁵ i shpejtë - Andra e jetës: Trina II, 32 është futur gabim kjo rimë, bëhet fjalë për Zot(zot) - Andra e jetës: Trina II, 32; është vendosur gabim titulli: Vëllaznit 3 (K. I), që është futur gabimisht tek rima: bukurija, kur duhej të ishte tek fjala: *diellit* - Vëllaznit 3 (K.I) që rimon me *prillit* - Vëllaznit 1 (K. I)

Kallxit

Nieri i léhtë
 Mba kryet përpjetë.
 “Po pse kaq krrut e prùjtun
 Po të shof, lum vllau, un tÿ?
 Qyr si rrij ndrëjt, pá më mujtun
 Gjã në bukurië në ket fushë”
 I tha një kallxë pá krye
 Kallxit me kokrra mbushë.
 Ja priti ky pá e fye
 “Bãnu edhé tine i plotë,
 Ké m’u përkulë at botë.”

Mîni i shkathtë⁶

Tepër po i sielle fluturim kandilit,
 Moj fluturë zeza, e po digje në têt;
 Njishtû tuj ndjekun dritën
 Shumë e shumë tjerë lafiten.

Deh largoju
 E në mend mësoju
 Prej ça s’rrënë,
 Se “kush e lyp’ e gjënë”

Ndéroni pleqniën

Vësh‘ me t’arta, o zhele t’shkreta
 Ndërën plaku e meriton;
 Dhun‘ e kore, po, i shkoft‘ jeta
 Faqeziut qi s’e ndéron.

Të nisunit e zogjve

T’ardhmen përsëri prëndvera,
 Prej së lérgut, ku pat tretë,
 E zogjve vjen potera

⁶ Këto vargje kanë lidhje me idenë e pjesës që konkretizojnë, por jo me subjektin që zhvendoset te flutura që digjet në dritë, ashtu si ... *mini bie në kurthë*...:

Çerdhen e vet me gjetë
 Qi dîmmit iku e e la.

Në librin e parë (stampa e dytë) kemi këto vargje të ndërfitura në prozat didaktike:

Bleta

Kúr ké gjã, e kúr teprija
 t'tállë nder t'mira e t'habitë,
 mëndò mirë, se ndoshta 'j ditë
 ké me pasun shum ngushtim.

Diten e êmmit të nânës

Diten e êmmit t'ând, o nân' e dashtun
 Njiket túbë lule due me t'dhânë peshqesh:
 Merri kto lule, o nânë, se jan' pasqyra
 E nji t'madhes dashtnië qi ké prei nesh.

Kjo boj' e kuqe t'a difton dashtnimin.
 Dashtniën prep éra t'a difton dahà.
 Shprishi kto gjeth ká nji, lule per lule,
 E zêmren' t'eme ké me e gjetë nder ta.

Ditt e javës e muejt e vjetës

Prill, qershuer, shtatuer, nândori
 kan se i cili dit trídhetë;
 veç ká frori 'j zet e tetë,
 E gjith tjerët tridhet' e nji.

Ia vlen të hetohet fakti që tek Rimari, prof. Ashta nuk ka shqyrtuar disa poezi, që ne i gjejmë tek Vepra "Ndre Mjeda 2" si:

- Sa vlen mësimi
- Punën tuej ju mos e lshoni
- Filloi toka me u pertri
- Luani
- Klluka
- Jo, s'mbaron pema

Po ashtu ka poezi të mbetuna dorëshkrim, të botuara në *Ndre Mjedja, vepra*

letrare 1, që nuk janë shfrytëzuar, si:

- Uzdaja pa dobi
- Iliria dhe Epiri

Apo tek Scahiri Elierz, poezi si:

- Jetimi

Vetë prof. Ashta thotë në dorëshkrim se ... *dy pika t'errta duken ktu: ajo e dorëshkrimeve dhe njoftja e atyne punimeve të tija botue pa emën o me sigla, o me pseudonim nder të perkohshme...* (fq 2)

Çështja që mbetet të diskutohet nga QSA është që në botimin e Rimarit nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, a ia vlen të shtohen edhe këto rima të tjera (ndoshta me karaktere grafike të ndryshme, që tregon se janë plotësime të botuesit), apo t’i rrimë besnikë Rimarit të Mjedës të punuar nga prof. Ashta, ashtu siç e ka konceptuar ai, me ato rima që përmban në original.

Nga gjithë sa thamë, Rimari i Ndre Mjedës, i punuar nga prof. Ashta, edhe sot, mbas më shumë se 65 vjetësh ekzistence si dorëshkrim, mbetet një vepër serioze dhe me vizion. Ai besojmë që do të vazhdojë ta ketë vendin e vet të spikatur në dorën e studiuesve të gjuhës dhe të letërsisë shqipe.

LITERATURË:

1. D. Ndre Miedia, Juvenilia (botim anastatik), Botimet Fishta, Lezhë 2017.
2. D. Ndré Mjedja, Lissus, Shtyp. “Zoja e Paperlyeme”, Në Shkodrë, 1928.
3. Dom Ndré Mjedja, Scodra, Tingllime, me pak oroena të N.B., Kumbona e së Diellës, botimi N. 1, Shtyp. “Zoja e páperlyeme” – Shkodrë 1939.
4. Këndime per Shkollë të para të Shqypnís, libri i parë, stampa e dytë.
5. Këndime per Shkollë të para të Shqypnís, libri i dytë, stampa e tretë.
6. Këndime per Shkollë të para të Shqypnís, libri i tretë, stampa e dytë.
7. Ndre Mjedja, vepra letrare 1, “Naim Frashëri”, Tiranë 1988.
8. Ndre Mjedja, vepra letrare 2, “Naim Frashëri”, Tiranë 1988.
9. Qendra Muzeore “Ndre Mjeda”, Enti Botues “Gjergj Fishta”, MJEDOLOGJI 3, 2016.
10. Ndre Mjeda, Vjersha dhe poema, Tiranë, Naim Frashëri 1953.
11. Ndre Mjeda, Guxo, Tiranë, Naim Frashëri 1953.
12. Ndre Mjeda, Shahiri elierz, Shkodër, 1888.

**The preparation of the publication of Ndre Mjeda's rhyme book,
made by prof. Kolë Ashta**

ABSTRACT

⁷Our work examines the manuscript Rimar from Ndre Mjeda and worked by proff. Kolë Ashta. It tries to point out the issues arisen in the process of preparing it for publication. It focuses on the scientific accuracy of prof. Ashta in the writing of Rimar and in his attitude towards some assonance, toward some rhyme from verses he doesn't consider to be genuine literary and toward some other rhyme, where there are also included verses Mjeda left as a manuscript.

From all these, the article tries to draw some conclusions about this piece of work, the contribution of proff. Ashta and the reasons why QSA created this special place to publication as a separate book.

⁷ *Punimi ynë shqyrton dorëshkrimin e Rimarit të Ndre Mjedës, të punuar nga prof. Kolë Ashta dhe përpiqet të vërë në dukje çështjet që kanë lindur në procesin e përgatitjes së tij për botim. Ai fokusohet në akribinë shkencore të prof. Ashtës në shkrimin e rimarit dhe në qëndrimin e tij ndaj disa asonancave, ndaj disa rimave prej vargjesh që nuk i konsideron pjesë të mirëfillta letrare dhe ndaj disa rimave të tjera, ku hyjnë edhe vargje që Mjeda i ka lënë dorëshkrim.*

Nga të gjitha këto artikulli përpiqet të nxjerrë disa konkluzione për veprën, kontributin e prof. Ashtës dhe arsyet pse QSA po i lë një vend të veçantë botimit të tij si libër më vete.

Ilda ERKOÇI

QYTETI SI TEKST, TEKSTI SI QYTET: SHKODRA LETRARE

Hyrje

Vitet e fundit, ka pasur një rritje të kërkimeve e studimeve rreth detajeve gjeografike të letërsisë me një theks të veçantë në mënyrën sesi autorët kanë përshkruar vende të ndryshme në veprat e tyre.¹ “*Ndikimi i letërsisë si forcë krijuese shihet në mënyrën se si shumë pjesë të Britanisë, për shembull, shihen a kujtohen me sytë e poetëve dhe romancierëve*” shprehet kritiku Pokok.² Louentheli e mbështet këtë mendim duke shtuar se “*ne i perceptojmë vendet jo siç i shohim vetë, por në bazë të asaj që kemi lexuar a dëgjuar për to.*”³ Kjo ka çuar në një rritje jo vetëm të studimeve në fushën e turizmit letrar⁴, por edhe të numrit të njerëzve që duan të kenë përvojën e tyre letrare në gjurmët e një autori apo të personazheve të dashura për ta. Lind pyetja: “Çfarë e nxit një lexues të shndërrohet në turist letrar?” Ky punim do të mundohet t’i japë përgjigje kësaj pyetjeje përmes një rrëfimi autoetnografik⁵ të një udhëtimit letrar në qytetin e Shkodrës të bërë nga autorja e këtij punimi.

Dy fjalë për turizmin letrar

Turizmi letrar është në njëfarë mënyre materializimi i letërsisë përmes kërkimit të artefakteve që lejojnë rindërtimin e përvojës së leximit përmes udhëtimit. Ai e bën letërsinë më të prekshme. Arsyeja pse dikush niset për turizëm letrar është që të kërkojë njerëz, objekte, vende konkrete, e pse jo edhe të jetojë për pak kohë në ‘botën’ që e ka njohur përmes leximit. Letërsia e njeh lexuesin me imazhe vendesh si destinacione

¹ Shih: Butler, 1985; 1991; Pocock, 1982; Squire, 1990 etj.

² D Pocock, bot. *Humanistic Geography and Literature London*: Croom, 1981, fq. 13.

Shënim: Të gjitha përkthimet nga burimet në gjuhën angleze janë bërë nga autorja e këtij punimi.

³ David Lowenthal. “Past Time, Present Time: Landscape and Memory”, *The Geographical Review*, 65(1), 1975, f 6

⁴ Shih Squire, 1994, 1996; Busby & Hambly, 2000; Herbert, 2001; Anderson & Robinson, 2002; Busby, 2004; Watson, 2006 etj.

⁵ Mbi përdorimin e autoetnografisë si metodë kërkimi do të flitet më poshtë.

potenciale e kështu ndikon drejtpërdrejt a tërthorazi në vendet që zgjedhin turistët. Në këtë kuptim mund të themi se letërsia ka një cilësi që i jep asaj njëfarë roli promocial. Sipas Aron Santesos, “*duke kundruar një vend letrar, veçanërisht një që lidhet me origjinën e një autori a veprë, ne marrim një lloj pushteti mbi tekstin e krijuar aty që na lejon ta kuptojmë atë më mirë sesa vetëm po të lexonim kritikë letrare ... Me fjalë të tjera, vendi letrar kthehet në tekst kritik.*”⁶

Robinsoni e Andersenit e shpjegojnë këtë dukuri me marrëdhënien e veçantë që ekziston mes shkrimtarit dhe lexuesit: “*Si një formë estetike e turizmit kulturor, turizmi letrar është i veçantë. Letërsia nuk është si format e tjera të artit. Ndryshe nga artet pamore dhe muzika, letërsia përfshihet në nivel personal nga kushdo që di të lexojë dhe kupton konvencionet e përdorura nga autori kur tregon një histori a lidh fjalët për të krijuar struktura estetike dhe semantike. Arti shkëmbehet më lehtë mes shkrimtarit dhe lexuesit sesa, fjala bie, skulptorit dhe publikut të tij.*”⁷

Kritikët ia atribuojnë këtë faktit që letërsia mbështetet te fjala: “*Një argument mund të ishte që turizmi letrar është i veçantë për këtë arsye: si lexues, ne jemi më afër veprës së artit pasi ne mund ta kuptojmë se si mund të përdoret ajo stilistikisht dhe mund të kemi të njëjtin interes si autori për të treguar histori rreth njerëzve dhe përdorim fjalët për të shprehur emocione*”.⁸

Robinsoni gjen lidhje mes letërsisë dhe turizmit edhe përtej librit, në atë që flitet rreth librit:

“*Në praktikë, është e vështirë, në mos e pamundur që letërsia artistike të ekzistojë vetëm si fjalë në letër. Në aktin e leximit, në bisedat rreth tekstit dhe hapësirat shumëdimensionale që ata zënë, kur i jep një libër një miku, në diskutimin, interpretimin dhe analizën që pason leximin, gjenerohen veprime, qarkullojnë ide dhe krijohen realitete të ndryshme. E gjithë letërsia është subjekt i transformimit deri në atë pikë sa s’mund të flitet më vetëm për fjalën e shkruar.*”⁹

Për kritikun Robinson, të lexuarit është një praktikë kulturore njëlloj si turizmi: “*Sado paradoksale të duket, të lexuarit e letërsisë është një akt sa intim e personal, po aq edhe pjesë e një eklogjie kulturore më të gjerë Ai përcaktohet nga vendndodhje dhe ide që janë të koduara në shoqëri dhe që kuptohen brenda disa kufijve hapësinorë e kohorë. Akti i të qenit*

⁶ Aaron Santesso, cit. sipas Maltby, fq. 6.

⁷ Robinson, dhe Andersen, fq. xiv.

⁸ Po aty, fq. xiv.

⁹ Robinson e Andersen, fq. 41.

turist është një përvojë sa personale e subjektive, aq edhe pjesë e një fenomeni të gjerë kulturor me tipare të përgjithshme”.

Barku gjithashtu flet për një lidhje mes këtyre dy akteve përmes koncepteve të prodhimit dhe konsumit. Si letërsia dhe turizmi janë aktivitete prodhuese: duke krijuar një imazh letrar, prodhohet edhe një ‘sens vendi’. Në të njëjtën kohë, të dyja janë aktivitete konsumi: turizmi ka të bëjë me konsum vendi, letërsia me atë të të lexuarit.¹⁰

Hapësira dhe roli i saj në letërsi

Perceptimi i vendit, argumenton Hill-Milleri “vepron si një pikëmbështetje për fantazinë”, sepse “një vend është elementi që strehon kujtimet.”¹¹ Hapësira është “fokusi i përvojës njerëzore, kujtimit, dëshirës dhe identitetit.”¹² Ajo përbën një konstrukt shoqëror që mund të lexohet përmes tekstit dhe po kështu të ndërtohet përmes tekstit. Studimi i hapësirës na bën të mundur të kuptojmë më mirë edhe faktorët shoqërorë, ekonomikë e materialë që ndikojnë në konstruktet letrare.

Në ditët e sotme, gjithnjë e më tepër po përdoret edhe koncepti i *gjeokritikës*. Gjeokritika është një metodë e analizës dhe teorisë letrare që ka të bëjë me studimin e hapësirës gjeografike. Termi është përdorur për herë të parë në Francë nga Bertro Vestfal.¹³ Është një metodë ndërdisiplinore e analizës letrare që fokusohet jo vetëm në të dhënat kohore si lidhje mes jetës dhe kohës së autorit (siç ndodh në kritikën biografike), historisë së tekstit (si në analizën e tekstit) ose në tregim (që studiohet nga narratologjia), por edhe në të dhënat hapësinore.

*“Emocionet tona sikur zgjohen në ato vende ku kanë shkelur këmbët e atyre që duam e admirojmë. Athina na magjeps jo vetëm me ndërtesat e saj të mrekullueshme dhe veprat madhështore të artit antik, por edhe me kujtimin e njerëzve të mëdhenj: “këtu jetonin, këtu uleshin, këtu përfshiheshin në diskutimet e tyre filozofike. Dhe unë me admirim kundroj varret e tyre.”*¹⁴

Këto janë disa rreshta nga Ciceroni që thonë shumë për lidhjen

¹⁰ Barke, fq 84.

¹¹ Katherine C.Hill-Miller. *From the Light House to Monk's House: A Guide to Virginia Woolf's Literary Landscapes*. London: Duchwork, 2001, fq. 1.

¹² Barker, Chris. *Cultural Studies: Theory and Practice*. London: SAGE Publications, 2000, fq. 192.

¹³ Shih: Westphal, *La Géocritique, Réel, Fiction, Espace*, Paris, Éditions de Minuit, 2007.

¹⁴ Ciceroni, *Ligjet*, Nr. 2.

kuptimplote mes hapësirës dhe kujtimeve e për rrjedhojë, ndikimit emocional e simbolik që elementi hapësirë/vend mund t'i shtojë ritualeve letrare.

Vendi është një hapësirë gjeografike, por bëhet edhe imazh letrar kur shkruhet rreth tij, megjithëse vendi ekziston në mënyrë të pavarur nga imazhi i tij. Si turistë, ne konsumojmë imazhin. Ne biem në kontakt me imazhin (imazhin letrar të një vendi) përmes leximit dhe për rrjedhojë mund të duam të bëhemi pjesë e tij. Kështu, nga diçka thjesht fizike, vendi bëhet edhe një përvojë.

Robinsoni dhe Anderseni argumentojnë se letërsia, falë vlerave të saj estetike, na bën ta shohim vendin si diçka më tepër se thjesht një koncept gjeografik: *“Që nga takimet tona të hershme me letërsinë, jo vetëm njihemi me vendet në një kuptim gjeografik, por gjithashtu mësojmë t'i shohim ato në një kontekst moral. Ne mësojmë që bukuria është kapur dhe interpretuar nga shkrimtari i cili luan një rol primar pasi vepra e tij ka marrë frymëzim nga një vend i caktuar dhe ka ndikuar për ta bërë të njohur këtë vend”*.¹⁵

Nga lexues në udhëtar

Çfarë e shndërron një lexues në udhëtar?

Sipas Iv Shëvrelit, njerëzit ndryshojnë sa i takon formave të njohjes dhe të perceptimit të botës dhe njerëz të ndryshëm e lexojnë një tekst në mënyra të ndryshme. Imazhi dhe joshja e të huajës është çfarë shpesh nxit kureshtjen. Shëvrel mendon se leximi përmes të cilit ti synon *“t'i afroresh ndjenjave të autorit, të ribësh së brendshmi udhën e tij”*¹⁶ plotësohet me udhëtimin real.

Sipas Vajnrihut, lexuesi bën sikur është autori *“duke kaluar nëpër të gjitha pikat e krijimit letrar. Kjo përlligj kërkimet për kuptimin e vërtetë të një teksti dhe praninë e një letërsie të arratisjes jashtë vetvetes, jashtë botës.”*¹⁷ Çdo imazh vendi është subjektiv sepse merr formën e ndjesive, perceptimeve dhe përvojave personale të autorit, por edhe të lexuesit. Konceptit të vendit i bashkëngjitet ai i kohës dhe përfytyrimet sërish ndryshojnë nën dritën e një përvojë të re moshore e jetësore.

Turistët letrarë ndryshojnë sa i takon kuptimit që i japin një veprë letrare, prandaj çdo udhëtar krijon një lidhje unike me një vend të caktuar

¹⁵ Robinson e Andersen, fq. 29.

¹⁶ Po aty, fq. 36.

¹⁷ Weinrich, cituar sipas Chevrel, fq. 37.

letrar. Në veprën e tij *Akti i të lexuarit: teori e përgjigjes estetike* (1978), Iser e prezanton tekstin si një strukturë që ‘konkretizohet’ nga lexuesit në varësi të vlerave e përvojave të tyre personale. Ai gjithashtu vë në dukje dallimin mes asaj që autori vërtet shkruante në tekst dhe çfarë i shtonte lexuesi tekstit. Sipas Iserit, rëndësia e një vepre nuk është te vetë vepra, por ajo nxjerr në pah aspekte të lexuesit për të cilat ai vetë s’ishte i vetëdijshëm më parë.¹⁸

Norman Holland besonte se motivimi i lexuesve ndikon shumë në mënyrën sesi ata lexojnë. Ai përqendrohet në atë që interpretimet e lexuesve zbulojnë rreth vetë atyre, jo tekstit. Sipas tij, detyra e kritikut është të shpjegojë jo tekstin si objekt sa efektet e tij te lexuesi. Në mënyrë të ngjashme, Rosenblat shprehet se megjithëse lexuesi udhëhiqet nga idetë dhe fjalët që ka dhënë autori, në fund është përvoja individuale e secilit lexues që i jep kuptim veprës. Derisa çdo lexues ka njohuri e besime të ndryshme, teksti do të ketë kuptime të ndryshme për njerëz të ndryshëm.

Teoria e reagimit fokusohet te lexuesi dhe mënyra sesi ai e ‘merr’ tekstin. Pra, në njëfarë kuptimi, teksti zhvendoset nga aspekti i tij fizik në formën e fletëve të librit në një formë të re që krijohet vetëm në momentin që lexohet. Në këtë mënyrë, kjo teori i bën veprat letrare t’i ngjajnë arteve performuese ku akti i leximit dhe interpretimit të tekstit krijon performancën. Në teorinë e reagimit të lexuesit, akti i të lexuarit është si një dialog mes lexuesit dhe tekstit dhe merr kuptim vetëm kur të dy janë të përfshirë në ‘bisedë’. Teoria e rithekson rolin e tekstit nga një objekt i pavarur në diçka që ekziston vetëm kur lexohet dhe ndërvepron me mendjen e lexuesit. Në këtë mënyrë lexuesi nuk është një marrës pasiv i asaj që thotë teksti, por luan rol aktiv. Pra, teksti shërben si një lloj katalizatori për të nxitur kujtime e mendime te lexuesi duke e lejuar atë të lidhë tekstin me përvojat personale – për shembull shumë nga ne mund të zgjedhim të rilexojmë një libër pas shumë vitesh pikërisht për të rjetuar të njëjtat ndjesi e evokuar kujtime të së shkuarës. Kjo i lejon teoricienët të shpjegojnë pse njerëzit kanë reagime dhe interpretime të ndryshme për një tekst të caktuar. Sipas kësaj teorie, leximi është një proces krijues, një lloj si shkrimi.

Pelegrinët letrarë motivohen në mënyra të ndryshme, herë nga një interes profesional në letërsi, e herë nga një interes personal për të eksploruar në hapësirë botën e veprave dhe autorëve të tyre të dashur. Së

¹⁸ Selden, fq. 55.

pari, pelegrinazhi letrar duket se është një kërkesë e brendshme nga ana e lexuesve-turistë që kërkojnë prova fizike që mund të mbështesin atë çfarë dinë dhe kanë mësuar nga veprat letrare. Një arsye tjetër për të shkuar për turizëm letrar mund të jetë e njëjta pse lexojmë letërsi artistike: nevoja për t'u shkëputur nga rutina e përditshme në kërkim të një përvoje më emocionuese. Turistët letrarë duket se qëllimisht e fshijnë vijën ndarëse mes trillimit dhe jetës reale, në përpjekje për t'u afruar fizikisht me botën e imagjinuar të narracionit.

Autoetnografia si metodë kërkimi

Në vijim është dhënë një model autoetnografik i një udhëtimi letrar në Shkodër. Përzgjedhja e kësaj metode jo shumë të njohur për ligjet me faktin që ajo mundëson një përshkrim e reflektim që s'e ofrojnë metodat e tjera.¹⁹ Elis, e përkufizon autoetnografinë si një metodë kërkimi që synon të përshkruajë dhe të analizojë një përvojë vetjake me qëllim që të hedhë dritë mbi elementët e një kulture më të gjerë.²⁰ Kërkuesi përdor aspekte si të autobiografisë, ashtu edhe të etnografisë. Sipas Sparks, autoetnografite janë "rrëfime personale të mbështetura mbi përvojën vetjake të kërkuesit me qëllim që të ndihmojnë të kuptuarit sociologjik."²¹

Hapa letrarë në qytetin tim

Aty si tash para se me ardhë fiset ishe
me tambël në plasaritjen e currave
e me themele në ujin e njelmë.
Të dhanë vetëm një emën: Shkodra.
E të thirrën qytet me kunora
e të hodhën përkrye gur
e hekurat e para.

U zgjove e përgjakun sa herë
e u kqyre në pasqyrën tande.
Me emën grueje u lave ndër ujna
t'lumejve dhe ndeje me petka të reja
në shkamb
e ndritun ballë diellit mbi fusha.²²

¹⁹ Coghlan dhe Filo, 2013.

²⁰ Ellis et al, 2001.

²¹ Sparks, fq. 21.

²² Martin Camaj, "Aty si tash para se me ardhë fiset ishe." <http://www.martin-camaj.de/sq/votra/vepra/poezi.html>

Dita 1

Nisem. E emocionuar sikur po bëj një zbulim. E frikësuar, thua se po bëj diçka të ndaluar. Nuk guxoj t'ia them kujt tjetër veç vetes. “Ti, e lindur dhe e rritur në Shkodër, do të bësh turisten në qytet?” më duket se më qeshin nën hundë. I kam premtuar vetes se do jetë diçka e re. Ndryshe. Si të mos kem qenë asnjëherë më parë. Ta shoh me sytë e atyre që i kënduan mrekullisht në vargje t’amshuara, ta shkel me në mend imazhet që pikturoi pena e tyre e palodhur.

Vendos që rrugëtimin tim letrar ta nis nga Shiroka. Nuk e di as vetë pse – ndoshta kam nevojë të thith ajrin e liqenit që të frymëzohem për çfarë më pret ...

Një fllad i ëmbël përkëdhel blirin aty pranë e përzihet me sherbelën nga mali i Taraboshit në këmbë të të cilit shtrihet paqësor liqeni. “A thua ta kenë ndjerë edhe shkrimtarët tanë?” më vjen natyrshëm të pyes veten. “A do të jenë ngopur mendimet e tyre me këtë aromë ndjellëse për të mbarsur më pas frymëzimin e tyre e për të lulëzuar në vargjet që na kaplojnë edhe sot shqisat?” Por përgjigje kush s’më jep, veç liqenit që rrudh lehtë fytyrën e tij për të përkundur varkat para se të vijë të puthet me bregun ... Ashtu si në vitin e largët 1918 kur Harapi do të lundronte në liqen për të kaluar matanë,

Dita ishte fort e bukur; dielli me rreze të veta, ndritte e flakëronte mbi syperfaqen e liqënit, porsi më një çiní të prarueme; një erë e lehtë më atë fllad të kandshëm qi lshote, ua thete vapën rrezeve shkrumuese, qi me tanë fuqinë e vet dielli lshote në pishen e zhegut; do tallaze të vogla, si të ishin tue shkue e tue ardhë nën ujë, pelqyeshem lmojshin e përkundshin lundren t’onë, e cilla, me atë lëvizje të qetë, mu gitte se po merrte hove të reja lundrimi; edhe voztarve, dikur u erdh zemra e u treti mezija; filluen bisedët e llafet, qi me një knaqsi të fjeshtë e mbajshin në një gjallni të pëlqyeshme at çetë të vogel kater vetësh, qi udhtojshim. ...²³

Krahi i Rumís me Krajë e Taraboshi me Zogaj e Shirokë kishin hî nen sjetull të hijeve e merrshin një pamje të veçantë; ato brija të zdashuna [...] porse, sherbela e pervujtë, qi rrasët i veshet atij shpati, endë një të shtrueme të kandshme, e cila njomë e gjallnon ato vende të zdashuna. Në tjetren ânë, rrezet e kuqlêmata të diellit, qi shtriheshin n’e djathten në Parû e në Veleçik, përftojshin e zblojshin

²³ Anton Harapi. *Valë mbi valë*. Romë, 1995.

tfaqje bukurije e madhnije, me të lânë pa mend: sá ndritte bora nder gerdhata të Parûnit si të ishin copa djamantit të njeshun nder ato bjeshkë.²⁴

Ashtu si autorit, e gjithë kjo panoramë nuk mund të mos më sjellë ndërmend kujtimet e fëmijërisë kur shlirët lodronim në gurët e bardhë e plot gëzim kërkonim freskinë e ujit:

O kujtime! O përshtypje! O kohë e fminis, kur, me moshatarët e mij, gzueshëm lundrojshim nëpër liqê! ... askush mâ i lum se na ...jeta me fuqí në shpërthim [...] fantazija porsí flutra e bardhë dalë prej gervoje [...] O kohë t'ambla qi nuk kthejnë mâ! Kujtimi i asaj perjudhe freskon e vên në fâsh, jeten e rrmyme prej tallazeve.²⁵

Përmendem nga ëndrra me sy hapur e kuptoj se ka kaluar goxha kohë. Marr rrugën e kthimit. Ndalem edhe njëherë për të shijuar atë panoramë shpirtqetësuese, që të paktën, bind veten, mund ta shoh akoma si e panë ata dikur:

Dielli ishte në prendim. Rrethue prej së largu prej do rêve të vogla, qi shllunga shllunga i bájshin kunorë, rrite ajo platë xhevahirit n'at madhni e n'at shkelqim si t'ishte kenë qandrue në têtanë natyra. Si të dojshin me e percjellë e me i dhanë mâ të mramin të pershendetun mbretit të natyrës, rrishin gati ato rê të qeta për me marrë prej si njetret e florinit, te velutit e drandofilles së ndezët, per me bâ me ato shndrrime të padame stolín e madhnueshme të diellit në prendim. ... dielli tuj lanë mbas veti nepër ajr ato rreze flakruese, ishte zhdukë, tue më lanë edhe mue me tanë natyren, në vetmín e qetë.²⁶

Kaloj aty ku Buna përqafton ethshëm Drinin e bashkë rrokin kalanë. Rojtare e përhershme përsipër rri Rozafa. Ai ujë që legjenda thotë, janë lotët e Rozafës, më rrjedh nën këmbë e sjell ndërmend të tjera kujtime ...

²⁴ Anton Harapi. *Valë mbi valë*. Romë, 1995, fq. 45.

²⁵ Po aty, fq. 44.

²⁶ Po aty, fq. 47.

Dita 2

Shkodra kumbon me zane, zhurmë e jetë.
E ai diell pranvere i ri shprazet n'shtëpija,
udha e lulishta, tue ngjall' ngjyra e shkëndija,
tue mbshtjell' gjithçka si një tis ari, i hollë.²⁷

Rimarr udhëtimin tim “turistik”, tashmë, larg heshtjes së paqtë të liqenit, në zhurmën e këndshme të qendrës së qytetit. Dua të shoh atë që për sy të huaj e të pamësuar me përditshmërinë e saj është “*Shkodra e bukur, mëkatore, me rrugët, portat, oborret plot mister, me tregtizat, kafenetë, kambanaret, minaret*”²⁸ Ndalesën e parë e bëj te monumenti kushtuar Gjergj Fishtës, i them “nadja e mirë” e vijoj më tej.

Me kënaqësinë që s’më mungon kurrë kur vij këtu, ec me nge përmes G’juhadolit, rrugës muzeale të projektuar nga Idromeno, e njohur edhe si “Venecia e vogël.” Përveç arkitekturës së mrekullueshme, kjo zonë është edhe një gurrë e pasur personalitetesh të ndritura, një “oaz i artë” siç e quan Gjon Stefa i cili numëron 123 figura të shquara të dalë prej këtu, mes të cilëve mjaft shkrimtarë. Dashamir Cacaj me të drejtë e konsideron atë një “*qytet brenda metropolit*”, një “*sokak të madh*” pa të cilin “*qyteti i ngjan një ore të madhe, por pa zemrek.*”²⁹

S’i ndahem Koliqit. Shkel me nge çdo gur të kalldrëmit që në sytë e shkrimtarit ngjanin me “*inxhi plot shkrepitima vizllore.*”³⁰ Mbërrij në destinacionin tim të parë. Ajo është aty, e mbyllur, e vetmuar. Po të mos ishte për pllakatën në mur, as nuk do të kisha arritur ta gjeja! Vendi ku ai kthehej me valixhe plot ëndrra! Për një moment, ashtu si vetë ai gjurmët e të cilit po kërkoj, “*shortia e jetës madhështore shkodrane, tashma në perëndim, më kapi e më robnoi. Ajo shtëpi, ajo odë, ato sende të heshtuna dikur kishin qenë plot jetë...*”³¹

Lë pas keqardhjen e momentit e sytë më shkojnë në katin e dytë, nga ku ai shihte përtej avullisë, “*pesë a gjashtë pullaze diku ma të ulta diku ma të nalta shtëpijash, faqen e një ndërtese të madhe me xhama të dritoreve që farfurinin, e ma larg majucin e një kumbonarje kishe. ...*”³² Megjithëse nuk mund të hyj në shtëpinë ku dikur kishte jetuar gjeniu i letrave, nuk

²⁷ Koliqi, “Shkodra në mëngjes.”

²⁸ Ismail Kadare. *Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe*, fq. 23.

²⁹ *Oazi i artë i Gjuhadolit*, fq. 5.

³⁰ Koliqi, “Pak t’imta për një lamtumirë.”

³¹ Koliqi, *Pasqyrat e Narçizit*, fq. 18-19.

³² Po aty, fq. 52-3.

mund të largohem pa kundruar rrugicat, sot të heshtura, por jo më pak të hijshme që dikur gumëzhinin nga zërat femënorë.

Mësoj se aty afër ndodhet (a më saktë, ndodhej) shtëpia e një tjetër figure të shquar, Luigj Gurakuqit, gjithashtu shtëpi karakteristike e denjë për monument kulture, që vitet e fundit është lënë të rrafshohet nga pakujdesia e shtetit. Dikur, ishte një shtëpi-muze mjaft e pasur me fotografi, dorëshkrime e sende vetjake të patriotit e letrarit.³³ Asaj shtëpie ai i kishte kënduar fort ëmbël:

Te ti m'fluturon mendimi, o shpiza e ime
Kur vjen ma thershëm malli me m'trazue.
Te ti, ku nisa s'parit me jetue,
ku çila syt, ku leva e pata gzime

Gjith herë ndërmend t'kam ty, ku laçë kujtime
T'amblla, që jetën m'panë një ditë gazmue;
Vetëm n'dhe t'huej, tue vuejtë e tue lëngue.
T'kam n'zemër ty, ku ndjeva t'parët dashtnime.

Ai skaj ma i vogli i yt, ma e vogla skutë
E jotja ka për mue aq ambëlsi,
Sa veç kujtimi i tyne shpirtin m'kputë.

E kur me râ shkoj n'mbrame me mjeri
Ty t'mendoj, e i tham vedit: oh â ma i butë
Shtrati, e ma i kandshëm â pushimi n'shpi!... (“Shpis s'ime” 1905)

Largohem drejt “gjuetisë” time të dytë: shtëpisë së Pashko Vasës. Të bie menjëherë në sy një derë hijerëndë e ruajtur mjaft mirë dhe me hapjen e saj s'mund të mos të të gufojë zemra kur sytë ndeshin me një kopsht që ruan pamjen e dikurshme, rrethuar me avulli ku lulëzon me tërë madhështinë një luleborë, e veç disa hapa më tej një pus i vjetër. S'mund të dëshiroja pritje më të mirë! E emocionuar bëj drejt shtëpisë, çardaku i së cilës shfaqet hijerëndë në faqen ballore. Më mjaftojnë pak këmbë shkallë për t'u ndeshur me një befasi alla-shqiptare: shtëpia-muze, monument kulture (i vetmi i këtij lloji në qytet, pra, shtëpi shkrimtari), sot është një hotel! Zhgënjimi nis të fashitet kur kuptoj se shtëpia, fatmirësisht, është

³³ Hamdi Bushati. *Shkodra dhe motet*. Shkodër: Rozafat, 1998, vëll II, fq. 107.

ruajtur goxha mirë. Është një banesë tipike shkodrane me gjithë bukurinë e kohës kur u ndërtua: kopsht, pus, çardak, trapazan, e plot ornamente që kënaqin syrin e shuajnë nostalgjinë. Kapërcej pragun që në mendimet e mia më kthen pas në kohë. I gëzohem këtij shndërrimi të përkohshëm që vetëm zhytja në botën letrare ta jep.

Lë pas Vasën në hotelin e tij e nisem drejt një tjetër shtëpie të transformuar, asaj të Filip Shirokës, poetit që i lutej dallëndyshe t'i falte me shëndet qytetit të vet:

Shndet prej mejet të m'i falesh
saj' shpis' vjetër ku jam le,
me ato vende rreth t'përfalesh
ku kam shkue kohën e re;
atje shko, pra, fluturim,
fal me shndet gjytetit tim!³⁴

Një bar-restorant-muze me emrin “Tradita”, lokali ka gjithçka përveç asaj që kërkoj unë. E vetmja gjë që e lidh me shkrimtarin duket se është një pllakatë në fasadën e saj të jashtme.

Në kthim, s'mund të rri pa hedhur sytë drejt asaj që dikur ishte shtëpia e Migjenit. Më duhet të kënaqem vetëm duke e kundruar e ëndërruar që një ditë të kthehet në gjendjen e dikurshme.

Por, dua ta mbyll bukur ditën, ndaj fshij nga mendja këto imazhe e i zëvendësoj me vargje; këto nuk mund të shkatërrohen kurrë e i bëjnë ballë kohës më mirë se çdo gur:

Sa ambël n'mbramje shqimet drita e diellit
qi bje kadalkadalë andej kah ana
e malit tue lan' mbrapa ngjyrat e t'tana:
zambakë ar, vjollza e fletza drandofillit,
e n'at zjarrm lulesh, ndez' nder skaje t'qiellit
vizaton Rozafati gurt vigana,
e nëpër hyj qi kallen n'qiellt e gjana
del si vetull hyjneshë hana e prillit.³⁵

Marr me vete një përzierje mendimesh e ndjesish: emocione, kënaqësi por

³⁴ Filip Shiroka, “Shko dallëndyshe”.

³⁵ Koliqi, “Shkodra në mbramje.”

edhe zhgënjim e keqardhje për ato që kanë humbur nga neglizhenca. Por, prapë vazhdoj të ëndërroj bashkë me Shkodrën:

Zani m'grishë me jetue
 E jo me afrue qepallën me qepallë
 E me ndej tue andrrue,
 Më thotë zani: me këndue jetës
 Më thotë zani: kndoj s'vërtetës.

Por Shkodra prapë andrron
 E zemra nuk e lshon.
 Dhe mue më dridhet një shpresë
 Si n'zemren tande:
 Kshtu mes mjerimit na buron andrimi
 Pse ty e mue, Shkodër, me andrrue na kande.³⁶

PËRFUNDIME

Ky punim solli një panoramë të dukurisë së turizmit letrar, rolit të konceptit 'vend' në letërsi dhe ofroi një model udhëtimi letrar në Shkodër përmes metodës së autoetnografisë.

Letërsia mund të luajë një rol kyç në krijimin e imazhit të hapësirës të lexuesi, por edhe në nxitjen e këtij të fundit për të materializuar këtë imazh në një destinacion konkret në kërkim të të cilit ai niset. Roli i letërsisë në turizëm nuk duhet nënvlerësuar: ajo mund të përjetësojë imazhin e një vendi si destinacion turistik duke ngjyrosur perceptimet tona të atij vendi kur ky i fundit shfaqet në fletët e një libri. Turizmi letrar rrit interesin për lexim dhe afrimin me letërsinë, kuptimin e vlerësimit e saj.

Turistët letrarë motivohen nga faktorë të ndryshëm, qofshin personalë a profesionalë. Mënyra se si ata e lexojnë një tekst dhe e interpretojnë atë si dhe përvojat e tyre vetjake janë shtysa për shndërrimin e një lexuesi në turist.

³⁶ Gaspër Pali. Cituar sipas Gjon Stefës, *Oazi i artë i Gjuhadolit*, fq. 100.

Referenca

- Barke, Michael. “‘Inside’ and ‘Outside’ Writings on Spain.” *Literature and Tourism: essays in the reading and writing of tourism*. Eds. Robinson, Mike and Hans Christian Andersen. London: Thomson, 2003, fq 80-104.
- Barker, Chris. *Cultural Studies: Theory and Practice*. London: SAGE Publications, 2000.
- Bushati, Hamdi. *Shkodra dhe motet*. Shkodër: Rozafat, 1998
- Camaj, Martin. “Aty si tash para se me ardhë fiset ishe.” <http://www.martin-camaj.de/sq/votra/vepra/poezi.html>
- Chevrel, Yves. *Letërsia e Krahasuar*. Përkth. A. Xhiku, Tiranë: Albin, 2002
- Coghlan, A. dhe K. Filo. “Using constant comparison method and qualitative data to understand participants’ experiences at the nexus of tourism, sport and charity events.” *Tourism Management*, 35, 2013, fq 122-131
- Ellis et al. “Telling secrets, revealing lives: Relational ethics in research with intimate others.” *Qualitative Inquiry*, 13(1), 2001, fq. 3-29
- Harapi, Anton. *Valë mbi valë*. Romë 1995
- Hill-Miller, Katherine C. *From the Light House to Monk’s House: A Guide to Virginia Woolf’s Literary Landscapes*. London: Duchwork, 2001, fq 1
- Kadare, Ismail. *Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe*. Tiranë: 8 Nëntori, 1991
- Koliqi, Ernest. *Gjurmët e stinve*, Shkodër, 1933
- Koliqi, Ernest. *Pasqyrat e Narcizit*. Shkodër: Camaj-Pipa, 2001
- Lowenthal David. “Past Time, Present Time: Landscape and Memory”, *The Geographical Review*, 65(1): 1975, fq 6
- Maltby, Deborah. “The Redemptive Myth of the Rural: Thomas Hardy’s Literary Tourists and Englishness.” 2009
<<http://www.ies.sas.ac.uk/events/conferences/2007/literarytourism/index.htm>
- Pocock, Douglas, bot. *Humanistic Geography and Literature* London: Croom, 1981, fq 13.
- Robinson, Mike dhe Hans Christian Andersen (redaktorë). *Literature and Tourism: essays in the reading and writing of tourism*. London: Thomson, 2003.
- Selden, Raman dhe P. Widowson. *A Reader’s Guide to Contemporary Literary Theory*. 3rd ed. University Press of Kentucky, 1993, fq 51-60
- Shiroka, Filip. “Shko dallandyshe”. *Zani i zemrës dhe shkrime të tjera*. Tiranë: Toena, 2005
- Sparkes, A.C. “Autoethnography and narratives of self: reflections on criteria in action.” *Sociology of Sports Journal*, 17, fq 21-43
- Stefa, Gjon. *Oazi i artë i Gjuhadolit*. Lezhë: Gjergj Fishta, 2011

The city as text, the text as city: literary Shkodra***ABSTRACT***

Literary tourism is a form of cultural and heritage tourism which has increased considerably during the last few years. Literature plays a significant role in creating destinations, contributing this way in the further development of tourism. Literary tourism can be credited with making people aware of literature and inciting their interest in reading. As most of the research in the field has been made with a focus on tourism, this paper aims at providing a more literary perspective by using autoethnography as a research method. The role of 'place' in literature and the reader's perception, interpretation and reaction to a text make up the theoretical framework of this paper.

Sokol AXHEMI

QASJA URGJENTE DREJT NDËRMARRJES SË POLITIKAVE KOMBËTARE MIGRATORE. IDE DHE ARGUMENTE

Hyrje

Shtete të ndryshme të botës paraqesin statistika nga më interesantet, në lidhje me çështjet e larmishme që kanë të bëjnë me zhvillimet e popullsisë në to. Në këtë mënyrë, duke u njohur me shtesën natyrore të popullsisë së tyre, lindjet dhe vdekjet, strukturat përkatëse të popullsisë (moshore, gjinore, profesionale, sipas vendbanimeve etj.), faktorët ndikues të evolucionit të tyre, ndërmarrin edhe studime specifike për të ndërtuar politikat e tyre mbi popullsinë. Çështjet dhe problematikat e lëvizjeve të ndryshme të popullsisë, migrimi i tyre drejt destinacioneve të brendshme apo ndërkombëtare, janë një tjetër drejtim, ndaj të cilit shtetet kanë shumë ndjeshmëri dhe vëmendje. Në mënyrë të veçantë atë e shohin të lidhur ngusht edhe me impaktet e shumta në dimensionet sociale, ekonomike, mjedisore etj., me të cilat ai shoqërohet. Vëmendja shtohet, sidomos në rastet kur ndikimi është evident në kuadrin e rolit dhe kontributit që luan në treguesit kryesorë që kanë të bëjnë me vetë zhvillimet e popullsisë (kryesisht në shtesën natyrore të popullsisë, në çrregullimet strukturore dhe në depopullimin e hapësirave të ndryshme sociogeografike etj.). Në këtë rast ndjehet nevoja e analizave të thelluara të shkaqeve, pasojave dhe tendencës që shfaqin këto lëvizje migrative.

Çështja e migrimit të popullsisë paraqitet shumë evidente edhe në vendin tonë. Tashmë opinioni publik gjithnjë e më tepër po sensibilizohet nga të dhënat apo informacionet e ndryshme në lidhje me zhvillimet aktuale të popullsisë shqiptare. Projektionet e institucioneve ndërkombëtare, statistikat demografike të ndryshme kanë bërë të mundur realizimin dhe daljen në evidencë të analizave të studiuesve të fushave të ndryshme, të cilët po vlerësojnë maksimalisht situatën në lidhje me zhvillimet e popullsisë shqiptare. Madje në mjaft raste vërejmë se edhe përfaqësuesit e funksionit social të pushtetit po bëhen gjithnjë e më të ndjeshëm në këtë drejtim. Duhet lënë mënjanë propaganda, opinionet divulgative dhe gjërat e përgjithshme dhe duhet të merremi konkretisht me një situatë të tillë. Ajo

çfarë po paraqitet reale dhe krejtësisht e dukshme është se popullsia e vendit tonë, njerëzit po ikin gjithnjë e më shumë, çdo ditë e natë, çdo muaj e vit.

Nën këtë këndvështrim, me obligimin dhe shqetësimin për të orientuar politika të veçanta me situatën prezente tentojmë të paraqesim më poshtë nevojën dhe domosdoshmërinë e ndërhyrjes me një set politikash specifike të popullsisë. Krahas saj, shprehemi për nevojën dhe domosdoshmërinë e qasjes se funksionit social të pushtetit, për një përputhje, kontratë, marrëveshje politike të të gjitha palëve, për të shkuar drejt një pakti kombëtar për migrimin. Ky material shkencor përfshin në strukturën e tij dy çështje themelore: argumentet drejt nevojës dhe domosdoshmërisë urgjente për ndërmarrjen e politikave migratore dhe pikëpamjet tona në lidhje me ndërhyrjen që duhet realizuar. Njëkohësisht punimi përmban krahas analizës së detajuar edhe disa tabela konkrete informative mbi migrimin. Autori paraqet në përfundim të punimit edhe disa konkluzione.

Argumentet drejt një qasjeje urgjente mbi politikat migratore në Shqipëri.

Përballja me një fenomen të tillë, siç është migrimi, padyshim që për vendin tonë, paraqitet si një risi në aspektin shkencor dhe konkret aplikativ. Përvojat dhe eksperiencat tona kanë qenë minore, si në drejtim të njohjes dhe analizës për të, ashtu edhe të ndërhyrjeve që duhen realizuar. Një gjë e tillë ka qenë e lidhur ngusht me vetë evolucionin e zhvillimeve të popullsisë që kanë karakterizuar Shqipërinë në periudha të ndryshme. Ndonëse jemi të mendimit se në kuadrin e migrimit të brendshëm, sidomos gjatë periudhës 1970 - 1990, ka pasur analiza dhe studime të karakterit shkencor, që janë bashkëshoqëruar me masa të ndryshme konkrete praktike në njësi administrative të Shqipërisë, të cilat u përfshinë nga lëvizjet e shumta të popullsisë. Një gjë e tillë ka qenë e pranishme në rastin e lindjes, zhvillimit dhe evoluimit të një numri evident të njësive administrative urbane industriale, apo transformimeve të vazhdueshme të realizuara në shumë njësi administrative rurale, kryesisht malore të vendit. Të tilla mund të veçojmë ato të Laçit, Rubikut, Kuçovës, Memaliajt, Martaneshit, Bulqizës etj., në të cilat proceset e orientimit të popullsisë për t'u vendosur atje, në kuadrin e migrimit të brendshëm, njohën si arsye zhvillimin e industrisë dhe degëve të saj në to. Njëkohësisht iniciativat dhe aksionet e ndryshme në fushën e bujqësisë dhe emancipimit të zonave të ndryshme rurale njohën lëvizje e zhvendosje populsi, pothuajse në të gjitha fshatrat,

pjesë e territoreve malore të vendit.

Lëvizja e popullsisë drejt këtyre njësive administrative ishte e ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me zhvillimet ekonomike, industriale dhe bujqësore, të bashkërendura me elementet e risive të reja sociale, që shoqëruan lindjen apo zhvillimin, transformimin e ndryshimin e mjaft prej qyteteve të reja industriale dhe zonave të ndryshme rurale (Dukagjin, Vermosh, Iballe, Kam, Ksamil, Lukove etj.) gjatë periudhave të ndryshme në vitet 1945 - 1990. Shembujt dhe argumentet e mësipërme janë sinjifikative për të argumentuar praninë e këtyre lëvizjeve migruese të brendshme në kuadrin e karakteristikave të ndryshme që ato shfaqen, ashtu siç vlerësojmë edhe mungesën e pranisë së një eksperience me tipare e veçori specifike, ndikuese në zhvillimet e popullsisë, në kuadrin e migrimit të jashtëm.

Por situata në të cilën po zhvillohen lëvizjet migrative të popullsisë së vendit tonë në këto vitet e fundit dallojnë qartësisht nga disa tipare dhe karakteristika të veçanta, të cilat ndjejnë dhe kanë nevojën dhe domosdoshmërinë e analizës dhe studimit të detajuar të tyre. Një metodikë e tillë analize dhe studimi duhet të jetë urgjente, sepse në këtë emergjencë që paraqitet situata, do të ndikonte dukshëm edhe në krijimin e mundësive të ndryshme, me qëllim për të ndërhyrë me anë të politikave të veçanta migratore. Argumentet në këtë drejtim janë të shumta dhe të shumëllojshme, të cilat burojnë nga gjendja faktike migrative, efektet e shfaqura dhe problematikat bashkëshoqëruese. Le të shtjellojmë më poshtë, në mënyrë konkrete disa prej tyre, në mënyrë që trajtesa jonë drejt qasjes që duhet ofruar në këto momente të jetë e argumentuar. Ky është mendimi ynë duke qenë tërësisht të hapur ndaj debateve që shpalos situata migrative në Shqipëri.

Vlerësojmë çdo ditë e në vazhdim se mungesa e ndjeshmërisë për të reaguar konkretisht vetëm orienton qartësisht një rritje në vazhdimësi të treguesve negativë dhe problematikë mbi popullsinë e vendit tonë, duke krijuar edhe tendenca shqetësuese për të ardhmen. Të dhënat tregojnë në mënyrë koherente rritje të migrimit, kryesisht atij të jashtëm, ndryshime në strukturat migratore, në rritje të moshës mesatare të popullsisë, në efektet dhe impaktet sociale e ekonomike, në treguesit e shtesës natyrore, në depopullimin e territoreve, në mungesë e gjenerim problematikash në fuqinë punëtore e në tregun e punës etj. Vlen të përmendet edhe një realitet i ri, që gjithnjë e më shumë po vihen re nuanca imigratore të popullsisë mjaft të shprehura, ndonëse të lokalizuara apo të kufizuara, të cilat shumë shpejt duhet të merren në konsideratë duke u analizuar dhe përcaktuar rregulla e norma të qarta, lidhur ngusht me një politikë migratore

kombëtare. Evidentimi i tematikave të mësipërme, të pranishme në lëvizjet e popullsisë shqiptare në këtë periudhë janë tabloja e përgjithshme” sinoptike migrative” që ndjen nevojën e analizës dhe studimit të detajuar.

Destinacionet kryesore migratore, ku popullsia shqiptare orientohet për t’u vendosur, ato më të preferuarat për të, mbeten vendet kryesore të BE-së (Gjermania, Britania e Madhe, Franca etj). Por për të bërë të mundur një argumentim të nevojës për të ndërtuar politika migratore efikase, të drejtpërdrejta dhe me efekte reale, është e domosdoshme përcaktimi i karakteristikave themelore të situatës migratore në Shqipëri. Në mënyrë kronologjike po mungon një koordinim efikas aq i rëndësishëm ndërmjet studiuesve të fushës nga njëra anë dhe funksionit social të pushtetit nga ana tjetër. Një gjë e tillë çdo ditë e më tepër po sjell mosveprim, masa jo efikase apo sporadike, probleme serioze në tërësinë e treguesve që lidhen me zhvillimet aktuale dhe të ardhshme të popullsisë shqiptare.

Në vazhdimësi që nga viti 2011 e deri më tani, pavarësisht të dhënave të ndryshme statistikore zyrtare apo jo, vendase apo ndërkombëtare, institucionale apo të anketave e pyetësorëve të shumtë, evidentohet migrim i qytetarëve shqiptarë drejt vendeve të ndryshme të Evropës. Qartazi shihet se si destinacionet kryesore shfaqen (siç e theksuam më sipër) disa nga shtetet me të zhvilluara evropiane, siç janë (Gjermania, Franca, Britania e Madhe) dhe me pak disa prej vendeve të tjera të BE-së (vendet nordike, Austria). Mesa duket një gjë e tillë paraqitet e ndikuar nga fakti i zhvillimit të fuqishëm ekonomik që mbizotëron në këto shtete, mundësitë për punësim, pamundësia e realizimit të mbulimit me krahe pune të mjaft sektorëve të ekonomisë, zgjerimi i grupmoshave të treta në to, si dhe nevojës së shtuar të sektorëve të shërbimeve, pranisë së një oferte prezente tashmë e afirmuar nga vetë këto shtete ndaj një qasjeje ndryshe në politikat e tyre imigratore. Në këtë drejtim duhet përmendur rasti i Gjermanisë dhe Francës që me anë të ligjeve dhe vendimeve të posaçme kanë shprehur ofertën e tyre për fuqi punëtore ndaj imigrantëve. Në kuadrin e Ballkanit Perëndimor, shqiptarët, siç raportojnë shifrat, paraqiten ndër emigrantët e parë në këto shtete si azilkërkues e muajt e fundit në kuadrin e përfshirjes nga programet e ndryshme shtetërore të punësimit në këto vende.

Në një material shkencor të paraqitur pak kohë më parë në një revistë shkencore universitare, kam evidentuar ndër të tjera se “*Statistika të ndryshme evidentojnë në lëvizje migratore të tilla gjatë këtyre viteve të cilave u referohemi në analizën tonë (në 2011 janë larguar nga Shqipëria afro 55 162 persona, në vitin 2012 janë larguar nga vendi ynë afro 52 307 persona, në vitin 2013 largimi përfshin afro 49 425 persona të larguar, në*

vitin 2014 numri i personave të larguar arrin në afro 46 525, në vitin 2015 afro 41 443 persona të larguar, në vitin 2016 shifra e ofruar nga INSTAT shkon në rreth 32 532 persona dhe në vitin 2017 rezultojnë afro 39 905 persona të larguar nga vendi ynë”. (Akhemi, Sokol: Politikat mbi popullsinë në Shqipëri. Situata aktuale dhe tendencat. Buletini i USH-së 2018). Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë kronologjike ecurinë e largimeve nga Shqipëria drejt vendeve të ndryshme evropiane të popullsisë gjatë kësaj dekade të dytë të mijëvjeçarit të ri.

VITET	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Nr.i të larguarve	55,162	52,307	49,425	46,525	41,443	32,532	39,905	38,792	43,835

Tabela Nr.1 Numri i shqiptarëve të larguar nga vendi gjatë dekadës së fundit (2011 – 2019).

Institucionet e ndryshme statistikore ndërkombëtare, kryesisht ato evropiane shprehen edhe për një rritje në vazhdimësi të aplikimeve për azil nga shtetasit shqiptarë, të cilët vendosen në këto vende të BE-së. Kërkesat gjithnjë në rritje të këtyre aplikimeve janë tregues që konfirmojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe migrimin intensiv që po ndodh nga shqiptarët gjatë kësaj periudhe. Revista Monitor, ndër të tjera, në analizat e saj paraqet edhe një ecuri të numrit të aplikimeve për azil nga shqiptarët në periudhën 2011-2018. Ndërsa raportohet se për vitin 2019 numri ka tejkaluar 20 mijë persona.

VITET	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Nr.i aplikimeve	3,190	7,760	11,410	17,310	68,945	32,990	26,070	19,025

Tabela Nr.2 Numri i aplikimeve për azil të shqiptarëve në vendet e BE-së 2011-2019 (Revista Monitor, 14.03.2019).

Në vazhdimësi ndikuar nga kjo situatë migrative, por edhe nga faktorë të tjerë socialë, ekonomikë dhe politikë, po vihet re një zbrastje e mjaft zonave rurale, kryesisht periferike dhe e zonave urbane të vogla. Të dhënat janë shqetësuese për mjaft prej njësive administrative të Shkodrës, Dibrës, Pukës, Kukësit, Korçës, Gjirokastrës, Vlorës etj. Në mënyrë të shpejtë, por me trend të qëndrueshëm në vazhdimësi, popullsi lokale, individë dhe familje po largohen në mënyrë spontane, por edhe të organizuar drejt destinacioneve evropiane. Tashmë tendenca shihet qartë që nuk është më prezente ajo e migrimit të brendshëm drejt zonave urbane, apo kryeqytetit, por me intensitet dhe orientim të qartë drejt migrimit të jashtëm, kryesisht

në vendet evropiane. Mesa duket një rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka luajtur edhe lëvizja e lirë e njerëzve, në kuadër të përfshirjes në liberalizimin e vizave brenda zonës Shengen, që ka ndikuar edhe për një mundësi të tillë të ecurisë intensive të lëvizjes së popullsisë shqiptare. Ky argument shfaqet edhe nga klauzola e qëndrimit për një periudhë tremujore fillestare gjatë së cilës mjaft prej individëve apo familjeve të tëra, suportuar edhe nga migrimi zinxhir vendosen tek të afërm të tyre në mjaft prej vendeve të BE-së, duke synuar e tentuar vendosjen dhe “instalimin” përfundimtar të tyre si emigrantë. Një element tjetër favorizues është edhe kërkesa gjithnjë e në rritje e vendeve të ndryshme evropiane për punëtorë sezonalë, me kontrata kohore pune apo me kërkesa specifike profesionale, sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, kryesisht në fushën e shërbimeve apo profesioneve të veçanta. Shumë afektive paraqitet konkretisht, sidomos periudha 2017-2019 në këtë sens migrativ të sipërpërmendur.

Gjithnjë e më tepër po vihet re një imigracion interesant drejt vendit tonë nga grupe dhe kategori sociale të veçanta, por mjaft të larmishme nga pikëpamja e origjinës së tyre. Spikasin mjaft prej grupeve sociale të tillë si pensionistët (kryesisht italianë dhe në mënyrë më të kufizuar ato nordikë), grupe të veçanta emigrantësh klandestinë (sirianë, afganë, bangladeshas), si dhe kategori sociale të profesioneve të ndryshme dhe kombësive të ndryshme. Secili nga këto grupe e kategori sociale, gjithnjë e më tepër po e rrisin prezencën e tyre në hapësirën sociogjeografike të vendit tonë, si në numër ashtu edhe në kuadrin e shpërndarjes gjeografike. Prezencë e konsiderueshme e tyre vihet re në zonat urbane të Tiranës e Durrësit, por gjithnjë e më tepër ato po shfaqen ndonëse në mënyrë më të kufizuar edhe në Fier, Shkodër, Sarandë, rivierën shqiptare dhe në zonat turistike veriore të vendit (kryesisht në Valbonë, Kelmend) etj.

Ndër këto grupe sociale imigrantësh të vendosur në vendin tonë spikasin edhe ato të pensionistëve, kryesisht italianë dhe nordikë. Tërheqja e tyre dhe vendosja rezidenciale në Shqipëri është e lidhur ngusht me disa faktorë kryesorë. Ndër më të spikaturit shprehen qartazi për standardin e jetesës në vendin tonë, lidhur ngusht me shpenzimet që iu duhen për të realizuar sa më mirë opsionalitetin e jetës individuale ndikuar nga çmimet dhe nivelin e jetesës tek ne, në raport me ato të vendeve të tyre të origjinës. Vendosja e tyre më e shprehur dhe e konsoliduar është në Durrës, e cila është e shoqëruar me ndikimin e faktorit të dytë mjaft të qenësishëm për ta, që është klima e ngrohtë dhe deti, një mundësi favorizuese për një shëndet të mirë. Vleresojmë se disa nga këto grupe sociale imigrantësh pensionistësh italianë e nordikë, po e zgjerojnë jo vetëm numrin e tyre, por

edhe shpërndarjen gjeografike. Po vihen re tendenca të vendosjes së tyre edhe në Vlorë e Sarandë, ndikuar edhe nga prania e peizazheve turistike të vetë këtyre zonave “joshëse” të vendit tonë. Një gjë e tillë konfirmohet edhe nga agjencitë imobiliare të pranishme në këto njësi administrative.

VITET	2014	2015	2016	2017	2018
GJITHSEJ	9,091	10,563	12,519	12,906	14,162
EUROPA	6,668	7,562	8,324	7,637	8,212
AZIA	1,240	1,711	3,244	3,618	4,022
AFRIKA	932	991	225	341	494
AMERIKA	238	271	703	1,268	1,396
OQEANIA	13	28	23	42	38

Tabela 3. Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas vendit të origjinës, 2014-2018 (INSTAT 2019).

Një kategori sociale mjaft interesante, por e lidhur ngusht me globalizimin e ekonomisë është edhe prania në vendin tonë e mjaft profesionistëve të fushave të caktuara dhe të ardhurit për biznes në Shqipëri. Ndërsa të parët janë të pranishëm kryesisht si profesionistë të fushës në disa profesione të caktuara, si: mjekë, inxhinierë të IT, specialistë e teknologë të prodhimit në fushën e teknologjisë ushqimore, tekstileve e fasonerisë, TV etj., të dytët janë pjesë e fushës së bizneseve nga më të ndryshmet, që nga ndërtimtaria, kompanitë hoteliere e turistike, industrisë së lehtë e asaj ushqimore, minierave e energjisë etj. Gjenerimi në vazhdimësi i këtyre bizneseve është shoqëruar edhe me disa risi dhe tipare karakteristike. Ndër më kryesoret veçojmë rritjen e numrit të kësaj kategorie sociale imigrantësh, shpërndarjen gjeografike të tyre dhe zgjerimin e strukturës profesionale. Një gjë e tillë krijon një argument tjetër për nevojën dhe domosdoshmërinë për marrjen në konsideratë të përfshirjes së tyre në krijimin e modeleve dhe sjelljes zyrtare që një politikë migratore kombëtare duhet të përcaktojë, në kuadrin e rregullave dhe kriterëve që duhen vendosur.

VITET	2014	2015	2016	2017	2018
GJITHSEJ	100	100	100	100	100
EVROPA	73.3	71.6	66.5	59.2	58.0
AZIA	13.6	16.2	25.9	28.0	28.4
AFRIKA	10.3	9.4	1.8	2.6	3.5
AMERIKA	2.6	2.6	5.6	9.8	9.9
OQEANIA	0.1	0.3	0.2	0.3	0.3

Tabela 4. Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas vendit të origjinës në përqindje, 2014-2018 (INSTAT 2019).

Të dhëna interesante që duhen përdorur si argumente të rëndësishme drejt emergjencës për t'u marrë në konsideratë ndërtimi i politikave kombëtare migratore ofrojnë strukturat profesionale të popullsisë së vendit tonë. Mjaft profesionistë nga fusha e disa profesioneve të kërkuara sot në disa prej vendeve të BE-së, po bëhen subjekte të rëndësishme të lëvizjes migratore. Ofrimi nga këto vende i mundësisë së punësimit dhe stabilizimit të tyre edhe me norma të qarta juridike (siç është rasti i ndërhyrjeve legjislative nga ana e Gjermanisë) ka bërë të mundur orientimin e mundësisë për të migruar drejt këtyre vendeve të mjaft infermierëve e mjekëve, inxhinierëve, specialiteteve të larmishme të IT, punonjësve të kualifikuar të fushës së shërbimeve etj.

Ndërhyrja që duhet realizuar

Tërësia e analizës së paraqitur më sipër bart në vetvete mjaft argumente, të cilat duhet të merren në konsideratë për të bërë të mundur në mënyrë të menjëhershme realizimin e një seti të detajuar masash emergjente për të ndërhyrë. Ndërhyrja me anë të një dokumenti strategjik, nën termin e një pakti kombëtar për migrimin është mëse i domosdoshëm. Kjo lidhet sa me faktorët tradicionalë, shkencorë e të njohur, e po ashtu me shkaqe e faktorë lokalë. E këtu duhet të përfshijmë gjendjen ekonomike, nivelin e pagave e mirëqenien, varfërinë e pamundësinë për punësim, situatat sociale e politike, zhgënjimet e njëpasnjëshme e ngopjen me propagandë e “lugën bosh”. Është imperative që të gjitha palët politike të marrin përgjegjësinë e të mendojnë për këto zhvillime problematike që po kalon popullsia shqiptare, pavarësisht asaj se çfarë duam ne.

Autori i këtyre radhëve muaj më parë u mundua të sensibilizojë opinionin politik me anë të një të përditshmeje teksa evidentoi mundësinë dhe domosdoshmërinë e riaktivizimit të politikave mbi popullsinë. Diçka u bë, por shumë pak e deri e pandjeshme për të ndikuar në zhvillimet pronataliste të popullsisë së vendit tonë. Tashmë kemi ardhur në një urgjencë të ndërmarrjes së hapave të duhura dhe të menjëhershme për ta marrë me seriozitet një problem kaq madhor, siç është migracioni. Është jetike ndërtimi i një pakti kombëtar mbi migracionin, i cili duhet shoqëruar me matricat praktike përkatëse për zbatim. Në të kundërt ne do të numërojmë në vazhdimësi ikjet shqiptare, plakjen e saj, rënien e numrit të lindjeve, mungesën e specialistëve dhe të fuqisë punëtore në sektorë të ndryshëm.

Ky pakt kombëtar për migrimin duhet të analizojë me objektivitet situatën në të cilën ndodhet popullsia e vendit tonë, të na japë shifra të sakta dhe statistika serioze dhe jo të hallakatura për të justifikuar situatën

demografike, të evidentojë qartësisht faktorët ndikues dhe rrugën nëpër të cilën duhet të ecim me shpejtësi për të ndaluar avancimin e mëtejshëm të kësaj situatë, më pas të ndërhyhet me urgjence për të bërë rregullimet e duhura. Është e pafalshme që një vend me resurse të tilla natyrore të lëngojë në moskthimin e tyre në mundësi për zhvillimin e një mirëqeniejeje. Pothuajse të gjitha vendet e rajonit tejkalojnë vendin tonë në lidhje me indikatorët që evidentojnë nivelin e pagave, të ardhurat, mirëqenien, proporcionalitetin kontributiv në shërbime, jetese, mirëqenie etj.

Duke e marrë me seriozitet një situatë të tillë, duke vënë në qendër të vëmendjes, pikërisht ardhmërinë e vendit tonë, pakti kombëtar mbi migrimin, do të ndikojë që të lindin dhe aplikohen edhe politika të veçanta ndikuese për zhvillime pozitive të popullsisë së vendit tonë në të ardhmen. Aplikimi i politikave ekonomike, hapja e vendeve të reja të punës, përfshirja e grupeve sociale të rinjve në punësim, përfshirja e investimeve të qenësishme, suportimi dhe bashkëpunimi i sipërmarrjeve të mëdha të biznesit, rritja e pagave, rishikim i sistemit të taksave në funksion të gjenerimit të të ardhurave më produktive për shtresat e ndryshme të popullsisë, përfaqësojnë disa nga mundësitë që domosdoshmërisht duhet të merren në konsideratë nga ana e institucioneve që kanë për detyrë të qeverisin shqiptarët dhe të “mendojnë për mirëqenien e tyre”.

Në mënyrë të veçantë duhen ndërtuar politika sociale për të rinjtë, shtresat e mesme dhe profesionistët. Vërejmë rritjen e tendencës migratore të këtyre grupeve sociale të sipërpërmendura, gjë që shumë shpejt mund ta vendosë në pikëpyetje edhe mbulimin me teknikienë të aftë e të zotë të shumë profesioneve në vendin tonë për vitet e ardhshme. Nëpërmjet politikave të tilla, ndikimi do të jetë efektiv edhe në problematikat e tjera bashkëshoqëruese, siç janë ato të rënies drastike të lindshmërisë. Janë pikërisht këto largime të shumta të popullsisë riprodhuese një nga shkaktarët kryesorë që sot disa nga ndarjet administrative të vendit tonë nga pikëpamja statistikore na rezultojnë me shtesë natyrore negative, që do të thotë që numri i lindjeve ka rënë aq shumë sa që numri i vdekjeve është më i lartë se lindjet.

Samite të ndryshme evropiane dhe botërore po përfshijnë në mënyrë të qenësishme në fokuset e tyre trajtesat dhe analizat mbi zhvillimet e popullsisë sot dhe ndërmarrjen e politikave të larmishme ndaj problematikave që shfaq ajo. Mjaft prej këtyre samiteve kanë përfshirë në optikat e tyre edhe migrimin dhe politikat migratore. Pakti kombëtar mbi migrimin, që është i domosdoshëm të vihet në zbatim në vendin tonë, mund të gjenerojë mundësinë e pasjes në dizpozicion të eksperiencës së krijuar

nga vende të ndryshme të botës në situata të tilla, ndonëse kemi mendimin se tiparet dhe karakteristikat që po shfaq migrimi shqiptar në dekadën që lëmë pas janë specifike për vendin tonë.

Tërësia e çështjeve të ngritura më sipër duhet të na bëjë të gjithëve të përgjegjshëm për situatën në të cilën ndodhemi, prandaj edhe ndërhyrjet institucionale shtetërore duhet të jenë urgjente dhe efikase. Nëse veprohet shpejt dhe me efikasitet, me programe të qarta e politika konkrete, të gjithë bashkë, pushtetarë, studiues, të gjithë ata, që duan të mirën e këtij vendi dhe ardhmërinë e tij, mund të ndikojnë drejt zhvillimeve pozitive në drejtim të politikave mbi popullsinë dhe veçanërisht mbi migrimin.

KONKLUZIONE

Paraqitja e ideve dhe argumenteve nga ana jonë për domosdoshmërinë e ndërmarrjes së politikave migratore në materialin e mësipërm është një mundësi dhe propozim, që tentojmë të japim për marrjen në konsideratë, sa më shpejt të një situatë të tillë migrative të pranishme në vendin tonë. Në lidhje të ngushtë me atë se çfarë trajtuam është e rëndësishme edhe dhënia e disa konkluzioneve, ndër të cilat mund të veçojmë, si më kryesoret:

- Ndërmarrjen e një studimi interdisiplinar mbi situatën migrative në Shqipëri, në të cilën të përcaktohen qartë gjendja, statistikat e të dhënat, motivet, shpërndarja gjeografike.
- Evidentimin e tendencës migrative të popullsisë së vendit tonë, problematikat me të cilat shoqërohet dhe impaktet përkatëse.
- Analizën e situatës imigrative, tendencat e këtij fenomeni, shpërndarjen gjeografike, impaktet e ndryshme bashkëshoqëruese.
- Masat që duhet të merren në këtë drejtim, nën të ashtuquaturën 'Politika kombëtare migratore', të cilat të bëjnë të mundur matrica përkatëse konkrete që të orientojnë zhvillime të rëndësishme pozitive për popullsinë e vendit tonë.

LITERATURA

- Axhemi, Sokol (2020): Nevoja e një pakti kombëtar për migrimin. *Gazeta Panorama*, 28 janar.
- Axhemi, Sokol (2018): Politikat mbi popullsinë në Shqipëri. Situata aktuale dhe tendencat. Buletini i USH-së.
- Ikonimi, Luljeta (2009): E drejta migratore. Manual trajnues. Botim, Tiranë Grup autorësh. Profili i emigracionit në Shqipëri. Botim I Mb, Tiranë, 2017.
- INSTAT Publikime mbi të huajt në Shqipëri 2019.
- I O M Essentials on Migration Management, a Guide for Policy Makers and Practitioners”, Vëllimi I, Seksioni 1.6,2004
- Revista Monitor 19 mijë shqiptarë aplikuan për azil në BE në 2018, të parët në botë në raport me numrin e popullsisë. 14 mars 2019.
- Syri. Net Emigracioni masiv; Shqipëria pakësohet me 16 mijë persona. 26.03.2020

**Urgent approach to undertaking national migration policies.
Ideas and arguments**

ABSTRACT

The issue of population migration is very evident in our country as well. Public opinion is now increasingly being sensitized by various data or information on current developments in the Albanian population. Projections of international institutions, different demographic statistics have made it possible to carry out and record the analyzes of researchers in different fields, who are maximally assessing the situation regarding the developments of the Albanian population. In many cases we even notice that representatives of the social function of power are becoming increasingly sensitive in this regard. What is realistic and quite obvious is that the population of our country is getting more and more people, every day and night, every month and every year.

In this respect, with the obligation and concern to orient particular policies to the present situation, we attempt to outline the necessity of intervening with a specific population policy set. Alongside it we express the need and necessity of approaching the social function of power, for a reconciliation, contract, political agreement of all parties, to move towards a national pact on migration. This scientific paper encompasses two fundamental issues in its structure: the arguments for the urgent need and

necessity for undertaking migration policy and our views on the intervention to be undertaken. At the same time, the permanent work along with the detailed analysis also provides some concrete information tables on migration. The author concludes with some conclusions.

Mimoza PRIKU

RECENSION

Dy fjalë mbi përmbledhjen me studime “Gjurmime filologjike mbi latinitetin dhe shkrimet e vjetra shqipe” të prof. as. dr. Evalda Pacit, kërkuese shkencore mbi letërsinë e vjetër shqipe në Akademinë e Studimeve Albanologjike, Tiranë

(Paraqitur për diskutim pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”)

Autorja Evalda Paci ka përmbledhur disa kontribute të realizuara në vitet e fundit të kërkimeve të saj në dy fusha të rëndësishme studimore, që kanë të bëjnë si me gjurmime mbi latinitetin dhe çështje të mësimdhënies së gjuhës latine në nivele universitare dhe pasuniversitare, ashtu dhe me shkrimet e vjetra shqipe, në veçanti me disa vepra që prej vitesh janë objekt i punës së saj studimore. Siç e thekson edhe vetë autorja në parathënien me të cilën është paraprirë shtjellimi i kësaj lënde, një pjesë e mirë e këtyre kontributeve është përvijuar në proces të angazhimit të saj me mësimdhënien e gjuhës latine në degë të veçanta studimi në Universitetin e Shkodrës, një përvojë që ajo është përpjekur ta konkretizojë dhe në pasqyrimin e shkrimeve konkrete që janë vendosur në pjesën e parë të kësaj lënde. Janë trajtuar kësaj punime që të botuara në dekadat e para të shekullit të kaluar dhe të paracaktuara për një përdorim funksional në nivele shkollore në arsimin shqiptar të kohës, ruajnë dhe në ditët e sotme vlerën e doracakëve që i shërbejnë më së miri gramatologut, mësimdhënësit të gjuhës e të kulturës latine në universitetet shqiptare, studiuesit që kërkon të rindërtojë një panoramë diakronike në drejtim të studimeve që janë përpiluar në kohë në lidhje me studimet mbi latinitetin dhe pasqyrimin e tij në shkollat tona në vitet e kaluara. Një synim i tillë është konkretizuar në disa shkrime të kësaj përmbledhjeje, duke u shtrirë dhe në një trajtesë që ka objekt të vetin përkthimet e klasikëve nga bota greke e romake në të

përkohshme kulturore të kohës, pikërisht në një kohë të përafërt me botimin e gramatikave latine të ndërmendura në shkrimet e mëparshme të cituara. Një linjë e tillë studimi është ndjekur nga autorja dhe vite më parë, duke u konkretizuar në kontribute që kanë parë dritën e botimit dhe në revista shkencore të botuara jashtë Shqipërie, apo dhe në botime në grupe autorësh që kanë pasur të njëjtën tematikë studimi. Elementet latine dhe latino-romane që bëjnë të mundur që të qasen mes tyre kultura dhe gjuhë të afërta në disa pikëpamje, qofshin dhe gjeografike janë trajtuar në një syth më vete të kësaj përmbledhjeje, duke bërë të mundur të rimerren dhe kontribute themelore në fushë të studimit të gjuhësisë së krahasuar dhe asaj romane. Kjo e fundit bëhet natyrshëm objekt studimi në këtë shkrim të autores duke qenë rumanishtja një gjuhë neolatine e përvijuar në një substrat të veçantë në shumë pikëpamje e që ka bërë të mundur realizimin e mjaft kontributeve që kanë përfshirë siç e dimë dhe albanologë e ballkanologë të mirënjohur, jo vetëm latinistë dhe studiues të gjuhësisë e të filologjisë romane.¹

Gjurmimet mbi autorë të letërsisë së vjetër shqipe janë prej vitesh objekt i kërkimeve të autores Evalda Paci, që ka parë të arsyeshme të bëjë pjesë të kësaj lënde dhe disa kontribute që kanë në qendër të vëmendjes si letërsinë e vjetër shqipe si objekt i studimeve ndërdisiplinore, ashtu dhe vepra të veçanta që kanë tërhequr me vite vëmendjen e gjurmuesve të filologjisë së tekstit dhe të kësaj periudhe të veçantë të zhvillimit të shkrimit shqip. Një vepër komplekse në shumë pikëpamje mbetet *Meshari* i Gjon Buzikut, i njohur për natyrën aspak të thjeshtë të ndërtimit dhe të përmbajtjes, që ka bërë të mundur të kërkohet gjatë si për mundësinë e gjetjes së ekzemplarëve të ngjashëm me të, si për modele të arsyetimit të lëndës që përmbahet në të. Mbetet kjo e sipërcituara një pistë përherë për t'u ndjekur dhe nga autorja, duke qenë për t'u sqaruar dhe mundësia e ekzistencës së një ekzemplari të vetëm për një vepër kaq unike, si libri i Gjon Buzikut. Ky libër është një pikënisje për shumë studime e vëzhgime, ndër të cilat linja e qasjes me të tjera vepra të së njëjtës traditë është ndër më të rëndësishmet dhe më frytdhënëset për shumë drejtime studimi. Një

¹ Shih dhe kontributin përkatës mbi këtë argument të autores E. Paci në vëllimin me titull *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit (Albanian and Balkan languages)*, botim i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, si akte të konferencës shkencore ndërkombëtare të mbajtur në nëntor të vitit 2011, f. 341 - 355.

linjë e tillë pasqyrohet dhe në një nga kontributet që përmbahen në këtë përmbledhje e që ka të bëjë me leksikun e liturgjisë në veprat e letërsisë së vjetër shqipe, me vëmendje të përqendruar te përdorimi sintetik *Zotynë* e te pasqyrimi i tij në këto vepra (shih dhe artikullin përkatës të Pacit në *Hylli i Dritës*, n. 3-4, 2014, f. 129-139). Ky studim më vete i autores, i rimarrë dhe në vijimësi në gjurmime të mëtejshme të saj, ka qëllim të nëvizojë dhe rëndësinë që paraqet dhe në ditët e sotme gjurmimi tekstologjik në lidhje me përdorime të veçanta në veprat e letërsisë së vjetër shqipe. Qasen mes tyre autorë si Gjon Buzuku dhe Pjetër Bogdani, ky i fundit dhe në optikën e një vështrimi të vëmendshëm që bën të mundur të vlerësohet sërish larmia e përdorimeve në fushë të liturgjisë dhe të leksikut të teologjisë së krishterë.

Kontribute që kanë objekt të vetin vështrimin tekstologjik në lidhje me pjesë të veçanta të librit të Gjon Buzukut dhe në veçanti një element mjaft domethënës për studimet në lidhje me të si *kolofo*ni apo pasthënia janë vendosur në pjesën e fundit të përmbledhjes, duke pasuar njëri-tjetrit në pikëpamje vijimësie. Është treguar vëmendje si ndaj faktit që duhej paraqitur vijimësia e gjurmimeve në lidhje me këtë argument, bashkë me terminologjinë përkatëse që e karakterizon atë nga një studiues në tjetrit, ashtu dhe ndonjë vërejtje mbi elemente të veçanta të përmbajtjes së kësaj pjese përmyllëse të librit të Gjon Buzukut.

Autorja ka përfshirë si kontribut më vete dhe një trajtesë të zgjeruar mbi mbiemrin e panyjshëm në këtë libër, duke u përpjekur dhe të realizojë qasje me ndonjë realizim të mëvonë në kohë në të cilin dhe pasqyrohen gjedhe më të veçanta të përdorimit të mbiemrit të panyjshëm në gjuhën shqipe e më në veçanti në vepra me referencë të qartë ndaj tekstit biblik dhe atij liturgjik. Mbiemri i panyjshëm mbetet një klasë që mund të trajtohet akoma më gjerësisht në studimet tona, në veçanti të morfologjisë historike të shqipes, por dhe aspekti semantik në ndonjë rast është një tjetër drejtim në të cilin mund të kryhen vëzhgime. Vëmendjen ndaj kësaj kategorie të rëndësishme jo vetëm morfologjike kolegja Paci e ka dëshmuar në artikuj të veçantë të botuar në *Hylli i Dritës* (n. 1, 2010), por edhe me një punim monografik të përqendruar pikërisht mbi probleme të gjurmimit në disa aspekte të klasave mbiemërore në shqipen e vjetër e më konkretisht në *Mesharin* e Gjon Buzukut (Evalda Paci: *Sistemi mbiemëror në Mesharin e Gjon Buzukut*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011).

Aparati bibliografik që lidhet me këtë lëndë të trajtuar bën të mundur të ricitohen dhe kontribute në fushë të filologjisë së tekstit dhe, në veçanti, të filologjisë së studimit të tekstit biblik në shqipe dhe në gjuhë të tjera.

Përgëzojmë autoren për iniciativën e botimit të kësaj lënde studimore dhe i urojmë suksese në realizimin me sukses të saj.

Prof. dr. Mimoza Priku

NEKROLOGJI

Më 13 janar të këtij viti u nda nga jeta prof. dr. David Luka. U lind në qytetin e Shkodrës, më 1935, kreu shkollën pedagogjike në qytetin e



lindjes, ndërsa studimet e larta i përfundoi në Universitetin e Tiranës, dega gjuhë-letërsi. Shërbeu si mësues nga Tepelena, në Kukës e së fundi në Shkodër. Pas ndryshimeve politike të viteve '90, prof. D. Luka qe kryeredaktori i parë i gazetës “Shkodra”, gazeta e parë opozitare në vitin 1991, pas gazetës “Rilindja Demokratike”. Drejtor i Radio

Shkodrës për disa vite, pas vitit 1992 e më pas edhe pedagog i gjuhës shqipe në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. La pas shumë vepra e shkrime, kryesisht në fushën e gjuhësisë historike.

Korpusi i veprës së tij, i shtrirë në një periudhë 48-vjeçare (1972-2018) përfshin një punë mbi 5000 faqe, ku mund të përmenden njëzet vëllimet “Studime gjuhësore”, 130 artikuj në revista të ndryshme shkencore, brenda dhe jashtë vendit, autor i disa teksteve universitare, si : “Fonetika historike e gjuhës shqipe”, “Historia e albanologjisë” dhe “Studime për historinë e gjuhës shqipe”. Studimet e D. Lukës mund t’i ndajmë në dy drejtime, së pari në fushën e gjuhësisë historike dhe së dyti, në politikën gjuhësore. Vetë studimet e tij në gjuhësinë historike mund t’i ndajmë sipas këtyre disiplinave: etimologji, fonetikë e gramatikë historike, histori e gjuhës shqipe dhe leksikografi historike. Etimologjia ka qenë një prej fushave të preferuara të tij, punimet në këtë fushë përfshijnë rreth 2000 faqe dhe paraqesin jo vetëm analiza gjuhësore në kërkim të burimit të fjalës, por mbi të gjitha një metodologji të re, duke shtuar kështu jo vetëm kontributin në rritjen e numrit të fjalëve të analizuara (saktësisht janë marrë në shqyrtim 3656 fjalë), por duke dhënë një metodë shkencore të kohës. Prof. David Luka është dhe një prej emrave më në zë në fushën e studimeve të fonetikës historike. Studimet e tij (25 të tilla në këtë disiplinë) mbi theksin, apofoninë, metafoninë në gjuhën shqipe, si dhe mbi mjaft dukuri të tjera të


lidhura me vokalizmin dhe sistemin bashkëtingëllor të gjuhës sonë. Vepra gjuhësore e prof. David Lukës është një prej arritjeve dinjitoze në fushën e studimeve albanologjike në përgjithësi dhe të gjuhësisë historike në veçanti gjatë në tri dekadat e fundit.

Dr. Erzen Koperaj

BOTIME


Osmani, Tomor

Gramatika të gjuhës shqipe : refleksione. Shkodër : Botimet Shkodra, 2020. 296 f.; 21 cm. (Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Qendra e Studimeve Albanologjike) ISBN 978-9928-4569-3-9




Kosteri, Anisa

Leksiku i pasur në fjalorin e Bashkimit : monografi. Shkodër : Botimet Shkodra, 2020. 218 f.: 21 cm. (Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Qendra e Studimeve Albanologjike), ISBN 978-9928-4569-5-3




Çapaliku, Alfred

Penda të traditës : studime letrare / Alfred Çapaliku ; red. shkenc. Artan Haxhi ; lektore Ermira Alija, Isida Hoxha. – Shkodër : Shkodra, 2020, 168. f. : me foto ; 21 cm. ISBN 978-9928-4628-4-8



Kolë Ashta dhe studimet albanologjike ndër vite. Shkodër : Universiteti “Luigj Gurakuqi”, 2020. 268 f.; 20 cm. (Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Fakulteti i Shkencave Shoqërore. Qendra e Studimeve Albanologjike), (Studime shqiptare 30), ISBN 978- 9928-4341-7-3



ISSN 2221 - 6855

***Doli nga shtypi prill 2021 – tirazhi 120 kopje – Formati 176 x250 mm. Shtypur
në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”***